



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 16 DHE 22 NËNTOR 2012**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 16. I 22. NOVEMBRA 2012. GODINE**

**NËNTOR - NOVEMBAR
2012**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Informimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës nga kryeministri i Kosovës, z. Hashim Thaçi, për takimin e dytë të zhvilluar në Bruksel me kryeministrin e Serbisë,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ansamblin kombëtar të këngëve dhe valleve “Shota” dhe për ansamblet tjera,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës,
8. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mallrat e liruar nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor dhe
10. Shqyrtimi i raportit të tretë për zbatimin e Planit të Veprimit të Kuvendit të Kosovës për integritet evropian për vitin 2012

Dnevni red

1. Vreme za izjašnjavanje izvan dnevnog reda,
2. Informisanje Skupštine Republike Kosova od strane Premijera Kosova, g. Hashim Thaçi, održanom u drugom susretu u Briselu sa premijerom Srbije,
3. Prvo razmatranje Nacrta zakona o izvršenju krivičnih sankcija,
4. Prvo razmatranje Nacrta zakona za bezednost i zdravlje na radu,
5. Prvo razmatranje Nacrta zakona o Nacionalnom ansamblu pesama i igara “Shota” i drugih ansambla,
6. Prvo razmatranje Nacrta zakona o izmenama i dopunama Zakona o Kosovskoj akademiji nauka i umetnosti,
7. Drugo razmatranje Nacrta zakona o davanju na korišćenje i razmenjivanje opštinske nepokretne imovine,
8. Formiranje ad hoc Komisije o izboru članova Nezavisne komisije za medije,
9. Prvo razmatranje Nacrta zakona o robama, oslobođenim od carinskog poreza i robama sa nula carinskim porezom,
10. Razmatranje Trećeg izveštaja o sprovođenju Plana delovanja Skupštine Kosova za evropske integracije 2012. god.

Seancën e drejtoi kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Zëvendëskryeministër,

I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Pika e parë e rendit të ditës:

1. Deklarime jashtë rendit të ditës

Fjalën e ka deputeti Nait Hasani.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për ministrat,

Unë kam një kërkesë për Kryesinë e Kuvendit.

Tani jemi në muajin nëntor, në përvjetorin e pavarësisë së shqiptarëve dhe të shtetit shqiptar, kërkoj nga Kryesia e Kuvendit dhe nga institucionet ta bëjnë në mënyrë të organizuar këtë manifestim, ta bëjmë në mënyrë të organizuar edhe shkuarjen në Vlorë, që deputetët të mos shkojnë veç e veç, por të shkojnë të organizuar, ta kenë vendin e merituar si deputetë, si Kuvend i Kosovës dhe ta ndiejnë veten përgjegjës, pikërisht për atë pjesëmarrje, sepse është një njëqindvjetor. Besoj që prej këtyre deputetëve, asnjëri më nuk do ta presë njëqindvjetorin tjetër, po do të jetë pjesë e këtij njëqindvjetori.

Dhe, kërkoj që të jemi pjesëmarrës të atij manifestimi jubilar të njëqindvjetorit të Shqipërisë, si deputetë në mënyrë të organizuar, prandaj, kërkesa ime është që Kryesia e Kuvendit, ta organizojë këtë, ta marrë përgjegjësinë dhe organizimin.

Ndërsa, kërkoj po ashtu nga deputetët, që ta mbështesin si kërkesë, që të jemi pjesë e këtij manifestimi njëqindvjeçar.

KRYETARI: Faleminderit! Unë jam i obliguar të ju njoftoj se organizimet rreth njëqindvjetorit i bën shteti i Shqipërisë dhe ata kanë dërguar ftesa dhe ne i përgjigjemi protokollit të Republikës së Shqipërisë. Ne nuk bëjmë protokoll të veçantë për këtë çështje.

Fjalën e ka deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Kabinet qeveritar,

Kolegë të nderuar deputetë,

Edhe pse në këtë kohë, fatkeqësisht transmetimi nuk është drejtpërdrejt, sepse është hera e tretë ose e katërt me radhë që kur Kuvendi ka tema të rëndësishme, këtë pjesë ndahet

për Qeverinë dhe kjo tregon edhe njëfarë kontrolli mbi Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Kolegë deputetë, “përçaj e sundo” - është motoja më e preferuar e komunistëve. Komunizmin, njësoj si fashizmin, harmonia ndërnjerëzore dhe bashkimi i tmerron. Këto dy sisteme nuk duan t’i shohin as dy veta bashkë. Pikërisht, këta lloj njerëzish edhe sot deklarojnë që pjesëtarët e FARK-ut që luftuan me emblemën e UÇK-së, nuk do të pajisen me librezë të veteranëve të luftës së lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Shqiptarët sot tmerrohen dhe turpërohen për falsifikimin e historisë së kohës së re dhe më të re të tyre. Prandaj, unë sot i njoftoj të gjithë ata që më janë drejtuar këto dy ditë me shqetësim, që në Komisionin Qeveritar është edhe përfaqësuesi i Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Kosovës dhe kjo e drejtë sublime, për të gjithë ata që kanë marrë pjesë në luftë, si e drejtë e juaja e garantuar edhe me ligj, për kontributin e dhënë për çlirimin e vendit, ju takon.

Fatmirësisht, sot i gjithë populli e di dhe krenohet se lufta e lavdishme e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nuk identifikohet me tipat e Muharrem Xhemailit, si profiterë të pasluftës. Faleminderit!

KRYETARI: Duam ta shndërrojmë në Institut të Historisë, Parlamentin. Fjalën e ka deputeti Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Sipas deklarimeve të mbrojtjes së shtetases gjermane Natalija Velijaj, transferi i parave në skandalin prej 1,4 milionësh të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ishte bërë sipas kërkesës së kompanisë austriake. Pra, Ministria i ka kaluar paratë kompanisë së Natalisë, ndërsa kompania austriake i ka dërguar me shkrim se ku t’i shpërndajë paratë.

Deri në momentin, që ky fakt nuk ka dalë në media, asnjë problem nuk ka pasur midis kompanisë dhe Ministrisë. Me të dalë në media afera, kompania ka filluar presionin mbi Ministrinë e Punëve të Brendshme, sepse kompania austriake ende nuk i kishte marrë paratë, pagesën e plotë, që parashikonte nga i gjithë tenderi. Pra, nuk i ka marrë 14 milionë.

Me daljen në media, presupozimi i kompanisë ka qenë se do të anulohet kontrata dhe nuk do t’i marrë fare paratë.

Paratë janë paguar nga MPB-ja, por një prej këtyre kësteve nuk e ka arritur destinacionin. Ky këst është saktësisht 10% e kontratës së nënshkruar për shtypjen e pasaportave. Është e pamundshme të besohet se kjo është e rastësishme, e aq më vështirë është të besohet se Bajram Rexhepi nuk ka qenë në dijeni për këtë.

A ka mundësi që procedura për një tender prej 14 milionësh të përfundojë dhe të nënshkruhet kontrata, pa qenë i informuar ministri? Sepse, është dëshmuar tashmë, se

këtyre nuk u ikën as punësimi i një nëpunësi nëpër ministrinë a agjenci shtetërore, e lëre më tenderët milionësh.

Po, edhe një pyetje shkon për Bajram Rexhepin, këtu. Ku i ka ky ministër njësitet e inteligjencës që i përmend kaq shpesh për të arsytuar dhunën e policisë në protestat e “Vetëvendosjes”? Pra, pse ky njësit i inteligjencës nuk e informoi Bajram Rexhepin për këtë skandal, para se të dalë në media?

Auditori i Përgjithshëm, në raportin e tij për MPB-në në vitin 2011, në faqe 15 konkludon se në momentin kur kompania austriake e ka fituar tenderin, nuk ka pasur përfaqësues vendor. Pra, po lexoj nga raporti, thotë: “Në pajtim me kontratën, operatori ekonomik me të cilin MPB-ja ka arritur marrëveshje, apo ka nënshkruar kontratë në lidhje me furnizimin me pajisje për punimin e pasaportave biometrikë, duhet të regjistrohet në regjistrin e shoqërive tregtare dhe emrave tregtarë të Kosovës, brenda një afati të arsyeshëm.”.

Te kontrata në fjalë, kompania OESD nuk u është përmbajtur kushteve të kontratës, përkatësisht nuk ka arritur ta kompletojë dokumentacionin për themelimin e njësisë së saj, deri më 27 shtator të vitit 2011. Rrjedhimisht, pajisjet që kanë ardhur për shtypjen e pasaportave, është dashur që të figurojë MPB-ja si importues, për shkak se kjo kompani nuk ka pasur të drejtë të bëjë import në Kosovë, meqenëse s’ka qenë e regjistruar në import.

Pra, Ministria e Punëve të Brendshme ka qenë e përfshirë drejtpërdrejt në këtë kontratë dhe në këtë aferë, për shkak se madje ka pranuar që të shërbejë edhe si importues për këtë kompani, e cila i ka shtypur pasaportat. Dhe, prapë Bajram Rexhepi na thotë se ‘unë nuk kam ditur gjë’.

Bajram Rexhepi, dje po ashtu na tha, se në momentin kur e ka kuptuar se çfarë ka ndodhur ka insistuar që të nisin hetimet dhe se është duke i përcjell me vëmendje dhe aktivisht zhvillimet në këtë çështje. Për shembull, kaq i vëmendshëm është Bajram Rexhepi, sa që sot ai ka udhëtuar në Vjenë, për t’u takuar me përfaqësuesit e kompanisë austriake “Oesterreichische Staatdruckerei”.

Ai duhet t’u tregojë qytetarëve të Kosovës dhe Kuvendit, se për çfarë po takohet tash me kompaninë austriake, e cila dyshohet të jetë përfshirë në aferë. Pse bash tash kur kjo aferë e mori dhenë? Pra, çka u bë, a nuk po shtypen pasaportat mirë, që ka shkuar të shohë procesin, apo pse ka shkuar Bajram Rexhepi në Vjenë sot? Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Burim Ramadani.

BURIM RAMADANI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuara deputete,

Të nderuar deputetë,

Skandalet në Ministrinë e Punëve të Brendshme, po vazhdojnë me radhë dhe ky nuk është vetëm një skandal, që e përmendi zoti Ymeri dhe mediet në tërësi, por skandali

tjetër është po ashtu, edhe ajo që po ngjan në Inspektoratin Policor të Kosovës, ku pas asaj buje të madhe që u bë për konfiskimin e një sasi të madhe të arit, që dyshohet që është vjedhur në Pejë, tashmë ajo sasi rreth 40 kg e arit po mbahet në zyrat e Inspektoratit Policor të Kosovës, përkundër ose duke shkelur të gjitha ligjet që e përcaktojnë se ku mbahen mallrat e konfiskuara, në këtë rast ari i konfiskuar.

Kjo është konfirmuar dje edhe nga ministri i Punëve të Brendshme, Bajram Rexhepi, gjegjësisht është konfirmuar edhe njëherë shkelja e ligjit në këtë pjesë. Dhe, më lejoni që të ngrit këtë shqetësim dhe këtë paralajmërim të rrezikut, sepse jo vetëm që po shkelet ligji, por po ashtu, rrezikohet që kjo sasi e arit sërish të humb dika, sepse Inspektorati Policor i Kosovës nuk e ka asnjë lloj infrastrukture të sigurisë dhe as infrastrukturë ligjore për t'i mbajtur apo ruajtur mallrat e konfiskuara.

Nëse hetimet janë duke u bërë për këtë çështje, atëherë hetimet mund të vazhdojnë shumë gjatë, mund të vazhdojnë deri në dy vjet dhe Inspektorati Policor i Kosovës nuk ka infrastrukturë të sigurisë, që ta ruajë mallin e konfiskuar as edhe për një ditë. Prandaj, vërtet ky veprim i Inspektoratit dhe kryeshefit të Inspektoratit Policor, po e sjell këtë inspektorat në një rol, si polici mbi policinë dhe kjo është definitivisht devijim i madh i konceptit të Inspektoratit Policor të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Nijazi Idrizi.

NIJAZI IDRIZI: Faleminderit!

I nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Fjalën time dëshiroj ta bazoj në takimin e djeshëm që e kishim këtu e që u bë debat lidhur me Buxhetin e Kosovës.

Dëshiroj ta theksoj faktin se Kosova është vend demokratik, i rregulluar në bazë të standardeve të Bashkimit Evropian, vend i ndarë me tri pushtete: pushtetin legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor, në të cilat pushtete rolet dhe përgjegjësitë e secilit pushtet janë të ndara me Kushtetutë dhe ligjet në fuqi.

Po ashtu, dëshiroj ta theksoj faktin që këto role dhe këto përgjegjësi i kanë bartësit e vet të cilët duhet t'i zbatojnë ato nëpër vendet e tyre. Dje, sikur kjo gjë nuk u mor parasysh dhe ne kaluam nga një rol në tjetrin, duke bërë shkelje të ligjeve dhe Kushtetutës.

Debati i djeshëm do të duhej të ishte për planin për buxhetin, për planifikimet buxhetore të komunave dhe të Kosovës, përgjithësisht, por aty ai nuk shkoi. Për fat të keq, këtu pati, u luajt, u bënë politika lagjesh, politika fshatrash, të cilat politika një pjesë e deputetëve është shndërruar në zëdhënës të komunave. Dy pushtetet ekzekutive do të ishte mirë, që fjalët, debatin e tyre rreth zhvillimit të Kosovës, ta bazojnë në nevojat e qytetarëve të vet dhe projektet e tyre duhet t'i çojnë deri te implementimi duke i argumentuar sipas prioritetëve. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Haki Demolli e ka fjalën, në emër të Grupit.

HAKI DEMOLLI: I nderuar kryetar i Kuvendit,
Të nderuar ministra të Kabinetit qeveritar,
Të nderuar deputetë të Kuvendit,
Me dorëheqje të anëtarit të Kabinetit Qeveritar, nënkuptohet e drejta e zëvendëskryeministrit, ministrit dhe zëvendësministrit, që të heqë dorë nga ushtrimi i funksionit, për të cilin është zgjedhur apo emëruar.

Dorëheqja e qeveritarëve si një akt moral, mund të paraqitet për shkaqe dhe arsye të ndryshme. Në shtetet ku sundon rendi dhe ligji dhe ku organet shtetërore vërtet zgjidhen me mjete dhe procedura demokratike, qeveritarët e tyre në shenjë të respektimit të parimeve themelore demokratike, madje edhe për gafet dhe lëshimet më të vogla, që herë-herë nuk kanë të bëjnë fare me funksionin dhe përgjegjësinë e tyre, apo madje edhe për gabimet e të tjerëve, janë të gatshëm dhe paraqesin dorëheqjet nga funksionet e tyre.

Për të ilustruar atë që theksova më lart, do të përmend disa prej dorëheqjeve dhe shkaqet e tyre në vende të ndryshme të Evropës. Kështu, do të filloja nga rasti i kryetarit të Hungarisë, Pal Shmit, i cili gjatë këtij viti ka paraqitur dorëheqje nga posti i kryetarit të shtetit, sepse iu ka marrë titulli i doktorit të shkencave për shkak të plagjiaturës.

Në shtator të këtij viti, ministri i Punëve të Brendshme të Gjeorgjisë, Baço Allaja, ka paraqitur dorëheqjen e tij pas publikimit të video-incizimit, në të cilin shihet keqtrajtimi dhe torturimi i të burgosurve. Ministri në dorëheqje, ndër të tjera ka theksuar: “Ndiej përgjegjësi morale dhe politike, sepse nuk ia kemi dalë ta çrrënjosim torturimin.”

Gjatë tetorit të fundit, ministri çek i Punës, Jaromir Drabek, ka paraqitur dorëheqje për shkak të arrestimit të zëvendësministrit të tij për mito. Ministri Drabek, në dorëheqjen e tij ka thënë: “Nuk ndiej kurrfarë fajësie, por jam i gatshëm për të bartur përgjegjësi politike”. Edhe kryetari gjerman ka paraqitur dorëheqje për shkak të dyshimit se ka realizuar përfitime pasurore duke marrë kredi private nga miqtë e tij të pasur për blerjen e shtëpisë private.

Në tetor të këtij viti edhe ministri i Drejtësisë japoneze, Keisu Tanaka, ka paraqitur dorëheqje, për shkak të dyshimit se në të kaluarën ka qenë i lidhur me krimin e organizuar dhe Jakuzat mafioze.

A thua, qeveritarët tonë e njohin institucionin e dorëheqjes dhe a mund të paramendohet një akt i tillë i tyre? Përgjigjja thjesht është, jo. Sepse, një veprim të tillë të tyre nuk e kemi parë edhe përkundër faktit se kemi hetime penale ndaj ministrave, zëvendësministrave, sekretarëve të ministrive, edhe përkundër faktit se ka afëra të keqpërdorimeve dhe të mitos, afëra të vjedhjes së arit e të drogës, lidhje me krimin e organizuar aktual, por edhe në të kaluar, keqtrajttime dhe cenime të të drejtave të qytetarëve, shkollim dhe diploma e doktorate me rënie të lirë, asnjëri prej tyre nuk e pa të arsyeshme dhe të rrugës, për të paraqitur dorëheqje, si një akt moral për të bartur përgjegjësinë politike për lëshimet e shumta që janë bërë gjatë qeverisjes së këtij vendi.

Në fund do të thosha, rastet dhe praktikat e theksuara të zyrtarëve të shteteve të tjera dhe vetë ky deklaram imi si deputet, le të shërbejë si një trokitje në ndërgjegjen e tyre. Faleminderit!

KRYETARI: Shkoftë në veshin e duhur! Fjalën e ka deputeti Arsim Bajrami.

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, zoti kryetar!

Ajo për çka unë do të angazhohem, ka të bëjë ruajtjen e kredibilitetit kushtetues dhe institucional të Kuvendit dhe ruajtjen e kredibilitetit të institucionit të deputetit, sepse në sondazhet që po i vijnë dhe po i përcjellim, po shihet se kredibiliteti dhe autoriteti i deputetit dhe i Parlamentit është në rënie e sipër. Dhe, unë mendoj se kjo është rezultat i faktit, se jo rrallë ky Kuvend dhe sidomos, deputetët po dalin jashtë funksionit kushtetues.

Ne duhet, po më duket edhe njëherë, të gjithë ta lexojmë Kushtetutën, ta kuptojmë rolin që kemi, sepse debati i djeshëm për buxhetin dhe debati në pikën - Çështje të ndryshme, që vazhdimisht po përsëritet, po i nxjerr shumicën e deputetëve jashtë misionit të tyre kushtetues. Sepse mos të harrojmë se pritjet e popullit nga deputetët janë që ata të jenë legjislatorë të mirë, ata të udhëheqin politikë në nivel Republike e jo të bëhen zëdhënës të interesave lokale, të lagjeve, të komunave. Është detyrë e komunave, kemi zgjedhje komunale dhe do t'i vlerësojmë.

Në anën tjetër, nën pikën - Çështje të ndryshme, kur është vë ky mocion në Rregullore, është menduar për ngritjen e çështjeve që ndodhin midis dy seancave dhe që janë me interes për opinionin e gjerë. Ne, në këtë çështje, jo vetëm që s'po ngremë çështje që duhet ngritur, por shpesh herë po dalim edhe në kompetenca të dy pushteteve tjera, sidomos po e marrim rolin e gjyqësorit dhe, kjo tregon mungesën e një kulture kushtetuese, po si duket nuk ka pasur programe të mira të trajnimit, jo vetëm për këtë legjislaturë, por edhe për legjislaturat e kaluara.

Nëse, të nderuar kolegë, dëshirojmë ta rrisim autoritetin tonë edhe për këtë kohë të mandatit, sa na ka mbetur, të fokusohemi në detyrat tona kushtetuese. Detyrë jona kushtetuese është të bëjmë ligje të mira, t'i lexojmë ligjet, t'i amendamentojmë ligjet, të marrim nisma legjislative, të jemi aktivë në proceset e vendimmarrjes politike në nivel Republike, në nivel shteti, e jo kështu, për çdo ditë ta lodhim opinionin me gjëra krejt treciale, derisa nuk shtrojmë dhe nuk merremi me çështje për të cilat edhe jemi votuar, po për çështje të cilat i kemi premtuar në zgjedhje. Ne nuk kemi premtuar shtrimin e rrugëve nëpër lagje, apo nëpër, po kemi premtuar se do të merremi me çështjet vitale të shtetit, me çështjen e veriut, me çështjet legjislative.

Dhe, unë uroj që ne të kthehemi në funksionin tonë kushtetues dhe jam i sigurt se edhe raportet ndërkombëtare edhe raportet vendore, do të jenë shumë më pozitive, në qoftë se ne vërtet e kuptojmë misionin kushtetues, që e kemi si Parlament në përgjithësi, e në veçanti si deputetë. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Albana Gashi e ka fjalën.

ALBANA GASHI: Faleminderit, kryetar!

Në kohën kur më së shumti flitet për integrimin evropian, për lidhje me miq të fuqishëm ndërkombëtarë, për buxhet zhvillimor, për përkushtim qeveritar, e të tjera si kjo, midis protestave që shihen gati në secilin sektor, kemi në dorë edhe një peticion, i cili për nga përmbajtja dhe kërkesa është në fakt e vërteta e madhe e suksesit të këtij pushteti.

Banorët e fshatrave Zllatar, Dardani dhe Mirovallë të komunës së Ferizajt nuk kanë pasur dhe ende nuk kanë mundësi të shohin transmetimin e Radio-Televizionit Publik të Kosovës, por as edhe televizioneve të tjera, sepse nuk është i shtrirë rrjeti tokësor. Këto fshatra gjenden 48 kilometra larg nga ndërtesa ku gjendet Qeveria. Kosova është disa mijëra kilometra katrorë dhe Qeveria në fjalë ka marrë përsipër të shtrojë kryq e tërthorë me asfalt autostradash, ku banorët e fshatrave, si Zllatar, Dardani dhe Mirovallë, nuk do të kalojnë mbase asnjëherë.

Tani po e lexoj tekstin e peticionit.

“Ne, banorët e fshatrave Zllatar, Dardani dhe Mirovallë të Komunës së Ferizajt, me vetëdije dhe vullnet, kërkojmë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe nga Komisioni i Pavarur për Media, që t’i marrin masat për shtrirjen e rrjetit tokësor të valëve radiotelevizive në fshatrat tona. Që nga paslufta nuk kemi pasur qasje në sinjalin e televizioneve tona nacionale. Ne jemi të privuar nga e drejta për t’i shikuar televizionet tona nacionale. Mungesa e sinjalit është shkelje flagrante e të drejtës sonë për informim. Nga një përlllogaritje e bërë, vetëm ne banorët e këtyre tri fshatrave kemi paguar për RTK-në 37 mijë e 638 euro, ndërkohë që asnjëherë sinjali i Televizionit tonë publik dhe i televizioneve tjera nacionale nuk ka arritur në shtëpitë tona.

Nuk është normale që sinjalet e televizioneve nga Serbia e Maqedonia arrijnë deri tek ne, kurse jo edhe televizionet tona. Kjo për ne është e papranueshme, kemi reaguar shumë herë, por jemi shpërfillur nga institucionet përgjegjëse. Por, me sa jemi në dijeni këto nuk janë fshatra të vetme edhe në Bistricë, Koshtovë e Cerajë, sinjali i televizionit tonë nuk ka shkuar asnjëherë.

Zoti kryetar i Kuvendit dhe ju përgjegjës të Komisionit të Medias, ju bëj thirrje që në emër të këtyre banorëve të këtyre fshatrave duke qenë se Qeveria e Kosovës nuk duket se e ka vëmendjen për të dëgjuar...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Rasim Demiri.

RASIM DEMIRI: Zahvaljujem predsedniče!

Poštovane kolege i kolegince poslanici,

Govornica Skupštine Kosova se često zloupotrebljava od pojedinih zastupnika i služi za iznošenje neistina, kleveta, uvreda kao i za obračune sa političkim neistomišljenicima.

Tako je na sjednici Parlamenta, 8 novembra 2012.godine, poslanica Emilija Redžepi, u diskusiji po tački dnevnog reda o potvrđivanju odluke Vlade Republike Kosovo o osnivanju universiteta u Prizrenu, iznela niz neistina, kleveta i uvrede na rad profesora edukativnog fakulteta ovog universiteta na nastavi u bosanskom jeziku.

Poslanica Emilija Redžepi bez ikakvih dokaza i argumenata iznosi optužbe na račun profesora ovog fakulteta, čime je nanijela štetu i ukrnula rad i autoritet pomenutih profesora a poznato je celokupnoj bošnjačkoj javnosti, kakve su napore dosad uložili prozvani profesori da se otvori i održi nastava na bosanskom jeziku na ovom universitetu.

Tvrdnje o krivičnim prijavama i zloupotrebama službenih položaja pojedinih profesora na edukativnom fakultetu, koje je gospođa Redžepi iznela za ovom govornicom, su proizvoljne i plod su njene političke netrpeljivosti i mržnje prema neistomišljenicima. Zahvaljujem!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Ali Sadriu.

ALI SADRIU: Faleminderit, zoti kryetar!

Dje ishim dëshmitarë të një diskutimi, për mua shumë të pakëndshëm. Dhe, unë publikisht e shpreha, se nuk ndjehem mirë në ato rrethana, kur disa kolegë tanë filluan të fajësojnë se Drenica nuk është zhvilluar në mungesë të investimeve nga ministrat e LDK-së.

Po ju përkujtoj se në kohën kur unë kam qenë ministër, nuk po e them rastësisht, sepse një ministër, s'do t'ia përmend emrin, se po ia përmendin të tjerët shumë, në TV Mitrovica, po të njëjtën gjë e ka thënë, që e ka thënë edhe kolegja dje. Unë po e bëj një veprim shumë më të rëndë se që e kam bërë atëherë, atëherë e kam bërë me kënaqësi, sot po e bëj pakëndshëm, por i detyruar.

Edhe pse në Qeverinë që unë kam qenë, kryeministër ka qenë pjesëtar i juaj, ministri Bajram Rexhepi, ministër ka qenë edhe kryeparlamentari Jakup Krasniqi, e që unë po ju them këtu publikisht, që s'kam pasur asnjëherë asnjë intervenim, për asnjë investim në atë pjesë.

Megjithatë, në Drenicë është investuar dhe është investuar edhe pse kemi qenë nën protektorat dhe llogari nuk i kemi dhënë Kuvendit tonë, këtu, në mënyrë legjitime, i kemi dhënë, por megjithatë kemi pasur edhe mekanizma tjerë. Është investuar në Kompleksin Jasharaj, që të tjerët nuk kanë guxuar ta bëjnë dhe për këtë unë kam mirënjohje. Nuk është vetëm ky, po ka edhe shumë e shumë projekte tjera. Po deshët, mund t'ua specifikoj dhe besoj dhe jam thellë i bindur, pas një analize që e kam bërë mbrëmë, del se pesë herë më shumë është investuar në Skenderaj se sa në Shtime, prej nga vi unë.

Prandaj, nuk është një mënyrë e tillë e komunikimit dhe ju garantoj se në këtë mënyrë ju nuk e nderoni Drenicën, por e ulni Drenicën, që për mua Drenica është një vend i vuajtur, një vend që ka vuajtur shumë, që represioni ka qenë më i ashpër dhe nga ky shkak, mos harroni atë që ua kujtova, se derri ka gjithkund, kujtoj që aty keni më shumë dhe ajo është për të keqen e juve, atje. Faleminderit!

KRYETARI: I kemi edhe dy minuta. I kemi tre të paraqitur dhe unë dua t'i them nja dy-tri fjalë për dy-tri çështje.

Jo për tjetër, po realisht të tregoj ndoshta më tepër arsye, pse është kjo pikë e rendit të ditës. Çka do të duhej, ne si deputetë dhe jo vetëm në këtë pikë të rendit të ditës, ta ngrinim si çështje?

Çështje jetike, jo vetëm për sot, por për të ardhmen e vendit tonë është planifikimi hapësinor. Po të shikohet Kosova prej 10 mijë e 878 kilometrave katrore, në asnjë pjesë të Kosovës nuk kemi një planifikim të mirëfilltë hapësinor. Kemi një kaos urban në të gjitha qytetet, përfshirë edhe kryeqytetin e Republikës së Kosovës.

E di që në letra ne kemi bërë plane, edhe urbanistike, edhe të planifikimit hapësinor, por ato kanë mbetur në letër dhe në praktikë, në asnjë pjesë të vendit tonë nuk zbatohen. Prandaj, do të duhej që jo vetëm Parlamenti, por ndoshta këtu duhet të lindte iniciativa, sigurisht edhe e ekzekutivit edhe e pushteteve lokale që t'i kushtojmë një rëndësi më të madhe kësaj hapësire tonë jetësore, se ne s'do të kemi hapësirë më të madhe jetësore se këtë që e kemi. Dhe kjo hapësirë, vërtet duhet të shfrytëzohet me një planifikim tepër të kujdesshëm dhe në këtë rrafsh ne si shoqëri dhe si institucione po tregojmë që s'kemi asnjë përkujdesje, jo vetëm për të sotmen, por fundi i fundit ne duhet ta planifikojmë hapësirën tonë edhe për 100 vjet edhe për më shumë, se nuk jemi gjenerata as e parë, as e fundit, që do të jetojë në këtë hapësirë dhe në këtë rrafsh, po të shikohet, edhe njëherë po them, të gjitha ndërtimet që bëhen në të gjitha drejtimet, nga kryeqyteti ynë, kemi një kaos urban dhe kjo s'e nderon askënd. Dhe, ne si njerëz që kemi marrë përgjegjësinë nga qytetarët, për të krijuar rend, rregull, ligj dhe mirëqenie, nuk jemi duke i kryer detyrat tona dhe pastaj...

Si deputet, dua ta them edhe një çështje dhe po e përfundoj. Ne kemi obligime, Parlamenti është një institucion përfaqësues, është institucion ligjvënës dhe është institucion mbikëqyrës. Kemi të drejtë të kujdesemi edhe për lagjen tonë, kemi të drejtë të kujdesemi edhe për fshatin tonë, kemi të drejtë të kujdesemi edhe për komunën, por edhe për Kosovën si tërësi. Mendoj se e shfrytëzoja kohën 30 minutash dhe vazhdojmë me rendin e ditës.

Pika e dytë e rendit të ditës:

2. Informimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës nga kryeministri i Kosovës, zoti Hashim Thaçi, për takimin e dytë të zhvilluar në Bruksel, me kryeministrin e Serbisë

Për rend të ditës? Mirë, urdhëro zoti Ismet Beqiri, e ke fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Kam propozim që së pari një njoftim yni të futet në rend të ditës, për një zëvendësim në një komision dhe e dyta, zoti kryetar, ju kisha propozuar që pika e 6-të, të jetë pika pas informatës të zotit kryeministër, të jetë pikë e parë, që i bie të jetë pika e tretë e rendit të

ditës. Po, pika e gjashtë, të jetë pika e tretë, realisht e rendit të ditës. Këtë propozim e kam.

KRYETARI: Kemi një njoftim të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike dhe mund ta renditim si pikë të fundit të rendit të ditës.

Po na duhet një votim formal. Kush është për? Faleminderit! A ka kundër?

Edhe pika e gjashtë të rendit të ditës të jetë e treta. Kush është edhe për këtë? Faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës.

Kryeministri i Republikës së Kosovës, zoti Hashim Thaçi, ka shprehur gatishmërinë, që ta informojë Kuvendin e Republikës së Kosovës për takimin e tij të dytë me kryeministrin e Serbisë, në Bruksel, me ndërmjetësimin e përfaqësueses së lartë të Unionit Evropian për Politikë të Jashtme dhe Siguri, baroneshës Eshton.

E ftoj kryeministrin e Republikës, zotin Hashim Thaçi, ta marrë fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit!

I nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Zonja dhe zotërinj,

Ju falënderoj për mundësinë që ma keni dhënë edhe sot, që në përputhje me Rezolutën e Kuvendit të Republikës së Kosovës, të informoj Kuvendin e Republikës së Kosovës, qytetarët e Kosovës, për takimin e dytë të zhvilluar në Bruksel në mes meje si kryeministër i Qeverisë së Republikës së Kosovës, me ndërmjetësimin e baroneshës Eshton, me kryeministrin e Serbisë, zotin Daçiq. Prandaj e falënderoj gjithë spektrin politik për këtë mirëkuptim dhe këtë mundësi.

Të nderuar deputetë, zonja dhe zotërinj, ashtu siç jeni në dijeni, më 7 nëntor në Bruksel, u mbajt takimi i dytë i radhës, në kuadër të procesit të normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe asaj të Serbisë.

Ky dialog është në përputhje të plotë me Deklaratën e Pavarësisë, Kushtetutën e Kosovës, ligjet e Kosovës dhe Rezolutën e miratuar në Kuvend, për normalizimin e marrëdhënieve në mes dy shteteve tona, pra për një fqinjësi të mirë.

Më lejoni të theksoj se ky proces është tepër i rëndësishëm, është mundësia dhe rruga e vetme, që mundëson normalizimin e marrëdhënieve ndërshtetërore dhe rrjedhimisht edhe njohjen e shtetit të Kosovës nga Serbia në një fazë të mëvonshme.

Në takimin e dytë kemi shënuar progres konkret, sidomos në çështjen e zbatimit në praktikë të Marrëveshjes teknike për menaxhimin e integruar të kufirit.

Tani më lejoni që në detaje të ju informoj për të gjitha çështjet që janë diskutuar në takimin e dytë.

Si pikë e parë, përsëri dhe çdo herë, do të vazhdohet të ngritët, çështja e personave të zhdukur, që vazhdon të mbetet një problem shumë i dhembshëm, jo vetëm për familjarët e personave të zhdukur, mirëpo edhe për tërë shoqërinë kosovare. Dhe, kjo çështje është diskutuar në dy takimet e para, është ngritur nga unë dhe do të vazhdojë të ngrihet vazhdimisht, derisa të përmbyllet ky proces, gjithmonë e them, me mbështetjen e plotë të Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në një presion që mund t'u bëhet autoriteteve të Beogradit, që kjo çështje të zbardhet njëherë e përgjithmonë.

Jemi pajtuar që kjo është një çështje humane dhe shumë e dhembshme, e cila duhet të zgjidhet patjetër dhe sa më shpejtë. Për këtë qëllim ne jemi pajtuar që të intensifikohen takimet e grupeve punuese të ndërsjella për gjetjen dhe zbardhjen e fatit të personave të pagjetur. Unë në këtë rast kam kërkuar nga Komisioni Qeveritar i Republikës së Kosovës, që të jetë në krye të detyrave dhe obligimeve dhe të bëjnë gjithë çfarë është e mundur, që të jenë sa më efikas në punën e tyre.

Unë jam i përkushtuar që të mos kursej asgjë nga potenciali ynë, qoftë njerëzor apo financiar që fati i personave të zhdukur të zbardhet njëherë e përgjithmonë. Kam kërkuar dhe udhëzuar të gjitha agjencitë shtetërore të Republikës së Kosovës, që të bëjnë të pamundurën, që të arrijnë rezultate në këtë mision njerëzor, por dhe shtetëror.

Si çështje e dytë e diskutuar ndërlidhet drejtpërdrejt me zbatimin në praktikë të marrëveshjeve për menaxhimin e integruar të kufirit.

Lidhur me këtë çështje ne jemi pajtuar, që zbatimi në praktikë i IBM-it të fillojë në muajin dhjetor dhe atë në katër vendkalime kufitare: Bërnjakë, Jarinjë, Merdar dhe te pika kufitare Dheu i Bardhë. Ndërsa, sa u përket dy pikave kufitare tjera, zbatimi i IBM-it do të fillojë në periudhë të mëvonshme, për shkak se në këto vendkalime kufitare aktualisht nuk ka qarkullim të mallrave, por vetëm të udhëtarëve dhe gjësëndeve personale, që ata i bartin me vete. Pra, është fjala për pikat kufitare të Mutivodës dhe Muçibabës.

Natyrisht, zbatimi i IBM-së në këtë fazë do të bëhet në pikat ekzistuese kufitare, sipas marrëveshjes së arritur ndërmjet grupeve të ekspertëve.

Në fazën e mëvonshme Bashkimi Evropian është zotuar se do të financojë ndërtimin e vendkalimeve kufitare të përbashkëta, për zbatimin sa më efikas të IBM-së.

Vendkalimet e përhershme të financuara nga Bashkimi Evropian, pritet të ndërtohen në zonat neutrale, ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë. Lidhur me këtë çështje, më lejoni të sqaroj edhe një element që ndërlidhet drejtpërdrejt me rolin e EULEX-it në këto pika kufitare.

Unë me përgjegjësi të plotë e theksoj dhe e bëj të qartë për ju dhe për opinionin publik, se EULEX-i do të ushtrojë funksionet e tij në përputhje me mandatin e dhënë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mënyrë të njëjtë në të gjitha pikat kufitare. Pra, e theksoj se roli i EULEX-it në pikat kufitare, në veri të vendit do të jetë krejtësisht i njëjtë me rolin e EULEX-it në pikat tjera kufitare, qofshin ato në jug, perëndim apo lindje.

Pra, EULEX-i e ka një mandat të vetëm dhe atë mandat do ta zbatojë njësoj në gjithë Kosovën, ashtu siç jemi pajtuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Si pikë e tretë që është adresuar në takimin e dytë, ndërlihet drejtpërdrejt me nevojën e hapjes së zyrave ndërlidhëse ndërmjet dy shteteve.

Ne duhet të pranojmë faktin se Serbia ende nuk e ka njohur shtetin e Kosovës, mirëpo ne jemi të bindur se procesi i normalizimit të marrëdhënieve ndërshtetërore, shpie drejtë përfundimit logjik, pra të njohjes së shtetit të Kosovës nga Serbisë, njohjes reciproke, që do të mund të ndodhë.

Pavarësisht këtij fakti, për shkak të nevojave të shumta që kanë qytetarët e Kosovës dhe qytetarët e Serbisë dhe me qëllim të krijimit të kanaleve zyrtare të komunikimit ndërshtetëror, për të adresuar problemet e ndryshme, është shumë logjike dhe praktike që Republika e Kosovës të hapë zyrën ndërlidhëse në Beograd dhe të njëjtën gjë ta bëjë edhe Serbia, në Prishtinë.

Unë mendoj se hapja e zyrave ndërlidhëse, të cilat do të ofronin dhe shërbime për pajisje të qytetarëve me dokumente udhëtimi, dokumente të gjendjes civile, pastaj promovimin e investimeve dhe bashkëpunimin ekonomik, do të ishte e rëndësishme për shtetin e Kosovës, por në të njëjtën kohë edhe për interesimin legjitim të Serbisë për qytetarët në Kosovë.

Sa i përket kësaj çështjeje, të nderuar deputetë, zonja dhe zotërinj, Serbia ende ka rezervat e saj, sepse e kupton qartë se një hap i tillë është edhe një hap më shumë drejt njohjes së Kosovës. Unë shpresoj se progres konkret lidhur me këto çështje do të bëhet në takimin e radhës, sepse edhe kjo është çështje që radhitet në kushtet e vëna Serbisë nga Bashkimi Evropian dhe shtetet anëtare.

Pikë e katërt që është diskutuar në takimin e dytë, pra është çështje që ndërlihet me domosdoshmërinë e transparencës së Serbisë për financimin e sektorëve të ndryshëm në Kosovë, e në theks të veçantë, financimin e strukturave paralele të sigurisë në veri të vendit.

Ju e dini se ndalimi i financimit dhe zhbërja e strukturave ilegale të sigurisë të Serbisë, që funksionojnë ende në veri të vendit, është çështja kryesore dhe më e rëndësishme që ndërlihet me këtë proces.

Për më tepër, ky është kushti kyç që duhet ta përmbushë Serbia në raport me Bashkimin Evropian për të bërë progres drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Ndërsa, tashmë është më se e qartë se Serbia nuk do të mund të bëjë progres drejt anëtarësimit në Bashkim Evropian, pa i plotësuar të gjitha kushtet e vëna në raport me Kosovën. Pra, pa u sjell në mënyrë evropiane edhe në raport me Republikën e Kosovës. Për më tepër, Serbia nuk do të mund të bëhet anëtar i BE-së pa e njohur Republikën e Kosovës.

Ne nuk e mohojmë të drejtën legjitime të Serbisë për t'u interesuar për komunitetin serb që jeton në Kosovë.

Po ashtu, ne nuk e mohojmë të drejtën e Serbisë për ta ndihmuar në forma të ndryshme, goftë edhe përmes ndihmave financiare komunitetin serb që jeton në Kosovë.

Për këtë qëllim, kjo gjë është adresuar shumë qartë edhe me dokumentin e Ahtisarit dhe janë përcaktuar dhe format se si mund të behët një gjë e tillë. Kjo do të respektohet në plotësi.

Pra, ne mendojmë se Serbia mund të vazhdoj financimin e saj për komunitetin serb që jeton në Kosovë, por për këtë duhet ta bëjë në mënyrë transparente dhe ndihma financiare duhet të kalojë nëpërmjet Buxhetit të Kosovës e nga aty të shpërndahet te komunat me shumicë serbe, siç është e planifikuar dhe përfshirë në dokumentin e presidentit Ahtisari.

Çështja e pestë që është diskutuar të nderuar deputetë, zonja dhe zotërinj, qytetarë të Republikës së Kosovës, në këtë takim ndërlidhet me masat për ruajtjen e trashëgimisë religjioze dhe kulturore serbe në Kosovë. Në këtë aspekt, ne jemi të vetëdijshëm për suksesin e konsideruar që kemi arritur bashkërisht dhe gjendja është përmirësuar dukshëm. Mirëpo, komuniteti serb ende ka shqetësimet e veta e që kryesisht ndërlidhen me mbrojtjen fizike të kishave, manastireve dhe objekteve tjera të rëndësishme.

Për të ofruar siguri shtesë unë kam propozuar krijimin e një njësie të veçantë në kuadër të Policisë së Kosovës e cila do të merret me ruajtjen e këtyre objekteve të trashëgimisë fetare dhe kulturore.

Policia e Kosovës, si polici më profesionale në rajon dhe multietnike, tashmë më ka marr në mbrojtje nga KFOR-ri disa nga këto objekte dhe do të ishte shumë pozitive që ta bëjë një gjë të tillë edhe me objekte tjera që sigurohen ende nga KFOR-i.

Policia e Kosovës është multietnike, është polici shumë profesionale që përmbush mandatin e përcaktuar me ligj.

Prandaj nuk kam dyshim në gatishmërinë dhe profesionalizmin e Policisë së Kosovës për t'i ruajtur këto objekte që fundja janë pjesë edhe e trashëgimisë së përgjithshme të Kosovës.

Çështja e gjashtë që është diskutuar dhe jemi pajtuar ka të bëjë me ndërtimin e një projekti të përbashkët infrastrukturor i cili do të financohej nga Bashkimi Evropian.

Fjala është për idenë tonë, për ndërtimin e autostradës Prishtinë-Merdar-Nish, apo Prishtinë-Mutivodë-Leskoc.

Të nderuar deputetë,

Komisioni Evropian, mund të konfirmoj se tashmë ka pranuar që të financojë studimin e fizibilitetit për ndërtimin e kësaj rruge, autostrade. Ndërtimi i kësaj autostrade do t'i hapte edhe një portë Kosovës, shtetit të Kosovës për të lidhur me korridorin evropian.

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të dashur të Republikës së Kosovës,

Takimi i radhës pritet të ndodhë në muajin e ardhshëm.

E di se ka pasur kërkesë që të informohet për datën e takimeve në vijim, por mund t'ju them sinqerisht se as unë nuk e di datën se kur do të ndodhë. Në momentin që ne do të informohemi, do të informoheni edhe ju.

Të nderuar deputetë,

Të nderuar të pranishëm,

Dua të përsëris edhe një herë, me asnjë çmim, me asnjë kusht ne nuk do të negociojmë të drejtën tonë për të ekzistuar dhe funksionuar si shtet, të drejtën tonë për të ekzistuar dhe funksionuar si anëtar i familjes evropiane.

Pavarësia e Kosovës është vetëm vullneti ynë, nuk është vetëm realitet juridik në Kosovë.

Pavarësia e Kosovës është fakt ndërkombëtar. Po ashtu dua t'ju siguroj që tërësia territoriale e Republikës së Kosovës është e pacenueshme dhe e njohur ndërkombëtarisht, nuk është, nuk ka qenë dhe nuk do të jetë kurrë në tryezën e diskutimeve.

Të gjithë janë të vetëdijshëm se pretendimi për ndryshimin e kufijve do të hapte Kutinë e Pandorës dhe do të prodhonte sërish konflikte dhe luftëra në Ballkan.

Tashmë, edhe Bashkimi Evropian çdo ditë e më shumë është duke u artikuluar qartë këtë çështje, duke ia bërë me dije Serbisë që ëndrrat e saj për ndarje do të mbesin gjithmonë ëndrra të parealizuara.

Unë e di shumë mirë që Serbia nuk është një fqinjë i rëndomtë i shtetit të Kosovës. Kemi pas vetes shekuj luftërash dhe konfliktesh, mijëra të vrarë, mijëra të zhdukur, miliona plagë.

Po ne e kemi për obligim që fëmijëve tanë t'u lëmë trashëgimi jo vetëm një Kosovë të pavarur dhe sovranë, por edhe një Kosovë në paqe me fqinjët e saj, të integruar në NATO dhe në Bashkimin Evropian.

Ne e kemi për detyrë që të punojmë që e kaluara të mos përsëritet kurrë, të punojmë edhe më shumë për të ardhmen. Ju faleminderit për vëmendjen tuaj!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit, zoti kryeministër! Për fjalë është paraqitur zoti Arsim Bajrami.

ARSIM BAJRAMI: I nderuar zoti nënkryetar,
I nderuar zoti kryeministër, zëvendëskryeministra, ministra,
Të nderuar kolegë deputetë,
Fillimisht më lejoni që në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të përshëndes informatën e kryeministrit për takimin e dytë dhe të shpreh kënaqësinë që në jetën tonë politike po instalohet një standard i ri, një kualitet i ri, një praktikë e mirë parlamentare dhe kushtetuese e informimit të Parlamentit për çështje me interes nacional.

Dhe, padyshim se ky është një kualitet i ri i jetës tonë, sepse po sigurohet një proces jashtëzakonisht transparent për një çështje kaq të rëndësishme, për një çështje në të cilën të gjithë duhet të jemi bashkë.

Ne e dëgjuam kryeministrin me këtë informatën detale dhe kryeministri na informoj pak a shumë për çështjet që janë diskutuar dhe unë vlerësoj këto gjashtë çështje për të cilat është diskutuar, janë prezantuar në mënyrë të dinjitetshme dhe janë çështje në interes të Kosovës, në interes të normalizimit të raporteve me Republikën e Serbisë.

Jemi të gjithë të vetëdijshëm se ky është një proces sa serioz, aq i vështirë dhe aq i përgjegjshëm, por një proces i domosdoshëm i tejkalimit të armiqësive, krijimit të normalizimit dhe fillimit të agjendës evropiane për Republikën e Kosovës. Dhe ne urojmë që ky proces të udhëhiqet në mënyrë të dinjitetshme, në mënyrë shumë të guximshme, shumë të vendosur, sepse ne në këtë proces po hyjmë si shtet, po hyjmë madje edhe si fitues dhe po i zgjidhim problemet e mbetura që i kemi me Serbinë, problemet e trashëguara nga lufta, probleme të cilat janë ricikluar.

Duke i dhënë plotësisht mbështetje informatës së kryeministrit, më lejoni t'i theksoj dhjetë parime në të cilat duhet të bazohet ky proces.

Parimi i parë që ne veç e kemi treguar edhe në të kaluarën është krijimi i unitetit politik në çështjet e interesit nacional. Dhe duhet shprehur kënaqësinë se ky unitet politik tanimë është arritur, sepse shumica e partive politike parlamentare e kanë mbështetur dhe po e mbështesin këtë proces. Më lejoni që të falënderoj opozitën për qasje jashtëzakonisht konstruktive në këtë proces dhe ta thërras opozitën që të jetë proaktive në tërë procesin dhe kontribuuese në të gjitha format në të cilat kërkohet, sepse ne kemi treguar edhe në të kaluarën këtë kulturë politike se në çështjet nacionale, në çështjet e interesit nacional ne dimë të udhëheqim politika shtetërore dhe të heqim dorë nga politikat partiake.

Momenti i dytë që dëshiroj ta theksoj dhe ta theksoj si vlerë e procesit është transparenca.

Kolegë të nderuar,

Procesi po zhvillohet në mënyrë transparente, jo vetëm në nivele politike, po edhe në nivel të opinionit. Kemi dëgjuar javën e kaluar dhjetëra paraqitje të kryeministrit me dhjetëra takime duke informuar të gjithë aktorët dhe përfaqësuesit e institucioneve me rrjedhat e zhvillimeve politike. Dhe unë mendoj se ky trend i filluar duhet të vazhdojë për shkak se duhet të koordinohen politikat kombëtare, filluar nga presidentja e Republikës deri te liderët e opozitës, duhet të jenë pjesë dhe duhet të informohen për rrjedhat e procesit.

Momenti i tretë, vendosmëria e Kosovës në këtë proces. Pak a shumë ne e kemi platformën politike. Platforma jonë politike është Kushtetuta e Republikës së Kosovës, është Rezoluta e Kuvendit të Kosovës dhe ne duhet në mënyrë të dinjitetshme në këtë proces ta funksionalizojmë sovranitetin e Republikës, jo ta mbrojmë, se nuk kontestohet sovraniteti i Republikës së Kosovës tanimë nga askush, nuk kontestohet integriteti territorial i Kosovës nga askush. Kemi dështuar edhe qëndrimet e fundit të Bashkimit Evropian. Por, ne duhet ta funksionalizojmë sovranitetin dhe integritetin në ato pjesë ku është bllokuar sovraniteti jonë edhe këtu bëhet fjalë kryesisht për veriun.

Duhet sa më shpejtë procesi të avancojë drejt çështjeve fundamentale të këtij procesi drejt çështjes së veriut dhe ne duhet të kërkojmë që gjendja e status quo-s në veri të ndërpritet dhe të fillojë funksionalizimi i plotë i parimit të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë në veri, të fillojë shpërbërja e strukturave kundërkushtetuese dhe kundërligjore, të krijohet legjitimiteti përfaqësues i serbëve i veri dhe të fillojë procesi i ngadalshëm, por i pandashëm i integritetit të atyre qytetarëve të Republikës së Kosovës, brenda strukturave edhe lokale, po sidomos edhe brenda strukturave qendrore të Republikës së Kosovës, në mënyrë që të funksionalizohet plotësisht pakoja e Ahtisarit.

Gjithashtu angazhohemi që model për këtë funksionalitet të jetë pakoja e Ahtisarit, sepse të nderuar kolegë, jo rastësisht presidenti Ahtisari ka fituar çmimin Nobel. Çmimin Nobel e ka fituar edhe për faktin se e ka gjetur zgjidhjen më të mirë për pakicat në rajon.

Krahasoni Konventën Evropiane për të Drejtat e Pakicave, krahasoni modelet e qeverisjes lokale në rajon, asnjë model më të mirë se atë që e ka dhënë pakoja e Ahtisarit për pakicat dhe për qeverisjen lokale nuk e keni. Dhe ka ardhur koha që bashkëqytetarët tanë në veri ta lexojnë mirë pakon e Ahtisarit dhe do të shohin se gjithçka që është legjitime për mbrojtjen e interesave kombëtare, interesave të identitetit kulturor gjuhësor e kanë në atë pako dhe të fillojnë të realizojnë të drejtat në sferën e arsimit, në sferën e shëndetësisë, në sferën e sigurisë dhe të fillojnë të participojnë në këtë proces.

Gjithashtu kërkojmë që sa më shpejt të caktohet një datë finale e shpërndarjes së strukturave kundër kushtetuese dhe sa më shpejtë të kërkohej nga Serbia që të ndalë në një mënyrë këtë agresion që po bën përmes strukturave të veta të sigurisë dhe të tregojnë një vullnet të mirë edhe gjatë procesit të normalizimit, në mënyrë që t'i hapet rruga, një zgjidhje e cila do të mundësojë që të funksionalizohet atje qeverisja lokale, të funksionalizohen institucionet e Kosovës.

Të nderuar kolegë,

Duhet të jemi racional, këto 4-5 muaj nuk do të jenë aq të lehtë, do të ketë tema edhe më të rënda. Ne do të insistojmë që marrëveshjet për të cilat është arritur marrëveshja të realizohen plotësisht dhe është logjike që ne do t'i besojmë marrëveshjeve tjera, në qoftë se implementohen marrëveshjet e deritanishme. Por, nuk duhet krijuar iluzione e gjithçka me Serbinë do të zgjidhet në këtë proces të normalizimit.

Edhe Kroacia, Sllovenia dhe vendet tjera kanë probleme me Serbinë dhe duhet kuptuar se normalizimi i plotë i raporteve me Serbinë është një periudhë e gjatë. Neve na duhet momentalisht që Serbia mos ta pengojë pavarësinë e Kosovës, nuk do të presim njohje de jure të Serbisë për Kosovën, por do të presim që Serbia nuk do ta mbajë peng shtetin e ri, nuk do ta bllokojë Kosovën dhe do të mundësojë plotësisht që Kosova të hyjë në proceset e integritetit.

Pas normalizimit të këtyre raporteve që është një përparësi evropiane edhe për Serbinë, por edhe për Kosovën, ne kemi çështje tjera, duke filluar nga çështja e suksesionit, nga çështja e dëmeve të luftës, kthimit të aseteve të Kosovës, por ky është një proces i cili kërkon kohë. Për momentin nëse dëshirojmë të kyçemi në këtë agjendën evropiane e ne nuk kemi arsye të ikim kësaj agjende evropiane, ne duhet sa më shpejtë të përmbyllim këtë proces të normalizimit, por në mënyrë të vendosur, në mënyrë të dinjitetshme si shtet plotësisht sovran dhe i pavarur edhe prezantimi që në këto dy takime ka qenë jashtëzakonisht dinjitoz, sepse takimet, bisedimet po mbahen midis dy kryeministrave të ty shteteve sovraane dhe të pavarura, në daç me flamuj, në daç pa flamuj, këto janë çështje notore.

Kryeministri i Republikës së Kosovës e përfaqëson Republikën e Kosovës të njohur nga afër 100 shtete dhe tanimë ky është fakt i njohur, të mos mashtrohem mbas formaliteteve po të shohim substancën e procesit. Diçka që për Serbinë ka qenë e imagjinueshme para një kohe, ne po e bëjmë realitet, sepse ata i kanë thyer tabutë dhe tani dalëngadalë po mësohen me Republikën e Kosovës, po mësohen me faktin se ky proces është i pakthyeshëm dhe mendoj se ky proces është edhe një shans për vetë Serbinë që ajo midis një politike të nacionalizmit ortodoks feudal, të zgjedh politikën e Bashkimi Evropian, por Kosova nuk ka dilemë, ne integrimin evropian dhe integrimin euroatlantik e kemi shpallur interes kombëtar dhe jam i sigurt se ky proces do të finalizohet me një zgjidhje e cila nuk prek vlerat kombëtare të shtetit të Kosovës. Ne duhet t'i shmangim nga fjalori ynë politik, paragjykimet që aty-këtu dëgjohen më tepër në Kosovë se sa në vendet tjera, paragjykime që nuk kanë bazë.

Së fundi, të nderuara kolegë deputetë,

120 deputetë të këtij Kuvendi do ta përmbyllin këtë proces, do ta përmbyllin, sepse jemi marrë vesh se çfarëdo marrëveshje finale në këtë proces do të ratifikohet në Kuvend të Kosovës, do të ratifikohet me 2/3 dhe mos të bëhemi pre e thashethemeve apo e fjalive që nganjëherë janë edhe qyqare, po në mënyrë të dinjitetshme, në mënyrë të vendosur ne të hyjmë në këtë proces, të mbikëqyrim si Parlament procesin dhe me raportimet që po i jep kryeministri të japim ndoshta edhe orientimet edhe propozimet dhe gjithsesi ky proces do të përmbyllet me sukses dhe në këtë mënyrë sovraniteti i Republikës së Kosovës do të

shtrihet në tërë territorin e Kosovës dhe ne paka shumë do të kompletohem si strukturë kushtetuese dhe shtetërore dhe do të funksionojmë me kapacitete e një shteti të plotë, sovran dhe të pavarur. Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka zoti Beqiri.

ISMET BEQIRI: Zoti nënkryetar,
Të nderuar kolegë deputetë,
Më lejoni shumë shkurt, i bie që të përsërisim ndoshta disa gjëra që i kemi thënë.

Lidhja Demokratike e Kosovës vazhdon ta ketë qëndrimin e njëjtë, të përkrahjes të çdo gjëje që është në të mirën e vendit, çdo dialogu që zhvillohet në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe së fundi në mbështetje të Rezolutës të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të aprovuar nga ky Kuvend.

Një ndër kërkesat tona të vazhdueshme ka qenë, sigurisht që edhe mbetet në të ardhmen që dialogu të jetë transparent dhe për këtë Kuvendi si organ më i lartë i vendit, të informohet dhe sigurisht që në fund ky Kuvend edhe të vendosë për çdo marrëveshje eventuale.

Kjo pikë e informimit të Kuvendit, pse jo edhe të transparencës tani po realizohet me informimin që po bëhet tanimë herën e dytë.

Lidhja Demokratike e Kosovës e ka thënë dhe e përsërit edhe sot se kontributin e saj do ta japë në Kuvendin e Republikës së Kosovës, roli ynë ka qenë është do të mbetet konstruktiv dhe në të mirë të vendit tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Në takimin e fundit që kryeministri pati me Daçicin, u përmend se për implementimin e marrëveshjeve të arritura në Bruksel, po citoj ishte një fjali aty që thoshte: “veriu është më ndryshe”. Kjo Qeveri, pra tashmë është pajtuar që veriun të mos e konsiderojë si territor të plotë të Kosovës. Veriu është territor i Kosovës vetëm në fjalimet e kryeministrit, por jo edhe në veprimet konkrete të kësaj Qeverie,

A mund të na e shpjegoni çdo të thotë kjo që “veriu është më ndryshe”, përse është thënë kështu? A mos do të thotë kjo se edhe për veriun çështja do të kërkohet të jetë më ndryshe se sa plani i Ahtisarit?

Përse marrëveshja e IBM-it, në të cilën zyrtarisht kufijtë e Kosovës askund nuk figurojnë si kufij shtetërorë, nuk do të zbatohet në dy pika kufitare? A mos është edhe kjo një shenjë se jeni treguar i pasinqertë kur thoni se pas 25 korrikut është vënë kontrolli i plotë në kufijtë tanë verior?

Kryeministër,

Në një prej intervistave tuaja të fundit keni folur për muhabetin që e keni pasur me Daçiqin.

Dhe keni thënë se kur Daçiqi ju ka thënë se do t'ju arrestonte, ju i keni thënë atij se edhe ju do të mund ta kishit arrestuar në Kosovë, por keni dhënë urdhër dhe me ndikimin tuaj që ai të mos preket.

A mund të na e shpjegoni më hollësisht, kush nga policia paska dashur ta arrestojë Daçiqin dhe pse keni ndërhyrë në këtë proces? Përse i pengoni institucionet e sigurisë që ta kryejnë punën e tyre, dhe i viheni në mbrojtje Ivica Daçiqit?

Çka është kjo Qeveri që ministër i saj i jep urdhër të paligjshëm policisë që rrahën qytetarët paqësorë shqiptarë kur protestojnë kundër Serbisë, kurse ju jepni urdhër policor që Ivica Daçiqi, të mos preket dhe të qarkullojë i lirë nëpër Kosovë?

Zonja dhe zotërinj, deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Problemi më i vogël i negociatave me Serbinë është raportimi i kryeministrit në Kuvend.

Çështja kryesore nuk është apo raporton a po nuk po raporton kryeministri në Kuvend. Problemi kryesor është se kryeministri shkon të takohet me kryeministrin e Serbisë dhe flet veç për Kosovën, ky është problemi kryesor.

Me siguri që në këto biseda të kryeministrit me Daçiqin, nuk është folur asgjë për Serbinë, e as për Luginën e Preshevës. Atje është folur vetëm për trashëgiminë kulturore të Kosovës, se kah i konvenon Serbisë t'ia mbajë autostrada e kombit, se në ç'mënyrë Serbia do të vazhdojë t'i financoje strukturat e veta të paligjshme në Kosovë dhe dalëngadalë kështu po shkojmë drejt temës së veriut të Kosovës.

Përkundër herëve tjera, kësaj radhe kryeministri çuditërisht është treguar shumë i zellshëm për raportuar dhe për të informuar. Siç duket, ai e ka qejf raportimin, sidomos në kesi rastesh kur mund të na thotë ç'të dojë e ne nuk mund ta verifikojmë krejtësisht a po na tregon drejt apo jo. Kështu që ai mund të na e zbukuroj bisedën me Daçiqin, ashtu siç ia ka qejfi. Në takim nuk ka pasur kamera, biseda nuk ka transkript, kështu që kryeministri mund ta kthejë këtë në takim për ta promovuar patriotizmin e tij të shtirur, duke na thënë se ka folur për të pagjeturit e kështu me radhë. E vërteta, në këtë rast, varet krejtësisht prej ndërgjegjes së kryeministrit. Por, ne mendojmë se ndërgjegjja e kryeministrit nuk është e përshtatshme për të na treguar të vërtetën, sepse kemi të bëjmë me njeriun që na premtoi se nuk do të ketë negociata politike me Serbinë, dhe shkoi pikërisht në këto negociata.

Pardje tha se i ka dërguar ftesë edhe "Vetëvendosjes" për informim, por as kjo nuk është e vërtetë, prandaj ndërgjegjja e kryeministrit dhe e vërteta takohen rrallëherë.

Këtij Kuvendi pastaj nuk i kanë munguar premtimet e kryeministrit, në stilin se në fund të negociatave do të na njeh Serbia, pastaj do të bëhemi pjesë e Kombeve të Bashkuara e kështu me radhë. Bile edhe ne si deputetë, por edhe qytetarët e Kosovës janë lodhur nga premtimet e pambajtura të kryeministrit. Por diçka tjetër i ka munguar këtij Kuvendi. Këtij Kuvendi i kanë munguar dhe i ende i mungojnë betimet e kryeministrit. Ajo që kanë nevojë qytetarët e Kosovës është që kryeministri i tyre të betohet se nuk do të ketë kurrfarë autonomie për veriun e Kosovës. Sepse edhe Bosnja u bë anëtare e OKB-së, ama vetëm atëherë kur Serbia e mori nën kontroll Republikën Serbe, atje.

Kryeministër, betohuni përpara të zgjedhurve të popullit dhe para të gjithë qytetarëve të Republikës, se nuk do të bisedoni me Serbinë kurrë për veriun e Kosovës dhe se nuk do të pranoni kurrfarë autonomie për këtë pjesë të Kosovës.

E keni rastin që t'i qetësoni zemrat e qytetarëve të këtij vendi.

Tash ndodhemi në prag të 100-vjetorit të pavarësisë shqiptare. Kjo ngjarje e madhe kombëtare anembanë po shënohet me aktivitete të ndryshme e manifestime në çdo pjesë të trojeve shqiptare. Por, ju keni zgjedhur mënyrën më të keqe për ta shënuar këtë ngjarje, sepse këtë gjë po e bëni me negociata me Serbinë.

Sot, unë këtu kam sjell me vete një flamur kombëtar, të cilin do ta vendos në këtë foltore. Zoti kryeministër, qytetarët e këtij vendi presin nga ju që të betoheni përpara flamurit kombëtar se kurrë nuk do të bëni pazar me një pjesë të territorit të Kosovës, se kurrë pra nuk do të pajtoheni që veriut t'ia jepni autonominë. Po e lë këtu, në foltore.

KRYESUESI: Fjalën e ka zoti Gjini. Flamurin e ke aty!

ARDIAN GJINI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Zoti nënkryetar, zoti kryeministër,

Që në fillim Aleanca, qartë, pa asnjë hezitim e shumë publikisht e ka mbështetur procesin e dialogut për normalizim të marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë.

Arsyet të cilat na kanë shtyrë në këtë drejtim prapë kanë qenë tepër të qarta. Nuk ka pasur të bëjë fare me ndihmesë ndaj Qeverisë, ka pasur ekskluzivisht të bëjë me ndihmesë ndaj Kosovës, ndaj vendit. Dhe, prapë janë dy arsye pse.

Çështja e parë është se për tema të këtilla në Kosovë duhet të ketë konsensus dhe kemi provuar që t'i ndihmojmë konsensusit.

E çështja e dytë është se Kosova ka nevojë edhe për dijen edhe për vullnetin e gjithë atyre që e kanë, në mënyrë që këto biseda të jenë ekskluzivisht në të mirë të Kosovës, që çfarëdo marrëveshje e cila duhet të ratifikohet dhe do ta përsëris prapë, të ratifikohet në Kuvend, të jetë në interes të Kosovës. Dhe gjithsesi interesi i Kosovës nuk mund të jetë kundër interesit të paqes dhe prosperitetit në rajon. Mirëpo, ne si deputetë të këtij Kuvendi, fillimisht mendojmë për interesin tonë. Ajo që ne presim në këtë proces është jo

vetëm që të dimë se çka po ndodh dhe çka po flitet në Bruksel, kjo është e rëndësishme, por nuk është e mjaftueshme.

Ne mendojmë se thyerja e akullit ka ndodhur dhe tani hyjmë në procese të cilat ne duhet të jemi të përgatitur.

Nëse ne si Aleancë dëgjojmë se flitet për autostradën, atëherë mendojmë se Kosova duhet të jetë e përgatitur me variante, me plane kontingjente. Dhe, këto variante dhe plane kontingjente nuk është e mjaftueshme që të bëhen vetëm në Qeveri, për hir të konsensusit dhe për hir të një vote të ardhme në Kuvend, që kërkon ratifikim për çfarëdo marrëveshje. Do të kërkojmë përgatitje dhe plane kontingjente dhe këto plane duhet të bëhen me gjithë aktorët në Kosovë, jo vetëm në qeveri për shkak se pas Rezolutës në Kuvend, është e pamjaftueshme që vetëm Qeveria të merret me këto tema.

Nëse flitet për njësitë e Policisë së Kosovës, të cilat posaçërisht do të stërviten për t'i mbrojtur objektet e kultit në Kosovë, posaçërisht ato të Kishës Ortodokse, atëherë prapë do të duhet të ketë plane, variante, plante kontingjente të cilat duhet të arrihen në Kosovë dhe nuk është e mjaftueshme që të arrihen vetëm në Qeveri.

Mendojmë se këto plane, të cilat do të përgatiten në mënyrë që të kenë mbështetje, në mënyrë që të arrihet konsensusi, në mënyrë që Kosova të nxjerrë përfitime sa më të mëdha, duhet të fillojnë që të përgatiten dhe mendojmë se në këtë fazë është jashtëzakonisht e domosdoshme që Kosova të fillojë të punojë në këtë drejtim. Edhe një herë po e përsëris, nuk e mjaftueshme që ne të dëgjojmë se çka po flitet, për ne është absolutisht, totalisht e parëndësishme kush çka hanë, çka pinë dhe kush ulet në të majtë e kush ulet në të djathtë, janë totalisht të parëndësishme për Aleancën, janë totalisht të parëndësishme për Kosovën.

Mendojmë, se tanimë Kosova ka ardhur në fazë që duhet të fillojë të përgatitet me variante dhe me plane kontingjente, për shkak se po ju garantoj se pala tjetër është duke u përgatitur. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kryetarja e Grupit Parlamentar e Koalicionit për Kosovë të Re, zonja Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit!

I nderuar nënkryetar!

Përshëndetje për kryeministrin dhe Kabinetin qeveritar,

Dhe gjithë deputetët në këtë seancë,

Duke marrë parasysh se Kuvendi i Kosovës ka miratuar një rezolutë, e cila e obligon kryeministrin të raportojë pas çdo bisedimi me kryeministrin serb, atëherë kjo po bëhet një transparencë e cila është kërkuar çdo herë nga Kuvendi i Kosovës që Qeveria të raportojë në Kuvend të Kosovës.

Në rast se e marrim takimin e kryeministrin Thaçi, me kryeministrin e Serbisë, së bashku me baroneshën Eshton, mund të themi se kjo është agjenda e cila është angazhuar nga

Brukseli, në mbështetje të Uashingtonit për përmirësimin e marrëdhënieve në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë.

Kryeministri u deklarua se më 7 nëntor është takuar në Bruksel dhe cilat kanë qenë pikat në të cilat është zhvilluar biseda.

Në rast se e shohim çështjen e parë, çështjen e të zhdukurve, kryeministri potencoi që do të bëjë të pamundurën që familjarët e këtyre njerëzve të heqin një herë e përgjithmonë brengën e tyre apo të dinë ku janë eshtrat e të rënëve të tyre. Dhe Kjo, ndoshta do të jetë edhe çështja që e obligon me Kushtetutë, kryeministrin dhe ligjet dhe pakon e presidentit Ahtisari, por do të jetë edhe një çështje humane që do të zhvillojë Qeveria e Kosovës, në këtë aspekt.

Zbatimi i marrëveshjes së IBM-së u theksua edhe nga kryeministri, edhe nga dy zonjat që ishin pak më parë mysafire në Kosovë, që të gjitha marrëveshjet teknike duhet të zbatohen dhe unë në këtë rast kërkoj nga kryeministri që të bëhet edhe një presion edhe më i madh nga Brukseli dhe nga Uashingtoni, në Qeverinë e Serbisë, që këto marrëveshje të zbatohen.

Nevoja e hapjes së Zyrës Ndërlidhëse mes shtetit të Kosovës dhe shtetit të Serbisë, në rast se Qeveria e Serbisë hap një zyre në shtetin e Kosovës, atëherë unë këtu jam e bindur që ajo është drejt njohjes së pavarësisë së Kosovës.

Transparenca e shtetit serb në financimin e strukturave paralele në veri apo strukturave ilegale në veri të Kosovës, kryeministër, këtu duhesh të kërkojsh ndoshta edhe pak më shumë nga Brukseli dhe nga Uashingtoni, që njëherë edhe përgjithmonë Serbia të dijë që Kosova e ka shpallur shtetin e vet më 17 Shkurt dhe Kosova së bashku me të gjitha subjektet politike. Kryeministri e ka obligim kushtetues që t'i tregojë Serbisë se ne jemi shtet dhe në këtë shtet zbatohet ligji, kushtetuta, integriteti dhe sovraniteti i vendit.

Çështja e masave mbrojtëse të kulturës serbe, mund të themi se kryeministri e din që në Ministrinë e Punëve të Brendshme, ka Drejtorinë për Mbrojtjen e Objekteve Vitale dhe Sektorin për mbrojtjen e këtyre objekteve. Me sa më duket, me pakon e presidentit Ahtisari u janë dhënë mjaft të drejta të gjitha minoriteteve.

Ndërtimi i projektit të përbashkët, korridorit i cili do të lidhë Kosovën me Serbinë, prapëseprapë kryeministri është në dijeni që çdo ratifikim do të vijë në Kuvend.

Mirëpo, si deputetë të këtij Kuvendit të Kosovës dhe si subjekte politike, pavarësisht të disa deputetëve të cilët nuk kanë një konsensus për çështjen e bisedimeve, ne i bëjmë me dije kryeministrit, si deputetë të Kuvendit të Kosovës, që do të ketë mbështetjen për këto bisedime, për arsye se është çështje e cila në rast se nuk kryhen këto bisedime mes Kosovës dhe Serbisë, atëherë as Serbia nuk do të jetë në BE, as Kosova nuk do të jetë në BE.

Duhet të përsërisim edhe një herë se kryeministri e ka obligim kushtetues, ligjor dhe kombëtar, pavarësisht pse është flamuri këtu, që të mbrohet territori i Kosovës, në bazë të ligjeve, në bazë të Kushtetutës dhe të bëhet me dije që pavarësia e Kosovës është njohur mbi 90 shtete dhe Kosova është shtet i cili shumë shpejt do të jetë edhe anëtar i BE-së. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Trajković është paraqitur për fjalë.

RADA TRAJKOVIĆ: Poštovani kolege poslanici, Želim da kažem da sam bila jako tužna na početku kada je premijer Kosova i Metohije, gospodin Tači dao intervju "Jutarnjem Listu" u Zagrebu, gde je između ostalog kazao da će Srbija reagovati na to što je gospodin Tači iz Zagreba putuje za Brisel.

Ja mislim stereotipe i netrpeljivosti iz prošlosti ne treba potencirati u momentu kada se ide na nečemu što je normalizacija odnosa između Srbije i Prištine, i to je nešto što mislim da nije bilo u redu.

Sa druge strane, želim da govorim o prvoj tački pregovora i slušala sam vrlo pažljivo, gospodin Tači je kazao da će on Vladu, agencije, policiju obavezati u smislu rešavanja sudbine kidnapovanih i nestalih.

Ništa tužnije za svakog odgovornog čoveka nema nego gledati kolone porodica kidnapovanih i nestalih lica bez obzira čije su. Ali, ne vidim ni nikog kompetentnijeg osim premijera, gospodina Tačija i bivšeg potparola Slobodana Miloševića, mislim na Dačića, koji mogu da daju konkretan i jasan odgovor na sudbinu nestalih i kidnapovanih.

Gospodine Tači, vi ste bili na terenu, prvi čovek takozvane Oslobođilačke vojske Kosova. I vi sa terena znate gde su ubijeni i kidnapovani Srbi. Ja mislim isto tako, gospodin Dačić, kao pripadnik režima koji je vodio sukobe na Kosovu isto tako može da da odgovore vrlo efikasne koji će pomoći porodicama kidnapovanih i nestalih da pronađu one za kojima tragaju i koji su u dubokom ubeđenju da su oni živi.

Želim da vam kažem, što se tiče samih prelaza, želim onako životno iskustvo da prenesem, jer ja stalno putujem i izlazim na prelazu Merdare, s obzirom da sam tu i rođena. Ja, zaista želim da bude normalizacija. Želim da Srbi koji izlaze i ulaze na prostoru Kosova i Metohije ulaze slobodno. Želim da Albanci koji ulaze isto tako sa srpske strane diaspora ulazi potpuno, potpuno slobodno, neometana od bilo koga. I jedni i drugi imaju nekada češće, nekada ređe, zavisi koja se grupacija nalaze ispred policije i pogranične institucije, ili tih administrativnih prelaza, na nekorektno ponašanje određenih dela administracije.

U tom smislu za mene iz enklave biće olakšavajuće ako su tu i predstavnici kosovskih institucije i predstavnici srpske države. Ali, ono što sam u razgovoru i sa Albancima i sa Srbima čula, to je njihova zabrinutost. Znaite, nekada kažu: znate gospođo Trajković mi smo ratovali, pa da li ćemo imati ambleme jedne ili druge na uniformama, kako ćemo to se složiti. Neki govore da im je neki član porodice ubijen od jedne ili druge policijskih

snaga. To sve je u stvari nešto što treba da navede sve nas da razmišljamo na način što ćemo pomoći da to integrisanje tim prelazima protekne u što boljoj atmosferi u smislu izbora i ljudi koji će se tu nalaziti, koje će karakterisati tolerancija i da sve prolazi i da se navikava na jedan dobar i korektan način.

Što se tiče severa, ja mislim da je pre rešavanja pilot-projekta za Jerinje, možda važnije, i za mene sam duboko ubeđena važnije rešavanje u stvari pitanje statusa severa Kosova. Da onaj narod tamo koji je zaplašen, na jedan način bude rasterećen svih onih strahova koje dolaze od prihvatanja institucije iz Prištine. Jer nemojte misliti, možda vas ne informišu da ne postoje strahovi tih ljudi koji žele normalno da žive. Moj najveći je strah za broj Srba se više ne smanjuje, jer dve trećine Srba je proterano sa ovog prostora i želim da se stabilizujemo, kao zajednice, kao narod, da budemo ono što kažu - da naše trajanje bude dugovečno a funkcionalnost očuvana.

Ja moram da vas informišem, možda ne znate, ali samo 40% nadležnosti iz projekta Ahtisarijevog paketa je preneseno na novostvorene opštine sa srpskom većinom. Iz paketa policije gotovo nijedna nadležnost.

Da vam ne govorim da sve više centralne institucije urušavaju etničku strukturu tih novostvorenih većinskih srpskih opština na način što vrše privatizaciju zemljišta, tako da u Gračanici već onaj ratar je preživeo još jednu privatizaciju koja će potpuno poremetiti strukturu stanovništva mimo Ahtisarijevog plana. Posle nje, možemo isto tako da vidimo. To je da potpuno nelegitimno, nelegalno u lazi se na društvenu imovinu, ore se, kopa, obrađuje se bez ikakve dozvole, bez dogovora između stanovništva i ljudi koji su došli da uzurpiraju imovinu da bi prehranili svoje porodice. I to je pre svega rezultat nečega što je gospodin Krasnići malo pre kazao. Na prostoru od 10 hiljada kvadratnih kilometara niko ne vodi računa o projektu prostornog planiranja, gde možemo da zaštitimo poljoprivredno zemljište, da ga ne pretvaramo u građevinsku zemljište i da na taj način u stvari očuvamo mogućnost razvoja poljoprivrede za ishranu i budućnost stanovništva koje je prilično siromašno.

Gospodine premijeru! Ne bih se složila sa vašom konstatacijom da imate efikasnu policiju. Ja zaista ne znam nijedan slučaj gotovo identifikacije zločina nad Srbima, i odgovornosti za zločin nad Srbima.

Ja znam mnogih slučajeva, a i ovog poslednjeg koji je bio u gnjilanskoj regiji i gde su pretučeni srpski policajci, upalo se u kuću, rušilo, decu maltretirali, a na kraju dobili oslobađajuće presude.

Znate, ja mislim da odgovorna policija, koju svi mi želimo, treba da bude policija koja će pre svega biti odgovorna za bezbednost ne prepoznavajući ni vas ni mene kao pripadnika jedne ili drugog naroda, ali nas jasno prepoznavajući kao ljude koji jesmo legalno funkcionisali ili ilegalno funkcionisali.

Znači, ja mislim da taj stepen zaista nije u redu, a uz to zaista, ma koliko to bilo neprijatno i gospodi iz Samoopredeljenje, bilo mi je jezivo fizički napad i fizička tortura

koja je bila nad poslanicima Samoopredeljenje jer prosto mi je bilo muka da gledam ljude....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja kolege Trajković, unë edhe një herë ua kam tërhequr vërejtjen se me Kushtetutë, Kosova nuk është Kosovë e Metohi, por Kosovë.

(Ndërhyrje)

Ju, mund të dëshironi ta quani edhe diçka tjetër, por po ngjallni reaksion në sallë. Mua nuk po më pengon dëshira juaj, por reaksioni në sallë është i madh dhe do të ishte mirë që të keni pak më shumë kujdes vetëm në këtë emërtim, ndërsa kërkesat tuaja janë krejt legjitime, siç janë edhe të të tjerëve. Fjalën e ka zoti Shaip Muja.

SHAIP MUJA: I nderuar kryesues i Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Të nderuar deputetë,
I nderuar kryeministër,
Të nderuar qytetarë të Kosovës,
Edhe një herë dua që fuqishëm të shpreh mendimin dhe qëndrimin tim mbështetës lidhur me bisedimet që po zhvillohen ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, të udhëhequra nga kryeministri i Republikës së Kosovës, zoti Thaçi.

Bisedimet që tanimë po zhvillohen nga dy shtete të pavarura dhe sovrane, të monitoruara nga BE dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, tregojnë se dy shtete janë duke biseduar për zgjidhjen e problemeve të akumuluar nga regjimet shoviniste të Serbisë.

Temat që janë duke u diskutuar mendoj se janë shumë mirë të shtruar dhe janë tema që besoj se do të relaksojnë marrëdhëniet reciproke ndërmjet dy shteteve dhe sigurisht do të jenë në interes të dy popujve.

Menaxhimi i integruar i kufirit, si temë e shoshitur nga zëvendëskryeministrja Tahiri, vitin e kaluar, po bëhet realitet dhe diçka që përfundimisht Kosovës po i hap një rrugë drejt njohjes reciproke të sovranitetit territorial dhe sigurinë e dyanshme mes dy shteteve të pavarura dhe sovrane.

Mjerisht, IBM është trajtuar në mënyrë jo të denjë nga disa shkurtpamës të cilët nuk e kuptojnë rrugën dhe rrugëtimin për integrimin në Bashkimin Evropian.

1. Ndërtimi në zonën neutrale të pikës së përbashkët kufitare dhe kontrollet e plota sipas standardeve evropiane, këmbimi i informacioneve, mendoj se me këtë formë të menaxhimit do të ndalohet kontrabanda e bërë për 12 vjet rresht, me vlerë prej 7 miliardë euro.

2. Do të ndalojë marshimin e strukturave paralele të cilat janë mbeturina të Milosheviqit.

3. Do të ndalojë kaosin dhe anarkinë që mbretëron në veri dhe duke ofruar siguri për të gjithë qytetarët atje dhe do të ndihmojë që më shpejt të integrohen institucionet e Republikës së Kosovës, sipas marrëveshjes së Ahtisarit, si një zgjidhje optimale.

4. Keqbërësit matrapazë e të gjitha nacionaliteteve do të luftohen me ashpërsinë më të madhe të ligjeve në fuqi, duke zbatuar ligjin në këtë pjesë, të jetësohet edhe një standard tjetër evropian për t'u integruar në BE si dy shtete anëtare të barabarta.

Prandaj, duke u nisur nga këto që theksova, ju lus të gjithëve, pa marrë parasysh përkatësinë kombëtare, që këto angazhime t'i përkrahni dhe ta inkurajoni fuqishëm, sepse e kemi përgjegjësinë para brezave që vijnë pas nesh dhe sigurisht se të gjithë ne dëshirojmë që ata të jetojnë në paqe e lumturi.

Një nga temat më të ndjeshme, është tema e të pagjeturve, është një temë e cila nuk mund të zgjidhet brenda ditës e javës.

Të nderuar kolegë,

Unë i kuptoj plotësisht familjarët e të pagjeturve, sepse edhe unë e kam pasur fatin e keq ta kam familjarin tim të zemrës dhe të shpirtit, vëllanë tim, që për disa kohë ishte i pagjetur. Derisa e kemi gjetur, kemi pasur, unë dhe familja ime, ndjenjat e përzieria, ku para dite e imagjinonim të gjallë dhe nga mbrëmja disi varrosej në terrin, për t'u ngjallur pastaj deri në ditën kur e kemi gjetur.

Prandaj e inkurajoj secilin qytetar që din dhe ka informacione të kontribuojë për t'i gjetur këta persona që janë viktimat të një gjenocidi ndaj popullit shqiptar dhe si i tillë ka marrë dënimin edhe ndërkombëtar si regjim shfarosës.

Në këtë kuptim, shteti serb dhe lidërsihipi i saj nuk duhet të mbajë informacione të mbyllura e të klasifikuara, sepse në këtë mënyrë ajo do të bartë peshën e fajit të krimit të regjimit të Millosheviqit.

Duke biseduar ne mund të demonstrojmë para botës se jemi të gatshëm të falim, të marrim peshën e përgjegjësisë që ne e kemi dhe të ndalojmë njëherë e përgjithmonë shpifjen sistematike që bëhet në adresë të lidërsihipit të Kosovës nga mercenarë politikë ndërkombëtarë e kombëtarë për trafikim organesh e të qeniesh njerëzore.

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të Kosovës,

Jam njëri nga ata që apostrofohem për trafikim organesh, dhe që nga dita e parë kam thënë se kjo është një shpifje e kulluar dhe kjo kërkon angazhim ndërkombëtar, sepse dëmi që na është bërë, qoftë në planin kombëtar e njerëzor është munduar të goditet edhe vlera më e lartë e angazhimit tonë për liri e pavarësi. Këtë pavarësi e arritëm në saje të luftës së denjë që e bëri UÇK-ja dhe si e tillë UÇK-ja ishte dhe mbetet një vlerë e jashtëzakonshme dhe si e tillë për të do të shkruhet me krenari, sepse bëmë luftë të pastër, në përputhje me konventat ndërkombëtare.

Po ashtu, kërkojmë nga faktorët e ndërlidhur për zbardhjen e fatit të pagjeturve që të jenë më këmbëngulës dhe më praktikë e kërkues para organeve të Serbisë, që të hapen varret kolektive e të mos miratojnë konkludime se s'ka më varre në Serbi e në Kosovë.

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar deputetë,

Varre ka në veri të Kosovës, ka disa të tillë, dhe e dinë mirë, e di faktori ndërkombëtar po e di edhe KFOR-i. Dhe me arsyetimin se për shkak të sigurisë së brishtë kjo nuk vlen, sepse kjo jo që siguron apo shtyn kohë për një kohë më të mirë, është gabim. Sa më shpejt të hapen këto varre aq më mirë do të jetë klima e bashkëjetesës dhe e integritetit institucional.

Të nderuar qytetarë,

Unë jam i befasuar kur më kanë rënë në dorë disa informacione të bazuara dhe të faktuara për një varrezë masive, që kanë pasur informacione edhe institucionet ndërkombëtare të Kosovës, që janë në Serbi dhe askush nuk ka marrë guximin që të bëhet presion mbi Serbinë, për ato varre. Ato varre janë hapur me 3.5.1999, vendin ku vizitohet nga Nebojsa Filiq, ish-shefi i shërbimit sekret për Medvegje dhe komandant i policisë së regjionit të Leskocit.

Më 5.5.1999, te vendi i quajtur Petrile, ku ndahet rruga për rrugë të Zajçevcit, nga kamionët zbriten ngarkesa tejet sekrete dhe ngarkohen me 5 traktorë të popullatës lokale. Ngarkesa është mbuluar me llastik të bardhë, vozitës janë të popullatës lokale, kurse në krye të traktorëve qëndrojnë nga 2 policë të uniformuar dhe të armatosur. Ngarkesa zbarkohet te vendi i quajtur Kapi, ose përmendore, në kufi të Kosovës dhe Serbisë, ndërmjet dy fshatrave të Svircës.

Më datën 6.5.1999, në të njëjtën mënyrë transportohen edhe 2 traktorë dhe me datën 7.5.1999 varrosen në varrezën masive të gjitha trupat. Të njëjtën ditë, i ndjeri Mihajlo Jojiq, duke i parë prej largësisë duke punuar pas largimit të policisë, e vërteton se brenda gjenden kufoma dhe rroba njerëzish. I njëjti person rezulton i humbur prej dimrit të kaluar ku, pasi që mori ushqimin në punktin ushtarak në Boroc, u humb çdo gjurmë. I njëjti është burim i kësaj informate.

Më 3.4.2011, në të njëjtin vend ndërtohet një pikë e qëndrimit të policisë së Serbisë dhe nuk ka qasje në këtë pikë. Supozohet nga i njëjti burim, se kufomat mund të jenë të larguara ose mund të jenë ende aty.

Unë mendoj që ky informacion është i bazuar dhe mund t'i ndihmojë sekretarisë edhe përmes 'google earth' ku mund ta gjejmë dhe kjo u adresohet miqve tanë në lozhë ndërkombëtare që na ndihmojnë në dialog, që brenda një kohe shumë të shkurtër mund të shkojnë në atë vend në kohën prej një orë e gjysmë dhe të fillohet zhvarrimi për t'i identifikuar ato kufoma fatkeqe të atij regjimi milosheviqian. Ta njoftojmë prokurorinë e krimeve të luftës të Serbisë, që mos të flejë mbi varre të krimit të Milosheviqit dhe të mos merret me skema shpifëse antishqiptare, sepse ato varre do të jenë njollë e përjetshme e

popullit serb, e që për mua nuk është fajtor populli, por regjimi dhe mos u bëj pjesë e regjimit.

Unë personalisht s'e fajësoj popullatën serbe, dhe në këtë frymë ne së bashku po e bëjmë historinë, duke fuqizuar çdo ditë këtu ligjin dhe shtetin në dobi të gjithëve, pa marrë parasysh përkatësinë kombëtare. Kjo është ardhmëria, kjo është e vetmja rrugë.

Lus sekretarinë që këtë material t'ia dërgojë Zyrës së të Pagjeturve të Qeverisë dhe organeve të drejtësisë vendore, ndërkombëtare dhe zyrave diplomatike dhe unë jam i gatshëm ta ruaj konfidencialitetin e të gjitha informatave që dini për varrezat masive dhe ju garantoj se do t'i dekonspiroj kështu të gjitha.

Unë jam goditur vet nga shpifësit, trilluesit e mercenarët kombëtarë e ndërkombëtarë, por nuk jam gjuhëzuar, sepse unë besoj se njeriu mund të gabojë, por Zoti nuk gabon asnjëherë. Unë jam i pastër para Zotit, para familjes sime dhe para veprës sime për lirinë dhe pavarësinë e vendit tim. Unë e përkrah këtë dialog edhe pse jo plotësisht është i mirë, por optimal dhe i arsyeshëm...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hyseni e ka fjalën.

SKENDER HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar anëtarë të Qeverisë,

Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, në korrik të vitit 2010, në mendimin këshillëdhënës rreth shpalljes së pavarësisë së Kosovës, ka konstatuar rrethanat e veçanta, edhe faktike edhe legale të cilat janë të veçanta për Kosovën e të cilat kanë sjell deri te shpallja dhe pavarësimi i Republikës së Kosovës.

Janë katër rrethana dhe specifika, edhe legale edhe faktike, të cilat Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë i ka vënë në spikamë, si diçka që e bëjnë Kosovën rast shumë të veçantë, dhe këto janë:

1. Shpërbërja e dhunshme dhe jo konsensuale e ish-Federatës Jugosllave;
2. Aprovimi nga Organizata e Kombeve të Bashkuara i Rezolutës 1244;
3. Administrimi ndërkombëtar i Republikës së Kosovës; dhe
4. Shterimi i të gjitha mundësive për të arritur në një marrëveshje të negociuar, të pajtueshme dhe të pranueshme për të dyja palët për statusin e Kosovës.

Janë këto katër rrethana pak më specifike, edhe legale, edhe faktike që kanë mundësuar, i kanë dhënë legjitimitet të plotë shpalljes së pavarësisë së Kosovës, shpalljes së koordinuar të Kosovës, shtet i pavarur dhe sovran.

E theksova këtë që t'ia kujtoj Qeverisë së Republikës së Kosovë që është bartëse e dialogut me Republikën e Serbisë, se sa është e domosdoshme dhe e nevojshme që të kihet kujdes kur publikisht proklamohen, favorizohen modele të caktuara për normalizimin e marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë.

Këto deklarime publike marrin peshë akoma më të madhe kur bëhen nga pjesëtarë, anëtarë të Qeverisë në zyrë, siç ishte rasti me deklarin e ministrit të Jashtëm Hoxhaj rreth modelit gjerman, përkatësisht Traktatit gjermano-gjerman. Ishin dy deklarime tej mase kundërtëuese brenda një periudhe shumë të shkurtër kohore. Derisa në Prishtinë, ministri Hoxhaj i tha Kosovës dhe popullit të Kosovës, që ky model është interesant për Kosovën, vetëm 3-4 ditë më vonë në Tiranë e dëgjua ministrin Hoxhaj të thoshte që ky model nuk është i mirë për Kosovë.

Unë i përmenda rrethanat specifike që kanë sjell te pavarësia e Kosovës, për të konstatuar që normalizimi i marrëdhënieve midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, nuk duron importim të modeleve të gatshme, sepse janë rrethana krejtësisht të veçanta. Modelet si ai Makaos, i Hong-Kongut, Tajvanit dhe përfundimisht edhe të Traktatit gjerman-gjerman, janë përmendur në faza të caktuara të ndryshme të procesit negociator Kosovë-Serbi.

Nga Kosova ato prore janë hedhur si tërësi, edhe pse secili nga ato modele mund të përmbajë elemente të caktuara, mirëpo është gabim fundamental nëse favorizohen në një fazë krejtësisht fillestare të bisedave me Serbinë, modele të caktuara është gabim strategjik dhe tregon për mungesë orientimesh fundamentale strategjike në këtë dialog, që e konsideroj gabim dhe hendikep të madh.

Normalizimi i marrëdhënieve Kosovë-Serbi, patjetër që në një fazë të caktuar do të rezultojë në një traktat paqeje, jo domosdoshmërisht miqësie, sepse është herët të flitet për të, por gjithsesi një traktat paqeje dhe një traktat për një raport, marrëdhënie funksionale midis dy shtetesh të pavarura dhe sovrane. Dhe, ky traktat duhet të jetë i veçantë që i merr parasysh të gjitha specifikat që marrëdhëniet midis këtyre dy shteteve i karakterizojnë. Janë marrëdhënie krejtësisht të veçanta dhe unë në përmbyllje të fjalës time, me keqardhje po shoh se u zbraz kjo prapaskena, do të kërkoja nga Qeveria e Republikës së Kosovës, që të jetë shumë, shumë e kujdesshme në deklarime publike dhe të mos deklarohet me lehtësi të padurueshme për variante të caktuara, sepse kjo mund ta dëmtojë, mund ta dëmtojë në mënyrë të pariparueshme rezultatin përfundimtar për Republikën e Kosovës në këtë proces aq delikat dhe aq të rëndësishëm. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kurti e ka fjalën.

ALBIN KURTI: Deputetë, të Kuvendit të Kosovës,
Duhet ta bëjmë dallimin midis temës së etabluar në dialog dhe asaj që përmendet në bisedime. Këto nuk janë e njëjta gjë. Të pagjeturit mund të jenë përmendur, por kjo s'i bën ata temë.

Në komunikatën e Zyrës së baroneshës Eshton, pas takimit ndërmjet Thaçit dhe Daçiqit, nuk figuron tema e të pagjeturve. Pse? Pra, për këtë do të duhej të përgjigjet kryeministri.

Për çështjen e të pagjeturve, unë besoj që arrihet tek e vërteta përmes kërkesës për drejtësi dhe përgjegjësi. Pra, nuk e gjejmë një herë të vërtetën dhe mandej të kërkojmë përgjegjësi, por duke kërkuar përgjegjësi, mund të arrijmë tek e vërteta. Mirëpo, në takimet me Daçiqin, aty nuk ka kërkesë për drejtësi dhe përgjegjësi, sepse Daçiqi është bërë partner në zgjidhjen e problemeve dhe kështu ai ndodhet sipër problemeve, ndërkohë që është vetë problemi.

E dëgjuam edhe sot që Qeveria e Kosovës bazohet në pikëpamjen e Brukselit për IBM, menaxhimin e integruar të pikave kaluese dhe jo të kufirit kur zëbërthehet si fjalë sipas qëndrimit të Bashkimit Evropian. Pra, së pari kufiri ynë nuk njihet si ndërshtetëror, por vetëm si administrativ. Së dyti ai është zëbërthyer në shumësi pikash kaluese që s'përbëjnë kufi me tamam. Së treti, po harrohet barrikada në lumin Ibër dhe ndarja e Mitrovicës, përmes përqendrimit vetëm te kufiri.

Kufiri i jashtëm nuk është më kufi, atëherë kur kemi edhe kufi të brendshëm.

Me IBM, kufiri i Kosovës me Serbinë po tregohet pa u bërë një herë mirë, plotësisht.

Pikat tona kufitare po fitojnë status të veçantë. Nëse kështu bëhet normalizimi i marrëdhënieve me Serbinë, atëherë më mirë dhe më e dobishme është që t'i kemi marrëdhëniet abnormale.

Në dialogun politik në Bruksel, vendi i vëmendjes është kufiri i jashtëm i Kosovës, përmes IBM, meqenëse kemi normalizim të marrëdhënieve dhe jo barrikada në lumin Ibër, meqenëse nuk kemi normalizim të shtetit të Kosovës. Nëse mbetet e ndarë Mitrovica, do t'i duhet edhe brezi të ardhshëm të shqiptarëve të sakrifikohen.

Pra, edhe më tej them që problemi kryesor nuk është si në një zonë neutrale do të krijojmë baraka të përbashkëta me Serbinë, po se si do ta bashkojmë Mitrovicën. Thelbi është bashkimi i Mitrovicës. Dhe, mendoj që nuk mund të ketë zgjidhje të drejtë për veriun e Kosovës, pa u bashkuar Mitrovica.

E keqja kryesore e planit të Ahtisarit, është decentralizimi territorial dhe administrativ mbi baza etnike. E keqja kryesore e këtij decentralizimi etnik është komuna e veriut të Mitrovicës. Nuk ka dëm më të madh në planin e Ahtisarit se kjo e keqja kryesore, sesa që është pranuar komuna e veriut të Mitrovicës. Mbi çfarë baze një gjysmë qyteti, me gjithsej 2.3 kilometra katrorë, bëhet komunë? Dhe, kjo është fara e ndarjes së përhershme të Mitrovicës dhe shndërrimit të veriut në konflikt të ngjirë.

Edhe kjo komunë që e parasheh plani i Ahtisarit, edhe dialogu politik me Serbinë, është dorëzim i Qeverisë së Kosovës, para 300 a 400 pjesëtarëve të MUP-it në veri.

Duket qartë që dialogu politik me Serbinë është vazhdim i bisedimeve të Vjenës nga viti 2006 e 2007 dhe është i ngjashëm me gjashtëpikëshin e Ban Ki-Munit.

Vetë Thaçi, në seancën e Kuvendit, më 1 nëntor tha që temat e dialogut me Daçiqin ishin: marrëveshjet e deritanishme, të pagjeturit, strukturat e Serbisë në Kosovë, mos pengimi i Kosovës nga Serbia për anëtarësime në organizatat ndërkombëtare, decentralizimi në Kosovë, trashëgimia kulturore serbe, siç e quajti kryeministri këtu e kështu e quajnë vetëm Serbia, por edhe Ban Ki Muni. Në gjashtëpikëshin e Ban Ki-Munit, e keni - Serbien patrimonin, pra trashëgimia serbe. Ky emërtim që po e pranon kryeministri është shumë i rrezikshëm, sepse kjo është justifikim i së drejtës historike të Serbisë mbi Kosovën, siç e quan ajo, sepse dihet që të drejtë demografike dhe të drejtë politike nuk ka mbi Kosovën. Po ai e bën historinë mit, mitin histori dhe mandej duke e stërkequr trashëgiminë kulturore ortodokse nëpërmjet emërimit, trashëgimi kulturore serbe, ajo thirret për atë se si do të duhet që të kthehet në Kosovë. Pra, e pret shansin e ardhshëm që të kthehet në Kosovë dhe argumenti kryesor është serbizimi i trashëgimisë kulturore të Kosovës në atë që ata e quajnë trashëgimi kulturore serbe.

Mandej, energjia dhe telekomunikacioni, zyrat ndërlidhëse. Po pra, decentralizimi në Kosovë dhe trashëgimia kulturore serbe. Edhe sot e dëgjuam prej kryeministrit që tha këto janë temat në Bruksel. Mirëpo, a nuk u mbyllën këto tema me planin e Ahtisarit, me Kushtetutën e Kosovës dhe me përmbylljen e mbikëqyrjes së pavarësisë? Pse tash prapë te decentralizimi, pse prapë te trashëgimia kulturore? Pra, është dëshmi që plani i Ahtisarit nuk është mbyllur, rrjedhimisht që plani i Ahtisarit është hapur. Planin e Ahtisarit s'ka qenë aspak i favorshëm, bile edhe anëtarët e Ekipit të Unitetit e patën thënë që është kompromis i dhembshëm, mirëpo plani i Ahtisarit e përmban farën e bosnjëzimit të Kosovës dhe njëkohësisht, duke qenë kompromis në qendër, s'mund të jetë kompromis i fundit.

Nuk mund të thuash po lëshoj pe për planin e Ahtisarit dhe s'do të lëshoj më pe. Kur të lëshosh pe për planin e Ahtisarit, shtohen kërkesat për të lëshuar pe më shumë, sepse ke lëshuar pe për diçka që është thelbësore. Do të lëshosh pe edhe pak, derisa të mbetesh me aspak.

Me këto bisedime Thaçi nuk mund të ketë platformë për dialog me Serbinë, në Bruksel. Ju e keni parë që edhe takimi i dytë u bë pa platformë. Ky dialog nuk është nismë e tij, bisedimet me Daçiqin kanë të bëjnë me qëllimet e Serbisë në Kosovë dhe synimet e saj drejt Bashkimit Evropian.

Thaçi, në rastin më të mirë mund të ketë strategji a taktikë se s'i t'i zvogëlojë ca konsesione që do t'i bëjë, ama ai s'mund të ketë platformë, sepse këto bisedime për çështje të brendshme të Kosovës, pa kushte për Serbinë, janë gjithsesi bisedime abnormale.

Nëse zgjidhja për veriun do të ishte plani i Ahtisarit, atëherë dialogu do të ishte veçse teknik. Pra, nëse na thonë që zgjidhje të jetë plani i Ahtisarit, ky dialog nuk është politik, është teknik, sepse zgjidhja po dihet. Mirëpo, dihet diçka tjetër, që nuk është kështu, që

dialogu është politik për një lloj autonomie për veriun, që mund ta ketë pikënisje e bazë planin e Ahtisarit, por jo edhe tavan e kulm. E keni vërejtur që shumë zyrtarë ndërkombëtarë po na thonë, pikënisja do të jetë plani i Ahtisarit, nuk po thonë që do të jetë tavani plani i Ahtisarit, po pikënisja. Pra, nisemi prej planit të Ahtisarit e ku mbërrijmë ta shohim ku na çon ky dialogu politik.

Unë nuk i kuptoj ata deputetë të cilët mund t'i besojnë kësaj qeverie për respektimin e Rezolutës për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë, kur së pari u fsheh motivi kryesor pse ai u soll në Kuvend, më 18 tetor, takimi me Daçiçin të nesërmen, më 19 tetor. Edhe çka duhet të bëjë kjo qeveri kundër shtetit të Kosovës, kundër pasurisë publike të Kosovës, që të themi se nuk i besojmë më. Pra, besoj se përvoja shumë e hidhur dhe e gjatë që e kemi me Qeveri, duhet të jetë e vërteta e kësaj qeverie, e jo premtimet më të reja të saj.

Mos harroni që ai që s' ka ushtri, marrëveshjet i mbetin të parealizuar dhe i duhet të negociojë serish e pafundësisht derisa të bindet se duhet të kushtëzojë e të forcohet. I dobëti nuk ka zgjidhje tjetër përveç se të forcohet.

Nëse mendon që je i dobët e duhet për t'u lidhur me të fortin, kjo është mënyra qysh do të mbetesh gjithmonë i dobët dhe gjithnjë e më i dobët deri sa të zhdukesh plotësisht.

Ne duhet të forcohemi. Partneriteti ynë, aleancat tona me shtetet që na kanë njohur duhet përdorur për t'u forcuar, e jo për të thënë qysh jemi të dobët e duhet për të mbetur të lidhur me ta.

Dhe, po kthehem edhe një herë. Te një shtet, demokracia është me rëndësi, po ushtria dhe ekonomia janë më të rëndësishme. Kur dy orë i mungon energjia elektrike Nju-Jorkut, e merrni vesh çka i bëhet demokracisë aty.

Ekonomia dhe ushtria janë themelet e shtetit. Ne s'po i kemi asnjë, e po shkojmë në bisedime me ata që s'na njohin as ekzistencën. Prandaj, nuk ka mundësi këtu që të ketë rezultate të dobishme prej një konteksti kaq të padrejtë. Në shkrimin që u botua në gazetën "Koha Ditore", të martën më 13 nëntor 2012, me titull: "Beograd - Prishtinë dhe ndihma e vogël e Brukselit "Jellko Kacin nënkryetar i delegacionit të Parlamentit Evropian për Shqipërinë, Bosnje, Mali i Zi, Serbinë dhe Kosovën, si dhe raportues në Parlamentin Evropian për Serbinë shkruan: "lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, të cilën në Serbi është duke e drejtuar kryetari i SNS-së Vuçiç, është parakusht për vendosjen e sundimit të ligjit që po ashtu "do të lirojë" serbët në veri të Kosovës.

Nga roli i pengut, përkatësisht objektit që është shfrytëzuar për shumë nevoja të brendshme politike serbe të të gjitha qeverive të mëparshme, ata më në fund do të jenë temë bisedimesh me nivel të lartë autonomie brenda tërë Kosovës. Kështu ka deklaruar Jellko Kokaci, asnjë reagim nga Qeveria jonë. Shtefan Llehne tha: "autonomi", Albert Rohani tha: "një lloj autonomie", Daniel Serveri që Ministria jonë e Punëve të Jashtme e ka paguar tre muaj 10 mijë euro si këshilltar në vitin e kaluar e propozoi formulën e Federatës Boshnjako-Kroate, mandej e kemi këtë modelin e dy Gjermanive. Ju po e

shihni qysh po bombardohemi me opsione në mënyrë që të ambientohemi me humbjen e veriut që është e garantuar me këtë dialog pa kushte për Serbinë e për çështje të brendshme të Kosovës. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Petar Miletic.)

KRYESUESI: Hvala! Reč ima poslanik Shaip Muja, replika.

SHAIP MUJA: I nderuar kryesues!

Parafolësi ynë aludoi tek disa deputetë, të cilët përkrahin dialogun me Serbinë dhe mendoj se konsumon në mënyrë të vullnetshme shpifjet edhe nuk paraqet në mënyrë reale realitetin lidhur me menaxhimin e integruar të kufijve duke i quajtur disa “baraka” aty.

Unë mendoj që nuk e njeh esencën e organizimit të kontrolleve evropiane ndërkufitare dhe etapën para se të fillojnë shlyerja e kufijve në tërësi në një Evropë të bashkuar. Prandaj, unë lus të gjithë ata, të cilët mundohen t’i futë parafolësi në lajthitje, mos t’i besojnë këtyre teorive, sepse janë teori boshe dhe ne duhet të dialogojmë. Më mirë të dialogojmë 100 vjet se sa të luftojmë edhe një vit. Prandaj, këto shqetësime janë të pabazuara dhe mendoj që janë në një situatë ku faktet paraqiten të shtrembëruara për të krijuar një opinion duke goditur çdo herë në një pikë dhe do të ndihet një zhurmë. Prandaj, i lus edhe parafolësit, është në interes të subjektit politik që të organizohet dhe të bisedojë në mënyrë më objektive lidhur me çështjet, të cilat parashtrihen dhe ta shohë me një sy më real situatën. Faleminderit!

KRYESUESI: Hvala! Kontra-replika gospodina Kurti.

ALBIN KURTI: Janë dy teza për integrimin në Bashkimin Evropian e njëra prej tyre është “sui generis” që po përdoret për Kosovën. Unë jam që Kosova të bëhet vend sovran me gjithë mend dhe mandej le t’i dobësojmë kufijtë, por pasi që t’i kemi ata njëherë. Dhe, është teza tjetër që shtet ndërtimin në Kosovë e redukton në ndërtim të shtetit anëtar, ku inkudrimi i Kosovës në Bashkimin Evropian, jepet si zëvendësim për sovranitetin e plotë. Unë nuk i përkas kësaj tezës së dytë dhe kjo teza e dytë po zhvillohet jo në formë teorie, por në formë të fakteve. IBM-i për Kosovën është marrë si akronim, IBM - Integrated Border Management, por, kur zbërthehet në deklaratat e Zyrës së Eshtonit, atëherë del “Integrated Crossing Points Management”, po pika kaluese Integrimi i Menaxhuar i Pikave Kaluese, s’po na e njohin si kufi. Ndërmjetësuesi s’po na njeh, Serbia s’po na njeh, e ju po thoni që po bëhemi sovran në këtë trekëndësh të Bermudeve, përkundrazi, unë mendoj që këtu neve na zhduket shtetësia.

KRYESUESI: Još jednom ću vam dozvoliti da imate repliku. Gospodin Muja ima reč.

SHAIP MUJA: I nderuar, kryesues!

Unë nuk mund ta kuptoj si mund të quhet një akronim i tillë kur në atë pikë kufitare do të ketë policë, do të ketë institucione, siç janë: kontrolli veterinar, do të jetë kontrolli

doganor, do të jenë të gjitha shërbimet të cilat i kanë një pikë doganore duke këmbyer edhe informacionet me qëllim të parandalimit të transferimit të dyanshëm të kimit.

Prandaj, këto shqetësime IBM-i është njëra ndër format më të rëndësishmet të këtij dialogu, të tjerat janë në rend të dytë dhe shpjegimet që mundohet parafolësi im t'i bëjë se ato janë "Cross border" nuk është e qëndrueshme dhe i sugjeroj që të lexojë më mirë. Janë munduar që ta quajnë "IBBM - Integrated ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Hvala, gospodine Muja. Da li želite da govorite, gospodine Kurti? Reč ima gospodina Kurti.

ALBIN KURTI: Si IBM duket mirë, si akronim, mirëpo në kllapa zbërthimi i saj nuk është fjala "Border" më, është "Crossing Points". Shikoni në deklaratat e Zyrës së Eshtonit dhe do të bindeni për këtë.

Prapë, po them s'është fjala për teori, është fjala për fakte. Dhe, mos u kënaqni me këso aspiratash, ambiciesh të vogla do t'i kemi policët tanë në kufi. Edhe në kohë të autonomisë ke pasur policë në kufi. Nuk është çështje të kesh policë në kufi, çështje është ta kesh kufirin në kufi, që do të thotë shteti ynë të bëhet shtet sovran dhe mos harroni që në këto bisedime që po zhvillohen me Serbinë, nuk është Serbia veç kundër pavarësisë, Serbia është kundër shqiptarëve, ajo edhe autonominë neve na e ka hequr, edhe autonomia iu ka dok tepër asaj. Ajo ka provuar gjenocid në Kosovë, prandaj me Daçiçin që është pasardhësi drejtpërdrejtë politik i Millosheviqit të thuash që po e bëj Kosovën sovranë është absurde. IBM-i edhe njëherë kur zbërthehet si fjalë është Crossing Points, nuk...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Reč ima potpredsednik Vlade, gospodja Tahiri. Izvolite!

EDITA TAHIRI: I nderuar, kryeministër!

Kryesues i Kuvendit,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Meqenëse kam qenë në procesin e bisedimeve teknike ku është arritur edhe Marrëveshja e menaxhimit të integruar të kufirit ndërshtetëror midis Republikës së Kosovës dhe Serbisë dhe duke qenë se kjo marrëveshje ka qenë publike dhe për të gjithë ata që duan ta lexojnë drejt dhe ta lexojnë sipas ligjeve të Bashkimit Evropian, e kuptojnë mirë se është fjala për kufirin ndërshtetëror mes dy shteteve. Dhe, unë kisha rekomanduar për ata që kanë dilema që të shkojnë të lexojnë pak më shumë, veçmas Traktatin e Lisbonës, sepse ky traktat i Lisbonës, në fakt e definon IBM-in, menaxhimin e integruar të kufirit mes shteteve anëtare të Bashkimit Evropian dhe shteteve që aspirojnë të bëhen pjesë e Bashkimit Evropian dhe që se nuk ka asnjë rast tjetër që zbatohet në Evropë, përveç për kufijtë shtetëror.

E dyta, sigurisht që tendenca e palës serbe në këto bisedime ka qenë që të quhet “IBBM” por ne s’kemi pranuar, Qeveria e Republikës së Kosovës nuk ka pranuar asesi që kjo marrëveshje të dalë nga definicioni ligjor që e ka bërë Bashkimi Evropian dhe Traktati i Lisbonës. Prandaj, quhet IBM dhe prandaj në përkthim Integrated Border Management, siç e tha edhe një prej diskutuesve është fjala për border, për kufij edhe atë kufi ndërshtetëror.

Çështja e zbatimit të marrëveshjes është e precizuar shumë qartë, ju lutem në protokollin teknik deri në detaje. Të dyja shtetet me autoritetet e tyre përkatëse, pra veprojnë dhe bashkëpunojnë sipas modelit evropian, autoritetet përkatëse nëse ka nevojë edhe njëherë po ua themi Policia e Republikës së Kosovës, Doganat e Republikës së Kosovës, agjencitë shoqëruese të ABUK-ut etj që janë kompetente. Në anën tjetër po ashtu pala tjetër, shteti tjetër i ka përfaqësuesit e vet dhe deklaratat për të cilat dëgjova se dikush i referohet, unë do të thosha kështu: ju lutem, për krejt marrëveshjet e arritura Qeveria e Republikës së Kosovës i ka bërë publike. I kemi bërë publike që ju të gjithë të uleni t’i studioni dhe kur diskutoni, diskutoni mbi dokumentet që jemi marrë vesh, jo për deklarata që mund të dalin aty-këtu.

Pra, ky ka qenë edhe qëllimi jonë që t’ua vëmë në dispozicion marrëveshjet me tekste integrale dhe tash vijnë në pyetje kapacitetet për t’i analizuar ato. Ndoshta, duhet të ketë ekspertë në subjektet e caktuara, ekspertë të Bashkimit Evropian e të Integritimeve Evropiane që dinë të lexojnë, të interpretojnë drejt. E dyta, më lejoni t’ju them me politikat e betonimit të mendjes nuk mund të kontribuojmë për shtetin. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Na osnovu čega gospodine Kurti, nisam čuo da vas je govornik pomenuo. Niste pomenuti. Nisam čuo. Replika gospodina Kurti.

ALBIN KURTI: Tash e kuptuam një gjë që s’kemi mundur ta marrim vesh në Komisionin për Punë të Jashtme, për shkak se zonja Edita Tahiri nuk u përgjigjej ftesave tona.

Serbia, pra paska dashur IBBM, ne kemi thënë IBM dhe kompromisi ka qenë IBM me (Crossing Points) në kllapa, qysh e ke... tash e kuptuam se çka ka ndodhur.

Tjetra, ndërmjetësuesi... ndërmjetësuesi ne nuk na njeh. Traktati i Lisbonës nuk vlen për Kosovën, ty BE-ja nuk të njeh, kot thirresh ti në Traktatin e Lisbonës. Dhe, e treta mos u krahasoni me qëllimet e Serbisë. Serbia ka dashur IBBM edhe sa mirë që s’u bë, se Serbia ka dashur të na zhduk krejt. Pra, ju duhet të keni plane tuaja, qëllime tuaja dhe të shohim se sa po i realizojmë. Mos na i përmendi qëllimet e Serbisë edhe pozicionet e saj, sepse nuk mund ta masim suksesin tonë karshi qëllimeve të paralizuara të Serbisë, se ato janë gjenocidi mbi shqiptarë.

KRYESUESI. Edita Tahiri ima reč.

EDITA TAHIRI: Deputet Kurti, tash po të drejtohem drejtpërdrejt. Në Bruksel dhe në bisedime teknike nuk kemi shkuar për të shprehur listë dëshirash, kemi shkuar ta

mbrojmë interesin nacional dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ligjet e Republikës së Kosovës, ku IBM-i apo Menaxhimi i Integruar i Kufirit, është pjesë e Kushtetutës dhe ligjeve të Kosovës, siç e dini Kosova është model në rajon e cila e para e ka nisur dhe zbatuar këtë model evropian.

E dyta, IBM-i nuk është dëshirë e dashje, është ligj evropian, është e bazuar në Traktatin e Lisbonës.

E treta, për sa i takon zhdukjes, zoti Kurti, me gjasë jeni frikuar prej zhdukjes, prandaj s'keni marrë pjesë në lëvizjen për pavarësi edhe në luftën e UÇK-së. Mos u frikësoni tash është kryer kjo punë, ma. Frika nga zhdukja nuk ekziston zoti Kurti e kemi kryer ne. Faleminderit!

KRYESUESI: Gospodin Kurti!

ALBIN KURTI: Vetëm edhe një sqarim, kjo IBM-i si akronim me të vërtetë është IBM, por në kllapa mandej është (Integrated Crossing Points Managment) Pra, mos thoni të pavërteta, sepse po përpiqeni ta manipuloni, ta mashtroni opinionin me gjëra të paqena. Nuk bëhet fjalë për kufij normal, janë duke u përdorur formula “sui generis” që bëjnë eksperimente me shtetin tonë.

Dhe, le të mos e personalizojmë këtë debat, sepse e dinë qytetarët se ku kemi qenë e çfarë kemi bërë. Le të flasim për IBM-in, nuk është IBM-i sikurse të shtetet tjera normale, sepse BE-ja nuk na njeh dhe Traktati i Lisbonës nuk vlen për neve.

KRYESUESI: Gospođa Tahiri ima reč.

EDITA TAHIRI: Edhe te çështja e njohjes nga Bashkimi Evropian, e para, Republikën e Kosovës e kanë njohur shumica e vendeve të Bashkimit Evropian. 22 shtete nga 27, në mesin e tyre fuqitë kryesore evropiane e kanë njohur Republikën e Kosovës. Mirëpo, për të kuptuar se si veprojnë marrëdhëniet ndërkombëtare duhet të ketë njohje për marrëdhëniet ndërkombëtare. Për të njohur si veprojnë marrëdhëniet ndërkombëtare Komisioni për Politikë të Jashtme i Parlamentit Evropian u desh të mos mbetet kaq i izoluar. Vetë fakti që sot kemi një Komision për Politikë të Jashtme të udhëhequr nga zoti Kurti, të cilin asnjë shtet, asnjë Parlament nuk fton në takime, tregon se ka...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Hvala! Idemo dalje, reč ima poslanik Goran Marinković.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala predsedavajući!

Poštovani premijeru,

Poštovani ministri,

Poštovane kolege poslanici,

Ako pogledamo unazad, svih ovih godina čekao se ovaj trenutak oko početka pregovora Srbije i Kosova i stvarnoa mislim da je došlo vreme za ovaj istorijski dogovor.

Srbima i albancima je potreban dogovor oko zajedničkog života i dogovor o zajedničkoj budućnosti. Rešenje pitanja odnosa srba i albanaca na Kosovu mora se prići iz više različitih pravaca, kako bi smo rešili mnoga pitanja ma iz kog delokruga iz koje sve neinteresovanja dolazili.

Rešenju pitanja pregovora mora se prići iz još jednog razloga, a to je zajednički i za jednu i za drugu stranu. A to je da nerešavanje predstavlja prepreku obema stranama da nastave sa izgradnjom svojih institucija, bez čega neće biti suštinskog napretka obeju strana za evropske integracije, a znamo da je to cilj i Srbije i Kosova.

Poštovane kolege poslanici, s početkom pregovora moramo sa više optimizma gledati na dalje procese i dogovore obeju strana. Srpska strana mora da se izbori kako bi srbi na Kosovu mogli da imaju održiv opstanak uz maksimalne garancije Evropske Unije, kako bi se zaštitili njihovi legitimni interesi, među kojima izdvojiću neke a koji su najznačajniji a to su:

- povratak aprogananih,
- zaštita kulturnog i verskog nasleđa, kao i
- postavljanje što šire samouprave na teritoriji, gde je većinsko srpsko stanovništvo.

Ovi ciljevi, niti bilo koji drugi, se neće postići nametanjem rešenja ili izbegavanjem pregovora, pristup međusobnih ustupaka je veoma bitan za ceo proces pregovora, na primerima kao što je Dejtonski sporazum ili sporazum iz Ohrida, koji su iza nas i mogli smo videti delotvornost i efikasnost takvih sporazuma.

Gospodo poslanici, uzimajući različite primere u svetu, kao što sam pomenuo gore, mislim da ne možemo dobiti dobar rezultat. Dobar rezultat možemo dobiti jedino uzajamnim poštovanjem i uvažavanjem interesa obeju strana u pregovorima. Samo na taj način možemo doći održivog i trajnog rešenja. Hvala!

KRYESUESI: Hvala! Reč ima poslanik Ramiz Lladrovci.

RAMIZ LLADROVCI: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra, kolegë deputetë,

Procesi i bisedimeve me Beogradin, konkretisht të dy takimet të nisura midis dy kryeministrave si përfaqësues të shteteve të pavarura, konsideroj se si proces që duhet parë në radhë të parë në interes të plotë dhe shumë të rëndësishëm për vendin tonë.

Në këtë rast, dua të përshëndes dhe të falënderoj paraprakisht kryeministrin e Republikës së Kosovës, zotin Hashim Thaçi që duke kryer obligimin e tij na informoi ne me përmbajtjen e këtyre dy takimeve me atë që është biseduar në Bruksel. Por, nga e gjithë ajo që dëgjova nga ky raport do të veçoja vetëm disa nga çështjet. Pala jonë në këto bisedimi duhet përqendruar gjithnjë dhe në radhë të parë në mbrojtjen, artikullimin dhe zbardhjen e çështjes së të zhdukurve të luftës, problemi i të zhdukurve është më i prekshmi. Janë më shumë se 2 000 persona, fati i të cilëve ende nuk dihet dhe pa biseduar

nuk mund të zgjidhet asgjë, kurse alibia e të paditurit nga Qeveria serbe, nuk qëndron. Andaj, unë besoj se me qasje më të vendosur, sidomos nga strukturat e ngritura për këtë qëllim, është e mundur të ketë një zgjidhje më të shpejtë. Edhe pse nuk besoj se Qeveria serbe do të jetë e gatshme të dëshmojë për një pjesë të krimeve që i ka bërë në Kosovë, por është e domosdoshme që të ngulet këmbë deri në fund.

Kosova dhe mijëra familjarë të të zhdukurve të luftës tash sa kohë jetojnë në ankthin për fatin e tyre. Janë zhvilluar sa e sa takime paraprake në nivelet tjera midis Prishtinës dhe Beogradit, por asnjë rezultat nuk ka pasur në këtë drejtim. Zbardhja e fatit të pagjeturve është e domosdoshme, imediate dhe rëndësishë paqësore. Çështja tjetër që duhet zgjidhur dhe nga e cila presim po ashtu rezultatet konkrete nga ky dialog, është ajo e shpërbërjes së të ashtuquajturave strukturave paralele në veri të Kosovës. Inkurajoj kryeministrin që të jetë shumë i vendosur në këtë drejtim. Serbia duhet që sa më parë të tërhiqet nga veriu u vendit tonë me të gjitha strukturat, bandat kriminale që i financon atje.

Kjo do të duhej parë edhe si kusht për ecjen më tej në rrugën e bisedimeve për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve tona si dy shtete të pavarura e sovrane. Gjithashtu, për asnjë moment nuk duhet lënë anash çështjen tash e sa kohë të mbetur pezull dhe të pazgjidhur atë të shqiptarëve të tri komunave shqiptare përtej kufirit lindor të Kosovës: në Preshevë, Medvegjë e Bujanoc. Do të ishte e papërgjegjshme që kryeministri Thaçi e ka potencuar në informatën për të gjithë ne dhe e cila u bisedua në Bruksel, është ndërtimi i Autostradës Prishtinë - Merdar - Nish.

Të nderuar kolegë deputetë,

Ideja është interesante, ndonëse unë personalisht në këto rrethana dhe në kuadër të këtyre marrëdhënieve që kemi me Serbinë, nuk do të mund të udhëtojë nëpër të, unë e as shumë bashkëluftëtarë të mi. Por, ndërtimi i kësaj autostrade megjithatë do të jetë në interes për të dyja vendet dhe popujt tanë në aspektin e lëvizjes së lirë të njerëzve dhe mallrave, dhe zhvillimit ekonomik. Kjo do të jetë me interes mbase edhe për rajonin dhe më gjerë. Mbase me mentalitet të vjetër nuk mund të ndërtojmë rrugë të reja, nuk mund të mbërrijnë pajtimet e mëdha dhe marrëveshjet e reja. E hapin e parë në këtë drejtim për të shkëputur nga e kaluar e errët e saj duhet ta bëjë vetë Serbia.

Andaj, të nderuar kolegë deputetë, të gjithë ne duhet t'i përkrahim edhe më tej këto bisedime, por konform Rezolutës që kemi miratuar në këtë Kuvend. Kosova dhe populli ynë ka nevojë të jetë sa më parë pjesë e Evropës së bashkuar, kurse atje nuk mund të mbërrijmë duke izoluar dhe duke i ikur asaj që është platformë e civilizimit, uljes në tavolinë për të biseduar.

Në këtë tavolinë e kemi argumentin tonë. Është fat i madh që përfaqësuesit tanë në këto bisedime janë të barabartë me përfaqësuesit serbë, por njëkohësisht shumë më të dinjitetshëm. Edhe ne le ta mbrojmë dinjitetin e tyre, ta mbrojmë me vendosmëri. Ju faleminderit!

(Drejtimin e seancës e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Osmani e ka fjalën.

VJOSA OSMANI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Në radhë të parë është një çështje që shpresoj të sqarohet përfundimisht dhe ka të bëjë me gjuhën Kushtetuese që është përdorur në Rezolutën e Kuvendit, e cila në pikën pesë kërkon raportim dhe jo informim nga kryeministri.

Prandaj, ju lus që për hir të respektimit të Rezolutës edhe në kërkesën që bëhet nga kryeministri në të ardhmen të kërkohej jo informatë e Kuvendit, por raportim. Në fakt ajo po ndodh, po ndodh raportimi, sepse sikur të kishte informatë nuk do të kishte debat nga deputetët, por është mirë që edhe në dokumentet e Kuvendit edhe në dokumentet, kërkesat e kryeministrit t'i referohemi raportimit e jo informimit, sepse janë dy kategori të ndryshme kushtetuese dhe ligjore.

I kam disa pyetje për kryeministrin, shpresoj që të kemi sqarim. E para, ka të bëjë me çështjen e të pagjeturve. Zoti kryeministër, ju sot deklaruat se keni diskutuar për këtë çështje, mirëpo nuk e sqaruat në qoftë se kjo ka qenë thjeshtë një temë që e keni shtruar ju apo është diskutuar edhe nga kryeministri serb? Në qoftë se kjo temë është diskutuar edhe nga kryeministri serb, cilat kanë qenë informatat apo qëndrimi që e keni marrë nga ai lidhur me vendndodhjen e afër 2 000 të zhdukurve kosovarë? Arsyeja pse po pyes është sepse zëvendëskryeministrja Tahiri para shumë muajsh pat deklaruar në Kuvend se janë shumë afër zbardhjes së kësaj çështjeje dhe se sipas informatave që kanë marrë, të dhënat për të zhdukurit nga Kosova gjenden në arkivat e ushtrisë serbe, mos gabofsha ashtu patët deklaruar edhe është konfirmuar kjo informatë edhe në Kuvendin e Kosovës. Tani neve na intereson nëse ka ndonjë kontinuitet në këtë proces nga informatat që janë marrë në dialogun paraprak dhe nëse kërkesa juaj ka qenë specifike që të hapen këto arkiva të ushtrisë serbe. Nëse e keni bërë këtë kërkesë, cila ka qenë përgjigjja që keni marrë nga kryeministri Daçiq?

Po ashtu, mendoj që është e rrezikshme që e tërë kjo çështje prapë të shkojë vetëm në nivel të komisioneve qeveritare, sepse ai komision ne e dimë të gjithë ekziston qysh nga paslufta dhe nuk ka sjell rezultate konkrete. Vetë fakti që i kemi afër 2 000 të zhdukur ende tregon që kjo çështje domosdo duhet të shtrohet si kërkesë e pakompromis nga ju, e jo si diçka që është e negociueshme.

Çështja e dytë është çështja e strukturave ilegale. Menjëherë pas takimit të dytë që e keni mbajtur në Bruksel, RTK-ja ju ka cituar që ndër të tjera është biseduar edhe për veriun. Unë po supozoj që kjo ka qenë në kontekst të largimit të strukturave ilegale serbe në veri, mirëpo shpresoj që ta sqaroni kur thoni “kemi biseduar për veriun”. Prapë, a ka qenë kjo thjeshtë kërkesë e juaja që ju keni thënë “të shuhet këto struktura” apo është negociuar për këtë? Sepse, çështja e shuarjes së strukturave duhet të jetë kërkesë e jo çështje negociimi apo çështje bisedimi.

Gjithashtu, na intereson të dimë si do të reagoni ndaj qëndrimit serb të përsëritur dhe edhe nga kryetari i Kuvendit serb, që strukturat serbe në Kosovë nuk do të shuhen, por e tëra që do të diskutohet në dialog është që financimi i tyre të bëhet transparent dhe të ketë mbikëqyrje të BE-së mbi këtë financim. Cili është qëndrimi juaj ndaj këtij pozicioni serb?

Sa i përket çështjes së trashëgimisë kulturore fetare serbe, është mirë që sot deklaruar se çështja që është diskutuar është mbrojtja fizike e tyre, mirëpo a ka kërkesë të Serbisë që të ketë privilegje të mëtutjeshme për Kishën Ortodokse Serbe apo në përgjithësi për trashëgiminë kulturore dhe fetare serbe në Kosovë? Duhet të potencohet se deri tani të drejtat dhe privilegjet që i janë dhënë trashëgimisë serbe, një kompromis mjaft i dhembshëm që e kanë pranuar i gjithë spektri politik në Kosovë, bie në kundërshtim me çdo parim të laicitetit dhe barazisë fetare e kulturore, parime këto që mishërohen në Kushtetutën e Kosovës. Nëse këto privilegje rriten, përveç që rrezikojnë funksionalitetin e shtetit të Kosovës, po ashtu rrezikojnë të krijojnë e thellojnë ndarje të mëdha ndër fetare në Kosovë dhe të krijojnë ndarje edhe mes komuniteteve në vend se t'i integrojnë ato.

Prandaj, shpresoj që para këtij Kuvendi dhe qytetarëve të Kosovës, do ta sqaroni në detaje se në çfarë konteksti është biseduar çështja e trashëgimisë kulturore e fetare dhe cilat kanë qenë kërkesat e shtruar nga Serbia?

Përfundimisht, ju e përmendët disa herë para këtij Kuvendi që Serbia ka interes legjitim mbi qytetarët serbë në Kosovë, interesimi i tyre mbi qytetarët e Kosovës është interesim legjitim, e përdorët fjalën “legjitim”. Mirë, besoj që do ta sqaroni. Dy herë u përmend që ka të drejta që të interesohet dhe këto të drejta janë të drejta legjitime për t'u interesuar për qytetarët serb. Pyetja ime është: në qoftë se edhe ju konsideroni që keni interes legjitim për të drejtat e qytetarëve të Kosovës Lindore. A i konsideroni ato po ashtu interes legjitim?

Përfundimisht, një pyetje që shpresoj që do të sqarohet këtu u përmend disa herë çështja e IBM-it, unë nuk po hy në detaje, sepse e vërteta në fakt është në mes të asaj që u tha nga zoti Kurti dhe zonja Tahiri, është e vërtetë që përmendet fjala “Crossing Points”, por është po ashtu e vërtetë që përmendet Traktati i Lisbonës, i cili shumë qartë e përcakton konceptin e IBM-it, por në fakt problemi është te protokollin teknik që duhet të zbatohet dhe sa jemi informuar ne së fundi në këtë Kuvend problemi ka pas mbetur te mos nënshkrimi nga Serbia. Cilat janë të arriturat deri tani rreth nënshkrimit apo mosnënshkrimit nga Serbia lidhur me protokollin teknik, i cili sqaron besoj shumicën e dilemave që u përmendën sot këtu në Kuvend lidhur me IBM-in? Faleminderit! Shpresoj që do të marr përgjigje.

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë, Edita Tahiri.

EDITA TAHIRI: Lidhur me pyetjet që u shtruan nga deputetja Osmani e para dua t'ju njoftoj se pala serbe e ka nënshkruar protokollin teknik me vonesë 6-7-mujore. U desh ta nënshkruajë në fund të raundit të nëntë, në fund të shkurtit, por e ka bërë në fund të shtatorit dhe për këtë ne kemi marrë njoftimet zyrtare nga Bashkimi Evropian, që tashmë është e nënshkruar. Dhe siç e dini kur është arritur kjo marrëveshje ne vazhdimisht kemi

thënë se marrëveshja e IBM-it është ndër marrëveshjet më të rëndësishme që ka ndodhur në dialogun teknik, sepse me këtë de fakto Serbia ka njohur integritetin territorial të Republikës së Kosovës. Kjo u pa pastaj kur Bashkimi Evropian në dokumentin për zgjerim për Serbinë, të cilin ia dorëzoi në fillim të tetorit kërkoi decidivisht që Serbia duhet të respektojë integritetin territorial të Republikës së Kosovës.

E dyta, lidhur me këto çështjet e të pagjeturve, siç e kemi thënë edhe atëherë ne kemi dorëzuar me shkrim platformën dhe kërkesat tona dhe është e vërtetë që një prej kërkesave tona ka qenë hapja e arkivave të ushtrisë serbe dhe në takimet që po ndodhin midis dy shteteve në nivel të kryeministrit të Republikës së Kosovës, zotit Thaçi dhe andej homologut të tij serb me ndërmjetësimin e baroneshës Eshton, mbi këtë bazë pra ka filluar në dialogun teknik, vazhdojnë bisedimet për çështjet e pagjeturve. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kryeministri i Kosovës, zoti Hashim Thaçi.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, e nderuara deputete Osmani, për pyetjet tua korrekte!

Zëvendëskryeministrja i potencoi disa prej çështjeve që ju i ngritët gjithashtu dhe sqaroi dhe falënderoi për punën e saj të shkëlqyeshme që e ka bërë në këtë proces. Unë nuk kam çka t'i shtoj më tepër asaj se sa që e prezantova në fillim që është e tëra, e kam informuar edhe kryetarin e Lidhjes Demokratike të Kosovës, zotin Mustafa edhe përfaqësuesit e AAK-së, edhe partitë tjera politike ata që kanë dashur që të jenë të informuar edhe unë ju falënderoj për korrektësinë dhe mbështetjen në proces.

Ajo çka unë deklarova dhe do të rideklojoj përsëri, unë interesimin e Serbisë për serbët në Kosovë e respektoj për aq sa ne kemi mirëkuptuar dhe aprovuar në dokumentin e presidentit Ahtisari, as më pak, as më shumë. Dhe në këtë drejtim, ajo çka ka ndodhur në takimin e dytë pajtueshmëria jonë për projektin infrastrukturor, pra për fillimin e ndërtimit të autostradës me mjetet e Bashkimit Evropian, Prishtinë - Merdar - Nish apo Prishtinë - Mutivodë - në drejtim të Leskocit, është hapi i parë që bëhet dhe ka qenë iniciativë e jona që të punohet në këtë drejtim dhe unë e mirëpres atë pajtueshmëri tonën dhe falënderoj Bashkimin Evropian për mirëkuptimin që ka treguar që të ndërtojmë autostrada komunikimi që e lidhin Kosovën me korridorin evropian. Prandaj, sa i përket hapësirave ku jetojnë shqiptarët me shumicë në takimin e dytë ne kemi arritur që këtë projekt infrastrukturor ta nxjerrim dhe ai projekt infrastrukturor i autostradës, ju jeni e informuar se do të kalojë kryesisht në hapësirat e banuara me shumicë shqiptare edhe në Kosovë edhe në hapësirat tjera përtej kufirit aktual të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, bëjmë pauzë deri në orën 14:00 të drekës.

* * *

(Vazhdimi i mbledhjes, pasdite)

(Mbledhjen e drejtoi nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Të nderuar deputetë, ju lus që t'i zini vendet. E vazhdojmë seancën. Rendi ka mbetur te zoti Selimi. Urdhëro!

REXHEP SELIMI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Ky debat është ai që pak a shumë ma ka orientuar fjalimin me të cilin do të ju drejtohem juve.

E dëgjova nga një koleg deputet që thotë se për procesin e normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë, respektivisht për procesin e negociatave me Serbinë, që thotë le ta pranojmë këtë proces në mënyrë të dinjitetshme, sado i dhimbshëm qoftë ai. Kështu, më duket, përafërsisht, nëse kam arritur ta parafrazoj.

Apo, edhe një anëtar i Qeverisë që thotë 'mos keni frikë nga ky proces'. Dhe, nuk e di pse m'u kujtua tmerri i shumë civilëve shqiptarë në kohën e luftës, kur batutën e dhimbshme të trishtueshme: "Mos u tutë, se e kam dorën e lehtë!", e kam dëgjuar shumë shpesh.

Po ashtu, gjatë diskutimeve të anëtarëve të mazhorancës e dëgjova një thënie që nuk e kam dëgjuar me herët, por as që e kam ndërmend ta ruaj si një thënie të mençur: "Më mirë 100 vjet dialog, sesa një vit luftë!".

Kjo i bie që të mohohet lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Kjo i bie që lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nuk ka qenë e mirë dhe i bie që më e mençur është 100 vjet dialog me Serbinë sesa një vit luftë që e ka bërë Ushtria Çlirimtare e Kosovës.

Dhe, në fund, kryeministri na tha që në pikën e pestë të rundit të dytë është trajtuar tema e trashëgimisë, respektivisht Qeveria e Kosovës ka marrë angazhime për ruajtjen e trashëgimisë fetare e kulturore serbe në Kosovës.

Po trashëgiminë kulturore kombëtare shqiptare, pse nuk na e mbroni, zoti kryeministër? Po flamurin kombëtar shqiptar, pse nuk na e mbrojt asnjëherë z. kryeministër?

Në të njëjtën ligjëratë, me të njëjtin ton optimizmi u tha që njësitë e veçanta të Policisë së Kosovës do të merren me ruajtjen e trashëgimisë kulturore, respektivisht me ruajtjen e objekteve kulturore të ashtuquajtura serbe në Kosovë.

Këtu fillon ndarja e njësive të Policisë së Kosovës me detyra etnike, për qëllime etnike, që i bie se këtu de facto fillon ndarja etnike e njësive të Policisë së Kosovës.

Gjatë kësaj rrjedhe të kësaj seance kishte disa reagime të disa deputetëve, vetëm të mazhorancës, kësaj radhe, rreth flamurit kombëtar shqiptar në foltoren e Kuvendit të Kosovës, duke klithur si nëpër dhembë se ne e kemi bërë moti këtë betim, se ne e kemi bërë kur ju keni qenë të vegjël e të tjera, e të tjera.

Unë kam dyshime nëse vërtet është bërë ai betim ndonjëherë, por e kam fjalën për ata që nëse kanë arritur ta bëjnë atë betim, dua të jua kujtoj edhe njëherë. Betimi i ushtarit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, për ata që e kanë harruar, ishte:

“Si pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, betohem se do të luftoj për çlirimin e tokave të pushtuara të Shqipërisë dhe bashkimit të tyre. Do të jem përherë besnik, luftëtar i denjë i lirisë, vigjilent, guximtar dhe i disiplinuar, i gatshëm që në çdo kohë, pa e kursyer as jetën time, të luftoj për mbrojtjen e interesave të shtetit dhe të atdheut. Nëse e shkel këtë betim, le të ndëshkohem me ligjet më të ashpra të luftës, dhe nëse tradhtoj, qoftë i humbur gjaku im. Betohem!”

Pra, shumë të tillë që u ka humbur gjaku, i kemi edhe këtu në Kuvendin e Kosovës.

KRYESUESI: Zoti Halit Krasniqi e ka fjalën.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryesues!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Zëvendëskryeministër, ministra,

Të nderuara kolege dhe të nderuar kolegë deputetë,

Gjatë punimeve të paradites, e kam ndërruar nja tri herë fjalën time, sepse impononin akcentet që u dëgjuan dhe ma imponuan tani një përmbajtje, të cilën do të mundohem ta paraqes këtu.

Kur kam folur për femrën në këtë foltore, i kam spikatur virtytet e saj më të çmueshme që i njeh historia e njerëzimit dhe sidomos historia e pushtimit tonë shumëshekullor dhe natyrisht që jam munduar ta përshkruaj me asnjë histori pushtuese, as në aspektin e strategjisë, as në letër dhe as në ekzekutimin e asaj që quhet ‘strategji pushtuese, femra dhe asnjë pushtues e asnjë prej pushtuesve të shumtë në tokat tona nuk ka marrë pjesë dhe ky është një virtyt për të cilin duhet të krenohen të gjitha femrat e popujve pushtues që i kemi pasur në këto troje.

Kur e dëgjon një zë këtu, për satën herë, duke ia tërhequr vërejtjen që ta respektojë Kushtetutën, ligjet në fuqi dhe emërtimin e Republikës së Kosovës, të njohur tanimë edhe ndërkombëtarisht, natyrisht se nuk mund të rrih e të qëndrosh indiferent. Aq më tepër kur ajo ka një bas dhe një zë kumbues dhe i afrohet mikrofonit dhe gumëzhin e gjithë salla.

Unë për veten time, me shumë respekt, do t’i qasem kësaj teme, duke pasur në konsideratë që gjuha serbe te ne ende nuk përjetohet si e folme e një populli milionësh, për arsye se me këtë gjuhë janë urdhëruar vrasjet që i kemi dëgjuar me veshët tanë. Dhe, është urdhëruar një dhunë rrëqethëse që e kemi përjetuar edhe shumica e të pranishmëve në këtë sallë.

Natyrisht se kjo është për të të ardhur keq dhe gjithashtu edhe flamuri i Serbisë ende nuk perceptohet si flamur dhe simbol kombëtar, sepse imazhet e valëvitjes së këtij flamuri mbi tanket serbe ende janë të freskëta në kujtesën tonë dhe ato sillen edhe në memorien

tonë, që nuk është shlyer. Edhe përkundër që e kemi një numër të madh të qytetarëve serbë në Kosovë dhe për hir të tyre do të mundohem që të jem shumë i kujdesshëm dhe i vëmendshëm në atë që e flas, të cilët e pranojnë dhe e njohin Republikën e Kosovës, të cilët bëjnë përpjekje për t'u integruar në këtë jetë, tash pas asaj katrahure që e përshkrova dhe për hir të këtyre, natyrisht që edhe ne po bëjmë përpjekje t'i harrojmë ato imazhe që i përshkrova dhe t'i kalojmë ato përjetime, të cilat janë të pashlyeshme në kujtesën tonë. Sepse, këta qytetarë serbë, që duan ta ndërtojnë jetën e re bashkërisht me ne, meritojnë respekt, meritojnë përkushtim dhe natyrisht se kjo ne nuk duhet të na mungojë.

Ndonjëri që ngre dyshime për përkushtimin dhe identitetin e kryeministrit në bisedime me Serbinë, duhet ta dijë se populli i Kosovës shumë më i sigurt ndihet në bisedime kur ai është i pranishëm me duar në xhepa se ndonjëri prej tyre me kallash në tavolinë me kryeministrin e Serbisë, për shumë arsye, të cilat i njohim të gjithë dhe nuk kam nevojë t'i numëroj asnjërën nga ato.

Çështjen e parë që unë kam dashur ta ngre këtu, ka qenë ajo që është çështje e parë në bisedimet me Serbinë, që është çështje më tepër se humane, që ngërthen edhe politika dhe strategji në bisedime - zbardhja e fatit të qytetarëve tanë të zhdukur.

Fillimisht, tema e parë dhe kryetema kur të fillojnë bisedimet me këtë përmbajtje, gjithçka do të shkojë mirë dhe mbarë, sepse aty menjëherë ke palë të akuzuar dhe palë akuzuese.

Kështu unë e kuptoj çështjen e dytë që dua ta ngre, që është çështja e katërt në bisedime. Kjo është një nga problemet kryesore, të cilat me shumë vëmendje ai që i ka ideuar bisedimet, meriton respekt - ndërprerja e funksionimit dhe shpërbërja e formacioneve që mbështeten nga Serbia në veri të Kosovës, të cilat formalisht nuk e njohin dhe në asnjë mënyrë nuk e respektojnë Kushtetutën e Kosovës, e as ligjet në fuqi.

Duke qenë se prej këtyre vijnë shumë të këqija, jo vetëm ndaj Republikës së Kosovës, por edhe ndaj qytetarëve serbë që e çmojnë dhe që duan ta ndërtojnë jetën e re me këto probleme të vjetra e të reja, kjo është një nga çështjet që është ngritur me shumë sens.

Çështja e tretë, që është çështja e dytë në bisedime - menaxhimi i integruar i kufijve, është me rëndësi që të trajtojë dhe të përshëndesë vendosjen e marrëdhënieve, të raporteve dhe të sistemit që tash po quhet kufi i integruar, dhe në këto katër pika, në dhjetor, ashtu si të shkojë dhe si është planifikuar, e përshëndes.

Në dy pikat tjera, që më vonë është planifikuar të bëhet integrimi i kufijve, i kisha propozuar kryeministrit dhe Qeverisë, që ose t'i ndërrojë vendkalimet, ose t'i ndërrojë emërtimet e tyre, sepse toponimia e tyre është shumë sarkastike, ka konotacione shumë pezhorative në gjuhën shqipe. Dhe, doemos na imponohet gjithsesi në këto dy pika, o vendkalimet të ndërrohen, ose të ndërrohen emërtimet, të cilat nuk kanë të bëjnë me toponiminë tonë, absolutisht. Ato janë të pushtuesve.

E në qoftë se vazhdojmë, tani jo veç ai. Nga mesi i shtatorit... këtë do ta lër më vonë.

Dalim pastaj te një fenomen që u trajtua këtu. Fenomenet në trekëndëshin e Floridës, Portorikos dhe Ishujve të Bremudeve po mundohen të barten e të instalohen në zhvillime politike. Por, nëse atje as analizat dhe eksperimentet e fizikës dhe as laboratorët e kimisë, e as ekspertët e këtyre fushave nuk kanë mundur të zbulojnë se çfarë po ndodh, se cilët janë ata faktorë dhe cilat janë ato elemente që e humbin edhe komunikimin e telekomunikuesve më të sofistikuar, natyrisht se këtu tani, në këtë Parlament, në këto zhvillime dhe në këtë vend, është një instrument që quhet intuitë e hollë e këtij populli, që nuk lë asgjë pa lexuar dhe nuk lë asgjë pa emërtuar në zhvillimet e sërkequra që ndodhin te ne këtu, të cilat është për të të ardhur keq që e kanë gojën plot komb e plot atdhe, por janë prodhim vendor me premisa politike dhe që janë duke kryer obligime ose kanë miopi politike. Dhe, këto janë të dhimbshme, edhe njëra, edhe tjetra, sepse edhe këto kanë konotacione në marrëdhëniet tona, në zhvillimet tona dhe në raportet tona, në të tashmen dhe në të ardhmen.

Unë për veten time, me këtë do ta mbyll, por e kam një temë tjetër, të cilën jam duke pritur nga 18 shtatori për ta trajtuar.

Unë e pashë zëvendëskryeministrin këtu, të cilit ia kam kërkuar një dorëheqje të motivuar dhe të arsyetuar në këtë Parlament. Të nesërmen, e kam pasur një takim nëpërmjet shtypit, me foton timen në faqe të parë, se unë ia paskam kërkuar atij një milion dollarë, në një vend, dhe një milion euro, në një vend tjetër.

Unë kisha shumë dëshirë që ai të ishte këtu, por megjithatë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit!

(Reagim)

Jo, jo! Nuk je në temë. Fjalën e ka Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Zoti kryeministër,

Zëvendëskryeministre,

Tash neve na ka mbetur të biseduar ndërmjet veti dhe me zëvendëskryeministren, e cila është e mandatuar sipas këtij Kuvendi për dialog teknik.

(Ndërhyrje)

Po ki konsideratë, dhe faleminderit kryeministër!

Më lejoni që para se të filloj, tash pas fjalës të zotit Krasniqi, është problem të kthehet normaliteti dhe vëmendja tuaj, por unë do ta ofroj solidaritetin tim si deputet dhe si njeri i këtij Kuvendi lidhur me një lajm të keq që sot e ka marrë Kosova, e ai lajm lidhet me një koleg tonin që ka munguar shumë kohëve të fundit, po mungon edhe sot - konfirmimi i aktakuzës nga gjyqtarët e EULEX-it. kundër zotit Limaj. Është lajm jo i mirë dhe vërtet

besoj, si njëri prej atyre që beson në drejtësi, në organet e drejtësisë, të ftojme që drejtësia të shkojë në vend, por të shkojë në vend dhe t'i trajtoj me prioritet gjithmonë problemet kryesore të Kosovës, problemet që e rëndojnë Kosovën dhe natyrisht njëra prej problemeve është sundimi i ligjit.

Keqardhja ime vjen edhe në konsultim me shefin e Grupit Parlamentar të LDK-së, sepse vërtet ky Kuvend nuk e meriton të mbahet në një agjendë të tillë. Sidoqoftë, tema është jashtëzakonisht e ndjeshme dhe unë po diskutoj prapë, sepse jam njëri nga votuesit e Rezolutës për dialog politik dhe normalizim të raporteve me Serbinë dhe në këtë rrafsh, mandati i këtij Kuvendi për kryeministrin dhe ekipin është që të punojë shumë dhe ta ruajë rezolutën dhe parimet e saj, që dialogu vërtet të shkojë në drejtim të duhur dhe në interes të Republikës së Kosovës.

IBM është marrëveshje e rëndësishme. Të gjithë e kuptojmë se Komisioni Evropian bën zgjidhje inventive për Kosovën, e nuk po them kurrëgjë të re, sepse për shkak të neutralitetit që ka ndaj statusit të Kosovës, Komisioni Evropian gjithmonë e gjen mekanizmin, i cili nuk e cenon shtetësinë e Kosovës, si në këtë raport, por në të njëjtën anë as interesin e Republikës së Serbisë, si palë e bisedimeve.

IBM është njëra prej ngjarjeve të mira, sepse Qeveria e Serbisë është detyruar ta adaptojë marrëveshjen dhe t'i marrë obligimet e saj karshi Kosovës, dhe në momentin e parë që vendoset zbatimi i kësaj marrëveshjeje, vendoset pak a shumë kontrolli dhe detyrimet në këtë proces, që lidhet me kufijtë e Kosovës.

Është fakt se Brukseli e pranon që IBM të lexohet drejt në Kosovë, por në të njëjtën kohë të lexohet pak më shtrembër në Serbi, por kjo nuk duhet të na shqetësojë ne, sepse me rëndësi është që na e kanë pranuar të drejtën e leximit ashtu siç e parasheh Traktati i Lisbonës.

Zgjidhjet inventive dhe mekanizmat specifikë për Kosovën do të vazhdojnë, por është e rëndësishme që delegacioni ynë që udhëhiqet nga kryeministri, të mos lejojë që procesi të degjenerohet, sepse temat fillimisht duken dhe mund të jenë më të lehta, por do të shkojnë gradualisht duke u rënduar në interes të zgjidhjes së problemeve.

Problemi më i dhimbshëm janë të zhdukurit, por nuk duhet parë vetëm një anë të medaljes të zhdukurit, se problemi tash e 12 vjet është i hapur dhe si i tillë duhet të zbardhet deri në fund, në mënyrë që edhe për problemet tjera të arrihen zgjidhje praktike, të qëndrueshme dhe të implementueshme.

Ne nuk kemi shumë besim se do të implementohen të gjitha marrëveshjet, sepse Serbia ka treguar historikisht që obligimet dhe marrëveshjet që i ka bërë nuk i ka çuar deri në fund asnjëherë, ose në forma obstruktive i ka penguar, por sidoqoftë nuk mbetet në përgjegjësinë tonë nëse ajo nuk i zbaton.

E jona është që obligimet që i marrim ne t'i zbatojmë dhe në këtë rrafsh ne të vazhdojmë t'i kryejmë angazhimet tona.

Në fund, zoti kryeministër, dy deklaratat e fundit, që kanë qenë lidhur me dialogun politik, janë se ju jeni lodhur duke i bindur njerëzit që s'ka ndarje të Kosovës, dhe e dyta që platforma juaj është Kushtetuta.

Si njëri prej deputetëve që e ka një mendim pak më ndryshe, por jo duke e cenuar territorin e Kosovës, as duke e cenuar Kushtetutën e Kosovës, unë besoj se duhet ta keni parasysh që kufijtë lindorë dhe veriorë të Kosovës të ruhen njëjtë. Interesat etnike të grupeve tona, të shqiptarëve në pjesën lindore, të trajtohen drejt sikur që ne i kemi trajtuar ato të grupeve etnike serbe brenda Kosovës.

Unë besoj shumë që një ditë kufiri, demaskimi i kufirit dhe pranimi i këtij kufiri do ta përmbyllë procesin e normalizimit, sepse pa zgjidhjen e drejtë dhe pa vendosjen e drejtë të këtij kufiri nuk mund të ketë zgjidhje të qëndrueshme, sepse, fundja, edhe lufta e fundit, edhe problemet e mëhershme, edhe pushtimet e mëhershme dhe okupimet e mëhershme kanë qenë të lidhura për territor. Serbia edhe sot e ruan dhe e mban këtë angazhim në raport me territorin e Kosovës, prandaj detyra juaj më e madhe është që ta ruani territorin e Kosovës dhe ta garantoni këtë territor të Kosovës, sepse procesi përfundimisht do të mbyllet me demarkim të kufirit dhe me njohje.

Për mua, shumë e rëndësishme është se si do të arrijmë deri te kjo pikë. Deri atëherë, mbështetjen time do ta kesh deri në fund, në mënyrë që procesi vërtet ta marrë drejtimin e duhur. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.)

KRYETARI: Fjalën për replikë e ka kryetarja e Koalicionit për Kosovë të Re, deputetja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit kryetar!

Duke marrë parasysh se sot e kemi në debat çështjen e raportimit të kryeministrit për çështjen e bisedimeve, njerëz që nxjerrin këtu psiko-analiza, do të them se ka fakte për gjithçka dhe mund të binden, e në rast se duan ashtu le të konsultohet me shefin e partisë së vet, i cili është sot i pranishëm këtu - kryeministri, dhe mund të merremi vesh shumë lehtë.

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Visar Ymeri. Ju lus, të qëndrojmë në temë, sepse ne e kemi të caktuar një rend të ditës.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Do të flas sot për disa çështje që u shtruan këtu në debat nga folësit e ndryshëm, por edhe që u bënë pjesë e replikave.

Pra, po filloj me atë që u trajtua më së shumti këtu, që është marrëveshja për menaxhimin e integruar të kufijve, për shkak që mendoj se u bë një - ta quaj ashtu hallakatmë faktesh e interpretimesh të tyre për këtë marrëveshje dhe nuk u mor vesh asgjë në fund.

Traktati i Lisbonës, i cili natyrisht përmendet në marrëveshjen për menaxhimin e integruar të kufirit nuk vlen dhe nuk mund të vlejë për vendet, të cilat nuk i njeh BE-ja. Këtë duhet ta kemi parasysh të gjithë.

Është e njëjtë për shembull me monedhën. Ne e përdorim monedhën euro, por kjo nuk do të thotë se ne jemi pjesë e Traktatit të Mastrihtit, e as që jemi pjesë e vendimmarrjes në Bankën Qendrore të Evropës, dhe këtë e dimë të gjithë. Pra, fakti se e përdorim euron, nuk na bën pjesë të këtyre mekanizmave që e menaxhojnë euron. Fakti që ne e kemi marrë si model menaxhimin e integruar të kufijve me Serbinë, kjo nuk bën pjesë në Traktatin e Lisbonës, për shkak se Traktati i Lisbonës është traktat juridik, i marrëdhënieve juridike ndërmjet shtetesh, ndërkohë që Kosova nuk njihet si shtet nga BE-a. Këtë nuk mund ta fshehë askush. Shtetet individuale e njohin, por jo BE-a si institucion.

Natyrisht, BE-a nuk ia lejon askujt, asnjë vendi, që t'i kopjojë konceptet e saj juridike apo ekonomike, siç nuk na i ndalon as ne. Po ashtu, nuk e ndalon asnjë vend që të përdorë terma që janë saktësuar në traktatet e saj. Për shembull, po të dojë edhe Maroku mund të përdorë çfarëdo termi apo rregullimi të ngjashëm me ata të BE-së, por kjo nuk e detyron asnjë vend të BE-së që të ketë marrëdhënie sipas këtyre traktateve me të. Pra, e kam fjalën për Marokun.

Po kështu, kjo nuk do të thotë se BE-ja po na e njeh shtetin pse ne duam t'i përdorim rregullimet që përmban Traktati i Lisbonës.

Kushdo nga ekipi i Kosovës që e ka përdorur apo e ka sugjeruar referencën tek Traktati i Lisbonës dhe ata zyrtarët e Kosovës që e kanë pranuar këtë, e kanë treguar një injorancë të pashembullt juridike. Disa i dëgjuam edhe sot.

Po, është e vërtetë se në traktat shpjegohet dhe përcaktohet IBM, pra Marrëveshja për menaxhimin e integruar të kufijve, por për Kosovën apo për vendet tjera që BE-ja nuk i njeh ky përcaktim është vetëm në nivelin e dijenisë. Pra, është një dijeni që ekziston një traktat i tillë, e nuk është normë juridike, për shkak se nuk mund të bëhet normë juridike me një palë të cilën nuk e njeh, së cilës nuk ia njeh ekzistencën juridike. BE-ja nuk i referohet Lisbonës kur flet me Kosovën dhe madje as që e detyron Serbinë t'i detyrohet Lisbonës kur bisedon për Kosovën. Edhe një çështje e fundit që u ngrit këtu në raport me BE-në, është e vërtetë se këtë e tha edhe zëvendëskryeministrja Edita Tahiri. Është e vërtetë që 22 vende të Bashkimit Evropian e kanë njohur Kosovën, mirëpo zonja Tahiri, në bashkëpunim me kryeministrin Thaçi, ia shtuan kësaj njohjeje të pastër të pavarësisë, që ka ndodhur në kohën kur është shpallur kjo pavarësi, njollën e 1244 me fusnotën. Pra, një njohje që ka qenë e pastër e pavarësisë dhe e sovraniteti të Kosovës, tash në fund ia shtuan edhe njëfarë mënyre kërkuan që tash të njihet Kosova me një emërtim tjetër. Pra, ky është problemi që e kemi me BE-në dhe me këtë Qeveri.

Tjetra që dua të nge këtu, janë disa çështje që i përmendi në fjalën e tij hyrëse, në informatën e tij, kryeministri i Kosovës. Tha që transparenca e Serbisë për financimin e

strukturave ilegale të sigurisë në veri është diskutuar dhe është kërkuar nga ky. Pra, që Serbia të na tregojë se ke po e financon dhe si po e financon.

Deri para do kohe thoshte që këto struktura duhet të shpërbëhen fare, tash po kërkon transparencë në financimin e tyre. E kjo në njëfarë mënyre është përdorim i transparencës për t'i legjitimuar këto struktura ilegale dhe për ta pranuar praninë e tyre në Kosovë dhe, në anën tjetër, duhet ta kemi parasysh faktin që Serbia na tregon për strukturat paralele, pra që bëhet transparente karshi strukturave të saj ilegale në Kosovë, kjo nuk nënkupton edhe në asnjë mënyrë nuk mund ta shmangë dhe ta anulojë shkeljen që këto struktura ia bëjnë, si Kushtetutës së Kosovës, si sovranitetit të Kosovës, po ashtu edhe integritetit territorial të vendit. Pra, Serbia mund të na tregojë edhe nuk ka çka të na tregojë, se ne të gjithë e dimë që ato janë këtu, por kjo nuk e ndryshon aspak situatën.

Ju referua ky dialog disa herë Rezolutës, e cila është miratuar në këtë Kuvend me shumicë votash, e pika 3 e saj thotë, nëse e keni harruar, po jua lexoj: “Dialogu dhe rezultatet e tij të jenë në pajtim me sovranitetin e Kosovës, subjektivitetin ndërkombëtar, integritetin territorial dhe rregullimin e brendshëm kushtetues të Kosovës”. Kjo pikë tashmë është shkelur në secilin takim që e ka pasur kryeministri Thaçi me Ivica Daçiçin në Bruksel, në temat të cilat janë hapur. Se këtu po thotë: jo vetëm rezultatet, por edhe dialogu, për çka flet e jo për çka nuk flet, duhet të jetë në përputhje me sovranitetin e Kosovës. Dhe, më tregoni ju mua nëse biseda që e ka hapur kryeministri për ta ndarë një njësit të veçantë të Policisë së Kosovës me Ivica Daçiçin në Bruksel, a është në përputhje me sovranitetin e vendit, për shkak se kryeministri na tha se ka qenë ide e tij. Në rregull, nëse ka qenë e tij, që po prirem t'i besoj, atëherë përse këtë ide nuk e ka diskutuar me Kabinetin e vet qeveritar? Pse këtë ide nuk e ka diskutuar me deputetët e Republikës së Kosovës këtu në Kuvend? Për shkak se nuk ka as dy javë që raportoi për një takim të parë me Ivica Daçiçin. Pse nuk e përmendi këtu? Pse bash në Bruksel dhe pse bash me Daçiçin? Pse pra këto ide brilante të kryeministrit së pari dëgjohen në Bruksel, në praninë e kryeministrit kriminel serb, e jo me deputetët dhe ministrat e Kabinetit të tij?

Çështja e dytë, a nuk është një marrëveshje xhentëlmene, ta quaj kështu, që ka dalë nga takimi i parë, të cilën, për të qenë korrekt, e ka thënë kryeministri i Serbisë, e nuk është demantuar nga zoti kryeministër i Kosovës, ndoshta edhe nuk ka qenë fare marrëveshje, që nuk do të ketë veprime të njëanshme. A nuk është kjo po ashtu shkelje e sovranitetit të vendit për shkak se natyrisht që përbrenda një vendi, ku ti jetë sovran, ka veprime të njëanshme. Nuk merresh vesh ti për gjithçka, për secilën lëvizje tënde, si Qeveri, me një shtet tjetër, se kjo nuk është më sovranë. Pra, nuk është kjo marrëveshje, nëse ka ndodhur, po them, a nuk është kjo shkelje e sovranitetit të vendit? Unë mendoj se është. Është shkelje e sovranitetit institucional të vendit.

Çështja tjetër që po ashtu është shkelje e sovranitetit të vendit, është edhe raporti me Marrëveshjen për menaxhimin integruar të kufirit, pra protokolli teknik, i cili kërkon që në pikat kufitare të Kosovës, në fund me atë marrëveshje që e kanë bërë, diku do të jetë policia serbe, diku Policia e Kosovës, e kështu me radhë. Por, duhet ta kemi parasysh një gjë. Nuk mund të ketë kurrfarë marrëveshje për menaxhim të integruar të kufijve pa pasur demarkacion të kufirit. Pra, ne nuk kemi demarkacion të kufirit me Serbinë për shkak se

Serbia nuk e njeh kufirin e Kosovës si kufi shtetëror dhe nuk mund të ndërtojme tash marrëveshje për ta menaxhuar një kufi, pa e pasur një herë kufirin, të pranuar nga të dyja palët. A nuk është kjo marrëveshje për menaxhimin e integruar të kufirit shkelje pastaj edhe e Kushtetutës së Kosovës? Ti po i thua policisë së Serbisë që mund të vish deri te kjo pikë, pa e ditur ku është kufiri. E deri ku paska mundësi të vijë policia e Serbisë dhe kush po i jep leje të hyjë brenda një pjese, e cila mund të konsiderohet territor i Kosovës?

Çështja e fundit që dua ta shtroj këtu është ajo që e përmendi kryeministri, që ka qenë njëra prej diskutimeve, pra njëra prej pikave për të cilën kryeministri tha që ka pasur një lloj dakordance edhe të Bashkimit Evropian - çështja e autostradës. Pra, vazhdimi i autostradës, që do ta lidhte Prishtinën me Nishin. Dhe, kryeministri tha që është një ide që Kosova e ka shtyrë përpara dhe është një ide që e paraqiti disi sikur të ishte e tij. Por, unë po ia përkujtoj kryeministrit dhe ju të gjithëve këtu, që kjo madje nuk është ide fare e re. Kjo është ide e kamotshme, të cilën përherë e ka synuar Serbia. Nëse ju kujtohet, Esat Pashë Toptani ka pasur marrëveshje me kryeministrin e Serbisë dhe në këtë marrëveshje, mes tjerash, natyrisht ne e dimë që kjo marrëveshje ka qenë që të copëtohet Shqipëria për ta ruajtur ai një lloj pushteti përbrenda pashallëkut të vet, por njëra prej pikave të marrëveshjes ka qenë që të lidhen Tirana me Nishin me hekurudhë, në mënyrë që mallrat, njerëzit dhe trupat serbe të mund të kalojnë lirshëm. Kjo marrëveshje është përsëritur edhe me një marrëveshje tjetër që ka qenë po ashtu marrëveshje që e ka sjellë një tjetër udhëheqës i shqiptarëve në pushtet, e që ka qenë marrëveshja që Ahmet Zogu e ka pasur me Nikola Pashiqin. Edhe në këtë marrëveshje, në mes tjerash, po ashtu, duke ia garantuar mbretërinë e Shqipërisë Ahmet Zogut, Nikola Pashiqi po ashtu ka kërkuar nga ai që ta lidhin Nishin me Tiranën me rrugë dhe hekurudhë, në mënyrë që prapë ushtria serbe të mund të kalojë lirshëm, mallrat të mund të kalojnë lirshëm, njerëzit dhe kështu me radhë.

Pra, në historinë e shqiptarëve janë dy rryma politike. Është rryma ‘esatiste’, e cila pastaj evoluon me Ahmet Zogun, dhe është rryma tjetër ‘qemaliste’, e cila pastaj përcillet nga Hasan Prishtina, Fan Noli dhe të tjerët. Këto marrëveshje, këto pika të marrëveshjes, siç është autostrada, rrinë në marrëveshjet e rrymës që e kanë nënshkruar këta dy eksponentë të rrymës ‘esatiste’. Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëro zëvendëskryeministret!

ZËVENDËSKRYEMINISTRJA EDITA TAHIRI: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Kryeministër,

Ministra,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni të jap disa shpjegime për disa paraqitje kontradiktore që i pati deputeti Ymeri. Edhe së pari dua t’ia kujtoj tezën, apo parimin e parë të Bashkimit Evropian.

Bashkimi Evropian nuk i njeh shtetet. Sipas së drejtës ndërkombëtare, shtetet njihen nga shtetet. Pra, Bashkimi Evropian nuk i njeh shtetet, prandaj edhe nuk domethënë që shtetet pse nuk janë njohur nga Bashkimi Evropian apo nuk pjesë e Bashkimit Evropian nuk mund ta zbatojnë marrëveshjen e IBM-it. Më lejoni t’i përmendi disa shembuj, zoti

Ymeri, për ta parë që as Shqipëria e as Mali i Zi nuk janë anëtarë të Bashkimit Evropian, por e zbatojnë IBM-in në Muriçan.

E dyta, Kosova dhe Maqedonia kanë lidhur marrëveshje dhe janë duke punuar për zbatimin e marrëveshjes së IBM-së. Kosova me Shqipërinë janë duke punuar në këtë drejtim dhe së shpejti do ta kemi marrëveshjen edhe me Malin e Zi, pavarësisht se ende nuk e kemi demarkacionin e kufirit. Vetëm për ta parë zoti Ymeri që gjërat në kuadër të epokës Euroatlantike e kanë një tjetër rrjedhë nga ajo që logjikoni ju. E para, po më habit një fakt sikur jeni zhvendosur në aspektin kohor në disa kohëra, kur i kemi pasur problemet e ndarjes së tokave shqiptare. Është e çuditshme që flitni për historinë e së kaluarës, ndërkohë që ne po punojmë për integrimet euroatlantike. Si është e mundur që flitni në kontestet e infrastrukturës, të logjikave të agjendave gjeopolitike të së kaluarës në kohën kur infrastruktura evropiane dhe rrugët, korridoret ajrore e hekurudhore të gjitha janë në kuadër të projektit për integritet evropiane dhe euroatlantike dhe ju jeni deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe në Kushtetutën e Republikës të Kosovës, prioritetet...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Jo, replikë është kjo, dy minuta. Urdhëro Visar, kundër-replikë, një minutë

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Së pari, unë nuk thashë që shtetet nuk mund ta zbatojnë, unë thashë që mund të marrin modele, askush nuk i ndalon, por nuk bëhen pjesë e Traktatit të Lisbonës, poqese nuk njihen së pari nga BE-ja dhe pastaj poqese nuk e nënshkruajnë këtë traktat. Domethënë, mos keqinformoni për atë çka e thashë unë. Mos i keqinterpretoni fjalët e mia. Pra, fakti që Shqipëria edhe Mali i Zi e zbatojnë Marrëveshjen e menaxhimit të integruar të kufijve, kjo nuk ka kurrfarë lidhje me rastin për të cilin po flasim ne, sepse edhe Shqipëria dhe Mali i Zi janë shtete të cilat njihen ndërkombëtarisht dhe askush nuk ka problem me to, ndërkohë që BE-ja si institucion nuk e njeh Kosovën. E njeh Kosovë me fusnotë. Nuk di a e keni parë edhe në fjalimet e Shtefan Fyles, me fusnotë paraqitemi, e lëre më edhe në dokumentet juridike. Pra, mos i përzini këto dy gjëra.

Çështja e dytë që e përmendët ju, domethënë nëse në fjalën time unë po i kthehem historisë, siç e thatë ju - historisë të së kaluarës, kinse paska edhe histori të së ardhmes, kjo natyrisht duhet të kihet parasysh për shkak se unë e përmenda një projekt infrastrukturor që ka figuruar në dy marrëveshjet, të cilat njihen, të cilat janë publike...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: E kryem këtë punë! Nuk kemi ardhur këtu të mbajmë histori, se të gjithë besoj e dimë historinë e këtij vendi!

(Ndërhyrje)

Ai e ka kohën e vet, e ka shfrytëzuar kohën e vet. Unë po ju them se IBM si marrëveshje është niveli më i lartë i marrëdhënieve të mira ndërmjet dy vendeve. Mund ta bëjnë IBM-në jo vendet që janë në konflikt. Por, megjithatë, të mos të hyjmë në shpjegime se nuk e di ku dalim. Vazhdojmë. Flora Brovina e ka fjalën.

FLORA BROVINA: Ju faleminderit, kryetar!

Përshëndetje kryeministër,

Përfaqësues të Kabinetit qeveritar,

Kolegë dhe kolege,

Sigurisht bisedimet janë fushëbeteja më e rëndë në paqe dhe këtë betejë Kosova, për shkak se ka shumë argumente që ndodhën më parë, duhet ta fitojë. Është beteja më e vështirë që duhet ta fitojmë. Në këtë aspekt e përkrah kryeministrin për rolin që e ka si kryeministër i vendit, i zgjedhuri i parë, dhe për shkak se duhet ta përkrahim njëzëri që të jetë më i fuqishëm dhe më vendimmarrës në këto bisedime.

Më pëlqen që bisedimet nisën me cekjen e temës për personat e zhdukur. Është tema më e dhimbshme tani e 15 vjet, që na mundon si një plagë e hapur që duhet shëruar, aq më tepër që paqja ndërtohet duke i zbardhur të gjitha krimet dhe duke pasur forcë ta ndërtojmë një dialog të qëndrueshëm. Na duhet ajo për shkak se kaloi një periudhë e gjatë dhe gjeneratat u rritën dhe i mundi harresa shumë njerëz që tani ndodhen në politikëbërjen e Beogradit, por edhe këtu ndoshta kanë harruar se ka ndodhur një gjenocid mes nesh, kanë ndodhur krime të papara dhe ata duhet të dëgjojnë, duhet të njihen me këtë të vërtetë dhe ta kenë forcën e kërkim-faljes dhe të pendimit dhe ne ta kemi forcën e zgjatjes së dorës së pajtimit, në mënyrë që bisedimet të jenë normale dhe të rrjedhin pastaj me temat më të prekshme, më të përditshme.

Zoti kryeministër,

Kërkoj që në këto bisedime, edhe ndërmjetësuesja e bisedimeve të njoftohet në detaje se çka ndodhi ta zëmë në varrezat masive që u zbuluan në vitin 2002, në Batajnicë dhe në Peruçac. Atje ndodhi krimi i paparë, kur mbi 1 000 persona të vrarë në Kosovë, ose të marrë të gjallë, u dogjën, u vranë dhe u bë përpjekje që të zhduken shenjat e tyre, e kësaj i thonë gjenocid. Eskhumimi ndodhi pa praninë e përfaqësuesit ndërkombëtar të Kosovës, pra UNMIK-ut, dhe ekspertëve të tij, edhe pse ishin në Kosovë; ai ndodhi pa përfaqësuesit dhe ekspertët e Kosovës, të cilët duhej të ishin pjesë e këtij eskhumimi dhe aq më keq dokumentacioni i eskhumimeve ndodhet në Gjykatën Supreme të Beogradit. Kryerësi i krimit nuk ka të drejtë të bëjë eskhumimin dhe t'i mbajë dokumentet.

Zoti kryeministër, kërkoj nga ku që ta kërkon këtë dokument dhe t'ia dorëzoni zonjës Eshton, sepse vetë dokumenti flet për gjenocidin, flet ky edhe për peshën e asaj që duan të falin dhe sigurisht palën tonë e bën të fuqishme dhe tregon se Kosova është orientuar kah paqja, e paqja e Kosovës do të thotë paqe në regjion.

Desha të ndalem edhe në një pjesë tjetër. Unë kërkoj gjithashtu nga ju që nëpërmjet zonjës Eshton të kërkon ngritjen e lapidarit për personat e zhdukur në Batajnicë dhe Peruçac, në mënyrë që ta kemi shenjën tonë të një lufte, ose gjenocidi të paparë. Serbia duhet ta pranojë këtë, në shenjë të të gjitha këtyre viktimave.

Këtu ndodhi diçka që nuk e prisja nga ju dhe Kabineti juaj. Jam shumë e prekur sa herë që ju dilni dhe flitni në emër të të burgosurve dhe pjesëtarëve të luftës, flitni se burgosja ka qenë diçka më e lehtë se sa të jesh pjesë e luftës. Bashkohem me mendimin juaj që thoni se i gjithë populli i Kosovës është pjesë e luftës për liri. Kjo është e vërtetë, por më takon mua, që jam pjesë e Luftës Çlirimtare të Kosovës dhe njëherësh ish e burgosur të deklarohej se cila pjesë ka qenë më e rëndë. Më besoni që ka qenë ajo e burgut. Atje, flas në emër të mbi 5 000 personave të burgosur dhe më shumë se 4 000 personave të zhdukur, të burgosurit kanë qenë personat potencialë që të zhduken gjithashtu. E nëse ju flitni, edhe mund të arsyetohet, sepse keni qenë pjesë e luftës, por jo edhe për pjesëtarët tjerë të Kabinetit, që kanë qenë në anë krejt të kundërt. Faleminderit!

KRYETARI: Arben Gashi e ka fjalën.

ARBEN GASHI: Faleminderit, kryetar!

Këtu u diskutuan shumica e temave të cilat u prezantuan nga kryeministri, si tema që janë biseduar në Bruksel. U fol për personat e zhdukur, u fol për lëvizje të mundshme të autostradës, u fol për marrëveshjet për menaxhimin e integruar të kufirit, u fol edhe për kufirin dhe mbrojtjen e interesave nacionale, u fol po ashtu nga zoti Haziri edhe për mbrojtjen e interesave të shqiptarëve që kanë mbetur në Serbi dhe për plot çështje tjera.

Unë, meqë i konsideroj si të shteruara këto tema, kisha vetëm dy çështje për kryeministrin, megjithëse desha ta theksoj edhe një çështje tjetër, për të cilën realisht shpreha keqardhje edhe herën e kaluar dhe ndodhi edhe sot që një deputete këtu e barasvlerësoi kryeministrin e Kosovës me kryeministrin e Serbisë, gjë që nuk është e drejtë kjo, e që të kthehem te tema, unë i kam dy pyetje për kryeministrin:

Pyetja e parë për kryeministrin është: A mburret ende kryeministri me aksionin e 25 korrikut dhe a ka ndryshuar mendimi i tij se është shtrirë autoriteti i institucioneve të Kosovës në veriun e Kosovës?

Pyetja e dytë është: A është diskutuar për Preshevën, Medvegjën, dhe Bujanocin dhe a pritët të diskutohet? Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Afrim Kasolli e ka fjalën.

AFRIM KASOLLI: Ju faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Ne këtu dëgjuam nga kryeministri se janë diskutuar disa çështje me kryeministrin e Serbisë, por nuk dëgjuam për një çështje tjetër nëse është diskutuar, për faktin se si ende në burgjet serbe mbahen të burgosurit politikë shqiptarë. Pra, dihet se fillimi i kësaj ngjarjeje ka të bëjë me arrestimin dhe kidnapimin e 9 shqiptarëve nga Presheva, ndonëse u kërkuan të arrestoheshin dhe të kidnapoheshin 17 sish, por nuk u gjetën të gjithë, më 27 dhjetor 2008.

Siç dihet, kjo maskaradë politike dhe juridike ishte orkestruar dhe ekzekutuar drejtpërdrejt nga bashkënegociatori i kryeministrit Hashim Thaçi, Ivica Daçiq, ministër i

atëhershëm dhe i tanishëm i Punëve të Brendshme, dhe tani po ashtu kryeministër i Republikës së Serbisë. Siç dihet, në këtë operacion kishin marrë pjesë mbi 2 600 pjesëtarë të xhandarmërisë serbe dhe kushtet në të cilat ishte zhvilluar ky intervenim brutal kishin qenë nga më të tmerrshmet.

Ndërkaq, pas 6 muajve të procesit hetimor, më 25 qershor 2009 ishte ngrehur aktakuza kundër tyre pa asnjë fakt, me pretekstin e krimeve kundër serbëve dhe minoriteteve tjera, kinse të kryera në Gjilan e rrethinë, gjatë periudhës nga mesi i qershorit deri në fundin e tetorit të vitit 1999. Këta të arrestuar po si ish-pjesëtarë të UÇK-së u akuzuan në aktakuzë se i kishin masakruar 59, e gjatë gjykimit të parë 89 civilë serbë dhe të minoriteteve tjera, ndonëse më pastaj u përmendën vetëm 2 emra serbësh dhe atë pa e dëshmuar me asnjë fakt se këta të arrestuar ishin fajtorë.

Gjatë procesit hetimor dhe gjatë gjykimit të parë, u paraqitën 251 dëshmitarë, 95% të Prokurorisë dhe 266 dokumente dëshmi, 92% të palës mbrojtëse, me të cilat u dëshmuar pakundërshtueshëm pafajësia totale e djemve shqiptarë nga Presheva. 100% u dëshmuar se asnjëri nga ata nuk ishin fare në Gjilan gjatë asaj periudhe. Gjithashtu u dëshmuar se vetëm dy nga ata kishin qenë pjesëtarë të UÇK-së dhe të dytë e pranuan vetë një gjë të tillë. Pastaj u bë vonesa nga trupi gjykues në nxjerrjen zyrtare të aktgjykimit të parë. Në vend se më së largu pas 30 ditësh, ajo ndodhi pas 3 muajsh e 8 ditësh.

Ndërkohë njësitet e EULEX-it kishin kryer hulumtime në Liqenin e Livoçit, afër Gjilanit, ku dëshmonin se nuk kishin gjetur asnjë mbetje mortore. Ky dokument ishte shumë i rëndësishëm, ngase Gjykata e Apelit, edhe pse me 4 muaj vonesë, e ktheu lëndën në rigjykim, me sugjerimin se gjykimi i parë nuk ishte ndërtuar në bazë të fakteve konkrete, se nuk kishte qenë i drejtë, se nuk mund të konsideroheshin krime lufte aktet e kryera pas përfundimit të luftës.

Natyrisht se pas këtij rigjykimi u liruan gjatë pjesëtarë të parë dhe u dënuan ata të fundit kinse kanë marrë urdhra nga të parët. Absurdi tjetër ishte se kryetarja e trupit gjykues, Snezhana Nikoliq-Garutiq, rreth 40 minuta sqaroi se si 6 të liruarit kanë kryer krime dhe nëpërmjet urdhrave dhe drejtpërdrejt, e u liruan si të pafajshëm, ndërsa për të dënuarit rreth 40 minuta tjerë sqaroi se ata nuk kanë bërë krime as edhe 80% nga ajo që ngarkohen, e prapëseprapë u dënuan.

Përsëri Gjykata e Qarkut në Beograd është dashur t'ia dorëzojë palës mbrojtëse vendimin zyrtar të aktgjykimit të dytë qysh më 19 tetor 2012, por ende nuk ia ka dorëzuar. Mirëpo, ajo që është tronditëse në tërë këtë rrëfim, pa dyshim se ka të bëjë me indolencën që ka treguar politika zyrtare e Kosovës ndaj kësaj ngjarjeje makabre dhe kjo indiferencë e arrin kulmin me veprimet destruktive të vetë ministrit të Drejtësisë dhe zëvendëskryeministrit Hajredin Kuçi. Atij i është bërë kërkesë për lëshimin e dokumentit, dëshmitë e EULEX-it, rreth hulumtimeve në Liqenin e Livoçit afër Gjilanit, ku hulumtuesit përkatës kishin konstatuar se nuk kishin gjetur as edhe një mbetje mortore, e që është një dokument pafundësisht crucial.

Pas 10 ditësh sqarime dhe pas detyrimit për kërkesën zyrtare, më 17.5.2011, dokumenti është dorëzuar më 13.6.2011. Përfundimisht kjo vonesë dhe papërgjegjshmëria totale nga Qeveria e Kosovës për lëshimin e një dokumenti të rëndësishëm, për as më pak e as më shumë se 1 muaj e 4 ditë, vetëm sa e ka rënduar gjendjen e të akuzuarave dhe e ka shpërfaqur indiferencën e kësaj Qeverie për t'i mbrojtur bashkëkombësit e saj nga dhuna e shfrenuar e montuar dhe dënimet politike të Ivica Daçiqit.

Përfundimisht, në fund më duhet ta demaskoj edhe një lajm që sapo u plasua nga RTK-ja se gjoja këtu dominoi një konsensus i plotë, me përjashtim të “Vetëvendosjes”, që adresoi kritika të ashpra ndaj këtij procesi të informimit në Kuvend nga kryeministri. E vërteta është se në këtë mënyrë propagandistike po tentohet të krijohet një iluzion për një konsensus të rrejshëm, sepse në të vërtetë nuk ka konsensus real për këtë çështje. Faleminderit!

KRYETARI: Hydajet Hyseni e ka fjalën.

HYDAJET HYSENI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar kryeministër, ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ju përshëndes dhe e mirëpres informatën e kryeministrit për procesin e deritashëm të bisedimeve. Sado që nuk jam i sigurt se do të duhej gjithëherë të shoqërohej me një debat, siç po e bëjmë, aq më tepër që praktikisht po na sillen vetëm informacione verbale, e jo dokumente për të cilat eventualisht edhe do të mund të bisedojmë.

Unë megjithatë mbetem i bindur se ne kemi hyrë në këtë proces dhe tani nuk duhet të diskutojmë se a duhet a nuk duhet të ishim, por tani duhet të shikojmë si të dalim faqebardhë dhe me sukses nga ky proces. Unë besoj dhe dëshiroj të besoj se përfaqësimi i Kosovës do të jetë ashtu siç është premtuar. E kam këtu parasysh përvojën e udhëheqësit të këtij procesi në emër të Kosovës nga Rambujeja dhe besoj që ajo frymë mund të maturohet, mund të përgjegjësohet edhe më shumë, por nuk mund të degradohet.

Është mirë që kjo çështje nuk po mbahet si përpara krejt e fshehur, por mendoj që do të ishte më mirë që në vend të akuzave ndaj deputetëve dhe sidomos drejtuesve të komisioneve, siç është Komisioni i Jashtëm, përfaqësuesit e Qeverisë të gjejnë mënyrat që të komunikojnë, siç janë të obliguar edhe me ligj, me komisionin. Çështja e marrëveshjeve është një çështje që duhet të shtrohet edhe në ndërlidhje ndërmjet Komisionit të Jashtëm dhe departamenteve të Qeverisë, e kjo nuk po ndodh.

Nuk shoh asgjë të keqe në qasjet e ndryshme që mund të jetë përplotësuese, përkundrazi mendoj se janë, jo vetëm të natyrshme, por edhe të nevojshme dhe më duken krejt të pakuptimta përprjekjet tani për t'u koncentruar te dallimet dhe për të harruar se megjithatë në këtë çështje e kemi një preokupim që është i përbashkët. Mund të them madje që në parim është edhe konsensual. Nuk shoh që dikush është kundër procesit të normalizimit në parim. Dallojmë rreth dinamikës, rreth hapave e tjera dhe kjo mendoj se është mirë. Dallimet në qasje vetëm e plotësojnë dhe e konsolidojnë qasjen.

Megjithatë, do të përmend disa nga çështjet që u shtruan dhe që u tha se veç janë bërë pjesë e këtij procesi. Jam dakord që të shtrohet në mënyrë adekuate çështja e të pagjeturve. Nuk mund të fillojë asnjë proces i dialogut me Beogradin pa e shtruar ta zëmë çështjen e Ukshin Hotit e të tjerëve, sepse është diçka që flet, por nuk e shoh si një çështje licituese, nuk e shoh si çështje negociuese, sepse do të binim në grackën që ata që i kanë masakruar njerëzit tanë, pastaj edhe të bëjnë pazare për shitjen e eshtrave të tyre, siç ka ndodhur individualisht, për fat të keq. Është një çështje që e obligon palën edhe nga aspekti i së drejtës ndërkombëtare që ta kryejë obligimin e saj dhe mendoj që kjo bie në grupin e çështjeve që janë shprehje të aktit të vullnetit të mirë, e jo çështje licituese. Çka duhet paguar ne për t'i marrë eshtrat e të masakruarve tanë që janë vrarë edhe varrosur, rivarrosur, dërguar jashtë Kosovës dhe tani duhet të paguajmë një targë për to. Mendoj se është krejt e pakuptimtë.

U shtrua me të drejtë, siç u tha këtu, e drejta e Serbisë për t'u kujdesur për pakicën serbe në Kosovë. Këtë nuk mund ta kontestoj, por e plotë zoti kryeministër, do të ishte që kjo çështje të shtrohet në parim, e drejtë e shteteve për t'u kujdesur për pakicat e tyre në pjesën tjetër dhe vetëm në këtë kuptim ajo merr kuptim, ndryshe kthehet pastaj në një qasje të njëanshme dhe mendoj se pastaj ndërlikohet e tërë çështja.

Ka të drejtë Serbia të kujdeset në përputhje me të drejtën ndërkombëtare për komunitetin serb në Kosovë, por ka të drejtë edhe Kosova të kujdeset për komunitetin shqiptar jashtë Kosovës në Preshevë, Bujanoc e Medvegjë. Janë çështje ekuivalente dhe mendoj se duhet trajtuar në mënyrë ekuivalente. Në raportet ndërmjet shteteve, ose ka parim të reciprocitetit, ose ka një parim tjetër, që është i dominjimit, por parime tjera s'ka. Prandaj, mendoj që Qeveria nuk duhet të tërhiqet nga ajo qasja parimore që ka qenë e mbështetur nga ky vend për një qasje reciprociteti në marrëdhëniet me fqinjët, përfshirë edhe Serbinë.

Po flitet për strukturat paralele dhe po përdoret shprehja “struktura paralele”. Unë kështu e shënova në thonjëza dhe nuk e thashë në thonjëza dhe do të duhej të quheshin me emrin e vërtetë. Janë struktura jo vetëm paralele, janë struktura jo vetëm ilegale, por janë ish-struktura të regjimit, janë struktura siç janë ish-targat, prandaj si të tilla është pak të thuhet se janë paralele. Janë ish-struktura dhe duhet të trajtohen si të tilla - jashtë kohe në çdo pikëpamje.

Edhe çështja e të drejtës për të financuar aspekte të ndryshme të funksionimit të komuniteteve në Kosovë, mendoj që do të duhej parë në përputhje me frymën edhe të Kushtetutës sonë. Dokumenti i Ahtisarit e ka një formulë tillë, po Kushtetuta jonë e ka absolutuar frymën e dokumentit të Ahtisarit dhe mendoj tani referenca duhet të jetë te Kushtetuta jonë dhe nuk mjafton vetëm transparenca, por do të duhej të zbatohet ajo që në Kushtetutën tonë dhe në ligj është thënë qartë - “duhet të bëhet në pajtim me ligjin në Kosovë”. Edhe çështjet tjera, edhe kur ky Kuvend ka fjetur dhe nuk e ka përkrahur ndonjë amendament që ka kërkuar që kjo të bëhet në frymën e ligjit, mendoj që megjithatë nuk e përjashton nevojën e domosdoshme që ligji të jetë referenca dhe suaza, në bazë të të cilit edhe mund të bëhet kjo.

Çështja tanimë tepër e diskutueshme e menaxhimit të integruar të kufijve, e cila po quhet IBM dhe kur e shikon në internet, kuptimi i parë është “International Business Machine”, i dyti “International Brotherhood of Magicians” - “Vëllazëria e Magjistarëve” dhe “Makina e Biznesit”. Pse nuk i themi ashtu siç është. Shqip është “Menaxhimi i Integruar i Kufijve” dhe nëse duhet të përdoret shkurtesa, shkurtesa në anglisht është IBM. Por, ajo që për mua është edhe më e rëndësishme se kaq, është që të mos e lejojmë as kuptimin e parë, as të dytin. Çështja duhet parë ashtu siç është. Në shqip, menaxhim i integruar i kufijve shkurt i bie MIK, dhe siç e tha edhe kryetari i Kuvendit, menaxhimi i integruar i kufijve funksionon ndërmjet vendeve që kanë raporte normale miqësore, por menaxhimi i integruar i kufijve ndërmjet vendeve që nuk e kanë të rregulluar çështjen e kufijve, le të më ndjejnë ata që mendojnë ndryshe, mendoj që është një bluf.

Dhe, këtu është edhe ajo që është diskutuar aq shumë. Ka menaxhim të integruar të jashtëm të kufijve dhe ky është kuptimi që ne duam t’i japim. Mendoj që duhet të insistojmë në të. Por, ka edhe menaxhim të integruar të kufijve të brendshëm, zona e zotërinj, e ky është rreziku në të cilin nuk guxojmë të biem. Fqinji ynë verior do ta shtyjë çështjen në këtë interpretim të kësaj sintagme dhe sa për faktorin ndërkombëtar mund të jetë i pranueshëm edhe njëri, edhe tjetri, nëse palët e gëlltitin. Prandaj mendoj që çështja duhet parë seriozisht siç është. Është një ambiguitet, i cili e ka rrezikun në vetvete dhe kjo duhet të jetë nxitje për përfaqësuesit e Kosovës që të jenë syçelë në këtë çështje dhe të insistojnë që në këtë çështje ne të pozicionohemi, jo vetëm si shtet, siç u tha, se ka shtete e shtete...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Hashim Deshishku e ka fjalën.

HASHIM DESHISHKU: Ju faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Është e ditur se dialogu është forma më e mirë për tejkalimin e problemeve, apo për zgjidhjen e tyre përfundimtare. Vlerësoj që ky është edhe qëllimi i dialogut me Serbinë.

Ky ka qenë edhe motivi kryesor për nxjerrjen e Rezolutës për bisedime, ku edhe caktohen kornizat, përkatësisht përgjegjësitë për to. Mirëpo, për dialog duhen dy palë të barabarta. Nëse njëri është më i fortë e tjetri më i dobët, nuk mund të priten rezultate konkrete, posaçërisht kur është në pyetje normalizimi i raporteve me Serbinë. Nga pozicioni i tashëm është reale frika se këtu do të ketë kufizime e shantazhime. Serbia do të mundohet të fitojë statusin kandidatit në dëm të Kosovës. Kjo u pa qartë edhe gjatë bisedimeve teknike, prej të cilave dolën disa marrëveshje, mirëpo nuk po vërehet efekti i tyre apo nuk po zbatohen, jo me fajin tonë, por me fajin e palës tjetër, Serbisë. Se Kosova i ka përmbushur të gjitha obligimet që i kemi arritur gjatë marrëveshjeve deri më sot. Ka pasur fjalë të mëdha kur është në pyetje menaxhimi i integruar i kufijve, por ende nuk ka ndryshuar asgjë. Tash sërish ka premtime se ajo do të ndodhë në dhjetor, por të shohim.

Në ndërkohë, në veri të vendit përgatiten protesta e veprime të tjera që pa dyshim se janë të nxitura edhe nga Serbia, të cilat do ta minojnë menaxhimin e integruar të kufijve. Po ashtu, është premtuar qarkullimi i lirë i qytetarëve, është premtuar siguria për lëvizjen e qytetarëve të Kosovës, por kjo deri më sot nuk ka ndodhur, ose po ndodh me përplot probleme e barriera, me qëllim që në çdo mënyrë të bllokohet ky qarkullim i kosovarëve në mënyrë të lirë nëpërmjet Serbisë. Shtetasit e Kosovës edhe më tutje e kanë problem të qarkullojnë, duke e shfrytëzuar si transit territorin e Serbisë, meqenëse nuk janë të sigurt, mund të arrestohen, të gjobiten, apo të terrorizohen në forma të ndryshme.

Na është premtuar se do t'i heqin të gjitha barrierat për eksportin e mallrave kosovare, por edhe këtu rezultatet janë të varfra. Ta zëmë, në shtator, eksporti i Kosovës në Serbi nuk ishte 1 milion euro, gati në nivelin e njëjtë çfarë ka qenë para një viti. Këtu nuk bëhet fjalë për atë se Kosova nuk paska çfarë të eksportoje, por për pengesat që Serbia vazhdon t'i bëjë. Do të thotë, se ne po e bëjmë punën, e nuk po bëjnë punë as garancitë e premtuara nga faktori ndërkombëtar, përkatësisht nga Bashkimi Evropian. Të gjitha këto janë argumente të mjaftueshme për forcimin e dyshimit se nga dialogu do të përfitojë Serbia. Ndërkaq, Kosova edhe më tutje do të mbetet me problemet e njëjta. Ka nisur dialogu në kohën kur Serbia nuk ka dhënë shenja se është e gatshme t'i shpërndajë strukturat kriminale dhe antikosovare që veprojnë në veri, si dhe ta ndërpresë financimin e tyre.

Lidhja Demokratike e Kosovës i ka dhënë përkrahje dialogut, e bindur se kjo është forma më e mirë për zgjidhjen e problemeve. Po ashtu, i është dhënë përkrahje me shpresën se gjatë këtij procesi, në plan të parë do të vihen interesat e shtetit të Kosovës dhe të qytetarëve të saj, e besoj se kryeministri do t'i ruajë interesat e Kosovës. Nga kjo del e qartë se përkrahja e LDK-së vlen vetëm nën kushtet që përpikërisht të respektohet Kushtetuta e Kosovës, si dhe Rezoluta e miratuar në Kuvendin e Kosovës.

Këto janë përgjegjësitë dhe kompetencat e grupit kosovar për dialog, pa marrë parasysh se kush qëndron në krye të tij. Po ashtu, ky grup duhet të ketë parasysh se Kosova i ka tejkaluar dy cikle të bisedimeve. Së pari, ato të Vjenës, prej nga kah dal Plani i Ahtisarit dhe pavarësia e vendit. E dyta, janë bisedimet e ashtuquajtura “teknike” apo të quajtura “teknike”, kur janë arritur disa marrëveshje, të cilat duhet të zbatohen, por deri më sot nuk po zbatohen nga Serbia. Prandaj, dialogu i tashëm duhet të jetë vetëm në funksion të forcimit të shtetësisë së Kosovës në rrafshin ndërkombëtar dhe tejkalimin e disa problemeve që e vështirësojnë jetën e qytetarëve, por që të gjitha duhet të jenë brenda kornizës së Kushtetutës së Kosovës dhe Rezolutës së Kuvendit të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Kemi edhe katër deputetë të Partisë Demokratike, të paraqitur sipas radhës. Ganimete Musli e ka fjalën.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar ministra, zëvendëskryeministre, kolege dhe ju kolegë deputetë,

Është bërë mirë që tashmë veç është bërë një praktikë e raportimit në Kuvend nga Qeveria e Kosovës dhe kryeministri është duke u treguar shumë transparent në lidhje me dialogimin që po bëhet ndërmjet shtetit tonë dhe shtetit të Serbisë.

Po më befason fakti se që nga konstituimi i këtij Kuvendi në këtë mandat ne po ballafaqohemi me lloj-lloj akuzash, të cilat gjithmonë e kanë një emërues të përbashkët, sipas të cilit “Vetëvendosja” është “patriotë”, ndërsa ne të tjerët jemi “tradhtarë”. Çka do të thotë kjo, të jesh patriotë? Po i marr dy shembuj të thjeshtë: patriotë janë personat, të cilat identifikohen me shtetin dhe popullin e tyre, pa i vendosur mbi popujt e tjerë, pa i zhvlerësuar dhe pa përhapur urrejtje për popujt e tjerë. Patriotizmi e ka për bazë përkushtimin e pasionuar për shtetin, i cili nuk perceptohet vetëm si përmbledhje e rregullave politike dhe juridike, por si një bashkësi e pakontestuar, bartëse e vlerave të përbashkëta. Patrioti preokupohet për mirëqenien dhe vetëm mirëqenien e popullit, të cilën permanent e vendos para interesave të tij personale. Patrioti ndihet mirë vetëm në të mirën e përgjithshme.

Mirëpo, duke ju përcjellë me shumë vëmendje qysh se jeni bërë pjesë e këtij Kuvendi, unë nuk kam mundur të vërej as edhe një veti të vetme patriotike tek ju. Ju, përveç zhurmës dhe përhapjes së gënjeshtreve, frikës dhe urrejtjes, asnjë veprim nuk e keni bërë pa e vënë në fokus vetëm interesin dhe etjen tuaj të sëmurë për pushtet. Ju po dëshmoni se jeni kundër shtetit, kundër institucioneve, kundër policisë dhe gjithë propaganda juaj përpëlitive bazohet në keqpërdorimin e ndjenjave të sinqerta atdhedashëse të këtij populli dhe, çka është më e keqja, në keqpërdorimin e emrit dhe gjakut të dëshmorëve të kombit.

Të nderuar deputetë,

Nëse me të vërtetë jeni aq patriotë sa na shiteni, na e shpjegoni aktin e heqjes së fotografisë së komandantit legjendar Adem Jashari nga qendrat e “Vetëvendosjes” në Gjilan. Urdhër ky që i lëndoi tej mase anëtarët e “Vetëvendosjes”, shumë nga të cilët përfundimisht e braktisën lëvizjen tuaj. Pse asnjëherë s’iu përgjigjët anëtarëve tuaj në kërkesën e tyre 11-pikëshe, në të cilën, ndër të tjera, kjo kërkesë përmbante edhe kërkesën që “Vetëvendosja” të prononcohet për luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Duke ju parë sa larg shkoni me propagandën tuaj për të arritur pak publicitet politik, dua të ju them se ju zotërinj, jo që nuk jeni patriotë, por nuk e keni as idenë se çka do të thotë kjo fjalë.

Krejt çka mund të ju quajmë, është të ju quajmë “shovinist” dhe grupacioni që ju e udhëhiqni paraqet një lloj tipik të shovinizmit social. Instrumentalizmi i çështjes më të shenjtë që ka ky vend, siç është emri dhe gjaku i dëshmorëve për interesa të vogla politike, jo që nuk është akt patriotik, por është i patolerueshëm për secilin që di ta vlerësojë këtë vend dhe sakrificën qindravjeçare të këtij populli.

Të nderuar deputetë,

Gjatë kësaj seance sot nga një koleg yni i nderuar, qytetarët e Drenicës u quajtën “derra”, por kjo nuk më befasoni aspak, sepse jo rrallë shqiptarët e devotshëm të këtij vendi gjatë kësaj historie janë quajtur “njerëz me bisht”. Prandaj, nuk më befason as fakti se një anëtar i këtij Kuvendi sot qytetarët e Drenicës i quan “derra”.

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Fadil Demaku.

FADIL DEMAKU: I nderuar kryetar i Kuvendit!

Zëvendëskryeministre, ministra,

Kolegë deputetë,

Sa i përket kësaj pike të rendit të ditës, u tha shumëçka dhe do të mundohem që të mos i përsëris kolegët, por do të ndalem në dy-tri çështje shkurtimisht.

Këtu u shtrua çështja e besimit ndaj kryeministrit dhe unë dua të jem edhe një herë i qartë se kryeministri e ka mandatin për ta përfaqësuar Republikën e Kosovës në bisedimet e Brukselit. Ai e ka përkrahjen e shumicës së qytetarëve, si dhe të forcave kryesore politike të vendit. Këtë mandat nuk e ka rastësisht, por pikërisht nga besimi shumë herë i treguar në interes të vendit në rrethana tepër të jashtëzakonshme.

Edhe një çështje tjetër. Edhe pse tashmë zonja Trajković nuk është në Kuvend, nga fjalimi i saj në seancë gjatë paradites, kisha dashur që ajo të kthehet në realitet dhe ta dijë se është në Parlamentin e Republikës së Kosovës, se me gjuhën e saj, jo që mund të bëjë diçka tanimë, por qasja e saj nuk është në interes, as të perspektivës evropiane të qytetarëve, që pretendon se i përfaqëson, nëse e ka ndonjë mbrapa. Dhe, këtu, qëllimisht ajo u mundua të bëjë një krahasim, barazim apo një relativizim të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës me agresionin dhe gjenocidin që e ka shkaktuar Serbia mbi vendin tonë.

Një çështje tjetër që do të isha ndalur pak është flamuri kombëtar, sepse vazhdimisht janë duke u bërë akrobacione me të. Unë i kuptoj kolegët e “Vetëvendosjes” se tash jemi në muajin nëntor dhe është 100-vjetori i shtetit shqiptar dhe më shpesh mund ta shohin edhe në televizionet shqiptare filmin “Nëntori i dytë”, e ai i përmallon dhe këta bëhen pak më emocionalë sa i përket kësaj çështjeje. Unë, jo që jam kundër dhe nuk duhet të keqkuptohemi, por nuk duhet të bëhet shumë lojë me këtë çështje, sepse, tek e fundit, ndonjë kolegu deputet, si zoti Halit Krasniqi, qysh ka ide interesante nganjëherë të kërkojë që t’ua huazojë atë flamurin gjigant tifozëve kuqezi të Kombëtares shqiptare dhe të vijë të na e mbulojë krejt Parlamentin këtu.

Kolegut Rexhep Selimi, ish-bashkëluftëtarit, i isha lutur sinqerisht, se është çështje e ndjeshme, që të mos vijë këtu dhe të na e lexojë më betimin e ushtarit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, sepse ne mund t’ia lexojmë për çdo ditë njëri-tjetrit, por mund të them se me këtë nuk i nderojmë dhe respektojmë dëshmorët e kombit. Faleminderit!

KRYETARI: Zenun Pajaziti e ka fjalën.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Kabinet qeveritar,

Meqenëse sot u debatua për shumicën e çështjeve, të cilat po ashtu ishin të përmendura në informatën e kryeministrit, mendoj që shumëçka prej tyre duhet të mos e përsëritim. Ajo që mendoj që duhet ta them është në traditën më të mirë që ky proces, jo vetëm i raportimit, por në rastet si kjo të debatit, ka mundësi që të nxirret një opinion shumë real i

gjithë përfaqësuesve të qytetarëve tanë për sa i përket, jo vetëm procesit të bisedimeve me Serbinë, por edhe për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me perspektivën tonë.

Dy çështje që më duhet t'i theksoj, e që mendoj që njëra prej tyre në asnjërin rast, sidomos nga disa përfaqësues të Kuvendit nuk u tha në mënyrën e duhur, është çështja e menaxhimit të integruar të kufijve. Duhet të mos e keqpërdorim këtë proces ose këtë çështje kaq të ndjeshme vetëm me rastin e bisedimeve. Ne duhet ta dimë se Kuvendi ynë e ka miratuar një ligj që ka të bëjë me menaxhimin e integruar të kufijve, duhet ta dimë se Kosova ka bërë përgatitje kohë më parë për këtë proces. Është njëra ndër kushtet që e kemi nga BE-ja për ta realizuar dhe po ashtu duhet të themi që edhe vetë BE-ja në standardet e veta, në principet e veta e ka adaptuar. U përmend Traktati i Lisbonës në direktivat e BE-së dhe rrjedhimisht të gjitha shtetet që dëshirojnë të aderojnë në BE, detyrohen t'i inkorporojnë këto kritere.

Prandaj, ajo që ishte vështirësi te ne, ishte që Kosova nuk kishte mundësi ta realizojë menaxhimin e integruar të kufijve pikërisht në pikat me Serbinë dhe procesi i bisedimeve është një rast i mirë për Kosovën, për institucionet e saj, që ta realizojë si të thuash ta imponojë edhe në relacionin me Serbinë, që të realizohet ky menaxhim. Pra, kjo sjell vështirësi në plan të parë për vetë Serbinë. Ju i keni parë, të gjithë kush e kanë përcjellë në media të ndryshme, se qytetarët serbë, vetë serbët, vetë Beogradi zyrtar ka pasur reagime, sepse ata u kanë servuar informata krejtësisht të rrejshme për vite me radhë qytetarëve të vetë dhe kanë reagime sidomos për menaxhimin e integruar të kufijve, ngase ata konsiderojnë se me realizimin e kësaj marrëveshjeje, Serbia praktikisht e humb Kosovën, ose sovranitetin, ose kontrollin mbi Kosovën. Dhe, ju e dini realisht tash se si është në këto pika kufitare. Dhe, në anën tjetër, ne konsiderojmë që me realizimin e kësaj marrëveshjeje Kosova plotësisht e kontrollon territorin në të gjitha pikat e saj. Prandaj, mendoj që nuk duhet të spekulohet me këtë proces, me menaxhimin e integruar të kufijve, aq më parë kur kemi pasur rast sot të dëgjojmë edhe krahasime historike krejtësisht të pavend në periudha të ndryshme historike.

Pra, ky është një proces që edhe pas kësaj marrëveshjeje Kosova duhet t'i detyrohet BE-së, respektivisht zbatimit të direktivave të BE-së sa i përket menaxhimit të integruar të kufijve.

Dhe një çështje tjetër krejt për fund që dëshiroj ta them është gjuha që po përdorin politikanët serbë në relacion me marrëveshjen, ose bisedimet me Kosovën. Duhet të kërkojmë edhe nga institucionet ndërkombëtare që të bëjnë presion që ata ta ndryshojnë gjuhën e tyre. Ne i kuptojmë ata se e kanë ushqyer një propagandë krejtësisht të pabazuar për vite me radhë për qytetarët e tyre dhe e kanë të vështirë ta pranojnë procesin, por ata duhet njëherë e mirë ta ndryshojnë gjuhën e komunikimit dhe t'i shërbejnë këtij procesi pozitivisht në drejtim të realizimit të marrëveshjeve që arrihen me Kosovën. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti kryeministër e ke fjalën, pasi s'ka më të lajmëruar për diskutim.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Të nderuar deputetë,

I nderuar kryetar,

Ju falënderoj për debatin, gjithashtu për diskutimet,

Për mua ishte një përgjegjësi, edhe kushtetuese, edhe ligjore, por edhe obligim moral, edhe kombëtar, që ta informoj Parlamentin e Republikës së Kosovës për takimin e radhës, pra për takimin e dytë që është zhvilluar ndërmjet meje si kryeministër i Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe kryeministrit të Serbisë.

Të jua them të drejtën, e çmoj lart debatin, në të njëjtën kohë edhe opinionet e ndryshme të spektrit të ndryshëm politik, por ju e dini se nuk mjafton vetëm për të qenë kritikë. Unë do të ju ftoj që të sillni ndonjëherë edhe ndonjë këshillë dhe rekomandim edhe për mua personalisht, gjë që do të jetë ndihmuese edhe për mua, por do jetë edhe në dobi të shtetit të Kosovës.

Jam më se i sigurt se në kuptimin elektoral, as unë që e zhvilloj takime dhe kam obligim kushtetues dhe ligjor me kryeministrin e Serbisë në Bruksel, nuk do të sjellë ndonjë dobi, por të jeni të bindur edhe ju se qytetarët e Kosovës dinë të reflektojnë shumë drejt që edhe kritikët pa argumente ndaj këtij procesi nuk do të përfitojnë diçka në kuptimin elektoral. Qytetarët e Kosovës dëshirojnë që ne t'i ndihmojmë njëri-tjetrit, ta kuptojmë njëri-tjetrin dhe të dalim të suksesshëm si shtet. Këtu u fol edhe për histori, edhe për betime. Unë jam betuar një herë dhe qëndroj shumë krenar pas atij betimi jetësor. Në atë betim timin lidhet vullneti i qytetarëve të Kosovës, prandaj nëse dikujt i ka mbetur merak - është çështje e tij, por dua të theksoj se një luftëtar nuk e lëshon flamurin nga dora si leckë. Prandaj, në shenjë të ruajtjes së krenarisë dhe dinjitetit të flamurit kombëtar, unë e marr flamurin dhe e mbaj në dorë.

Kjo është edhe në traditën e popullit tonë, por edhe në rregullat e luftëtarit të lirisë.

Të nderuar të pranishëm,

Tash e 13 vjet janë të njëjtët zëra, janë të njëjtit njerëz që po mbjellin frikë, që tentojnë të mbjellin frikë, urrejtje, defetizëm. Janë të njëjtit zëra me kombinime të ndryshme, natyrisht, që synojnë të mbjellin përçarje qytetare dhe politike. Janë të njëjtit njerëz me zëra të dështuar, që në mënyrë të vetme për ta realizuar një objektiv, e kanë pretendimin për përbaltjen e tjetrit.

Të nderuar deputetë,

Janë të njëjtit zëra që thurën deklaratime të ndryshme si profeci për procesin në Rambuje, në Vjenë, edhe tash në Bruksel. Koha dhe rezultatet e kanë dëshmuar krejt të kundërtën e asaj çka ata kanë deklaruar dhe propaganduar. Prandaj, unë ju ftoj të mos mbillni edhe më tutje ankh. Mos mbillni frikë! Kjo nuk është e ndershme, nuk është e moralshme. Kjo nuk është njerëzore, është e turpshme. Liria, pavarësia, sovraniteti dhe integriteti territorial i shtetit tonë, që e kemi ndërtuar me mund, djersë dhe gjak bashkërisht, kurrë nuk do të vihet në pikëpyetje. Prandaj, unë ju ftoj t'i lëmë anash ndarjet, të punojmë bashkërisht, pa dallime partiake, politike e qytetare. Të punojmë për Kosovën e re, të

punojmë për Kosovën evropiane. Të punojmë bashkërisht për t'ua lënë një të ardhme të sigurt fëmijëve tanë.

Këtu u përmendën edhe personalitete të ndryshme historike, prej Pashiqit, Esat Pashës, Zogut, Karagjorgjeviqit, Titos. Asnjërit prej këtyre shqiptarët fort s'ia kanë pa hairin. Prandaj, unë ju ftoj që të koncentrohemi në vlerat tona kombëtare, t'i ruajmë ato vlera, t'i realizojmë qëllimet tona dhe vizionin tonë. Se kush është zogist, esatist, e qemalist, mendoj se kjo punë i takon historisë, edhe në kuptimin ideologjik, edhe të përpjekjeve për liri dhe pavarësi të shqiptarëve. Me këtë logjikë nuk e di se si do ta vlerësonim ne Ismajl Qemajl Beun në vitin 1912, metë cilin sot krenohemi të gjithë me të drejtë. Se në vitin 1912 është shpallur pavarësia e Shqipërisë aktuale zyrtare, por jo pavarësia e shqiptarëve. Edhe Kosova me shqiptarë ka qenë.

Prandaj, t'i respektojmë vlerat tona kombëtare. Jemi në prag të 100-vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë, në prag të pesëvjetorit të pavarësisë së Kosovës, duke realizuar dhe afirmuar të drejtat e shqiptarëve si kurrë ndonjëherë më parë kudo që jetojmë, edhe në Preshevë, edhe në Maqedoni, edhe në Mal të Zi dhe kudo tjetër.

Unë e kam theksuar edhe më herët dhe e theksoj edhe sot shumë fuqishëm: Më së lehti dhe më së miri shqiptarët do të jetonin në një shtet të vetëm, pranë njëri-tjetrit, me vendet dhe popujt tjerë. Dhe, unë i besoj këtij qëllimi dhe vizioni të shqiptarëve se do të jetojnë në një hapësirë pa kufi në familjen e bashkuar evropiane. Ne kemi opinione të ndryshme, edhe për histori, dhe e dimë se kemi ditur t'i përbaltim personalitetet historike, pa të drejtë. Kanë rënë në gjumë patriotë, janë zgjuar në mëngjes tradhtarë; kanë rënë në gjumë tradhtarë, janë zgjuar patriotë. Pa të drejtë! Prandaj, të mos mbetemi viktimë e atyre perceptimeve, thjesht të gabuara, t'ia lëmë historisë vlerësimin e së kaluarës. Ne mund të bëjmë ndryshme në kuptimin e pretendimeve historike, t'i shkruajmë si të duam, por e kaluara nuk ndryshon kurrë.

Argumentet, faktet, nuk ndryshojnë kurrë dhe pikërisht duke i vlerësuar vlerat tona kombëtare, personalitet tona kombëtare, me propozimin tim, me mbështetjen tuaj dhe të Qeverisë së Republikës së Kosovës, unë e kam emërtuar Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës me emrin e komandantit legjendar Adem Jashari, por në të njëjtën kohë e kam emërtuar edhe autostradën me emrin e presidentit Ibrahim Rugova. Gjithashtu, kam propozuar edhe emërtimin e Universitetit të Prishtinës me emrin e themeluesit dhe ideatorit të shtetit, thjesht të shpalljes së Shqipërisë si shtet, Hasan Prishtina. Gjithashtu, Universitetin e Pejës me emrin e Haxhi Zekës, Universitetin e Prizrenit me emrin e Ukshin Hotit, Universitetin e Gjiçanit me emrin Kadri Zeka. Tash secili le të vlerësojë se kush i vlerëson vlerat dhe personalitet historike.

Të kthehemi në temë. Të pagjeturit. Nuk na duhet dialogu, u tha këtu. Unë do të isha pajtuar plotësisht se nuk na duhet dialogu, por unë nuk e kam atë fuqi si kryeministër i Kosovës ta bind Serbinë ta bëjë zbardhjen e fatit të pagjeturve. Nuk e kam atë fuqi, atë zotësi. Urdhëroni prej juve, cili e ka atë fuqi dhe zotësi, do ta ketë mbështetjen time morale, njerëzore, gjithë-institucionale shtetërore të Republikës së Kosovës. As atë

zotësi, e as atë njohësi nuk e kam. Unë nuk mund të ndikoj në kuptimin, nuk kemi favorizuar në kuptimin e një mirëkuptimi të tillë. Nuk jeni as ju të favorizuar.

Prandaj, e vetmja zgjidhje, përsëri e theksoj, është presioni që ne mund ta bëjmë nëpërmjet Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës tek autoritetet në Beograd.

Dhe, unë mendoj dhe ju ftoj të gjithëve, që kjo çështje është aq e dhimbshme, aq humane, të mos politizohet dhe të mos luhet me ndjenjat e njerëzve që i kanë humbur të afërmit e tyre, e secili nga ne, në një formë a formën tjetër, nëse jo në rrethin e ngushtë, në rrethin e gjerë familjar, e kemi dikë të zhdukur, të vrarë apo të dëmtuar, e me plagë nga Serbia. Prandaj, edhe kjo çështje duhet të na bashkojë, jo të na polarizojë në kuptimin politik, sepse të gjithë jemi të lënduar. Të gjithë jemi të goditur.

Sa i përket IBM-së, nuk do të futem në terminologji, është ajo që është. Nuk ka menaxhim të integruar të kufijve ndërmjet komunave. Ka vetëm ndërmjet shteteve. Dhe, këtë duhet ta bëj të qartë një herë e përgjithmonë.

E theksoj, pikat e menaxhimit, pikat kalimtare të menaxhimit të integruar të kufijve do të jenë në pikat aktuale që janë tani pika kufitare, ku do të jenë Policia dhe Dogana e Kosovës, natyrisht në bazë të standardit ndërkombëtar, edhe Policia dhe Dogana e Serbisë, por edhe me praninë e EULEX-it, që do të jetë një prani e njëjtë, sikur në veri, sikur në Merdar, sikur te Dheu i Bardhë. Dhe, kjo është shumë e qartë në marrëveshje. Tash ne mund të bëjmë interpretime të ndryshme, si të duam.

Trashëgimia kulturore: Trashëgimia kulturore e çdo komuniteti në Kosovë është trashëgimi jona e përbashkët dhe as më pak e as më shumë nuk do të jetë se ajo që është e përfshirë në dokumentin e presidentit Ahtisari që ky Parlament e ka aprovuar, e ka miratuar dhe në bazë të atij dokumenti që e kemi negociuar, e kemi shpallur edhe pavarësinë e Kosovës, të cilën e kemi nënshkruar të gjithë me krenarinë më të madhe. Prandaj, ai dokument, ajo substancë do të respektohet.

Njësitë e veçanta të Policisë: Policia e Kosovës, e theksoj edhe një herë, dhe dëshiroj ta qartësoj. Nëse janë 3 policë, do të bëhen 5; nëse janë 5, do të bëhen 7. Policia e Kosovës është polici multietnik dhe profesionale, pra do të jenë edhe shqiptarë, do të jenë edhe serbë, edhe turq, edhe boshnjakë, siç është përbërja e Policisë së Kosovës. Dhe të mos pretendojmë të krijojmë konfuzion në opinionin publik.

Transparenca e financimit të strukturave paralele: Ju diskutuat edhe nga ajo që e prezantova edhe unë. Në këtë drejtim, synimi dhe qëllimi ynë është shpërbërja dhe largimi i plotë i të gjitha strukturave paralele ilegale jolegjitime të sigurisë së Serbisë.

Ndërsa, sa i përket sistemit të shëndetësisë e të arsimit, unë do ta respektoj në përpikëri dokumentin e presidentit Ahtisari.

E ju e dini shumë mirë se edhe me përmbylljen e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës, dokumentin e Ahtisarit e kemi substancë kushtetuese dhe ligjore.

Prandaj, duhet të jemi edhe korrektë me njëri-tjetrin, edhe të përgjegjshëm përballë prezantimit të opinioneve para qytetarëve të vendit tonë.

Autostrada: Ide e këtij, ide e atij. Ne e kemi prezantuar objektivin tonë, e kemi prezantuar projektin, i kemi prezantuar idetë tona dhe është tepër mirë. Unë mendoj se duhet të ndihemi mirë secili nga ne që po e përfitojmë një projekt infrastrukturor, të munguar për Kosovën. Kufijtë me dëshirën tonë s'i kemi caktuar, as ju, as unë, as askush. I kemi këta që i kemi dhe fqinjët nuk i kemi zgjedhur ne. I kemi këta që i kemi.

Do të vazhdojë ndërtimi i projektit Besi-Mutivodë, në drejtim të Leskocit. Tash unë kam takuar deputetë, nuk dëshiroj të flas me emra, disa kanë dëshirë të shkojë në drejtim të Lllashticës dhe Dumnicës, e dikush kah Prapashtica. Kjo nuk është punë llastiku, është punë autostrade dhe është projekt ndërkombëtar.

Prandaj, do të kalojë përgjatë drejtimit që e përcaktojnë ekspertët që merren me studimin e fizibilitetit, ekspertët vendorë dhe ndërkombëtarë. Ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë që do të jenë të paguar, dhe kjo pagesë është konfirmuar nga Komisioni Evropian. Dhe kjo autostradë do ta lidhë Kosovën, shtetin e Kosovës, përgjatë gjithë kësaj hapësire, duke e kaluar kufirin e Kosovës në hapësirat me shumicë shqiptare deri në Leskoc, ndërsa do të vazhdojmë me zgjerimin e rrugës magjistrale në drejtim të Besianës dhe Merdarit.

Takimi tjetër do të ndodhë gjatë muajit dhjetor, por unë ju ftoj që disa çështje që kërkohen nga unë - deklarime politike - iniciojini, i futim në Kushtetutën e Kosovës dhe unë do t'i mbroj me këmbëngulësinë më të madhe. Iniciojini dhe futini në Kushtetutën e Kosovës, që shteti i Kosovës e mbron dhe e ruan të drejtën e mbrojtjes së të drejtave të shqiptarëve kudo që jetojnë në rajon. Dhe lini këto deklarata, por dilni me propozime, me Kushtetutë! Unë jam me ju dhe unë do t'i mbroj. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit, zoti kryeministër! Unë ju kisha lutur që ta keni parasysh që kemi diskutuar sa orë, nuk po kuptoj pse jeni lajmëruar për replikë, megjithatë unë ua jap të drejtën. Jeni 3 veta, më shumë nuk ka nevojë. Njësoj është ajo punë, më shumë s'keni çka thoni. Zoti Konjufca, e keni fjalën për replikë, dy minuta.

GLAUK KONJUFCA: E kërkoja të drejtën e fjalës, sepse më duket që kryeministri bëri disa përfundime të pavërteta lidhur me aktin tim, me gjestin tim. Për arsye se tha që unë e hodha flamurin. Unë nuk mendoj që e kam hedhur flamurin, mendoj që e kam lënë të palosur në foltore. Foltorja nuk është shportë e bërllokut, por është një pjesë e cila është e dedikuar për të folur deputetët, edhe kryeministri. Dhe, unë e lash aty të palosur flamurin me qëllim që ju ta vendosni dorën aty dhe të betoheni, sepse këtë e presin qytetarët e Kosovës, ma merr mendja, që nuk do të ketë kurrfarë autonomie për veriun e Kosovës.

Kjo duhet të jetë garanci, duhet të jetë siguri i qytetarëve të Kosovës, të cilët kanë të drejtë të jetë të shqetësuar këtyre ditëve të fundit me atë që po dëgjojnë, edhe prej zërave ndërkombëtarë, se veriu do të përfundojë në negociatë. Dhe, konkretisht, duke e parë situatën sikur pardje, kur patrullonte xhandarmëria e Serbisë atje, kurse forcat tona të sigurisë i shikonin me dylbi. Pra, për këto arsye unë e vendosa flamurin atje, e nuk e kam hedhur flamurin. Përndryshe, ju nuk mund të shtireni se po e merrni flamurin, se e doni më shumë se ne, sepse po ta kishit dashur aq shumë këtë flamur kombëtar, do të ishte atje në skaj prapa juve ai flamur, e jo ky që është aktualisht, sikur ta kishit dashur aq shumë.

Përndryshe, sa i përket betimit, ju thatë që e keni bërë një herë më 1999. Unë nuk e di a e keni bërë, a nuk e keni bërë. Mendova kë ta pyes për t'u informuar për këtë çështje. Një herë mendova ta pyes Berat Buzhalën, figurën tuaj emblematike partiake, por nuk m'u duk i përshtatshëm për këtë pyetje. Po më duket që Rexhep Selimin duhet pyetur më mirë, mendoj se më së miri mund të na e tregojë këtë punë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë, zoti Thaçi e ka fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Mua më vjen mirë që e pranoni gabimin e hedhjes së flamurit. Por, në të njëjtën kohë, unë ju ftoj që të reflektoni drejt në kuptimin e përgjegjësiave institucionale, kushtetuese, ligjore dhe shtetërore. Pasi opinioni ka të drejtë të dijë gjithçka dhe duhet të dijë, por në asnjë rrethanë të mos pretendohet të manipulohet me të, unë ju thash disa herë për zërat e dështuar të 13 vjetëve të kaluara në skenën politike kosovare dhe të përgjegjësiave shtetërore.

E theksova edhe më herët se po këta zëra 13-vjeçarë të zhurmshëm, të dështuar, kanë qenë edhe kundër Konferencës në Rambuje, edhe të Parisit, edhe të marrëveshjes me ndërkombëtarët. Keni deklaruar edhe se nuk do të ndodhin bombardimet. Ato ndodhën, liria e Kosovës erdhi. Kosova u çlirua.

Ju deklaruat në këto 13 vjet edhe kundër Rezolutës 1244, që garanton integritetin territorial të Republikës së Kosovës.

Por, shumë interesat qysh ju përputhen idetë ndonjëherë. Mos më keqkupto! Dua të besoj nga padija në raport me autoritetet në Beograd, kur edhe KFOR-in, edhe UNMIK-un, për një kohë të gjatë i keni quajtur pushtues.

(Ndërhyrje Glauk Konjufca: Po Serbia e mbron Rezolutën 1244!)

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Po Serbia nuk e ka sjellë KFOR-in këtu, or ti djalë!

Ju jeni deklaruar dhe keni protestuar duke i fyer të gjitha këto personalitete të skenës politike për dialogun në Vjenë, duke thënë që Kosova nuk do të bëhet e pavarur. Kosova u pavarësua. Përsëri e vlerësoj padituri, ose edhe arrogancë.

Ju jeni deklaruar kundër Ahtisarit, kundër dokumentit, jeni bërë deputetë të pakos së Ahtisarit. E gëzofshi! Dhe, është mirë që keni hyrë në proces.

Ju deklaroheni kundër Kushtetutës së Kosovës. Herë e respektoni, herë nuk e respektoni.

Ju e dini shumë mirë se ky Parlament ka nxjerrë Rezolutë të Kuvendit të Kosovës për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet shtetit të Kosovës dhe Serbisë, ndërsa ju vazhdoni përsëri kundër. Është e drejtë e juaja demokratike.

Ju jeni deklaruar kundër të gjitha simboleve dhe nuk e respektoni asnjë simbol shtetëror. Mendoj se kjo nuk ju bën nder. Besoni, ata që po ju mësojnë, ju mësojnë gabimisht. Ju mësojnë keq.

Ju jeni deklaruar edhe kundër pavarësisë së mbikëqyrur, të shpallur në mënyrë të koordinuar me SHBA-të dhe me Bashkimin Evropian.

Edhe kur arritëm suksesshëm ta përmbyllim procesin e mbikëqyrjes së pavarësisë, ju deklaruat se kjo nuk është përmbyllje, kjo nuk është pavarësi, ky nuk është sovranitet. Ok-ej! Ju përsëri deklaroheni kundër normalizimit të marrëdhënieve. Përsëri është e drejtë juaja.

Por, unë ju ftoj që së paku ta kultivoni debatin në një mënyrë pak më të avancuar etike dhe përgjegjësie kushtetuese dhe ligjore. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti kryeministër! Unë e respektova nënkryetarin e Kuvendit, Konjufca. Sipas Rregullores, kur raporton, e përmbyll kryeministri, prandaj replikat tani nuk kanë vend në këtë çështje.

Vazhdojmë me radhë sipas vendimeve të seancës, pika e gjashtë bëhet pikë e tretë e rendit të ditës:

3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar Projektligjin e propozuar nga deputeti Ramë Vataj dhe grupi i deputetëve dhe Kuvendit i ka rekomanduar që këtë projektligj të mos e miratojë në parim, si dhe të ngarkohet Qeveria për hartimin e Projektligjit të ri për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.

E ftoj deputetin Ramë Vataj, në cilësinë e propozuesit, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin. Zoti Vataj, e keni fjalën.

RAMË VATAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Këtu ka disa mendime, e pasi ka mendime për debat, disa ndoshta janë për ta shtyrë për të hënë vazhdimin e seancës. Edhe ashtu nuk ka kohë, janë lodhur, ose unë e kam

arsyetuar nismën time dhe ndryshimet që janë bërë në ligj. Kështu që seanca le të vendosë. Unë gjithsesi do t'i shpalos idetë e mia, ndryshimet që janë bërë, sepse për të gjitha mediet që më kanë thirrur deri tash nuk kam dashur të prononcohem rreth këtij ligji. Kam dashur këtu të deklaroj, e pastaj të flas për mediet, që të gjitha dilemat të hedhen. Si të doni ju, pyeteni seancën a ta vazhdojmë këtë pikë të hënën, a jo. Faleminderit!

I nderuar, zoti kryesues,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

E kam kënaqësinë që m'u dha rasti ta shpalos idenë time për nismën që e kam marrë tash e një vit me 49 deputetë, e atë nismë e kanë përkrahur deputetët e të gjitha partive, e prej tyre vetëm 9 i ka tërhequr nënshkrimet, nga subjekti i Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Unë kam obligim t'i bëj sqarimet e duhura rreth ligjit dhe të gjitha përfoljeve që janë bërë, sepse kohët e fundit janë dëgjuar edhe thyerje personale, që do të thotë se nisma ima e ka tronditur shumëkënd, edhe pse ajo ka qenë e paanshme. Unë jam nisur vetëm për kriteret, për instrumentin që duhet ta marrim për t'i zgjedhur anëtarët e rinj të Akademisë, ndërsa janë bërë shpifje edhe për ta hedhur çështjen krejt në anë të tjera, si "unë do t'i zgjedh njerëzit e partisë, ose shokët", e kjo fare nuk qëndron. Vetë mënyra e paraqitjes që edhe akademikët janë marrë me shpifje ndaj personalitetit tim, edhe ndaj personalitetit të deputetit, kjo tregon se ekziston diçka që ata i frikëson, nëse e ndryshojmë gjendjen që ekziston.

Unë do të nisem prej ligjit. Edhe ky që është, i mirë është. Unë kam thanë se duhet ndryshuar, por duhet të merren vetëm procedurat për zgjedhjen e anëtarëve të rinj për Akademi.

Rasti më i mirë se kam pasur të drejtë dhe me këtë i përgëzoj edhe deputetët tjerë që më kanë përkrahur në këtë nismë, janë debatet e zjarrta që janë duke u bërë ndërmjet Akademisë dhe anëtarëve tjerë, ose institucioneve, punëtorëve shkencorë, që e shprehin pakënaqësinë e tyre për procedurat me të cilat janë zgjedhur akademikët e rinj.

Mua më takon vetëm të sqaroj çka kam propozuar dhe çka përmban ligji i vjetër.

Së pari, unë e kam marrë ligjin e vjetër, që e ka stemën e UNMIK-ut, që është i vitit 2004, e i cili edhe 4 vjet pas shpalljes së pavarësisë, koka e shkencës dhe e dijes nuk bën përpjekje, por i trondit nisma e një deputeti që e llogarit veten se ka kapacitete intelektuale ta vlerësojë se duhet ndërruar ky ligj.

Se vetë Akademia e shkel ligjin ekzistues, po e lexoj vetëm nenin 1.2, ku thuhet: "Për punën e vet, Akademia i përgjigjet Kuvendit të Kosovës".

Të nderuar kolegë deputetë,

Ju që jeni prej fillimit në këtë Parlament, a mund të më tregoni, a ka pasur ndonjëherë raport të punës, apo i ka raportuar Akademia këtij Kuvendi që e ka themeluar, çfarë ka

arritur, çfarë ka bërë në atë institucion për të cilën është paguar? Të më falin, kur e kam marrë nismën nuk e kam marrë në emër asnjë akademik. Unë merrem me Akademinë, e jo me njerëzit që janë në të. Edhe kam thanë se kjo nuk i rrezikon ata. Kjo do ta përcaktojë instrumentin që do t'i çojë njerëzit e rinj në Akademi. Ata që janë mbeten, dhe vazhdojnë ashtu siç kanë vazhduar.

Pra, neni i parë është shkelur. Ky është viti i tretë, e nuk kam parë që Akademia e ka dërgua në Kuvend një raport pune për ta vlerësuar punën e tyre, për t'i arsyetuar rrogat që i marrin prej taksapaguesve.

A ka një institucion në botë, institucion publik që merr të holla prej taksapaguesve nuk i jep fare përgjegjësi askujt, as institucionit që e ka themeluar, as Presidentit, as Qeverisë. Tregoni, nëse ka një rast në botë, unë po e pranoj.

Nisma fillon prej këtij neni. Domethënë unë kam thënë që Akademia duhet t'i raportojë Kuvendit për punën që e ka bërë dhe ta arsyetojë buxhetin që do ta kërkojë për vitin e ardhshëm. Ta bëjë një plan të punës. Kjo është non sens për vendet e zhvilluara, sepse në vendet si Franca, Gjermania e tjera, akademiku e di dhe është i obliguar që në fund të çdo viti ta plotësojë CV-në e vet dhe i tregon shtetit çfarë ka punuar, me çka i ka kontribuar shtetit dhe dijes së atij vendi.

Unë kur e kam bërë këtë kërkesë në debat me anëtarët e Akademisë në grupin punues, thonë 'ne veprat i kemi të hapura, ejani lexoni kush të doni çfarë ka doni'. Kjo kështu nuk shkon askund. Unë nuk jam i detyruar, qoftë si punëtor shkencor, të shkoj në Akademi. Unë i lexoj veprat që më interesojnë, ato janë në internet, të gjitha i kemi në ueb-sajte. Hyni në faqe të Akademisë, shikoni çfarë pune gjeni, të tregojnë se çka kanë punuar.

Edhe statuti, edhe ligji i vjetër, thonë që për punën e vet Akademia i përgjigjet Kuvendit, por asnjëherë nuk i është përgjigjur.

Do të vazhdoj me nenet e tjera.

Unë e kam propozuar, kuptohet me ndihmën edhe të grupit punues, për shembull, që pranimi i anëtarëve të Akademisë duhet të bëhet në bazë të standardeve më të larta të veprimtarisë kërkimore-shkencore të krijimtarisë artistike. Edhe kjo duhet të futet në statut.

Loja më e madhe bëhet në statut, në finesa. Shiheni, thuhet neni 7 i ligjit të vjetër thotë, 'punëtorët shkencorë të cilët kandidojnë për Akademi duhet të kenë arritje të larta shkencore, që i kalojnë kufijtë e Kosovës'. Ato janë të matshme, hyni shihini në internet, ku janë ato arritje shkencore që i kanë treguar njerëzit që janë aty, ose le t'i marrin punimet shkencore të atyre që kandidojnë. Unë për këtë edhe e kam kërkuar një debat të veçantë dhe për mendoj që duhet ta bëjmë patjetër për procedurat si kanë shkuar në zgjedhjen e anëtarëve të rinj. Kam material të bollshëm, meqë njerëzit që kanë reputacion shkencor në botë, që kanë bërë shkollë në shtetet e zhvilluara, në Francë, Angli, Gjermani, Amerikë, i kanë dërgua CV-të e tyre e nuk janë vlerësuar. Ata i vlerëson bota, ndërsa akademikët tanë nuk mund t'i vlerësojnë për t'i pranuar në Akademi.

Tjetër? Kam bërë edhe propozim. Kuptohet këto janë propozime. E imja ka qenë të propozojë. Është seanca që vendos për këto propozime. Ne merremi vesh në bazë të përvojave të të tjerëve vendosim. Unë veç propozime kam bërë. Për shembull, kam bërë propozim të ndërrohet përbërja e seksioneve në Akademi. Merrini gjithë akademitë e regjionit, prej fqinjëve e deri më lart, afërsisht ose mos më tepër, ka 50% të shkencave të natyrës, teknike, mjekësore, bioteknologji, bujqësi, e kështu me radhë. Ne nuk e kemi këtë përbërje. Hyni në ueb-sajt, asgjë nuk po trilloj, hyni shihini kush janë anëtarët e Akademisë. Ajo duhet të ndryshohet në favor të shkencave, që e gjithë bota i njeh, e i lexon. Ky është ndryshimi që e kam propozuar. Çka i pengon akademikët nëse propozohet që kjo të ndërrohet në favor të shkencave të natyrës?

Tjetër? Me siguri i ka penguar, por unë nuk vendos, kam propozuar, që sikur akademitë tjera, shumica e tyre, se varet prej modelit, të kufizohet numri i akademikëve në Akademi. Ky numër duhet të jetë, për shembull, unë propozoj 30. Dhe për të qenë shumë në rregull në raport me të gjitha shkencat, sepse ne vendosim sa anëtarë do t'i ketë seksioni, jo si këtë herë diku 100 shkencëtarë propozohen, shkojnë e kandidojnë për 3 veta. Unë kam propozuar që ata shkencëtarë që e kalojnë moshën mbi 75 vjet, ose vdesin, konkursi del vetëm për shkencëtarin e fushës që duhet të hyjë në Akademi, por jo patjetër të plotësohet nëse nuk i plotëson kushtet. Kështu e kanë edhe...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Edhe një minutë e ke.

RAMË VATAJ: Mirë, ka qenë përbërja e seksioneve, një tjetër që i ka penguar po ashtu është se unë e kam vendosur një nen, që është absurditeti më i madh që të gjithë thirren në politizim. Unë kam thënë që në Akademi nuk mund të hyjë njerëzit që kanë funksione të larta politike dhe shtetërore. Tregoni cili vend i botës i dërgon politikanët në Akademi? Në vendet e zhvilluara, të civilizuar, ndodh që një akademik del në fushën e politikës, po assesi një politikan të hyjë në Akademi. Kjo nuk do koment. Ata që kanë qenë aty, askush nuk i prek.

Ndërsa, nuk duhet t'i kufizohet e drejta asnjë shkencëtar që të hyjë në Akademi, që llogarit në vlerësimin e punëtorëve shkencorë se ai duhet të hyjë. Nuk duhet patjetër të jetë ai banor dhe shtetas i Kosovës. Edhe ky është një propozim që e pasuron Akademinë, si edhe me anëtarët e rinj që do të vijnë me potencial shkencor, që i kalojnë kufijtë e Kosovës.

Kam e shumë gjëra tjera për të thënë, po do të kërkoj me ngulm që debati për zgjedhjet e fundit në Akademi të bëhet gjithsesi. Ajo e drejtë nuk mund të më privohet. E kam të drejtë me Rregulloren e Kuvendit, me 19 nënshkrime që i kemi mbledhur ta mbajmë debatin për zgjedhjet, për procedurat dhe për mënyrën sesi janë eliminuar disa, e si janë zgjedhur disa anëtarë të rinj për Akademi.

Këtë të drejtë e kam me Kushtetutë patjetër dhe do të ju sjell material, meqë kam të flas për kriteret që shumica nuk i kuptojnë, dhe për instrumentin që duhet ta përdorë Akademia.

Unë e kam marrë shembull konkret seksionin e shkencave të natyrës. Ne në seksionin e shkencave të natyrës, nëse unë kam propozuar që njësi matëse...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! T'i shtova 2 minuta, nga propozuesi e ke shndërruar në debat. Atëherë radhën e ka kryetari i Komisionit FunkSIONAL për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, zoti Idriz Vehapi.

IDRIZ VEHAPI: Nënkyetar, faleminderit shumë!

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

Komisioni FunkSIONAL, në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 30 tetor të vitit 2012, e shqyrtoi Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/19 për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, të propozuar nga deputeti Ramë Vataj, dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë rekomandim.

1. I rekomandohet Kuvendit që të mos e miratojë në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/19 për Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, të propozuar nga deputeti Ramë Vataj;

2. I rekomandohet Kuvendit që ta ngarkojë Qeverinë e Republikës së Kosovës për hartimin e Projektligjit të ri për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës brenda 3 muajve.

Më lejoni ta lexoj edhe arsyetimin, sepse është me rëndësi të sqarohet procedura se si ka ardhur deri këtu ky projektligj.

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/19 për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, i propozuar nga deputeti Ramë Vataj, i përkrahur nga grupi i deputetëve, është proceduar në Kuvend më 26.6.2012.

Kryesia e Kuvendit, në pajtim me nenin 53, pika 2 të Rregullores së Kuvendit, e ka proceduar projektligjin për mendim në Qeveri. Qeveria ka vlerësuar se projektligji, i propozuar nga deputeti Ramë Vataj, e ndryshon përmbajtjen e ligjit në fuqi mbi 50% dhe ka propozuar hartimin e Projektligjit të ri për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, me qëllim të zbatimit të tij më të mirë në praktikë.

Kryesia e Kuvendit, më 1 tetor 2012, e ka ngarkuar Komisionin për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media që ta shqyrtojë Projektligjin për

Akademine e Shkencave dhe te Arteve te Kosoves, te propozuar nga deputeti Rame Vataj dhe Kuvendit t'ia paraqese raportin para shqyrtimit te pare.

Komisioni, ne baze te nenit 56, paragrafi 2 te Rregullores se Kuvendit dhe ne pajtim me perfundimin e Kryesisë se Kuvendit, me 1 tetor 2012, ne mbledhjen e mbajtur me 30 tetor 2012, e ka shqyrtuar Projektligjin per ndryshimin dhe plotesimin e Ligjit nr. 2004/19 per Akademine e Shkencave dhe te Arteve te Kosoves, te propozuar nga deputeti Rame Vataj.

Komisioni me rastin e shqyrtimit te projektligjit e mori parasysh edhe mendimin e Qeverise. Komisioni, me shumice votash, vendosi qe t'i rekomandoje Kuvendit per mosmiratim ne parim te Projektligjit per ndryshimin dhe plotesimin e Ligjit nr. 2004/19 per Akademine e Shkencave dhe te Arteve te Kosoves dhe qe ta ngarkoje Qeverine per hartimin e Projektligjit te ri per Akademine e Shkencave dhe te Arteve te Kosoves.

Ky eshte mendimi i Komisionit Funkcional. Nderkaq, une do t'i them edhe dy-tri fjale ne emer te Grupit Parlamentar te Partise Demokratike.

Ne ne Grupin Parlamentar i kemi shqyrtuar rekomandimet e Komisionit Funkcional dhe mendimin e Qeverise dhe si grup parlamentar mendojme qe t'i kthehet Qeverise dhe brenda tre muajve te hartohet Projektligji i ri per Akademine e Shkencave dhe te Arteve te Kosoves. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ne emer te Grupit Parlamentar te LDK-se, zoti Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti nenkryetar!

Une, duke deshiruar qe vertet ta ruajme edhe klimen, dhe vazhdimisht e kam thene, nuk deshiroj as personalisht, as si subjekt politik ta politizoj, prandaj tekstin e shkruar qe e kam nuk do ta lexoj per arsyen e thjeshte, se nuk deshiroj, me vjen keq te them, te behem si ai qe ishte pak me heret, qe eshte e drejte e tij. Por, ne si grup parlamentar e perkrahim rekomandimin e Komisionit. Dhe, a e dini perse e perkrahim rekomandimin e Komisionit? Sepse, eshte thene qarte qe e ka perfshire edhe mendimin e Qeverise dhe mendimi i Qeverise eshte ai, i cili eshte i perfshire ne rekomandimin e Komisionit. Ne jemi qe te behet ndryshim, te plotesohet ligji, te shkoje ne procedura. Asnje problem per ne nuk eshte qe kjo te shkoje sipas procedures normale dhe te vijë nga institucioni kompetent, siç eshte Qeveria e Republikës se Kosoves. Te vijë ne procedim, e ne jemi ketu qe si deputete pastaj ta bejme një ligj sa me te mire qe eshte e mundur.

Prandaj, si LDK, si grup parlamentar, e perkrahim propozimin ose rekomandimin e Komisionit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ne emer te Grupit Parlamentar "Vetevendosje", zoti Kasolli.

AFRIM KASOLLI: Faleminderit!

I nderuar kryesues dhe te nderuar deputete,

Edhe unë nuk do ta zgjas shumë të debatohet më tepër për këto çështje. Po ashtu, Lëvizja “Vetëvendosje” i përkrah rekomandimet e Komisionit që ky ndryshim-plotësim i ligjit t’i rikthehet Qeverisë dhe pasi të kthehet nga Qeveria ne do ta japim kontributin tonë në amendamentimin tij, për ta bërë sa më funksional dhe sa më adekuat, në mënyrë që ky institucion akademik të funksionojë sipas standardeve të mirëfillta shkencore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të AAK-së, zonja Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës i përkrah rekomandimet e Komisionit Funksional dhe kontributin tonë do ta japim pasi ligji të kthehet prej Qeverisë në Komisionin Funksional. Faleminderit!

KRYESUESI: Në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, kryetarja zonja Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Koalicioni për Kosovë të Re i përkrah rekomandimet e Komisionit Parlamentar dhe beson e shpreson shumë se Qeveria do ta bëjë plotësim-ndryshimin e ligjit, që t’i lërë mundësi Akademisë së Shkencave të punojë me duar të lira. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! SLS-ja, zoti Stojanović.

MILIVOJE STOJANOVIĆ: Zahvaljujem predsedavajući!

Poslanička grupa SLS poštovaće odluku komisije. Nadamo se da ćemo od Vlade dobiti bolji predlog. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi “6+”, zoti Kinolli.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Edhe Grupi Parlamentar “6+” e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe i përkrah rekomandimet e Komisionit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani është radha e deputetëve. Zonja Bakalli e ka fjalën.

(Dëgjohet debat në sallë)

Tani janë paraqitur, unë nuk mund t’ua ndaloj fjalën. Nuk mund! Me Rregullore! Zonja Bakalli e ka fjalën.

AURORA BAKALLI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Unë shkurtimisht do t'i paraqes vërejtjet tona, si Lëvizje për Bashkim, lidhur me këto plotësim-ndryshime, që parashihen në Ligjin për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.

Duke filluar nga neni 5, ku është kërkuar që paragrafi të riformulohet si në vijim, ku thuhet se botime të publikimeve të rregullta dhe periodike të shkencëtarëve të suksesshëm brenda dhe jashtë vendit, nga fushat e shkencës dhe të artit. Ashtu si po kuptohet ky paragraf, është kërkuar që publikimet e shkencëtarëve tanë të botohen edhe në një botim të Akademisë. Kjo duhet të definohet shumë më qartë, sepse nëse nënkupton të ribotohen publikimet e shkencëtarëve tanë, atëherë kjo do ta fuste Akademinë në ujëra të rrezikshme në qarqe të shkencës, pasi punimet e publikuara tanimë janë në pronësi të botuesit tjetër.

Nëse mendohet që Akademia duhet ta ketë revistën e saj shkencore, që duhet të jetë e hapur për të gjithë, fundja si çdo revistë tjetër shkencore, atëherë atë e pret një punë shumë e rëndë për afirmim ndërkombëtar dhe, madje, në këtë fazë, nuk do të jetë atraktive as për hulumtuesit shkencorë vendorë pak më ambiciozë. Por, kjo assesi nuk do të thotë se me një punë të mirë të një ekipi të përkushtuar redaktorial nuk do të mund të arrihet afirmimi i një reviste shkencore të Akademisë sonë.

Gjithsesi, ky plotësim-ndryshim duhet të jetë më konciz dhe më i qartë. Sa i përket nenit 10, ku parashihet që Akademia nuk duhet të ketë më shumë se 30 anëtarë të rregullt aktivë dhe pesëmbëdhjetë anëtarë...

(Dëgjohen reagime nga salla)

...nuk u tha që nuk ka debat dhe meqenëse është pikë e rendi të ditës...

KRYESUESI: Unë ju lus, të gjithë deputetët, më fal zonja Bakalli, secili deputet e ka të drejtën e vet për të diskutuar.

Shikoni, unë e di që jeni lodhur. Edhe unë jam lodhur. Në qoftë se grupet parlamentare kanë vendosur që të hidhet në votim, atëherë i kisha lutur anëtarët e grupeve parlamentare, në qoftë se janë të disiplinuar, le ta tërheqin fjalën. Asnjë deputeti nuk kam të drejtë t'ia marr fjalën unë, sepse është e drejtë me Rregullore që të diskutojë. Tani s'kam çfarë të bëj!

Vazhdoni Zonja Bakalli dhe kërkoj falje që ju ndërpreva! Është mirë ta dëgjojmë kolegën.

AURORA BAKALLI: Faleminderit, kryesues!

Dhe, ky do të ishte një diskriminim shumë i madh që u bëhet deputetëve pa grup parlamentar. Nëse është pikë e rendit të ditës, atëherë edhe ne kemi të drejtë të diskutojmë.

Sa i përket nenit 10, ku parashihet që Akademia nuk duhet të ketë më shumë se 30 anëtarë të rregullt aktivë dhe 15 anëtarë me korrespondencë, konsiderojmë se duhet të jetë maksimumi 50 anëtarë të rregullt dhe 25 korrespondentë. Natyrisht, nëse ka kandidatë që i plotësojnë kriteret, përndryshe ky numër nuk ka nevojë të përmbushet domosdoshmërisht.

Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kroacisë, për shembull, si shtet me rreth 4,5 milionë banorë, lejon maksimumin prej 160 anëtarësh të rregullt.

Gjithashtu, nuk pajtohem me modifikimin e anëtarit të rregullt aktiv. Kjo më duket tendencioze dhe nuk e kam hasur në ligjet e vendeve të tjera të akademive, të paktën jo në ato që i kam lexuar unë, siç tingëllon diskriminues edhe mohimi i të drejtës së votës për anëtarët mbi 75 vjeç, kur dihet se titulli akademik është i përjetshëm.

Kur jemi te neni 11, i kemi vërejtjet më serioze dhe këtu ka vërejtje edhe nga Akademia e Shkencave dhe Arteve. Sipas këtij plotësim-ndryshimi, kërkohet që anëtarët e Akademisë të kenë përvojë në mësimdhënie dhe ta kenë titullin profesor. Megjithatë, nga ky kusht janë të liruar ata që punojnë jashtë Kosovës.

Kjo dispozitë më ngjan sikur planifikohet dhe konfigurohet për personalitete të caktuara, prandaj ne jemi absolutisht kundër.

Sipas një përkufizimi të tillë, sot në radhën e listës së akademikëve tanë, duke përfshirë këtu edhe ata që nuk janë më në mesin tonë, nuk do të figuronte ndonjëri nga akademikët, të cilët nuk e kanë pasur titullin e profesorit universitar, por që me veprimtarinë e tyre i kanë bërë nder Akademisë sonë të Shkencave dhe Arteve dhe kombit shqiptar.

E dyta, pse duhet bërë lehtësime për ata që veprojnë jashtë vendit. Me gjithë respektin dhe dëshirën, që bashkatdhetarët tanë nëpër botë të jenë sa më të suksesshëm, megjithatë ata që punojnë dhe veprojnë në vend arrijnë t'i bëjnë të pranishme ndërkombëtarisht institucionet tona. Pra, në rastin e dytë, pos që kontribuojnë për emrin e tyre personal, kontribuojnë edhe për institucionin kosovar.

Domethënë, propozimi ynë është që anëtar i rregullt i Akademisë së Shkencave dhe Arteve mund të zgjidhet shtetasi kosovar, rezultatet shkencore apo artistike të të cilit kanë vlera të larta, gjerësisht të pranuar.

Kur jemi te neni 13, ku kërkohet që kandidati për akademik të mos jetë në poste të larta administrative dhe politike, konsiderojmë se duke pasur parasysh rrethanat tona dhe ndikimin e madh të politikës në çdo sferë të jetës, atëherë një dispozitë e tillë mund të pranohet, edhe pse mund t'i bëhet e padrejtë ndokujt.

Meqenëse disa nga plotësim-ndryshimet i konsiderojmë të papranueshme, ne si Lëvizje për Bashkim do të votojmë kundër. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Muhamet Mustafa e ka fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuar kryesues,
Të nderuar ministra,
Meqenëse po bisedojmë për një institucion shumë të rëndësishëm dhe në fillim të një iniciative, ndoshta nuk është keq ta zhvillojmë një debat. Prandaj, duhet të kemi durim kur flasim për këtë.

Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës, e konceptuar si thesar i dijes dhe vlerave shpirtërore të Kosovës, që nga themelimi i saj, e konsideruar edhe si një nga elementet e shtetësisë së Kosovës, e ka luajtur një rol historik dhe në përgjegjësi të këtij roli historik.

Ajo, me gjithë sfidat që i ka pasur gjatë periudhave kur ka funksionuar dhe ka dhënë kontributet e veta, e ka ruajtur mëvetësinë e vet nga politika ditore dhe nga politikëbërja ditore, të cilat zakonisht mund t'i marrim si një politikantizëm, që zakonisht merr edhe përmasa vulgare.

Kushtet e reja të pavarësisë së vendit dhe forcimi i shtetësisë së Kosovës, me kushte të reja të strukturës institucionale dhe demokratike të vendit, akomodimi i një roli të akademisë duhet t'u përshtatet nevojave zhvillimore në vend. Pra, nevojitet, të them ashtu, një ridisnjim i pozitës së saj.

Kjo ka ndodhur pjesërisht me ligjin e aprovuar më 2004 dhe sot, në përgjithësi, mund të konstatojmë se në kushtet e dhëna, Akademia e ka ndërtuar një pozicion relativisht të mirë me asociacionet ndërkombëtare evropiane dhe rajonale të akademive simotra.

Sa i përket produksionit shkencor dhe artistik të këtij institucioni, sigurisht se mund dhe duhet të diskutohet, prandaj edhe Akademia duhet të jetë e gatshme të raportojë në Kuvend dhe në opinion. Por, diskutimi duhet të bëhet në bazë të një analize, që i vë në raport investimet që bëhen në Akademi dhe rezultatet që prodhon ajo, koston e funksionimit dhe rezultatet e saj.

Kjo shoqëri ka nevojë që t'i hapë këto debate në Akademi, para së gjithash, në Kuvend dhe në institucionet shkencore dhe asociacionet dhe aktorët tjerë të interesuar. Pra, Akademia ka nevojë ta ndërtojë strategjinë e zhvillimit të saj institucional. Raporti i Akademisë me institucionet dhe politikën duhet të ndërtohet mbi parimet e neutralitetit ndaj forcave politike dhe pavarësisë nga institucionet, brenda kufijve të mbrojtjes së lirisë së krijimit akademik.

Një pjesë e madhe e krijuesve tanë akademikë dhe artistikë u inkuadruan në lëvizjen e rezistencës aktive paqësore, duke u ndërlidhur me partitë politike, që ose e udhëhiqnin këtë lëvizje, ose ishin pjesë e asaj rezistence.

Pra, profili, ta quaj kushtimisht, politik i anëtarëve të rregullt dhe me korrespondencë mendoj se është, para së gjithash, produkt i kushteve dhe specifikave të zhvillimit të politikës së rezistencës aktive paqësore në Kosovë.

Është fakt që shumica e këtyre anëtarëve sot nuk janë aktiv në partitë politike, mirëpo ekziston kjo trashëgimi dhe deri në një masë mund të paraqitet edhe si ngarkesë. Mirëpo, është me rëndësi që anëtarësimi në këtë institucion mendoj se nuk ka qenë i predominuar ndaj kriterëve politike.

Akademia ka përgjegjësi që këtë trashëgimi ta menaxhojë në atë mënyrë, që t'i evitojë vendosmërisht reflektimet e interesave partiake, grupe me anëtarësimet në të dhe në funksionimin e saj. Njëkohësisht, edhe ata që janë të preokupuar me nevojën për reformimin e akademisë, në pajtim me kushtet e reja, duhet të përmbahen që aksionet dhe iniciativat e tyre ta marrin një gardh politik e partiak dhe grupor, pasi kjo është kundërproduktive, ashpërsion konfliktet në shoqëri dhe ka gjasa të mëdha që kjo të ndikojë në mbylljen e Akademisë ndaj iniciativave për reformim, edhe pse këto iniciativa mund të jenë edhe qëllimmira.

Prandaj, mendoj se propozimi i sotëm është i mirë dhe duhet të ndërtohet një qasje më gjithëpërfshirëse, më participuese, e liruar nga interferencat politike dhe duhet të rishikohet ky projekt, kjo përpjekje, sidomos disa nene të këtij teksti, të cilat mund të merren se kanë interferenca të tepruara të institucioneve, që e rrezikojnë pavarësinë e Akademisë.

Prandaj, ky lloj interferimi nuk do të ishte i zakonshëm për afirmimin e rolit të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës çfarë i duhet Kosovës. Andaj, do të ishte mirë, unë këtu e mbështes propozimin e Komisionit, por insisto që Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ta luajë një rol aktiv, ta krijojë një ekip të përbërë nga Akademia, pjesëtarët e saj, ekspertë tjerë dhe nëse ka nevojë edhe konsulentë të jashtëm, ta hapin debatin dhe, në rend të parë, në Akademi duhet hapur debatin, por edhe tek aktorët tjerë të interesuar, që për nga vokacioni duhet të jenë të interesuar, ta ndërtojnë një ligj që e afirmon rolin e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës në zhvillimin e dijes, shkencës, kulturës dhe artit në Kosovë, pa ngjyrimet politike dhe partiake. Ju faleminderit për durimin tuaj, sidomos në pjesën e dytë të diskutimit tim!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hyseni është paraqitur.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, nënkryetar!

Nuk isha paraqitur, po megjithatë e shoh të arsyeshme t'i theksoj vetëm dy çështje, me lejen tuaj.

E para, procedurale. E konsideroj në rregull që Komisioni të rekomandojë që Qeveria ta sjellë këtë ligj. Po, nuk mund të kalojë kjo çështje pa e shtruar - e pse Qeveria nuk e ka sjellë deri tani?

Është sa vite përpara? Është një ligj që ende e ka referencë rregulloren e UNMIK-ut. As akademia, as Qeveria nuk e ka parë të arsyeshme ta procedojë, së paku për këtë dhe së paku kjo e justifikon nismën e deputetit.

E dyta, ka ndryshuar shumë Kosova gjatë këtyre viteve, kur Akademia jonë ka punuar me rregulloret e UNMIK-ut. Po, me respektin që e kam për një pjesë të akademikëve, Akademia më së paku ka ndryshuar. Duhet të ndryshojë, zonja dhe zotërinj, edhe Akademia. Shikojeni opusin e saj! Shikoni përbërjen e saj! Shikojini emrat që kanë qenë!

Lidhja e Shkrimtarëve dhe Shoqata e të Burgosurve e kanë pas propozuar Adem Demaçin që ta bëjnë anëtar, në mënyrë adekuate. Shikoni emrat që janë brenda dhe Adem Demaçi është heshtur, është refuzuar me vite të tëra.

Parlamenti Evropian ia ka dhënë çmimin “Saharov” për të drejta të njeriut, Akademia jonë i injoron edhe vlerat e tilla. Duhet të ndryshojë edhe Akademia! Dhe unë shpresoj që ligji që do të vijë, ta përfshijë edhe atë materie që është thënë prej deputetëve dhe besoj që është edhe shprehje e akademikëve, e pjesës më të madhe të tyre, dhe në këtë mënyrë të shpëtohet e të mbrohet Akademia, e jo me avokatllëk të njëfarë trashëgimie, që nuk e nderon Akademinë. Shikojini emrat! Shikojeni opusin!

Ajo duhet të bëjë lustrimin dhe distancimin nga ajo e kaluar, që nuk e nderon Akademinë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në sallë janë 58 deputetë, na duhen së paku edhe 3 për të votuar. Nëse është dikush në bufe?...

Sipas Rregullores së Kuvendit, jam i obliguar që në fillim ta hedh në votim kërkesën e propozuesit dhe në qoftë se nuk fiton, atëherë fiton varianti i dytë.

Në sallë janë 65 deputetë. Pra, po e hedh në votim kërkesën e propozuesit, nga zoti Vataj dhe të tjerët për ligjin. Është vullneti juaj si e votoni, për apo kundër.

Votojmë tash!

Faleminderit! Me 45 vota kundër, një abstenim dhe 16 për, konstatoj se nuk miratohet propozimi, respektivisht kalon rekomandimi i Komisionit për t’iu kthyer Qeverisë. Nuk kemi nevojë ta votojmë. Faleminderit!

A jeni që ta vazhdojmë seancën, apo...? Zoti Reçica e ka fjalën.

ELMI REÇICA: Zoti nënkryetar,
Kabinet qeveritar,

Ne propozojmë që ta shtyjmë këtë seancë, se realisht po shihet që të premten, sidomos pas këtyre diskutimeve rreth bisedimeve me Serbinë, jemi shumë të lodhur, kështu që propozoj ta shtyjmë për ndonjë ditë tjetër, kur ta përcaktoni ju. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në marrëveshje me Kryesinë dhe me kryetarin, vazhdimi i seancës do të jetë të jetë të enjten, në orën 13.00.

* * *

(Vazhdimi i mbledhjes më 22.11. 2012, ora 10:00)

(Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi.)

KRYETARI: Po fillojmë me vazhdimin e seancës!

Të nderuar deputetë,

I nderuari kryeministër, zëvendëskryeministra,

Ministra të Kabinetit qeveritar,

Në sallë janë të pranishëm 65 deputetë, që do të thotë se mund të fillojmë me punë.

Seanca plenare e Kuvendit, e filluar më 16 nëntor, pasi i ka shqyrtuar tri pikat e rendit të ditës, i ka ndërprerë punimet për t'i vazhduar sot, më 22 nëntor 2012.

Në ndërkohë, Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 22 nëntor 2012, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, ka vendosur që kësaj seance t'i shtohen edhe dy pika të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mallrat e liruar nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor dhe

2. Shqyrtimi i raportit të tretë për zbatimin e Planit të Veprimit të Kuvendit të Kosovës për integritet evropian për vitin 2012

Na duhet një votim formal. Kush është për t'i futur këto dy pika të rendit të ditës? Faleminderit! Kundër, a ka? Abstenim, nuk ka. Do të thotë, pika: Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mallrat hyn në rend të ditës, dhe pika e dytë: Shqyrtimi i Raportit të tretë për zbatimin e Planit të Veprimit, janë dy pikat e fundit të rendit të ditës.

Vazhdojmë me pikën:

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim në parim. E ftoj ministrin e Drejtësisë, zotin Hajredin Kuçi, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

MINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Kryeministër,

Të nderuar deputetë, anëtarë të Qeverisë,

Më lejoni që para jush ta paraqes për miratim Projektligjin për ekzekutimin e sanksioneve penale. Me dispozitat e këtij projektligji është tentuar që të bëhet harmonizimi i plotë me Kodin Penal të Republikës së Kosovës, me Kodin e Procedurës Penale, me Kodin e Drejtësisë për të Mitur dhe Legjislacionit tjetër përkatës që është fuqi dhe që ndërlidhet ngushtë me ekzekutimin e sanksioneve penale. Më lejoni, të nderuar deputetë, që t'i theksoj disa nga ndryshimet kryesore dhe risitë që janë vënë në këtë projektligj. E para

është krijimi i instrumenteve ligjore për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit në institucionet korrektuese të Republikës së Kosovës.

Nën dy është përcaktimi dhe rregullimi i bazës ligjore për themelimin e njësive ekonomike, të cilat do të funksionojnë në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës. Kjo është një risi në Shërbimin Korrektues të Kosovës që të themelohen njësitë ekonomike, ku të burgosurit do të mund të punonin aty dhe të sillnin të hyra për Shërbimin Korrektues të Kosovës, por të hyra edhe në kuptimin vetjak për punën që mund ta bëjnë, qoftë në shfrytëzimin e tokës që e ka Shërbimi Korrektues i Kosovës në njësitë ekonomike, që mund të jenë sikur ato për axhustatorë, e për çështje të tjera që mund t'i kryejë të burgosurit brenda Shërbimit Korrektues.

Nën tre, rregullimi ligjor për kategorinë e personave të paraburgosur si kapitull i veçantë i këtij projektligji. Më lejoni, të nderuar deputetë, të theksoj se kemi raste të caktuara kur personat e paraburgosur, për hir të asaj që nuk i kanë vendimet adekuate nga gjykatat, për kohë të gjatë mund të qëndrojnë në qëllime të tilla dhe shpeshherë trajtimi i tyre nuk është adekuat me vendimet që i marrin.

Nën katër, rregullimi në mënyrë të specifikuar për personelin e Shërbimit Korrektues dhe atij Sprovues të Republikës së Kosovës, sikur që është: organizimi, përgjegjësia e të drejtave dhe detyrat e tyre dhe marrëdhënia e punës për zyrtarët e Shërbimit Korrektues, si dhe procedurat disiplinore për ata që bëjnë shkelje. Përcaktimi dhe rregullimi i mekanizmave mbikëqyrës ndaj institucioneve korrektuese, që përcaktohet me mbikëqyrjen e inspeksionale që e kryen Inspektorati, që tanimë është themeluar në Shërbimin Korrektues të Republikës së Kosovës, do të jetë një strukturë e veçantë në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë.

Po ashtu, do të themelohet Këshilli Profesional nga radhët e institucioneve shkencore, nga gjykatat, organet e administratës, shoqatat profesionale, shoqëria civile dhe institucionet tjera që merren me çështjet e luftimit të kriminalitetit, të edukimit të personave të dënuar dhe me qëllim të përcjelljes, hulumtimit dhe përparimit të sistemit të ekzekutimit të sanksioneve penale në vendin tonë.

Mbikëqyrjen lidhur me ofrimin e mbrojtjes shëndetësore të personave të burgosur, që e kryen ministria kompetente për punë të shëndetësisë, kësaj radhe do të provojmë ta bëjmë një ndryshim prej një njësie të veçantë, që është në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë për çështjet e shëndetësisë. Unë mendoj se kjo duhet të bartet në ministrinë kompetente, respektivisht në Ministrinë e Shëndetësisë. Po ashtu, është përcaktuar statusi juridik dhe është bërë organizimi dhe sistematizimi më i mirë dhe i qartë i funksionalizimit të Shërbimit Korrektues dhe Sprovues të Republikës së Kosovës. Më lejoni të theksoj se ky projektligj i ka 254 nene me 25 klerë dhe jam i bindur që gjithsesi do ta rregullojë çështjen e ekzekutimit të sanksioneve penale më mirë në vendin tonë. Dhe, në fund, të nderuar deputetë, më lejoni të ju informoj se shumë shpejt, në pjesën e parë të vitit tjetër, do ta sjell para jush Ligjin për mbikëqyrjen digjitale të të burgosurve, që nënkupton se një kategori e tillë do të jetë në mbikëqyrje adekuate, pa pasur nevojë që të shkojë në Shërbimin Korrektues, për arsye të shpenzimeve më të vogla dhe për arsye të kryerjes së

shërbimeve të tyre, me qëllim që të rehabilitohen dhe të kthehen si qytetarë të barabartë në vendin tonë.

Ju ftoj që t'i jepni sugjerimet tuaja dhe më pastaj ta miratojmë dhe të vazhdojmë me leximin e dytë. Faleminderit!

KRYETARI:Faleminderit! Fjalën e ka kryetari i Komisionit për Legjislacion Arben Gashi. Arbeni nuk është këtu. Atëherë, shkojmë sipas grupeve parlamentare. Në emër të Partisë Demokratike, deputeti Halit Krasniqi e ka kërkuar fjalën.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, zoti kryetar!

Zoti kryeministër, Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë dhe të nderuara deputete,

Projektligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale ka zgjuar interesim të veçantë në grupin tonë parlamentar për shumë arsye. Jo vetëm pse është një materie shumë e veçantë dhe sensitive, por edhe për faktin se pjesa më e madhe e grupit tonë parlamentar e ka përjetuar ekzekutimin e sanksioneve penale dhe gjithashtu e kemi pasur sensin dhe mirëkuptimin dhe natyrisht jemi sensibilizuar për faktin që pjesa më e madhe e këtij Parlamenti, si dhe grupet tjera parlamentare i kanë përjetuar ekzekutimet e sanksioneve penale. Duke qenë se shoqëria jonë kalon nëpër një transfer të përgjithshëm shoqëror, atëherë natyrisht i kemi kushtuar vëmendje të veçantë gjithë materies dhe kemi deklaruar se kontributin tonë do ta japim në komisionin përkatës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit të Lidhjes Demokratike, fjalën e ka deputeti Haki Demolli.

HAKI DEMOLLI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar me kujdes Projektligjin mbi ekzekutimin e sanksioneve penale për të cilin vlerëson se në esencë paraqet një lloj plotësimi dhe ndryshimi të ligjit që është në fuqi, si dhe paraqet përshtatjen apo harmonizimin e tij me disa dispozita të Kodit Penal të Kosovës, që do të hyjnë në fuqi në fillim të vitit 2013.

Nga leximi i këtij draftligji vërehet se një numër i madh i dispozitave të tij kanë mbetur të njëjta me ato të ligjit në fuqi, i cili është aprovuar nga ky Kuvend, në vitin 2010. Kështu, dispozitat mbi parimet e përgjithshme të ekzekutimit të sanksioneve penale, pastaj dispozitat mbi fillimin, respektivisht shtyrjen e ekzekutimit të dënimit, kushtet për strehimin, higjienën, ushqimin, përkujdesjen shëndetësore, të drejtat, përgjegjësitë dhe beneficionet e të dënuarve dhe një mori çështjesh të tjera rregullohen në mënyrë të njëjtë, pa ndonjë ndryshim apo pa risi përmbajtjesore.

Për dallim prej tyre, ndryshimet hasen te segmentet e caktuara që kanë të bëjnë me funksionimin e institucioneve përgjegjëse për ekzekutimin e sanksioneve penale, disa prej të cilave do të theksohen në vazhdim. Çështja që duhet shqyrtuar ka të bëjë me paragrafin e parë të nenit 205, në të cilin theksohet: “Shërbimi Korrektues i Kosovës

është organ qendror i Administratës shtetërore, i pavarur, i uniformuar dhe me grada në vartësi të Ministrisë së Drejtësisë”. Është mirë që gjatë diskutimit në procedurat e mëtutjeshme të këtij draftligji të përcaktohet nëse Shërbimi Korrektues i Kosovës është i pavarur, apo në vartësi. Sepse, nuk mund që në të njëjtën kohë të jetë edhe i pavarur, edhe në vartësi.

Për Grupin Parlamentar të LDK-së janë edhe dy çështje tjera që bartin dilema të caktuara. Dilema e parë ka të bëjë me nenin 206, që titullohet “Struktura organizative e Shërbimit Korrektues”, me të cilin parashihet që për kryerjen e punëve dhe detyrave nga kompetenca e Shërbimit Korrektues të themelohet njësi themelore organizative, e emërtuar si Zyra Qendrore e Shërbimit Korrektues të Kosovës. Kurse, konform nenit 207, paragrafi 2, në këto zyra qendrore mund të themelohen drejtoritë dhe sektorët e rinj.

Brenga jonë konsiston në faktin se mos po burokratizohet për së tepërmi Shërbimi Korrektues i Kosovës nëpërmjet themelimit të zyrave, drejtorive dhe sektorëve të rinj. A mos po u multiplifikohen kompetencat njësiteve të caktuara të këtij shërbimi dhe a ka nevojë për ngarkesa shtesë për buxhetin, edhe ashtu të varfër të Kosovës?

Dilema tjetër ka të bëjë me statusin e njësive ekonomike, të cilat parashihen me nenin 212, kurse statusi i tyre rregullohet me nenin 213, sipas të cilit njësi ekonomike e ka statusin e personit juridik dhe në qarkullim paraqitet në emrin e vet dhe për llogari të vet. Kjo dilemë sforcohet edhe më shumë kur merret parasysh fakti se sipas nenit 212, një institucion korrektues themelon një apo më shumë njësi ekonomike dhe po qe se kemi numër të madh të këtyre njësive të pavarura, vetvetiu pason pyetja se deri në çfarë niveli do të mund të mbikëqyret rregullsia e punës të tyre. Krejtësisht në fund do të theksoj se pavarësisht nga dilemat dhe çështjet e theksuara më lart, Grupi Parlamentar i LDK-së në parim do ta votojë aprovimin e këtij draftligji, kurse kontributin e vet do ta japë në komisionet përkatëse, me qëllim të qartësimit të dilemave të shtruara lidhur me dispozitat e tij. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Në emër të Grupit “Vetëvendosje”, deputetja Albulenë Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Edhe ne si Grup Parlamentar e kemi analizuar Projektligjin për ekzekutimin e sanksioneve penale dhe do ta votojmë. Duhet gjithsesi ta kemi parasysh që ne e kemi në fuqi Ligjin për ekzekutimin e sanksioneve penale, i cili mund të them që është pothuajse i ngjashëm me këtë që na është sjellë, kuptohet ky është paksa më i avancuar.

Por, ne e kemi shqetësimin tonë se ai që është në fuqi, por edhe ky që po e shqyrtojmë sot nuk do gjejë zbatim në praktikë. Pra, shumë nga dispozitat e këtij ligji veçse shkelen për çdo ditë, po i përmend disa, në mënyrë që të jetë më e kuptueshme për opinionin publik. Pra, fillimi i ekzekutimit të sanksioneve penale nuk respektohet në të gjitha rastet, varësisht se kush është personi që do ta vuajë dënimin. Më pastaj të burgosurve vazhdojnë t’u mohohen kushtet që u garantohen me ligj, por edhe me konventa ndërkombëtare, siç është e drejta në ushqim të shëndetshëm, higjienë, ngrohje, ujë,

medikamente, kujdesi joadekuat shëndetësor, burgjet e mbipopulluara etj. Pra, të gjitha këto janë shumë mirë të rregulluara në ligj, mirëpo fatkeqësisht që nuk po gjejmë zbatim në praktikë.

Pra, ne nuk e kemi problemin me mungesën e ligjeve, por me jozbatueshmërinë e tyre në praktikë. Më duhet të them gjithashtu që gjatë shqyrtimit të Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale kemi hasur në dy probleme. E para ka të bëjë me atë se në shumë dispozita të këtij draftligji lihet hapësira e interpretimit, e kjo shumë lehtë mund të keqpërdoret nga ministri apo zyrtarët që janë të thirrur ta zbatojnë këtë ligj, dhe e dyta ka të bëjë me atë që shumë dispozita, që duhet të jenë të obligueshme edhe për ministrin, edhe për zyrtarët apo drejtorët e burgjeve, përdoret fjala “mund”. Pra, jemi të vetëdijshëm që edhe kjo do të keqpërdoret. Mirëpo, do të insistojmë që të gjitha këto të rregullohen në shqyrtimin e dytë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të AAK-së, kryetari i Grupit, Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës do ta votojë në parim këtë projektligj. E kemi shqyrtuar edhe në komision, për shkak se shumica prej nesh që folëm jemi në komision. Sidoqoftë, do ta përsëris vetëm pak atë që u tha, se shumica dërmuese e provizioneve, të cilat vijnë me këtë projektligj janë të njëjta dhe mendoj se duhet të shikohet që në të ardhmen edhe ligjet që vijnë prej Qeverisë, edhe ato të cilat do të mund të vijnë me procedurat tjera të parapara, nëse janë në ndryshim të ligjit, të vijnë si projektligje për ndryshimin e ligjit dhe të vijnë vetëm ndryshimet.

Mendoj se nëse projektligjet do të vijnë të atilla, jo vetëm se Kuvendi do të shkarkohet prej punës nganjëherë gati të panevojshme, mirëpo gjithsesi se do të fokusohet edhe debati në Kuvend dhe do të merremi me ato ndryshime për të cilat sponsoruesi i ligjit ka paraparë se duhet të ndryshohen në ligjin ekzistues. Sidoqoftë, mendoj se ligji meriton që të kalojë në lexim të parë dhe gjithsesi të gjithë ne do ta japim kontributin gjatë procesit të amendamentimit në komision. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Koalicioni për Kosovë të Re, deputetja Sevdije Lama.

SEVDIJE LAMA: Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovën e Re e përkrah në parim Projektligjin për ekzekutimin e sanksioneve penale.

KRYETARI: SLS-ja? Nuk ka. Atëherë, për Grupin “6+”, deputeti Albert Kinolli.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuari kryeministër, Kabinet qeveritar,
Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar “6+” e ka shqyrtuar Projektligjin për ekzekutimin e sanksioneve penale dhe do ta përkrahim në parim, ndërsa kontributin tonë do ta japim nëpërmjet punës së komisionit. Faleminderit!

KRYETARI: Të paraqitur tjerë për diskutim nuk ka. Shkojmë me procedurën e votimit. Të pranishëm janë 82 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Me 75 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për ekzekutimin e sanksioneve penale. Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportin me rekomandime.

Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim në parim.

E ftoj ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, zotin Nenad Rashiq, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin. Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI NENAD RASIĆ: Hvala gospodine predsjedniče!

Poštovani premijeru, zamenici premijera,

Kolege ministri, dame i gospodo narodni poslanici,

Sigurnost i zdravlje na radu zaposlenih u opštem aspektu regulisano je odredbama Zakona o radu. Na Kosovu od 2003. godine postoji primenljiv zakon o sigurnosti na radu, zaštiti zdravlja zaposlenih i zaštiti radne sredine.

Nedostatak kompletnog i funkcionalnog sistema u oblasti sigurnosti zdravlja na radu, odnosno nedostatak odgovarajućih mehanizama, koji su deo ovog sistema, je učinilo nemogućim pravno i potpuno sprovođenje zakona na snazi.

Zakonodavne inicijative za izradu jednog novog Nacrta zakona za sigurnost i zdravlje na radu je potreba za približavanje sa zakonodavstvom Evropske unije u oblasti sigurnosti i zdravlja na radu. Tako da zahtev za približavanje ovog zakona evropske unije potiče iz mnogih dokumenata kao strateških, tako i političkih, kao što su zakonodavni program Vlade 2012., akcioni plan evropskog partnerstva, sektorske strategije 2011., i 2013, sporazum o zajedničkoj vazdušnoj evropskoj sredini, zajednička preporuka socijalnih partnera itd.

Uzimajući u obzir da se nesreće i povrede zaposlenih na radu nastavljaju da se događaju, preduzimaju mere za sigurnost i zaštitu zaposlenih na radnom mestu i u radnom

ambijentu. To će eliminisati rizike i razne nesreće, koje mogu da se dogode na različitim radnim mestima.

U cilju dopune sistema sigurnosti zdravlja na radnom mestu, Nacrt zakona je definisao osnivanje i funkcionisanje nacionalnog sistema, nacionalnog saveta za sigurnosti zdravlja na radu, licenciranje zaposlenih, koji su zaduženi za sigurnost i zdravlje na radu, kao poslodavca, licenciranje kompanija, ili privrednih subjekata, koji obavljaju poslove sigurnosti i zdravlja, odnosno koje procenio rizik na radu za poslodavca. Ove i druge utvrđene mere u ovom Nacrtu zakona garantuju poboljšanja zdravlja i sigurnost na radu, garantuju zdravlje i sigurnost za zaposlene.

Kroz preduzete mere i povećanja nivoa praćenja od strane inspekcija rada drugih relevantnih institucija, sigurnost i zdravlje zaposlenih na radnom mestu biće značajno poboljšane, što će smanjiti broj povrede i bolesti, a posebno će opasti neformalna zaposlenost. Sigurnosti zdravlja na radu osim sa socijalnog značaja kojeg puno ima, ima i ekonomskog značaja, jer štiteći živote i zdravlje zaposlenih, takođe je moguće povećanje proizvodnje, povećanje produktivnosti, i obezbediti ekonomsku perspektivu razvoja zemlje kroz kompanije koje pružaju usluge za procenu rizika na radu kod poslodavca, tako će se stvoriti nova radna mesta.

Dakle, preporuka je za usvajanje ovog zakona. Da bih skratio u jednoj sažetoj formi, mere koje će ministarstvo preduzeti u buduću, su: pre svega formiranje jedne ekspertske grupe, koja će biti u sastavu tri člana ministarstva eminentnih stručnjaka, jedan od strane poslodavaca, jedan od strane posloprimaoca, odnosno sindikata, koji će imati zadatak da licenciraju određene kompanije i pojedince, a svaka kompanija koja ima 50 + zaposlenih imaće obaveze da ima jednog radnika koji će biti zadužen za zaštitu na radu. Znači mere koje ćemo posle usvajanja zakona utvrditi, su: stvaranje jedne radne grupe koja će biti ministarstvo, poslodavci i posloprimaoci, licenciranje kompanije koja će ići u proveru kod poslodavaca da bi proverila njihov stepen rizika koji postoji na njihovim radnim mestima i na osnovu toga određivati koje su mere koje treba preduzeti i pored toga određivati ljude unutar tih kompanija koji će biti zaduženi za sigurnost na radu.

Naravno, sve dalje komentare smo spremni da razmatramo i da na osnovu vašeg predloga modifikujemo zakon eventualno, ili da zakon harmonizujemo nakon da bi bio što bolji za primer. Hvala!

KRYETARI: Kryetari i Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, deputeti Fikrim Damka.

FIKRIM DAMKA: Faleminderit, kryetar!

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 7 nëntor 2012, e shqyrtoi në parim Projektligjin për sigurinë dhe shëndetin në punë. Dhe, komisioni vlerësoi se Projektligji i plotëson kushtet e parapara të nenit 54 të Rregullores së Kuvendit dhe ia rekomandon Kuvendit për miratim në parim.

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë, shkojmë sipas grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, fjalën e ka deputetja Flora Brovina.

FLORA BROVINA: Faleminderit, kryetar!

Përsëritet kolegë dhe kolege,

Ligji për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë është një ndër ligjet shumë të rëndësishme dhe tregon përkushtimin e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Shëndetësisë për përkujdesjen e punëtorëve në punë.

Ky ligj del si rezultat i dy ligjeve themelore, që është Ligji i punës dhe Ligji për mbrojtjen shëndetësore dhe sigurisht në këto ligje parashihet përkujdesja e veçantë e punëtorëve në punë dhe më vjen mirë që edhe në emër të grupit kemi dhënë pëlqimin edhe në komision, që ky ligj të procedohet më tutje.

Me këtë ligj parashihet që obligimet e veta i marrin punëdhënësit, punëtorët dhe struktura tjetër e kontrollimit të shëndetit në punë dhe të sigurisë në punë. Sigurisht që shumë e nevojshme që punëtorët të njihen me të drejtat e veta dhe t'i marrin obligimet e veta për shëndetin dhe përkujdesjen personale në punë, por duke u kujdesur për vetveten, ata kujdesen edhe për kolegët e vet, por edhe punëdhënësi, qoftë ai privat, qoftë ai publik, i merr obligimet e veta që ta krijojë një ambient të shëndetshëm dhe t'i sigurojë edhe mjetet e nevojshme për siguri në punë. Ai gjithashtu merr përsipër që punëtorëve t'ua shpjegojë rrezikshmërinë e punës dhe t'i përcaktojë vendet e rrezikshme dhe përkujdesjen e veçantë për rrezikshmërinë në punë.

Ky ligj duhet të procedohet dhe të amendamentohet dhe ne si Grup Parlamentar do t'i japim vërejtjet personale, veç e veç, në amendamente në procedurat e mëtutjeshme. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e jep pëlqimin për këtë projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit të Lidhjes Demokratike, fjalën e ka deputeti Bahri Thaçi.

BAHRI THAÇI: Faleminderit, zoti kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Ligjin për sigurinë dhe shëndetin në punë. Meqë ky ligj i përcakton masat për përmirësimin e shkallës së sigurisë dhe shëndetit në punë, ne si Grup Parlamentar në parim do t'i japim përkrahje, por i kemi edhe vërejtjet tona.

Nën nenin 1, të përcaktohet me këtë ligj siguria e shëndetit në punë edhe për të vetë të punësuarit. Në vërejtjen në nenin 2, paragrafi 2, të projektligjit, togfjalëshi “punëtorët fillestarë” nuk duhet të futet me “praktikantët”, sepse është diçka që dallon ndërmjet praktikantëve dhe punëtorëve fillestarë. Pastaj, te neni 3, paragrafi 1.4, kemi një vërejtje, ku faktorët që ndikojnë negativisht, futen vetëm faktorët fizikë dhe kimikë. Aty duhet të hyjnë edhe faktorët biologjikë dhe faktorët tjerë, sepse nuk janë vetëm faktorët kimikë dhe fizikë ata të cilët e dëmtojnë shëndetin e punëtorit. Pastaj, përsëri në të njëjtin nen, pika 1.12, në fund e kemi: “...si dhe çdo dëmtim i shëndetit, i cili nuk rrjedh nga

sëmundjet e përgjithshme”. Unë mendoj se nuk ka sëmundje të përgjithshme, por duhet të ceket pikërisht kjo: nga ndikimi i dëmshëm i faktorëve fizikë, kimikë, biologjikë dhe faktorëve tjerë.

Pastaj, vërejtje në nenin 5: “Projektligji përcakton obligimet e punëmarrësit me rastin e vdekjes së të punësuarit”. Mendoj që është e drejtë që kjo të përcaktohet me ligj. Kemi gjithashtu vërejtje në nenin 6, paragrafi 1: Të fshihet fjala “rreziqet profesionale” dhe të zëvendësohet me “rreziqet që vijnë gjatë ushtrimit të profesionit”, sepse nuk ka rreziqe profesionale, por ka rreziqe të cilat vijnë gjatë ushtrimit të profesionit. Te neni 15 kërkojmë që të ceket shprehimisht obligimi që secila ndërtesë t’i ketë daljet emergjente, sepse aty kërkohen të gjitha tjera, por nuk ceket që ta kenë edhe daljen emergjente, përkatësisht shkallët për dalje emergjente. Dhe, gjithashtu, në paragrafin 1.7 të nenit 15 fshihet togfjalëshi “dhoma për pirjen e duhanit”, sepse ju e dini se ne në parim e kemi aprovuar Ligjin për duhanin dhe aty parashihet që të mos ketë dhoma për pirjen e duhanit, prandaj mendoj që është mirë edhe ajo të hiqet.

Në nenin 17 të projektligjit të bëhet specifikimi i punëve të veçanta, sepse përmenden shumë punë të veçanta, por në këtë ligj nuk ceken cilat janë ato. Vërejtje kemi edhe në nenin 23, në paragrafin 8 të nenit 23 të projektligjit, të bëhet klasifikimi adekuat i lëndimeve në punë. Kështu që në parim ne do të përkrahim këtë ligj. Faleminderit!

(Drejtimin e seancës e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Enis Kervan.)

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të “Vetëvendosjes”, Liburn Aliu.

LIBURN ALIU: Faleminderit!

Projektligjin për sigurinë dhe shëndetin në punë, Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” do ta votojë, edhe pse konsiderojmë se ky ligj në fakt nuk avancoi jashtëzakonisht më lart, në krahasim me nivelin e ligjit aktual. Pra, mund të themi që është bazuar komplet në ligjin aktual dhe nuk sjell diçka të re, diçka të pritshme, meqë prisnim diçka më tepër. Por, natyrisht e avancoi dhe e bëri më të mirë se ai që ishte. Prandaj, ne do ta votojmë, me gjithë faktin që kemi vërejtje të mjaftueshme.

Në këtë projektligj do të duhej të definohej që siguria dhe shëndeti në punë është e interesit publik dhe si rrjedhojë e kësaj pastaj do të vinin shumë elemente tjera, që do të duhej të shtoheshin. Sipas këtij projektligji, duhet të themelohet Këshilli Nacional për Siguri në Punë dhe njëjtë po ashtu edhe ligji ekzistues e obligon Qeverinë që ta themelojë Këshillin Nacional për Siguri në Punë që 9 vjet më parë, kur është aprovuar ky projektligj. Pra, ky këshill i ka nëntë vjet që nuk është aprovuar dhe tani në projektligjin e ri nuk bëhet asgjë tjetër, vetëm shtohet një nen me disa paragrafë pak më tepër, që është pak më ndryshe, pak më i shtuar se ai në ligjin aktual. Mirëpo, prapë edhe ky është i padefinuar qartë, e thekson vetëm se ky këshill do t’i përcaktojë politikat në fushën e sigurisë dhe të shëndetit në punë. Pra, nuk detajon diçka më tepër, nuk detajon nga kush do përbëhet, cilët do të jenë, madje thuhet të lëmive tjera, e nuk e definoi që dy përfaqësues do të jenë të lëmive tjera, e nuk dihet çfarë do të jenë ato. Mirëpo, ajo çka është më me rëndësi, nuk definoi qartë raportin se kush e harton projektin, kush e

kontrollon atë projekt, kush i përcakton politikat për projektet, siç është bie fjala për vlerësimin e rrezikshmërisë në punë, apo planet e evakuimit për sigurinë e ndërtesave, apo masat e ndryshme parandaluese. Thuhet që do të certifikohen personat. Ata persona do të paguhen dhe do të angazhohen nga kompanitë. Por, tash, me vetë faktin që paguhen nga kompanitë, në njëfarë mënyre kompania vetë e harton planin dhe vetë e zbaton, por në mbikëqyrje të tyre duhet të ketë një mbikëqyrje profesionale të kësaj veprimtarie.

Pra, nëse është dikush që i licencon ata, duhet të jetë dikush që do t'i kontrollojë pastaj edhe ato projekte. Mendoj se është një lloj konflikti i interesit, kur kompania vetë e harton planin apo vlerësimin e rrezikshmërisë në punë dhe pastaj e zbaton vetë. Dhe, kush e mbikëqyr këtë? E mbikëqyr Inspektorati, i cili nuk është i nivelit profesional që ta vlerësojë atë projekt nëse është në përputhje me kriteret e duhura. Ai e vlerëson thjesht vetëm a po zbatohet apo jo sipas atyre kriterëve. Pra, projekti në fjalë, projekti për masat parandaluese nuk definohet qartë se kush e kontrollon profesionalisht, apo kush i përcakton kriteret bazë për ato? Pasi e kemi shumë të qartë që kemi veprimtari të ndryshme dhe këtu madje në ligj nuk përcaktohen kriteret e kufizimeve, që do të duhej të thuheshin në të.

Kemi shumë ligje tjera që kemi pasur rast t'i shohim dhe t'i krahasojmë me këto, të vlerësohen kufijtë e zhurmës, kufijtë e emetimit të helmeve të ndryshme. Duhet të kenë kufij të përcaktuar, të jenë të përcaktuar madje edhe me ligj, në mënyrë të bëhen këto vlerësime të rrezikut, të ketë kriteret bazë që ata persona të licencuar t'i vlerësojmë.

Shembull konkret: Gjatë vizitës në “Sharrcem”, në Han të Elezit, me Komisionin për Mbrojtje të Mjedisit, pra në monitorimin e vlerësimit të ndikimit në mjedis, kemi pasur rast kur ka ndodhur një aksident dhe një punëtor ka vdekur. Thjesht, aty mungonte projekti. Pronari thotë ‘unë e kam pasur të definuar, ja ku e kam projektin e punës dhe si duhet të bëhet’, projekt i cili nuk ishte i kontrolluar nga askush, as nga niveli komunal, as nga niveli qendror, sepse ata të inspektorateve në fund të fundit nuk kanë kompetencë ta bëjnë një gjë të tillë. Nuk ka kush e vlerëson një projekt të sigurisë në punë, në mënyrë që pastaj në bazë të atij projekti të mund t'i drejtohesh punëdhënësit që aksidenti ka ndodhur për shkak se nuk e ke respektuar këtë pikë, apo atë pikë.

Çka është po ashtu me rëndësi, duhet që me ligj të definohen. Nuk duhet t'u lihen akteve nënligjore që të definohen, ta zëmë mbrojtja e kategorive të caktuara, siç është e grave, posaçërisht e grave shtatzëna në punë, meqë duhet të definohet çka ato nuk duhet të punojnë gjatë kohës sa janë shtatzëna, jo në periudhën kur ato veç janë shtatzënë, pasi puna mund të ndikojë drejtpërdrejt në shëndetin e tyre dhe të fëmijës që krijohet, e po ashtu duhet të definohet qartë edhe niveli i punës lidhur me shëndetin në mbrojtjen dhe sigurinë për fëmijët, të rinjtë dhe atyre që u lejohej me ligj të punojnë, pra të moshës nën 18-vjeçare.

E kur flasim për atë që kjo do të duhej të ishte, të trajtohej si e interesit publik, atëherë nga kjo pastaj do të rridhte që të definohet me ligj që në shkollat fillore e të mesme politikat, të ketë kurrikula të qarta në arsim, me të cilat definohet siguria në punë dhe shëndeti në punë.

Po ashtu, vërejtje kam edhe te pjesa e dënimeve, meqë këtu jepen sipas këtij drafti vetëm dënime mandatare me të holla, e unë mendoj se duhet të definohet, të jenë këto dënime më të rrepta, për faktin që mungesa e zbatimit të këtij ligji mund të kushtojë me jetën e njerëzve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar AAK-së, fjalën e ka deputetja Time Kadriaj.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryesues!

Qëllimi i projektligjit është përcaktimi i masave për përmirësimin e shkallës së sigurisë, të shëndetit të të punësuarve në punë që ndërlidhen me vendin dhe ambientin e punës; parandalimi i rreziqeve profesionale, eliminimi i faktorëve të rrezikut dhe aksidenteve, informimi, konsultimi dhe përmirësimi i nivelit të sigurisë dhe shëndetit në punë.

Për këtë arsye, ky projektligj është i një rëndësie të veçantë, sepse me këtë rregullohen me ligj të drejtat e punëtorëve, sepse siç jemi të informuar veç këtë vit ka pasur mjaft raste të aksidenteve në punë. Objektivi i projektligjit është garantimi i një shkalle më të mirë për t'i parandaluar lëndimet në punë, sëmundjet profesionale dhe sëmundjet tjera, si dhe ngritjen e nivelit të vetëdijes së punëdhënësit dhe të të punësuarve. Por, unë konsideroj se ky projektligj, pas miratimit në Kuvend, ta marrë formën e prerë të zbatimit më të mirë dhe funksional dhe të implementohet së bashku me reformat e tjera, të cilat e kompletojnë këtë ligj. Edhe një herë them dhe po e përsëris se problematika e shëndetit të të punësuarve dhe kushteve të vendit të tyre të punës nuk është te korniza ligjore, por tek implementimi, përkatësisht zbatimi i tyre nga Inspektorati i Punës.

Ata gjithmonë janë ankuar se nuk kanë infrastrukturë të mjaftueshme punuese, nuk kanë pajisje adekuate, nuk kanë mjete me të cilat do t'i zbatonin në përpikëri detyrat, nuk kanë përkrahje financiare dhe kanë paga të ulëta karshi punës që e bëjnë dhe ballafaqimeve me rreziqet që i sjell natyra e punës etj.

Grupi Parlamentar i Aleancës e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe do ta përkrahë në parim.

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, deputeti Gëzim Kelmendi.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit! I nderuari kryesues!

Të nderuar ministra,

Kolegë të nderuar deputetë,

Pa dyshim që e përshëndesim procedimin e këtij projektligji në Kuvend, por edhe një herë e shohim qartë që ky projektligj, ashtu sikur edhe projektligjet tjera që janë hartuar në Kuvendin e Kosovës, e shfaqin dukshëm mangësinë e tyre.

Disa projektligje janë të mira, por mangësia e tyre se nuk zbatohen si duhet në praktikë, ndërsa disa prej tjerave kanë edhe përbrenda ligjit mangësi. Vetë fakti se ne si anëtarë të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, ndër punët kryesore që i kemi pasur ka qenë monitorimi i dy projektligjeve, të cilët kanë pa dyshim qasje indirekte në

këtë projektligj, ka qenë monitorimi i Projektligjit për Inspektoratin e Punës dhe Ligjit në punë, kemi vërejtur shumë mangësi sa i përket sigurisë në punë. Punëtorët janë të cenuar, konkretisht shëndeti dhe siguria e tyre është e cenuar në çdo sferë të punës që ata bëjnë. Por, gjithashtu kemi vërejtur se një ndër mangësitë kryesore pse ky ligj aktual, i cili është në fuqi, nuk zbatohet si duhet, ka qenë mungesa e kapaciteteve të nevojshme të Inspektoratit të Punës. Ajo e ka bërë edhe më pak të zbatueshëm këtë projektligj.

Është vërtet shqetësues numri i lëndimeve në punë, numri i vdekjeve sidomos kohët e fundit kryesisht në fushën e infrastrukturës dhe të sigurisë në komunikacion, pastaj cenimi i integritetit, qoftë personelit mjekësor në vendin e punës, qoftë mësuesit-mësimdhënësit, konkretisht në shkollat e tyre fillore, të mesme, por edhe universitete. Është e pakuptueshme se si tolerohet cenimi i integritetit të shëndetit të mësuesit-mësimdhënësit në shkollat e tyre.

Shkalla e lartë e pasigurisë në vendet e punës te shumë sektorë pa dyshim i jep një fuqi edhe më të madhe këtij projektligj, por edhe një herë po them: Përderisa nuk rregullohet çështja e Inspektoratit të Punës, konkretisht nuk rriten kapacitetet e Inspektoratit të Punës, të cilat e monitorojnë zbatimin e këtij ligji, megjithatë mund të themi se edhe ky projektligj, sikur projektligjet tjera, mund të jetë i mirë në letër, por në praktikë i mangët, ashtu si po na ndodh me shumë projektligje, ngase nuk zbatohen në praktikë. Dhe, më keqja që nuk ka mundësi të monitorohen.

Ne si Koalicion për Kosovë të Re në parim do ta mbështetim këtë projektligj, ndërsa punën kryesore e kemi në komision. Aty do të japim kontribut në amendamentimin e këtij projektligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të SLS-së, fjalën e ka deputeti Milivoje Stojanović.

MILIVOJE STOJANOVIĆ: Hvala predsedavajući!

Poštovani članovi Vlade,

Kolege poslanici,

Poslanička grupa SLS razmatrala je Nacrt zakona za bezbednosti završje na radu i primetila je određene nedostatke kao i ostale kolege, koje su navele. Međutim, mi ćemo podržati na čelu ovaj Nacrt zakona, a svoje neke predloge ćemo priložiti u komisijama. Hvala!

KRYESUESI: “6+” Parlemlenter Grubu adına sayın Fikrim Damka.

FIKRIM DAMKA: Teşekkür ederim sayın Meclis Başkan yardımcısı,

İşyerinde sağlık ve güvenlik Yasa Tasarısı 6+ Parlemlenter Grubu tarafından incelendiği ve belki de çalışanlarımız açısından daha önceden onaylanması gerektiğini düşünmekteyiz.

Öalışanlarımızın işyerinde sağlıklı çalışma şartların yaratılacağı ve korunacağı işyerinde çalışanların güvenliğinin işverenler tarafından dikkat edilmesi ve tüm sorumluluklar bu

yasa ile altına alınmaktadır. Bu Yasayla sigaraya karşı olmamıza rağmen, işverenlerin sigara içen çalışanlara sigara içmeyenleri yapmak mecburiyetini de öngörmektedir.

İyi bir şekilde hazırlanmış bu Yasa Tasarısı 6+ Parlemneter Grubu olarak kabul etmekteyiz ve katkılarımızı ilgili komisyonda sunacağımızı bildirmekteyim.

KRYESUESI: Teşekkür ederim! Radha është e deputetëve. Tani fjalën e ka deputetja Xhevahire IzmaKu.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

I gëzohem faktit që ne sot po e diskutojmë në parim një ligj, i cili aq sa ka nevojë të miratohet sa më parë, aq shumë do të jetë një sfidë për t'u zbatuar në të gjitha organizatat, në të gjitha njësitë, qoftë publike apo qoftë private.

Në këtë drejtim, konsideroj se mandati ynë në mbikëqyrje të tij duhet të jetë një mision i shenjtë, që do të duhej të merrej shumë seriozisht, qysh prej ditës së parë të fillimit të zbatimit të tij.

Ligjin për siguri dhe shëndetin në punë e bën shumë të rëndësishëm fakti, se vendi ynë ka shumë nevojë të përmirësojë gjendjen e sigurisë dhe shëndetit të të punësuarve në punë. Në këtë drejtim, ligji shumë detajisht përcakton masat për mbrojtje në punë, por unë kam dyshimin që nëse nuk do të jetë efektive në terren puna e Inspektoratit, ky nen vështirë do të zbatohet, posaçërisht në sektorin privat.

Mendoj se ligjin shumë mirë do ta fuqizojë edhe organi tjetër qeveritar, që është përcaktuar në këtë ligj, Këshilli Nacional për Siguri dhe Shëndet në Punë, i cili do të jetë i fokusuar konkretisht në këtë sektor dhe me politikat që do të krijojë, do të zvogëlojë, shpresojmë rrezikshmërinë në vendin e punës.

Neni ku punëdhënësi është i detyruar që së paku një herë në tre vjet t'u sigurojë vizita të detajuara mjekësore punëtorëve, mendoj se është shumë i rëndësishëm, kur dihet se në çfarëdolloj vendi pune, në vendin tonë, kjo nuk ndodhë, vetëm në organizatat ndërkombëtare, fatkeqësisht.

Sektori privat në sferën e trajnimeve, shpresoj të përfitojë me detyrimet që dalin nga ky ligj, pasi që jo vetëm që kemi pasur raste të fatkeqësive në mungesë të dijes dhe praktikave, por as punën që kryejnë ata punonjës, duke shkuar drejt nga rruga në kompani, s'e besoj se mund të ketë kualitet as efektivitet, pa marrë parasysh se shumica mund të koncentrohen te një rreth i angazhuar i familjarëve të tyre. Por, e kam prapë fjalën te sektori privat, secili që nis një punë të re, ka nevojë së paku, që të ketë një trajnim tre javor dhe kjo është mirë e rregulluar në këtë ligj.

Ne të gjithë e kemi të njohur faktin se sa raste brenda vitit ndodhin lëndime, bile edhe vdekjeprurëse dhe këto, kryesisht në sektorin e ndërtimeve në sektorin privat dhe

asnjëherë, kurrë nuk u ndërmorën masa ndëshkuese ndaj atyre punëdhënësve, të cilët paraprakisht nuk i ndërmorën masat për mbrojtjen e atyre punëtorëve, të cilët punojnë nga mëngjesi në mbrëmje, për një pagë minimale.

Ligji, që sot po miratojmë ka rëndësi për faktin, se tash e tutje të gjithë punëdhënësit do të jenë të detyruar që të paguajnë, pra gjobat, nëse atakohen me nenet 5, 6, 9 dhe 10 të këtij ligji. Po ashtu, për shkelje të dispozitave të nenit të këtij ligji, investitori, kontraktuesi ose nënkontraktuesi do të dënohet me të holla në shumë prej 5 mijë deri në 35 mijë euro, që mendoj se do të ndikojë në ndërgjegjësimin e tyre paraprakisht, që të mos vijnë deri te këto raste.

Dhe, kjo së paku, kur të lënduarit pra, humbin edhe gjymtyrët e trupit e ne, po ashtu edhe këto raste i kemi parë gjithë këto vite. Sa djem të ri e burra kanë humbur pjesë të trupit në vendet e tyre të punës, e përsëris, në sektorin privat shumica. Disa nga ta mbetën në karroca invalide, u bënë barrë e familjeve të tyre.

Konsideroj që projektligji është shumë mirë i harmonizuar dhe shumë i nevojshëm për t'u miratuar. Unë do ta mbështes dhe do të votoj pro, në këtë fazë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Rita Hajzeraj-Beqaj.

RITA HAJZERAJ-BEQAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Ligji për sigurinë në punë e plotëson në njëfarë forme apo e komplementon Ligjin e punës dhe është mirë që ka ardhur në Parlamentin e Kosovës. Mirëpo, mbetet e dyshimtë se a do të implementohet, sikurse kemi ngecje edhe tek Ligji i punës, që ende nuk monitorohet siç duhet dhe ende vazhdojnë shkeljet ndaj punëtorëve.

Nga punëtorët tashmë çdo ditë e më shumë kemi ankesa, për sigurinë e tyre në punë. Çdo ditë e më shumë kemi humbje jetësh nga punëtorët. Me të vërtetë ka munguar ky ligj, sepse edhe arsyetimet, edhe nga Qeveria, por edhe nga punëmarrësit kanë qenë se mungon Ligji për siguri në punë dhe për atë arsye, pra punëtorët nuk i kanë pasur të gjitha kushtet apo kriteret e parapara, për sigurinë në punë.

Unë e mora fjalën, që t'i ceku dy kategori, për të cilat është dashur të flitet më shumë dhe të përcaktohen më shumë të drejta, për këto kategori në Ligjin për siguri në punë. Është kategoria e grave shtatzëna, të cilat duhet t'i kenë kushtet më të mira dhe kushtet e veçanta për punë, gjatë kohës së shtatzënisë dhe që nuk është e përcaktuar me këtë projektligj. Dhe, është kategoria tjetër e personave me aftësi të kufizuara, ku e dimë që secili sektor apo institucion, i cili ka më shumë se 50 punëtores apo 50 punëtorë, duhet ta ketë një person me aftësi të kufizuara. Pra, është i detyrueshëm që ta ketë një person me aftësi të kufizuara. Dhe, këtij personi me aftësi të kufizuar, së pari i shkelet e drejta e tij elementare, e drejtë njerëzore, që nuk ka as mundësi të qaset në objektin ku do të punojë, e lëre më për kushte tjera të punës.

Pra, këto janë dy kategori, të cilat desha t'i përmend dhe të cilat nuk janë të parapara me klauzola, apo me kushte dhe kritere të veçanta në këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Aurora Bakalli.

AURORA BAKALLI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Projektligji që kemi para vetes, pra Projektligji për sigurinë dhe shëndetin në punë ka për qëllim përcaktimin e masave për përmirësimin e shkallës së sigurisë dhe shëndetit të punësuarve në vendet e tyre të punës.

Ne si Lëvizje për Bashkim, konsiderojmë se ky është një ligj i rëndësisë së veçantë, duke pasur parasysh se aksidentet dhe lëndimet në punë janë dukuri mjaftë e shpeshtë tek ne. Sigurisht, edhe për faktin se shumë shpesh punëtorët tanë janë të pa profilizuar për punën që kryejnë, por nevoja e madhe për punë bën që ata të pranojnë të punojnë edhe të patrajnuar, punën që kryejnë dhe shpesh në rrethana me pasiguri të lartë.

Për më tepër, si në çdo vend tjetër të varfër apo për t'u shprehur më korrekt, vende me të ardhura të ulëta, të përcaktuara sipas Bankës Botërore, duket se jeta e njeriut dhe shëndeti i tij, fatkeqësisht kanë vlerë më të vogël. Pikërisht për këtë arsye, ne si Lëvizje për Bashkim, duke vendosur qytetarin në rend të parë, jemi për ligj korrekt dhe të aplikueshëm për sigurinë dhe shëndetin në punë.

Vërejtjet tona, sa i përket këtij projektligji, janë këto.

Duke filluar nga neni 4, që ka të bëjë me themelimin e Këshillit Nacional për Siguri dhe Shëndet në punë. Kemi fituar përshtypjen se është bërë si modë formimi i këshillave nacional, roli i të cilëve është shumë pro formë dhe rrjedhimisht shumë diskutabil. Këtë e vërteton edhe fakti se ky nen është i shkurtër, krahasuar me emrin që mban. Shumë pak përcaktohet në këtë nen lidhur me detyrat dhe obligimet e tij, ndërkaq është paraparë që me akt nënligjor të përcaktohen rregullat dhe procedurat e këtij këshilli.

Te neni 7, masat parandaluese, konsiderojmë se nga aspekti teorik ky nen është i përmbushur, por, sa do të përmbushet në praktikë, mbetet pikëpyetje.

Kur jemi te pika 3.1 e këtij neni, konsideroj se për aparaturat e vjetra duhet të kërkohet kontrollim teknik periodik, në intervale më të shpeshta, pasi që zakonisht pajisjet e vjetra janë më të rrezikshme në çdo aspekt.

Në nenin 10, pika 3, për punëdhënësin që punëson mbi 250 punëtorë, konsiderojmë se duhet të caktohet minimumi numri prej 2 ekspertësh, për kryerjen e detyrave nga aspekti i sigurisë dhe shëndetit në punë.

Në nenin 15, pika 1.7, ku kërkohet të sigurohet dhoma për pirjen e duhanit, kjo bie ndesh me Projektligjin aktual për kontrollin e duhanit, sipas të cilit ndalohet tërësisht pirja e duhanit në hapësirat publike dhe të punës.

Në nenin 20 të trajnimit të punësuarve, konsiderojmë që paraqet një element tejet të rëndësishëm, për parandalimin e aksidenteve në punë. Megjithatë, askund në këtë nen, nuk precizohet me siguri se si mund të dimë se është kryer trajnimi apo do të mjaftojnë deklaratat e punëdhënësve dhe të punësuarve.

Neni 23, pika 7.3 nuk është formuluar qartë dhe si e tillë mund edhe të keqkuptohet.

Sa i përket inspektorëve të punës dhe mbikëqyrjes së ligjit, konsiderojmë se ata duhet të kenë rol kyç po qe se synohet që ligji të jetë vërtet i zbatueshëm.

Ndërkaq, si vërejtje e përgjithshme, konsiderojmë se në këtë ligj shumë gjëra përsëriten dhe se sëmundjeve profesionale ju jepet shumë pak rëndësi.

Sa i përket sëmundjeve profesionale këto janë sëmundje që në mënyrë direkte provokohen nga faktorët e rrezikut, që janë prezent në ambientin e punës. Përndryshe, këto sëmundje zakonisht shfaqen ngadalë dhe zhvillohen gradualisht, gjë që i dallon nga aksidentet në punë dhe shpesh janë pa simptome. Për këtë arsye, për punëtorët që punojnë në vende ku potencialisht mund të ketë sëmundje profesionale, duhet të jetë obligatore, që në mënyrë periodike të kryhen teste specifike mjekësore për sëmundjet profesionale që mund t'u kanosen atyre.

Në parim do ta votojmë këtë projektligj dhe shpresojmë se vërejtjet tona do të merren parasysh. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka deputeti Hashim Deshishku.

HASHIM DESHISHKU: I nderuar kryesues i Kuvendit,

I nderuari Kabinet Qeveritar,

Të nderuar deputetë dhe deputete,

Projektligji për sigurinë dhe shëndetin në punë është një bazë e mirë për mbrojtjen e të gjithë të punësuarve, pa marrë parasysh sektorin si dhe për shëndet të punëtorëve, i cili premtan efikasitet më të lartë.

Mirëpo, duke pasur parasysh ambientin e përgjithshëm legjislativ në vend kam përshtypje se nuk ka një koordinim të mirë rreth hartimit dhe miratimit të ligjeve.

E them këtë meqenëse kam parasysh mungesën e legjislacionit për sigurime të përgjithshme shoqërore në vendin tonë, i cili do të mbulojë një numër shumë më të madh të qytetarëve të Kosovës, se sa projektligji që kemi në shqyrtim.

Kjo nuk ia humb vlerën këtij projektligji, por aprovimi i Ligjit për sigurimet e përgjithshme i paraprin krijimit të një ambienti, ku të gjithë e kanë trajtim të domosdoshëm shëndetësor. Po ashtu, sipas shpjegimeve që jepen në memorandumin përcjellës të këtij projektligji, aty parashihet që kryeministri ta formojë Këshillin Nacional për Mbrojtjen dhe Shëndetin në Punë, kurse Ministria e Punës ta ketë një këshill, i cili do t'i autorizonte personat fizikë dhe ata juridikë, në kryerjen e punëve të

sigurisë dhe shëndetit në punë. Asnjëri prej këtyre mekanizmave nuk figurojnë brenda këtij projektligji, prandaj është e kuptueshme dhe mund të formohet me një akt nënligjor, por nuk do të kemi mbulesë nga ligji që e kemi në shqyrtim.

Kur jemi këtu, po theksoj se edhe në nenin 26 kërkohet që Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale t'i nxjerrë aktet nënligjore për zbatimin e drejtë dhe të plotë të këtij ligji, por pa caktuar asnjë afat kohor, ndërkaq ligji hyn në fuqi 15 ditë mbasi të shpallet në Gazetën Zyrtare.

Ndonëse nuk mund t'i bëhen shumë vërejtje këtij projektligji, kur janë në pyetje masat që duhet ndërmarrë për krijimin e një ambienti të sigurt në punë, kam dilemën për mundësitë e aplikimit të tij në rrethanat aktuale. E para, ai nuk krijon implikime buxhetore, por paraqet ngarkesë për punëdhënësin, meqenëse sipas nenit 5, ai është i detyruar që t'i mbulojë të gjitha shpenzimet për shërimin e të punësuarit që ka pasur lëndim në punë apo sëmundje profesionale nëse nuk është i siguruar në ndonjë kompani të sigurimeve. Kjo duket se është krejt në rregull, meqenëse kemi të bëjmë me mbrojtjen e njeriut dhe të shëndetit të tij. Mirëpo, në këtë projektligj nuk parashihet zgjidhja se si të veprohet nëse lëndimi ndodh për shkak të papërgjegjësisë dhe mosrespektimit të udhëzimit nga punëmarrësit.

Është e qartë se në këtë rast duhet të ndërmerren masat parandaluese, por nëse lëndimi vjen si pasojë e momentit kur punëtori ka qenë larg nga mbikëqyrja, atëherë edhe ai duhet të marrë përgjegjësinë për pakujdesinë ndaj vetvetes. Për këtë arsye këtu ka vend të futet pika 2.5 e nenit 21, e cila obligon punëmarrësit t'i respektojnë të gjitha detyrimet, sepse në të kundërtën do të jetë përgjegjës për dëmin ose aksidentin e shkaktuar.

Neni 7, pika 1.6 është e paqartë, meqenëse në grumbullimin e masave parandaluese punëdhënësi bën zgjedhjen e pajisjeve, metodave të punës dhe procesit të punës, për të lehtësuar punën monotone dhe për të reduktuar efektet e saj në shëndet. Pyes ligjdhënësin, se në këtë ligj çka është punë monotone, si përkufizohet ajo dhe çka duhet ndërmarrë konkretisht, posaçërisht kur dihet se muratori duhet të palosë tulla tërë ditën dhe kjo mund të jetë punë monotone, por kjo është e natyrës së punës, apo minatori gjatë tërë ditës duhet të mihë xehe, e tjera? Dhe, unë e pyes edhe Ministrinë dhe atë se nga kjo të hiqet fjalia “punë monotone”, se asnjë punë nuk është monotone, por është punë e detyruar që një punëtor e pranon punën, të cilën do ta bëjë më vonë.

Në pikën 1.8 të këtij neni kërkohet zëvendësimi i kushteve të rrezikshme me kushte të parrezikshme ose më pak të rrezikshme. Do të ishte mirë të ndodhë kjo, por a mund të bëhet ky zëvendësim nëse teknologjia nuk lejon? Pra kjo masë, të mos jetë detyruese, por preferuese aty ku ka mundësi.

Po ashtu, brenda ligjit ka kundërshtime ndërmjet neneve, për shembull në nenin 13, pika 1.15, kërkohet të shënohet qartë ndalimi i pirjes së duhanit në vende të punës dhe në vende publike. Ne e dimë edhe këtë, edhe disa kolegë deputetë e cekën se kjo është në kundërshtim me Ligjin e duhanit dhe kjo mendoj se duhet të hiqet, objekti, dhoma e

pirjes së duhanit në objektin ku punohet, për arsye se bie në kundërshtim me Ligjin e duhanit.

Në nenin 23, njoftimi për aksidentin në punë. Si aksident vlerësohet edhe ai që ndodh gjatë kryerjes së një pune tjetër, pa ose me urdhër të punëdhënësit, për arsye madhore, në interes të punës. Krejt në rregull, por megjithatë duhet thënë më qartë: çka është arsyeja madhore?

Ose në pikën 7.3 të këtij neni, thuhet se aksident në punë është ai nëse ndodh gjatë kohës së pushimit të përcaktuar nga punëdhënësit, por vetëm nëse kjo ndodh në ambiente të punës e jo jashtë tyre, veçanërisht nëse punëmarrësit në këtë rast sillen në kundërshtim me rregullat e punës.

Dhe në fund, kam një vërejtje të neni 25, tek masat ndëshkuese. Ato janë tepër të rënda, por janë të pranueshme kur është në pyetje shëndeti i njeriut.

Vërejtje ime qëndron në faktin se ka hapësirë të madhe përcaktimi në masat ndëshkuese. Po përmend se ajo mund të jetë prej 500 - 35 mijë euro. Kjo është hapësira, që lejon vlerësimin në bazë të përcaktimit individual. Për me keq, ligji as që lejon mundësinë për ankesë ndaj një ndëshkimi të tillë. Unë mendoj se diferenca nga 500 euro deri në 35 mijë euro është një diferencë mjaft e madhe, ku vetvetiu i lejohet të manipulojë dikush me atë vendim që do të marrë prej 500 - 35 mijë dhe unë aty mendoj që do të jetë një hapësirë për t'i hapur dyert e korrupsionit dhe mendoj, që të lejohet në bazë të ligjit edhe ankesa e të dëmtuarit dhe të mos jetë pa asnjë ankesë.

Dhe, në fund unë në parim e përkrah këtë projektligj dhe kontributin nga Lidhja Demokratike do ta japim në komisionet përkatëse nga anëtarët tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Haki Demolli.

HAKI DEMOLLI: Faleminderit!

I nderuar kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Para se t'i paraqes disa vërejtje dhe propozime konkrete lidhur me dispozitat e këtij draftligji, do t'i theksoja dy çështje të përgjithshme.

E para, duke pasur parasysh se ligji i cili është në fuqi, me të cilin trajtohet siguria në punë dhe mbrojtja e shëndetit të të punësuarve i vitit 2003, është vlerësuar si një ligj i cili nuk e ka rregulluar në mënyrë të plotë dhe të drejtë sigurinë në punë, sjellja e këtij draftligji në Kuvend, është më se e mirëpritur, me shpresë se zbatimi adekuat i dispozitave të të njëjtit do të ndikojnë tek punëdhënësit, që t'i përmirësojnë kushtet teknike, të punës për punëtorët e tyre dhe në atë mënyrë do të zvogëlojnë aksidentet me pasoja të rënda, për shkak të nivelit të ultë të sigurisë në ambientet e punës.

Fatkeqësisht, vetëm në nëntëmujorin e parë të këtij viti, në Kosovë kanë humbur jetën 12 persona në vendet e tyre të punës. Andaj, aprovimi i një ligji më të kompletuar dhe i cili do të përcaktonte një politikë më të ashpër ndëshkimore, shpresojmë se do të ndikojë në rënien e numrit të aksidenteve në vendet e punës.

Mirëpo, në këtë rast duhet theksuar se për sanimin e gjendjes së rëndë në sferën e sigurisë në punë, nuk mjafton vetëm aprovimi i ligjit, por edhe zbatimi me konsekuencë i tij nga inspektorët e punës dhe, gjithsesi duhet analizuar numri i inspektorëve dhe numri i inspektimeve që bëhen prej tyre brenda vitit, sepse numri më i madh i inspektimeve, gjithsesi do të ndikonte në eliminimin e rreziqeve në punë e kjo do të parandalonte dhe do të zvogëlonte aksidentet në punë.

Si çështje të dytë do të theksoja strukturën dhe përmbajtjen e këtij ligji, sepse ligji si i tillë ka 6 kapituj, tre prej të cilëve konkretisht kapitulli i tretë, i katërt dhe i pestë përbëhen vetëm nga një nen, kurse edhe më befasues është kapitulli i gjashtë, i cili ndonëse ka titullin dispozitat përfundimtare, në të janë përfshirë gjobat dhe mbikëqyrja, gjë që nuk është rast në asnjë ligj të rajonit e as më gjerë.

Ndërsa, kur analizohet përmbajtja e draftit, vërehet se nenet e shumta të këtij drafti përmbajnë numër të madh të paragrafëve, që herë-herë përcillen me përsëritje të çështjeve që trajtojnë.

Sa u përket vërejtjeve konkrete, do të filloja me paragrafin 3 të nenit 6, në të cilin theksohet: “punëdhënësi i përgjigjet të punësuarit për dëmet e shkaktuara nga lëndimi në punë, sëmundjet profesionale, ose sëmundjet e lidhura me punën.”

Kurse, neni 25, paragrafi 2 përcakton, që për shkeljet e dispozitave të nenit 6 të këtij ligji, punëdhënësi do të dënohet me të holla prej 500 deri në 10 mijë euro. Paramendoni, mund të ndodhë që punëtori të humbë ndonjë gjymtyrë apo pjesë të trupit, për shkak të kushteve joadekuate teknike të ofruara nga punëdhënësi dhe kështu të paaftësohet për punë gjatë gjithë jetës. Kurse, punëdhënësi mos i përgjigjet fare të punësuarit, sepse ai është i vetëdijshëm që maksimalisht mund të dënohet deri në 10 mijë euro. E realisht shikuar, pasojat për punëtorin të jenë dhjetëra herë më të rënda. Andaj, propozoj që paragrafi 3-të i nenit 6, të rishqyrtohet edhe njëherë dhe në të specifikohen përgjegjësitë e punëdhënësit, në rastet kur lëndohen të punësuarit e tij, për shkak të përgjegjësisë objektive apo subjektive të tij.

Më tutje, duhet shqyrtuar edhe paragrafin e parë të nenit 9, ku thuhet se çdo punëdhënësi është i detyruar të ngarkojë 1 apo më shumë të punësuar për të kryer aktivitetet nga siguria. Kështu siç është theksuar, nënkupton që edhe bizneset e vogla, që kanë nga 2 apo 3 të punësuar, duhet të kenë një të punësuar nga sfera e sigurisë. Andaj, me qëllim të gjetjes së një zgjedhjeje më të kënaqshme, propozoj që punëdhënësit me numër të vogël të punësuarve, varësisht nga sfera e veprimtarisë së tyre, të sigurojnë shërbime të ekspertëve të sigurisë nga agjencitë përkatëse apo nga ndërmarrjet më të mëdha, kuptohet nëpërmjet punës kontraktuese.

Vërejtje konkrete mund t'i bëhet edhe paragrafëve 2 dhe 3 të nenit 10, sepse sipas paragrafit 2, punëdhënësi i cili punëson 50 deri në 250 të punësuar është i detyruar të caktojë një ekspert nga siguria, kurse në paragrafin 3 thuhet, se punëdhënësi që punëson më shumë se 250 persona e që nënkupton edhe me mijëra, duhet të angazhojë një ose më shumë ekspertë nga fusha e sigurisë. Pra, kështu si e përcakton paragrafi 3, edhe punëdhënësi që ka me mijëra të punësuar, nëse ka angazhuar vetëm një ekspert nga fusha e sigurisë ka përmbushur obligimet e tij ligjore. Sipas të gjitha gjasave, këtë ndarje të punëdhënësve sipas numrit të punësuarve, hartuesi i këtij draftligji e ka marrë nga ligji i Kroacisë. Por, këtu do të theksoja se ligji kroat mbi mbrojtjen në punë, në nenin 21 të tij, përcakton që punëdhënësi që punëson mbi 250 punëtorë është i obliguar që ta themelojë shërbimin personal, të mëvetësishëm për siguri në punë, i cili ka për obligim përcjelljen e gjendjes së sigurisë.

Kurse, në paragrafin e dytë të këtij neni të ligjit kroat, parasheh që numri i të punësuarve në shërbimin e tillë do të varet nga numri i të punësuarve në ndërmarrje. Andaj, propozoj që paragrafi 3 i nenit 10 të këtij draftligji, të riformulohet në përputhje me vërejtjet e theksuara më lart.

Ndërsa, në nenin 11, paragrafi 6, flitet për obligimin e punëdhënësit që të mbajë kontakte me shërbime të jashtme. Mirë është që obligimi i tillë të specifikohet, sikurse në aspektin e periudhës kohore të mbajtjes së tyre, ashtu edhe me llojet e kontakteve apo eventualisht, të theksohet se kjo çështje do të rregullohet me akt nënligjor.

Më tutje, në nenin 15 përcaktohet që për çdo objekt të destinuar për punë, punëdhënësi duhet të sigurojë planin për evakuim, pastaj rrugët, e vërtet duhet të jetë fjala “hyrjet” dhe “daljet” emergjente, hapësirën për pushim, hapësirën për duhan, e tjera. Duke pasur parasysh se objekte për punë mund të jenë edhe hapësirat e vogla, në të cilat thjesht është e pamundur të plotësohen këto kritere, mendoj se duhet specifikuar më për së afërmi madhësia e objekteve, lartësia e tyre dhe karakteristikat e tjera, që duhet poseduar një objekt për të cilin parashihet plotësimi i kritereve nga neni 15.

Më tutje, formulimi i paragrafit 4 të nenit 19 nuk paraqet formulim të një dispozite të mirëfilltë ligjore, sepse përmban këtë shprehje: “Përfaqësuesve të të punësuarve duhet t’u jepet rasti që të paraqesin vërejtje”. E unë mendoj se ligji nuk është akt që jep raste, por është akt që përcakton të drejta, por edhe obligime për subjektet e ndryshme.

Ndërsa, në kapitullin e tretë të këtij drafti, në të cilin bëhet fjalë për detyrimet e të punësuarit, mendoj se përveç obligimeve të përcaktuara me nenin 21, duhet theksuar edhe ndalesën e të punësuarit që të punojë nën ndikimin e alkoolit, drogave apo substancave të tjera dehëse, sepse puna nën ndikimin e këtyre substancave, jo rrallë ka qenë shkaktar i aksidenteve me pasoja të rënda.

Dhe, vërejtja ime e fundit konkrete, ka të bëjë me paragrafin 8 të nenit 23, në të cilin bëhet klasifikimi i aksidenteve në punë. Konkretisht, sipas këtij paragrafi, aksidentet ndahen në:

- aksidente që shkaktojnë paaftësi pune deri në 3 ditë, pastaj

- paaftësi të përhershme në punë dhe
- aksidente me pasojë vdekjen.

Mendoj, se duhet pasur edhe ndonjë klasifikim tjetër të aksidenteve që shkaktojnë edhe paaftësinë disamujore, apo paaftësi pune mbi një apo më shumë vite, e jo prej 3 ditëve të shkohet në paaftësi të përhershme pune, përndryshe ligji për siguri i Shqipërisë i vitit 2010, neni 29, njeh aksidentet që shkaktojnë paaftësi të përhershme mbi 3 ditë e jo deri në 3 ditë. Ju Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Salihe Mustafa.

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ky projektligj është projektligj i rëndësishë së veçantë, kur kemi parasysh faktin se ka të bëjë me sigurinë dhe shëndetin në punë.

Gjatë monitorimit të Ligjit për Inspektoratin e Punës dhe Ligjit të punës, Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, kemi hasur në pengesa të zbatimit të këtyre dispozitave, për shkak të mosmiratimit të Ligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë, sepse inspektorët e punës kanë qenë të hendikepuar gjatë vizitave në terren, pa pasur mundësi që të kërkojnë zbatimin e kësaj dispozite.

Projektligji për të cilin po diskutojmë sot është një projektligj i hartuar mirë, rregullon çështje shumë të rëndësishme dhe ka për qëllim ngritjen e vetëdijes të punëdhënësve dhe të punësuarve, për mbrojtje të shëndetit të të punësuarve.

Projektligji parasheh krijimin e Këshillit Nacional për Siguri dhe Shëndetin në Punë nga Qeveria e Kosovës, pastaj do të themelohet një trup ekspertësh, e cila trupë do ta përcjellë në vazhdimësi:

- gjendjen e sigurisë në punë,
- caktimin e një ose më shumë të punësuarve nga punëdhënësi në zbatimin e masave për sigurinë dhe shëndetin në punë,
- vlerësimin e vendeve të punës me rrezikshmëri,
- organizimin e dhënies së provimit profesional për sigurinë dhe shëndetin gjatë punës.

Një çështje tjetër e rëndësishme që rregullohet me këtë projektligj është ajo që parashihet në nenin 8, paragrafi 4, në të cilin thuhet: “Punëdhënësi në cilësinë e investitorit do të lidhë marrëveshje kontraktuale në formë të shkruar, me persona të cilët kryejnë veprimtari pune për të, përkatësisht me kontraktuesit dhe nënkontraktuesit, në të cilën marrëveshje përcaktohet përgjegjësia për sigurinë dhe shëndetin në punë”.

Pra, me hyrjen në fuqi të këtij ligji, faji për pasojat që mund të ndodhin, më nuk do të jetë jetim, por ka adresë. Gjatë monitorimit të Ligjit të punës kemi hasur në raste kur punëtori është lënduar, por kontraktuesi, punëmarrësi është arsyetuar se faji është te nënkontraktuesi, se ai nuk ka obligim të përkujdeset për sigurinë e mjeteve të punës.

Me gjithë përparësitë, unë kam edhe disa vërejtje të ky projektligj. Në paragrafin 17 të nenit 15 të projektligjit thuhet se punëdhënësi duhet të sigurojë, ndër të tjera, edhe dhomën për pirje të duhanit. Duke qenë se ky është Ligj për sigurinë dhe shëndetin në punë, dhe duke pasur parasysh Ligjin për duhanin, që nuk lejon hapësira të tilla, rekomandoj që ky paragraf të fshihet.

Gjithashtu, neni 17 i këtij projektligji është i paqartë, ky nen flet për punët e veçanta, pa i precizuar paraprakisht cilat janë punët me kushte të veçanta. Konsideroj, se duhet të përcaktohen punët që hyjnë në grupin e punëve me kushte të veçanta, ose të ngarkohet Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, që këtë ta bëjë me akt administrativ.

Përndryshe, e përkrahë në parim projektligjin dhe kontributin tim do ta jap në Komisionin Funksional. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti i fundit i paraqitur, Lutfi Zharku.

LUTFI ZHARKU: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Do të flas për projektligjin nga dy aspekte, që mendoj se janë të rëndësishme për zbatimin e këtij projektligji. Në parim, besoj se projektligji është i ngarkuar edhe për Qeverinë, por e ngarkon edhe biznesin. Unë do t'i përmendi disa raste.

Do të filloj me radhë.

Së pari, për Këshillin Nacional për Siguri dhe Shëndet në Punë. Këshilli i njëjtë ka qenë i paraparë edhe me ligjin e kaluar. Tash me ligjin e ri është në mënyrë më specifike e përcaktuar përbërja, megjithatë unë personalisht mendoj që është i panevojshëm si këshill të funksionojë. Bindja ime edhe më shumë rritet kur e shohim se me ligj nuk janë përcaktuar fare kompetencat se çfarë kompetencash do të ketë ky këshill, kurse në anën tjetër, prej përvojës, në shumicën e rasteve këshillat janë treguar që janë të panevojshëm apo thjeshtë, të mos them, nganjëherë edhe i përziejnë më shumë punët se sa që duhet të rregullojnë diçka. Kështu që, nëse në ligj nuk janë përcaktuar qartë kompetencat të cilat duhet t'i ketë ky këshill, mendoj se këshilli është i panevojshëm.

Në anën tjetër, ligji ka disa ngarkesa, besoj që janë të mëdha për shumicën e bizneseve tona. Ne flasim për biznese që janë 99% biznese të vogla në Kosovë, kurse një pjesë e bizneseve të mëdha industriale apo investorëve të jashtëm, këto çështje i kanë të rregulluara me rregullore të brendshme, edhe pa pasur nevojë që të përcaktohen me dispozita ligjore.

E para është, shpenzimet për kurimin e të punësuarit, nga lëndimi në punë apo sëmundja profesionale. Sipas ligjit, parashihet që të barten nga punëdhënësit, ose nëse nuk është punëdhënësi, atëherë punëdhënësi është i obliguar që t'i sigurojë të punësuarit në ndonjë kompani sigurimesh. Mendimi im është se kjo është e tepërt për kompanitë e sigurimit, për kompani për punëdhënësit, ne nuk kemi fond për sigurime shëndetësore, kurse po

kërkojmë nga bizneset që ata t'i sigurojnë punëtorët e tyre. Edhe në rastin më të mirë, nëse punëdhënësit duhet t'i sigurojnë punëtorët e tyre, ato shumicën e shpenzimeve apo shumicën e rasteve do të mundohen, që ato shpenzime t'i ndalin nga punëmarrësit apo punëtorët.

Në anën tjetër, shërbimet e mbrojtjes në ndërmarrje janë një kosto shtesë, prapë për ndërmarrjet e caktuara, sepse kërkohet që ato shërbime, nëse nuk mund t'i kryejë ndërmarrja, ata angazhojnë persona apo institucione të jashtme të cilat duhet të paguhen dhe në realitet, ato të gjitha janë shpenzime që për shumicën e ndërmarrjeve tona janë të papërballueshme.

Po ashtu, parashihet edhe certifikimi i personave dhe institucioneve për shërbimet e sigurisë në punë. Është një ngarkesë, besoj për Ministrinë së paku, që të merret me certifikimin e personave, që të ketë një komision të caktuar për të certifikuar, për të vlerësuar dijeninë e atyre personave, kurse në anën tjetër është një ngarkesë e posaçme për biznesin.

Si pikë tjetër është të punësuarit e ngarkuar për sigurinë në punë. Ligji përcakton në mënyrë të qartë, se çdo ndërmarrje duhet të ketë një person të ngarkuar për siguri në punë. Thotë, “nëse punëdhënësi është kompetent”, është çështje shumë e gjerë a është kompetent punëdhënësi. Kush e përcakton kompetencën. Domethënë, çdo punëdhënësi duhet apo çdo drejtor i një ndërmarrjeje, pavarësisht sa është, sipas ligjit duhet të certifikohet në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, që ka kompetencë për t'u marrë, për të garantuar siguri në punë. Kjo është një ngarkesë e tepërt për 99% të bizneseve apo për 100 mijë biznese që i kemi në Kosovë, të shkojnë dhe të certifikohen si punëdhënës se janë në gjendje ta kryejnë atë punë.

Në anën tjetër, përkufizimi, e përmendi edhe deputeti Demolli, me numër 50 - 250 për të pasur së paku një, apo mbi 250 për të pasur një apo më tepër, është një përcaktim arbitrar, them diskrecional, kështu që nuk i jep shumë zgjidhje, por përcakton me arbitraritet një numër të caktuar. Unë besoj se kjo dispozitë duhet zgjidhur në atë mënyrë, që organizata të obligohet ta ketë mbrojtjen apo të jetë kompetente për sigurinë dhe shërbimin në punë, por jo të përcaktohet numri i punëtorëve apo të përcaktohet se ç'shërbim duhet të ketë organizata dhe në anën tjetër që patjetër duhet të angazhojë ekspertë të jashtëm?

Kosto shtesë është dokumenti për verifikimin e rrezikshmërisë nëpër ndërmarrje. Për shumicën e ndërmarrjeve prapë është një kosto e papërballueshme, kurse në anën tjetër, këto të gjitha janë elaborate, që në parim merren shabllon dhe kopjohen prej një ndërmarrjeje në ndërmarrjen tjetrën, kështu që në realitet nuk do të thotë kurrëgjë për shumicën e ndërmarrjeve, kurse për ndërmarrjet e mëdha, është normale që ato kanë kapacitetet e tyre dhe do t'i përpilojnë në mënyrë të duhur.

Pikë tjetër është kontrolli mjekësor i çdo të punësuarit në çdo tre vjet. Unë besoj, se kjo është e tepërt për kontroll mjekësor në çdo tre vjet, duhet ndarë sipas vendeve të punës. Ka vende të punës, që ndoshta duhet kontrolli mjekësor çdo gjashtë muaj, nëse dikush punon në industrinë ushqimore, por edhe punëtorët e administratës të obligohen të

kontrollon çdo tre vjet - është ngarkesë për punëdhënësin, besoj se është e tepërt dhe është e panevojshme.

E fundit, që do të doja të cek është te gjobat është një hapësirë shumë e madhe në mes gjobës minimale dhe maksimale. Për shembull, kemi një gjobë 500 me 25 mijë, kështu që është 1:50. Unë e kuptoj që duhet të ketë një hapësirë, një liri për inspektorët të vendosin gjoba të ndryshme, por hapësira 1:50, është jashtëzakonisht e madhe dhe mund të kontribuojë vetëm në keqpërdorimin e gjobave eventuale e jo në rregullimin apo në disiplinimin e punëmarrësve për sigurimin në punë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Para se të kalojmë në votim, fjalën e ka kërkuar ministri. Urdhëroni, ministër!

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: Hvala, gospodine predsedavajući!

Hvala unapred svima na podršci.

Moram da kažem da puno je tehničkih detalja, tako da neću da ulazim u to, neki detalji su stvarno opravdani, neki zahtevi verujem da jesu. Ali najbitnije je da razjasnimo jednu stvar. Nacionalni savet za sigurnost i zdravlje na radu nikad do sad nije funkcionisao, zbog toga što nije imao delovanje na način šta bi trebalo kasnije da uradi.

Zato sam malo pre naglasio. Prvo se stvara taj nacionalni savet, koji je tri, jedan, jedan, odnosno tri člana ministarstva, jedan poslodavac, jedan posloprimaoca, koji bi tek onda tu imao mogućnost da licencira kompaniju koja će da određuje uslove za svaku firmu, koji bi trebali da budu u zaštiti na radu. To je vrlo bitno da razumete, da licencirana kompanija treba da ode u svaku kompaniju, jednu po jednu, da proceni šta je to, koje su mere da zaštiti radnike, jer sigurno nije ista mera, kao što je recimo u neku radnju, ne znam, minimarket, supermarket i ona što je u rudniku.

Zbog toga je bitno da kad se jednom licencira ta kompanija, da bude precizno utvrđeno koje su odgovornosti i koje mere da bi se sigurnost obezbedila.

Pojedinci takođe, koji budu licencirani pored kompanije će biti pod strogim nadzorom i ministarstva, a najviše pod strogim nadzorom inspektorijata.

Slažem se da treba da budu ovaj uključeni i kroz škole, ne znam ko je to rekao, da usred bude na podizanje svesti građana, odnosno od malih nogu da oni znaju da svako radno mesto ima određeni rizik, da tako nazovem, i da svako od njih mora da ima prava da bi bio zaštićen na poslu.

Ne slažem se za... inspektorijata. Ja garantujem da je inspektorijat u zadnjih tri godine, pogotovo povećao svake godine svoj nivo kontrole, koje obavlja. A za to je dokaz, u prošloj godini podsećam da je bilo 3.200 novih radnika, koji su registrovani po prvi put. Ove godine u prvih 10 meseci smo premašili taj broj. Znači ipak, broj kontrola i broj registrovanih radnika po prvi put, koji su oduvek radili a nikad nisu bili registrovani, se stalno povećava. Prema tome inspektorijat je ko je u jednoj manjoj meri povećao fizičke

kapacitete inspektora od 10%. Ja mislim da je na terenu povećao angažovanje, koje je doprinelo da imamo veći broj registrovanih radnike.

Što se tiče osoba sa ograničenim sposobnostima, koje je pomenula gospođa Rita, mi smo od ovog jutra napravili prvi draft zakona za osobe sa ograničenim sposobnostima. To ćete verovatno i vi videti biće interesantno, koje smo mere predložili da se preduzimaju. Naravno, još jedna je tu bitna stvar da se shvati da pored odgovornosti, koje preduzima društvo, Vlada, takođe ima odgovornosti, koje preduzima poslodavac. Nisu to neki preterani nameti, ali jesu bitni za sam razvoj infrastrukture.

Što se tiče onih soba za... što su bile pomenuli, soba za pušače, verovatno da po Zakonu o zdravlju nije dozvoljeno tako nešto postoji, ali ipak da bude dobra implementacija, da bude stvarna implementacija, stvarno bi trebali i poslodavci da bukvalno shvate zakon. Jer, vi ipak, teško je otići u neku privrednu kompaniju i da vi insistirate da vidite da je soba za pušenje, da bi mogli da ga kaznite zbog toga. Jer, mi smo oduvek rekli da su poslodavci naši partneri a ne oni koji bi trebali da insistiramo da ih po svaku cenu kaznimo.

Slažem se u vezi onoj kazni, koju ste ovde pomenuli, da je veliki raspon između one minimalne i maksimalne kazne. Ja verujem, da ćemo to moći da promenimo, da uskladimo sa različitim zahtevima. I mislim da kao i dosad, što smo uvek govorili da sve predloge, koje budete dali, da ćemo absolutno razmotriti i sigurno da ćemo naći kompromisno rešenje. Hvala još jednom, puno na podršci!

KRYESUESI: Faleminderit, ministër! Të nderuar deputetë, në vazhdim kërkohet deklarimi me votim, për miratimin në parim të Projektligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë.

Në mbledhje janë të pranishëm 75 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tani.

Konstatoj se me 70 vota për, një kundër dhe dy abstenime, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për sigurinë dhe shëndetin në punë.

Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme, që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

Në radhë është:

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ansamblin kombëtar të këngëve dhe valleve “Shota” dhe për ansamblët tjera

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni FunkSIONAL e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime, për shqyrtim në parim.

Ftoj ministrin e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, zotin Memli Krasniqi, që para deputetëve të Kuvendit, të paraqesë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRI MEMLI KRASNIQI: Të Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuara deputete dhe deputetë,

Të nderuar kolegë të Kabinetit Qeveritar,

Ndryshimi i ligjit nr. 03 L/056 për ansamblin kombëtar shtetëror të këngëve dhe valleve “Shota” dhe për ansamblet e tjera është treguar i nevojshëm më qe gjatë zbatimit në praktikë të këtij ligji janë paraqitur vështirësi të shumta që s’kanë lejuar implementimin e tij në tërësi.

Ansamblin kombëtar i këngëve dhe valleve “Shota” dhe ansambleve tjera në Kosovë janë institucione të rëndësishme të kulturës sonë, të cilat me dinjitet dhe krenari brez pas brezi e ruajnë dhe kultivojnë kulturën tonë, këngët dhe vallet tona burimore dhe përmes veprimtarisë dhe aktiviteteve të tyre, na e përkujtojnë trashëgiminë tonë të pasur shpirtërore, si pjesë shumë e rëndësishme e trashëgimisë kulturore.

Bazuar në misionin e tyre kulturor e kombëtar, për ne është përgjegjësi që të krijojmë hapësirë dhe kushte për funksionalizimin e këtyre ansambleve edhe përmes avancimit të infrastrukturës ligjore.

Problemet e evidentuara gjatë zbatimit të ligjit janë evituar me projektligjin e ri për ansamblin kombëtar të këngëve dhe valleve “Shota”, si dhe për ansamblet e tjera, i cili do t’i rregullojë qartë fushëveprimin, përkufizimet, llojet e ansambleve, themelimin, veprimtarinë, organizimin, financimin dhe statusin e artistëve.

Me këtë projektligj ansambleve do t’ju sigurojmë një ligj funksional dhe praktik, me që ndryshimet dhe plotësimet do të qartësojnë kuptimin e ligjit dhe do të ndikojnë në implementimin e synimeve të institucioneve të Republikës së Kosovës, për avancimin e kulturës si prioritet të saj e që është edhe kërkesë e vet komunitetit artistik.

Projektligji për ansamblin kombëtar të këngëve dhe valleve “Shota” dhe për ansamblet e tjera, nuk kërkon një kosto shtesë buxhetore, kështu që mund të konkludojmë se ka implikime financiare të zakonshme.

Andaj, të nderuar deputetë, duke pasur parasysh rëndësinë dhe nevojën e avancimit të infrastrukturës ligjore në këtë fushë, kërkoj nga ju që ta mbështesni këtë projektligj dhe shpreh gatishmërinë për të punuar bashkë në komisionet përkatëse, gjatë procesit të amendamentimit të tij të mundshëm. Ju faleminderit për vëmendje.

KRYESUESI: Faleminderit, ministër! Të nderuar deputetë, pas paraqitjes së projektligjit, hap debatin për diskutim në parim. Fjalën e ka kryetari i Komisionit FunkSIONAL për

Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, zoti Idriz Vehapi.

IDRIZ VEHAPI: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar zoti ministër,

Të nderuar deputetë,

Komisioni Funkcional në bazë të nenit 56, paragrafi 2, të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 7 nëntor 2012, shqyrtoi Projektligjin për ansamblin kombëtar të këngëve dhe valleve “Shota” dhe për ansamblet tjera dhe vendosi që Kuvendit t’ia paraqesë këtë rekomandim.

Të miratohet në parim projektligji për ansamblin kombëtar të këngëve dhe valleve “Shota”, si dhe për ansamblet tjera dhe të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet dhe amendamentet eventuale, që vijnë nga deputetët do të shqyrtohen në Komisionin Funkcional. Ju ftoj që ta miratoni në parim! Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është kryetarit ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Për Grupin Parlamentar të PDK-së, fjalën e ka deputetja Xhevahire Izmaku.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka analizuar Ligjin për ansamblin shtetëror të këngëve dhe valleve “Shota” dhe ansamblet e tjera dhe konsideron që është shumë i mirëpritur një infrastrukturë më e plotësuar në këtë drejtim.

Sigurisht që edhe vërejtjet tona qëndrojnë. Fillimisht, projektligji në fjalë ka nevojë të shikohet edhe nga ana drejtshkimore. Edhe kjo vërejtje ka shkuar edhe prej komisionit, mirëpo është një gjë, që mund të plotësohet shumë lehtë.

Ligji në fjalë ka për qëllim të bëjë rregullimin e veprimtarisë kulturore artistike, përgatitjen e shfaqjeve, veprave koreografike, këngëve, valleve dhe vlerave të tjera të trashëgimisë shpirtërore dhe materiale.

Ligji mundëson funksionalizimin e qartë të këtyre ansambleve me të gjitha organet udhëheqëse të tyre, duke bërë sqarimin se si definojnë ansamblet me status kombëtar, si ansamble kombëtare dhe ansamble të komunave, të cilat mund të krijohen me vendime të kuvendeve komunale.

Po ashtu, me këtë ligj mund të organizohen edhe ansamble private, të cilat po ashtu mund të kenë qasje në buxhetimin e tyre edhe nga Ministria e Kulturës, nëse me kohë i paraqesin, pra kuptohet me kritere të njëjta, projektet e tyre në këtë ministri.

Ansamblin kombëtar të këngëve dhe valleve “Shota” e themelon Kuvendi i Kosovës dhe në këtë drejtim e ka kodin e vet buxhetor, të cilin e shpenzon në bazë të planifikimeve dhe ligjeve tjera në fuqi.

Veprimtaria e ansambleve përfshin ruajtjen e traditës muzikore kombëtare dhe shfaqjen publike të koncerteve dhe formave tjera skeniko-muzikore, organizimin dhe realizimin e koncerteve të traditës shpirtërore, konservimin dhe arkivimin e lëndës muzikore të traditës shpirtërore e materiale, si dhe nxitjen, zhvillimin, avancimin, publikimin dhe promovimin e artit kombëtar brenda dhe jashtë vendit.

Vërejtja qëndron në faktin se derisa për ansamblin kombëtar përcaktohet mirë se anëtarët e Këshillit Artistik kompensohen për angazhimin e tyre, ky element nuk është përcaktuar me ligj edhe për ansamblet komunale, kur e kemi fakte që ansamblet e nivelit komunal e kanë përfaqësuar shtetin tonë edhe jashtë vendit në mënyrë shumë të denjë.

Vërejtja ime qëndron edhe në faktin se ndoshta është dashur të mendohet që në vend të fuqizimit me paga, që marrin anëtarët e Këshillit Drejtues të ansamblit “Shota”, ai buxhet të menaxhohet mirë, e them kushtimisht edhe për ansamblet e komunave, pasi ne kemi shumë djem e vajza të reja, të cilët punojnë me vullnet, mirëpo kuvendet komunale nuk kanë mundësi t’i stimulojnë me mjete materiale dhe në këtë drejtim biem ndesh me nenin, ku thuhet se ansambli ka detyrë të promovojë vlera të reja, pasi vlerat e reja kanë nevojë edhe të stimulohen.

Edhe një herë mendoj që ndoshta ka nevojë të rishikohet struktura organizative e ansamblin kombëtar dhe mendoj që ka ardhur koha që t’i racionalizojmë strukturat e zgjeruara udhëheqëse dhe të shikojmë më shumë nga kualiteti.

Këtu e kam fjalën që nëse ekziston një këshill i plotë artistik, i cili e ka një rol shumë të fuqishëm në këtë organizim, duhet të mendojmë gjatë punës në komision për rolin që kryen konkretisht Këshilli Drejtues i Ansamblit.

Po ashtu, ta shikojmë edhe një herë mundësinë e çështjes të rregullimit me ligj të kompensimit të anëtarëve në nivel kombëtar dhe ta shikojmë mundësinë ta rregullojmë këtë çështje edhe në nivel komunal.

Te neni ku përcaktohet mosha e pensionimit, mendoj se është shumë korrekte, ku për meshkuj është 50 vjeç dhe për femra 45 vjeç, pasi këta trupa kanë nevojë të paraqesin edhe imazh të rinisë dhe të bukurisë.

E vlerësoj edhe ruajtjen e fondusit, pasi në këtë drejtim si shtet i ri kemi nevojë për ruajtje të memories në çdo sferë, prandaj konsideroj që kjo është e nevojshme edhe në sferën e kulturës dhe është shumë mirë që është rregulluar në ligj.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike sigurisht do të votojë pro dhe do ta japim kontributin në vazhdim në komisione. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, deputetja Lirije Kajtazi.

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës është i prirë ta lexoj së mbari plotësim-ndryshimin e këtij ligji, duke dashur të vihet një bazë e mirë ligjore për funksionim të ansambleve, si ato të nivelit qendror, atyre lokale dhe stimulimit të atyre private.

Siç shihet, Ministria e Kulturës, e Rinisë dhe e Sportit premtan se e mbulon financiarisht edhe këtë ndryshim për ansamblin shtetëror dhe ansamblet e komunave, por ansamblet e komunave mbeten në mëshirën e mundësive fiskale. Kishim dashur që këto ansamble komunale të mos e kenë fatin e teatrove të qytetit, edhe pse ka qenë një dëshirë e kryetarëve të komunave që t'i marrë nën menaxhimin e vet, por dëshira ka përfunduar deri në zgjedhjen e drejtorit dhe nuk është financuar ajo që është esenciale - veprimtaria e teatrove.

Është evidentuar si vërejtje edhe nga Departamenti i Buxhetit, që është e nevojshme të shikohet realizimi i të hyrave, ndoshta kjo jo shumë nga aktivitetet se jemi të vetëdijshëm se nuk mund të ketë ku ta di sa, pos asaj që është pjesë e nenit 24, te pjesa e financimit, ku ansamblet e kanë të drejtën edhe të shfrytëzojnë donacione të ndryshme. Prandaj, do të ishte mirë që të ketë edhe një kontroll të të hyrave, më pak kur flasim për të hyrat nga aktivitetet, por te donacionet po.

Ne do ta votojmë këtë projektligj, normalisht nuk do të ndalemi këtu, por do të kontribuojmë edhe më tutje që ta pasurojmë ligjin me punën tonë në Komisionin Parlamentar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes”, deputeti Afrim Kasolli.

AFRIM KASOLLI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Edhe Lëvizja “Vetëvendosje” do ta aprovojë në parim Projektligjin për ansamblin “Shota”. Natyrisht i kemi disa vërejtje ekskluzivisht sa u përket raporteve ndërmjet Këshillit Drejtues dhe drejtorit të ansamblit, kompetencave të tyre, relacioneve, apo edhe te mënyra e zgjedhjes së tij, meqë thuhet se ai zgjidhet me konkurs publik, të shpallur nga Ministria përkatëse për Kulturë, por nuk precizohen kriteret se para çfarë paneli, d.m.th. cili është ai panel që do ta zgjedhë atë.

Mirëpo, sidoqoftë këto vërejtjet tona dhe të tjerat do t'i bëjmë gjatë amendamentimit të ligjit në komisione.

Kështu, ne e përkrahim në parim këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, kryetari i Grupit Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Unë do të flas shumë i shkurt. Pak më gjatë për qëndrimin e Aleancës që ta mbështesë këtë ligj do të flasë deputetja Teuta Haxhiu. Sidoqoftë, është një temë e cila duhet të përmendet në Kuvend. Prej vitit 2007 ose 2008 deri më sot, Kuvendi i Kosovës tri herë ka vendosur për Ligjin për ansamblin e këngëve dhe valleve “Shota” dhe ansamblet tjera.

Mendoj se nuk duhet të mbetet e pashënuar se Kuvendi i Kosovës po merret me këtë temë tri herë, që do të thotë ne kemi diçka defekt në sistem, për shkak se duke pasur parasysh të gjitha ato punë që i ka Kosova, të gjitha ato telashe që i ka Kosova, një Kuvend në këtë fazë ta shqyrtojë tri herë dhe ta miratojë tri herë një ligj për një ansambël të këngëve dhe valleve me të vërtetë është goxha qesharake dhe me siguri se në të ardhmen dikush do ta shohë me tepër interes këtë temë. Definitivisht, kjo nuk ka të bëjë aspak me paraqitjen e ministrin, e cila ishte korrekte, mirëpo ne dhe Qeveria duhet të reflektojmë se a kemi kohë, a kemi luks nga tri herë për pesë vjet t’i shqyrtojmë ligjet. Ndërlidhet po ashtu me fjalën time për pikën paraprake, kur thashë se të gjitha ligjet duhet të vijjnë si plotësim-ndryshime dhe ta dimë saktë për çka po flasim dhe i gjithë debati në Kuvend dhe fokusi të jetë për ato ndryshime, që pak më tepër ka të bëjnë me këtë ligj, do të thotë ky ligj është pak më i saktë në atë drejtim sa ai parapraku.

Edhe një herë po e vë theksin: Po më duket që Kosova nuk ka kohë nga tri herë të shqyrtojë ligje, as për duhanin, as për ansamblin këngë e valle. Duhet të ulemi të diskutojmë më gjatë dhe kur ta bëjmë një ligj, bile pak më gjatë ta ketë jetëgjatësinë e vet si i tillë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të KKR-së, deputeti Jeton Svirca.

JETON SVIRCA: Faleminderit, kryesues!

I nderuar ministër,

Kolegë deputetë,

Koalicioni për Kosovë të Re e ka shqyrtuar këtë projektligj, të cilin edhe do ta votojë.

Ne kemi disa këshilla për përmirësimin e ligjit, të cilat do t’i adresojmë në Komisionin përkatës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të SLS-së, deputeti Milivoje Stojanović.

MILIVOJE STOJANOVIĆ: Hvala predsedavajući!

Poštovani ministre,

Poštovani kolege poslanici,

Poslanička grupa SLS je razmatrala Nacrt zakona o Ansamblu pesama i igara “Shota” i drugih ansambla.

Imamo jedan zaključak da se radi o dobroj strukturi ovog Zakona. I ovim zakonom definiše se, odnosno uređuje se kulturno umetnička delatnost, priprema prestava, koreografskih dela pesama i gara i duhovno materijalnih vrednost kulturne baštine.

Ovim zakonom se omogućava osnivanje javnih i privatnih ansambala. Od javnih ansambala predviđena je kao nacionalni Ansambl “Shota”, koji će biti finansiran, koga osniva Skupština Kosova, a finansira se posebnim kodom od Ministarstva kulture.

Opštinskih ansambli osnivaju se odlukom skupštine opština, a finansiraju se iz budžeta opštine, takođe opštinskih ansambli mogu ka apliciraju za određena sredstva i kod Ministarstva kulture, a mogu da imaju i donacije.

Dobro je što na ovaj način regulisano finansiranje opštinskih ansambala. Međutim ja izdržavam jednu zabrinutost da li će opštinski ansambli, i pored ovakvog načina predviđeno za finansiranje, moći i uspeti da obavljaju svoju delatnost. Pre svega, iznosim zabrinutost za ansamble koji budu formirani od strane opštinskih struktura srpske zajednice, tamo gde su Srbi većina. Jer znamo da te opštinske strukture nemaju dovoljno sredstava i za neke druge aktivnosti, a onaj manje za ovakvu vrstu delatnosti.

S druge strane, ja bih podsetio članove Skupštine, kolege poslanike, da je Srpska zajednica imala je jedan profesionalni ansambl koje veoma profesionalno delovao, ansambl “Venac”, i trebalo bi razmisliti da se taj ansambl finansira pod okriljem Ministarstva kulture, kako bi mogao da prezentuje kulturnu baštinu srpske zajednice. Podržaćemo Nacrt zakona na prvom čitanju. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Në emër të Grupit Parlamentar “6+”, fjalën e ka deputeti Albert Kinolli.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuari nënkryetar!

I nderuari ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar “6+” e ka shqyrtuar Projektligjin për ansamblin kombëtar të këngëve dhe valleve “Shota” dhe për ansamblet tjera. Dhe Grupi Parlamentar “6+” në parim do ta votojë këtë projektligj, ndërsa kontributin tonë do ta japim nëpërmjet punës së Komisionit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Është radha e deputetëve.

Fjalën e ka deputetja Vjollca Krasniqi.

VJOLLCA KRASNIQI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar ministër,

Kohëve të fundit janë proceduar dhe miratuar një numër ligjesh të fushës kulturore, siç janë Ligji për teatrot, Ligji për bibliotekat dhe tani po e miratojmë edhe Ligjin për ansamblin “Shota” dhe ansamblet tjera.

Unë do të doja ta bëj një digresion të vogël në fjalën timen, mirëpo sigurisht do të më mirëkuptoni. Unë e mirëpres shqyrtimin dhe trajtimin e këtij projektligji, por do të doja ta shfrytëzoja praninë e ministrit këtu, sepse gjatë pikave të rendit të ditës - deklarime jashtë rendit të ditës dhe pyetjeve parlamentare - shpeshherë është e vështirë t'i gjejmë ministrat të pranishëm këtu, andaj dua ta shfrytëzoj këtë prani.

Zoti ministër,

Do të doja që edhe fushës së sportit t'i kushtoni më shumë vëmendje dhe më shumë përkujdesje në aspektin e infrastrukturës ligjore. Ne e kemi miratuar Ligjin për port, kemi bërë disa plotësim-ndryshime, mirëpo konkretisht në jetën sportive shumë pak ka pasur, apo asgjë s'ka ndryshuar. Ka kohë që po e presim Ligjin për sponsorim. Pse, zoti ministër, nuk po procedohet ky projektligj? Me miratimin e këtij projektligji mendoj që komuniteti sportiv do të frymonte më lirshëm. Ju sigurisht e shihni dhe jeni për së afërmi duke e parë veprimtarinë e klubeve sportive. Ata sponsorë, ata donatorë, po vijnë duke u zbehur çdo ditë. Po vjen duke u zbehur mbështetja e tyre. Cilësia në përgjithësi është e dobët. Pa mjete nuk ka cilësi. Edhe këta sponsorë që i kemi, nuk e bëjnë këtë se këto mjete do t'u kthehen, por e bëjnë për qëllime humane, për qëllime morale, apo se e duan një sport të veçantë.

Kohëve të fundit ka indikatorë pozitivë në pranimin e disa sporteve në arenën ndërkombëtare. Ne nuk kemi shumë me çka të marrim pjesë, sepse jemi protagonistë të disa pjesëmarrjeve të fundit në arenën ndërkombëtare të disa klubeve sportive.

Dhe, mendoj që slogani “me rëndësi pjesëmarrja”, tash më nuk do të duhej të zinte vend. Pa tendencë, zoti ministër po ju them që tash e tutje me rëndësi janë rezultatet.

Andaj, po ju sugjeroj edhe një herë që Ministria të punojë dhe ju si ministër të punoni më tepër në plotësimin e infrastrukturës ligjore sportive. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Kabinet qeveritar,

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Është një ligj, i cili e rregullon një segment të caktuar të kulturës, por mendoj se fushëveprimi i ligjit duhet ta ketë një domen më të gjerë.

Ky ligj e rregullon funksionimin e ansamblit “Shota”, por mendoj se ne duhet ta nxjerrim një ligj për trupën artistike shtetërore. Do ta nxjerrim një ligj, me të cilin do ta rregullojmë edhe funksionimin e trupave tjerë artistike, Termi “ansambël” është përcjellë vite pas viteve nga sistemi i kaluar, mirëpo ne do të duhej t'i kthehemi tamam termit shqip - trupa artistike e këngëve dhe valleve “Shota” dhe të funksionojë si e tillë.

Mirëpo, duke mos harruar se ne e kemi edhe trupën artistike të baletit dhe trupa të tjera artistike, mendoj që të gjitha këto trupa artistike shtetërore të nivelit shtetëror duhet t'i

rregullojmë me një ligj të veçantë, me Ligjin për trupat artistike shtetërore, dhe aty pastaj ta përcaktojmë nëpërmjet atij ligji financimin e tyre, ta përcaktojmë mënyrën e menaxhimit dhe format tjera të përcaktuara me atë ligj.

Ky ligj e rregullon një segment të caktuar të një fushëveprimi të caktuar, mirëpo mbeten edhe shumë segmente të tjera të parregulluara me ligj.

Prandaj, mundësia më e mirë do të ishte që ne vërtet mendojmë, edhe Ministria bashkërisht, por përgjegjësia është jona si ligjvënës, që ta zgjidhim këtë problem njëherë e përgjithmonë. Vetë mënyra e cekur këtu nga kolegu Ardian Gjini, i cili për këtë ligj tha se vjen për herë të tretë në Kuvend, nxjerr konstatimin që ky ligj dhe këtu diçka nuk është duke funksionuar në aspektin e ligjvënies. Prandaj, është mirë që ta zgjidhim këtë problematikë, të mendojmë në aspektin e përgjithshëm dhe t'i rregullojmë me ligj edhe aspektet tjera

Si do që të jetë, këtij ligji i jap përkrahje dhe mbështetje. Do ta votojmë që të kaloj në leximin e parë. Mirëpo, në aspektin e ligjit, mendoj që janë disa çështje të cilat mund të rregullohen. Mendoj se çështja e menaxhimit të këtyre trupave artistike, drejtori menaxhues, nuk do të duhej të ishte e përcaktuar kryesisht që të jetë i trupës artistike. Mendoj që te trupat artistike, drejtori artistik duhet të jetë vërtet i fushës përkatëse, të jetë i fushëveprimit përkatës, mirëpo menaxheri nuk mendoj që duhet ta ketë gjithsesi Fakultetin e Arteve, apo gjithsesi të jetë tamam i profesionit përkatës. Menaxheri është menaxher dhe ai mund të udhëheqë segmente të caktuara.

Ju e dini për shembull, Qendrën Klinike Universitare mund ta udhëheqë edhe një ekonomist, apo një jurist. Si nuk mund të zgjidhet një ekonomist apo një person përgjegjës, i cili e ka kryer shkollimin adekuat për menaxhim, të mos e udhëheq një ansambël, duke e pasur një përgjegjësi më të vogël. Prapë e them se mendoj që termi “ansambël” duhet të ndryshohet dhe të jetë “trupa artistike”, dhe nëse ky ligj kalon të jetë emërtimi - trupa artistike e këngëve dhe valleve “Shota”. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Teuta Haxhiu, le të përgatitet deputeti Sadri Ferati.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës do ta votojë në parim këtë projektligj.

Pajtohemi me shumicën e vërejtjeve që u thanë këtu, gjithsesi edhe me konstatimin e shefit të grupit Parlamentar të Aleancës.

Vërejtjet tona pikë së pari janë për shumë gabime drejtshkrimore që e kanë përcjellë këtë ligj, por edhe shumë ligje që po vijnë nga Qeveria e Kosovës. Është mirë ta kemi një lekturim të këtyre ligjeve, se me të vërtetë kjo është për shqetësim.

E kemi edhe një vërejtje, jo vetëm te funksionimi, se me të vërtetë unë mendoj se janë të rregulluara funksionimet e ansamblit kombëtar të këngëve dhe valleve “Shota”, por edhe të ansambleve komunale dhe ato private, mirëpo shqetësimi yni është financimi i këtyre ansambleve komunale. Është mirë që bashkërisht, si grup si Komision Funksional, të mendojmë në këtë drejtim. Unë shpresoj që do të gjejmë përkrahje edhe nga ministri, ta gjejmë një mënyrë të financimit, apo një mënyrë më të mirë të mundshme, që edhe këto ansamble komunale të funksionojnë ashtu siç duhet.

Këtu thuhet që ka implikime financiare shtesë, por thuhet që ato janë të zakonshme. Unë shpresoj që mund të gjejë zbatim në jetën e përditshme, pas miratimit në leximin e dytë dhe pas rregullimit dhe punës që do ta bëjmë në Komision. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Sadri Ferati.

SADRI FERATI: Faleminderit, i nderuari kryesues!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë,

Edhe unë në paraqitjen time do t’i përshëndes të gjitha angazhimet që ansambli “Shota” të funksionojë sa më mirë dhe që t’i mbajë gjallë vlerat tona kulturore.

Pra, me këtë qëllim, në nenin 4, përveç pra definimit të ansamblit shtetëror publik dhe atyre komunale, unë do ta kisha shtrua si të nevojshme që ta definojmë edhe një kategori tjetër, e ajo është trupat apo ansamblet e veçanta, pra ato të cilat janë unike, që krijojnë diçka të veçantë.

Nga përvoja ime do t’i përmend vetëm dy prej këtyre, siç është ansambli “Rugova” dhe vlerat që krijohen në regjionin e Hasit.

Unë nuk po them tash që në mungesë financiare atyre t’u sigurohet ky status, por është e pamjaftueshme të mbeten komunale, sepse duke e ditur që edhe në nivelin qendror kemi mungesa, edhe në nivelin lokal kemi mungesa financiare, do të ishte e dëmshme sikur të shuhet kjo veprimtari e prodhimit të tingujve të shkëlqyeshëm në ansamblin “Rugova”, që është unik në Ballkan, në tërësi, por edhe kostumografia që e hasim në regjionin e Hasit. Mund të mos jenë vetëm këto, të jetë edhe ndonjë tjetër, por unë do të bëj përpjekje që edhe në fazat tjera ta jap kontributin tim, që të definohen edhe ansamblet e veçanta, ansamblet unike, sepse krijojnë diçka që nuk mund ta gjejmë në ndonjë vend tjetër, prandaj mund të rrezikojmë ta humbim atë trashëgimi kulturore dhe muzikale, që e kemi të begatshme vetëm në ato zona, jo edhe diku tjetër. Në këtë aspekt po flas.

Te neni 10, meqenëse Ministria e emëron Këshillin, e mund edhe të mos ekzistoj këshilli, por të jetë menaxheri, pra udhëheqësi i ansamblit, duke u fuqizuar Këshilli Artistik.

Por, duke marrë parasysh se shumë krijues të fuqishëm artistikë kanë mbetur keq dhe dëshirojmë të krijojmë vend për ata dhe të kemi edhe në Këshillin Artistik njerëz të kësaj fushe, mund të pajtohem, pra motivi duhet të jetë ky. Por, jo edhe menaxhimi, ngase

karakteristikë e këtyre këshillave, e bordeve janë organet e pavarura, po jo te njësitë e Ministrisë edhe te njësitë komunale.

Pastaj, te neni 14, kur flasim për Këshillin, thuhet se ai e zgjedh kryetarin, por duhet të saktësohet që në asnjë rast përfaqësuesi i njësisë nuk do të duhej të jetë kryetar, meqenëse e themelon Ministria, e dërgon përfaqësuesin e vet. Pra, kryetari i Këshillit nuk duhet të jetë përfaqësues i Ministrisë.

Pastaj, tek pika 14, kur flasim për seksionet, paraqitet seksioni i solistëve dhe i orkestrës. Nuk e kam të qartë sesi është paraparë që të mos ekzistojë seksioni i valleve domethënë. Nëse kjo është e paraparë, unë nuk e kam të kuptueshme. Dhe, përgjegjësi i këtyre sektorëve solistë e orkestër. Ndërsa nuk kemi përgjegjës të sektorit të valleve. A mendohet që koreografi, i cili do të ekzistojë në Këshillin Artistik, do të jetë ky person dhe në këtë rast e kemi ngatërruar se çka është krijues, sikur koreograf, dhe çka është menaxher. Jo domosdoshmërisht, një koreograf dëshiron edhe të jetë menaxher i seksionit të valleve. Prandaj, kjo duhet të rregullohet.

Prandaj, në tërësi, edhe një herë e mbështetim votimin e ligjit në parim në leximin e parë, dhe shpresoj se disa nga këto çështje që po diskutohen, dhe sidomos te pika e parë, për të cilën diskutova, që të ketë statute të veçanta për disa ansamble si trupa që e ruajnë trashëgiminë dhe krijojnë vlera të veçanta, do të angazhohem fuqimisht. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Emilija Redžepi.

EMILIJA REDŽEPI: Zahvaljujem predsedavajući,

Uvaženi kolege poslanici,

Kulturna umetnička društva se svakako moraju podržati, kako sa moralnog, tako i sa materijalnog aspekta, jer je to u interesu očuvanja kulturne baštine vrednosti svih naših zajednica koje žive na prostorima naše države.

Raznolikost jednog društva upravo zavisi koliko su te zajednice prezentirane u svojoj kulturnoj baštini. Ono o čemu sam ja danas htela da govorim ide prvo u zahvalnosti Ministru za kulturu, zato što podržava sve aktivnosti koja se dešavaju na terenu, sve aktivnosti kulturne umetničkih društva, direktoru za kulturu omladinu i sport u opštini Prizren, koje podržavaju različite koncerte koja se sprovode na terenu.

Ja bih samo želela da dam jednu primedbu, koja bi bila adresirana na finansiranje određenih koreografija, odnosno pozorišnih prestava različitih zajednica. Ne govorim samo interesu Bošnjačke zajednice, nego i drugih ne većinskih zajednica, kako bi smo se bolje prezentirali u našoj zemlji, ali i u inostranstvu.

Takođe jedna međuetnička povezanost, međuopštinska povezanost donela bi do jednog poboljšanja komunikacije među naše omladine, koja živi na ovim prostorima, i svakako dovela bi više do jedne bliske saradnje između njih sami i njihovog druženja.

Takođe, koristim priliku da podržim ovaj zakon, nacrt čitanja zakona o Ansambl “Shota”, ali molim vas Ministre da i dalje podržavate sve aktivnosti u interesu manjinskih zajednica. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Hvala! Fjalën e ka deputeti i parafundit, Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, kryesues nënkryetar i Kuvendit,
Zoti ministër,
Faleminderit!

Natyrisht që projektligji në kornizën e brendshme eliminon disa nga problemet që i keni gjetur në ansambël, që përfshin edhe financimin dhe organizimin e ansambleve komunale, apo rolin e institucioneve komunale për organizimin, në mënyrë që të ndahet apo të çlodhet pak a shumë Ministrinë prej presionit të madh që ka në kërkesat buxhetore.

Unë kisha dashur që në kuptimin buxhetor vërtet të stabilizohet, të rregullohet kjo çështje, duke i obliguar komunat që në subvencione dhe në planifikime t’i rregullojnë këto çështje.

Dhe nën dy, kërkesa ime është që ndoshta ka ardhur koha përfundimisht që me gjithë historisë e bujshme, ansambli të quhet me emrin shtetëror, ashtu siç është, duke e larguar emrin “Shota”, si emërtim i mëhershëm, i cili më shumë e ka pasur kuptimin e multikulturalitetit dhe multietnicitetit në kohën e vet, në ish-krijesën, që nuk ekziston më.

Ansambl i këngëve dhe valleve me mision dhe me detyrë ligjore tash të jetë si i tillë, ndërsa emërtimi të jetë vetëm histori.

Unë e di që kjo do të duhej të harmonizohet brenda leximit të dytë ndërmjet Komisionit Funkcional dhe juve, por përfundimisht besoj që ka ardhur koha për ta larguar atë emër prej ansamblit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti i fundit i paraqitur, deputetja Blerta Deliu Kodra, ndërsa i ftoj deputetët të kthehen në sallë.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolege deputete dhe kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Është mirë që Projektligji për ansamblin e këngëve dhe valleve “Shota” ka ardhur në Kuvend, sepse ligji që deri më tash ka qenë në fuqi ka pasur mangësi të shumta, e të cilat mendoj se do të rregullohen pikërisht me këtë ligj.

Mendoj se pikërisht neni 29 i këtij projektligji, që e rregullon stazhin e beneficuar është për t’u vlerësuar. Po ashtu, edhe neni 30, i cili e rregullon çështjen e arkivave të këtij institucioni.

Me këtë projektligj ne do të ndikojmë në ruajtjen e traditës sonë muzikore dhe kulturore, por edhe të asaj kombëtare.

Edhe unë pajtohem me atë që e tha kolegu Haxhiu, i cili foli lidhur me emërtimin e ansamblit. Pse të mos quhet “trupë artistike”, e jo ansambël i valleve “Shota”, prandaj jam e pajtimt se duhet të përdoret një emërtim i tillë.

Unë uroj që në të ardhmen, ashtu siç e parasheh ligji, të themelohen edhe ansamble të reja nëpër komunat e Kosovës për shkak se ne kemi edhe ansamble të cilat veprojnë pothuajse në të gjitha komunat e Kosovës dhe të cilat bëhen edhe me vendim të asambleve komunale.

Ky ansambël, siç e dimë të gjithë, është themeluar pikërisht në vitin 1948 dhe që nga ajo kohë e deri më tani ka arritur të jetë njëri prej ansambleve të para artistike dhe ashtu, siç jemi të informuar, është shpërblyer me shpërblime të para nëpër shumë vende, edhe jashtë Kosovës.

Po ashtu, në fund uroj që ky projektligj të mundësojë një efikasitet në punë për të gjithë anëtarët e ansamblit dhe, para së gjithash, të ruhet etika dhe privatësia e valltarëve të ansamblit “Shota”, të cilët vërtet kanë kontribuar dhe po kontribuojnë në ruajtjen e traditës muzikore dhe të asaj kombëtare. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar ministri. Urdhëroni ministër!

MINISTRI MEMLI KRASNIQI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Unë vetëm desha që të ju falënderoj për kontributin dhe për komentet, dhe të them se ne si Ministri do të jemi absolutisht në dispozicion, në radhë të parë të Komisionit Funkcional, por edhe komisioneve tjera përkatëse që do ta shqyrtojnë më tej amendamentimin e këtij projektligji. Pa dyshim se ka mundësi për t’u përmirësuar, me gjithë faktin që ndoshta janë disa çështje të cilat ndërlidhen edhe me historinë, edhe me traditat, si për shembull çështja që u shtrua nga deputeti Ferati sa i përket Këshillit Artistik. Është një funksionim tashmë i mirë me vite të tëra dhe koreografi është realisht përfaqësues i valltarëve. Për këtë arsye janë vetëm dy seksione tjera të artistëve vokale dhe atyre të orkestrës.

Sa i përket çështjes së emërtimit, realisht është një praktikë pothuajse në të gjitha vendet, jo vetëm të rajonit, por edhe të tjera, që të quhen ansamble. Trupa artistike është pjesë e ansamblit; trupa artistike është kryesisht vetëm pjesa e artistëve, ndërsa ansambli si një institucion i rëndësishëm publik i kulturës e ka edhe pjesën e administratës, e ka edhe pjesën e menaxhmentit, por pjesë e saj është edhe pjesa e Këshillit Drejtues.

Sa i përket çështjes së zgjedhjes të drejtorit, Ministria absolutisht funksionon apo shërben vetëm si pjesë e administrimit të konkursit, ndërsa është këshilli drejtues ai i cili e menaxhon gjithë procesin në kuptimin edhe të zgjedhjes, por edhe të shkarkimit potencial, dhe kjo është në uniformitet edhe me ligjet të tjera, të cilat kanë të bëjnë me institucionet publike të kulturës.

Ndërsa për çështjet që u shtruan, unë besoj që mund të jetë një vendim që duhet të dalë edhe në konsultim me komunitetin artistik për qasjen tonë, legjislacionin në fushën e kulturës, që u shtrua ndoshta edhe nga zoti Gjini. Është edhe një mendim tjetër, se ndoshta ne nuk kemi nevojë që të kemi ligje për secilin institucion, por që të kemi një makro-ligj që e rregullon fushën e kulturës dhe institucioneve, në përgjithësi, dhe pastaj nëpërmjet akteve nënligjore, institucionale, statuteve, në radhë të parë, por edhe rregulloreve tjera të shkohet në detaje, të cilat tash për tash i mbulojnë ligjet.

Sidoqoftë, Ministria do të jetë gjithmonë në dispozicion, sepse fjalën e fundit pa dyshim që e ka ky Parlament i nderuar.

Ndërsa sa i përket çështjes që u shtrua për sport, unë me shumë dëshirë do të jem në dispozicionin tuaj dhe të gjithë deputetëve, zonja deputete, edhe nëpërmjet pyetjeve parlamentare, pse jo edhe nëpërmjet ndonjë debati, që do të duhej të bëhej për sportin, sepse ky Kuvend vetëm një herë ka bërë debat dhe ka shumë vite që kanë kaluar prej kur është bërë debati për sportin. Mendoj se jemi në një moment kur kjo temë absolutisht meriton të trajtohet nga Kuvendi i Kosovës, duke pasur parasysh të gjitha zhvillimet që kanë ndodhur, veçanërisht në një vit e gjysmë të fundit, pa dyshim që projektligji për sponsorime është një projektligj shumë i rëndësishëm.

Nuk jam i sigurt a është një projektligj që krijon mrekulli, por është një projektligj që krijon lehtësira. Ai është ende, për fat të keq, në tavolinën time çdo ditë, por në pamundësi të gjetjes të një zgjidhjeje, e cila nuk do t'i tejkalonte kornizat e marrëveshjeve që ne i kemi edhe me instancat ndërkombëtare financiare, ka mbetur pa u proceduar, sepse qëllimi ka qenë që të bëhet me të vërtetë një ndryshim dhe të mos kemi vetëm procedim të ligjit, i cili realisht nuk ndryshon çështjen që ndërlidhet me lehtësimet tatimore për sponsorues.

Si do që të jetë, qoftë për fushën e sportit, apo të kulturës, ne jemi në dispozicion të Parlamentit, jo vetëm në kuptimin e legjislacionit primar, por edhe sa i përket akteve tjera, të cilat mund t'i bëjmë bashkërisht. Ju faleminderit për mbështetjen dhe për vëmendjen!

KRYESUESI: Faleminderit, ministër!

Në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të Projektligjit për ansamblin kombëtar të këngëve dhe valleve “Shota” dhe për ansamblet tjera.

Në mbledhje janë të pranishëm 65 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se me 59 vota për, asnjë kundër dhe një abstenim, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për ansamblin kombëtar të këngëve dhe valleve “Shota” dhe për ansamblet tjera.

Ngarkohet Komisioni FunkSIONal dhe Komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

Kalojmë në pikën e radhës:

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

E ftoj kryetarin e Komisionit për Arsim Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Medie, Idriz Vehapi, që ta arsyetojë raportin me rekomandime. Urdhëroni, kryetar!

IDRIZ VEHAPI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Projektligji për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, pas leximit të parë, është shqyrtuar nga Komisioni FunkSIONal nen për nen. Po ashtu, është shqyrtuar edhe nga komisionet e përhershme. Projektligji përmban gjithsej 26 nene dhe një amendament. Është në përputhje me legjislacionin e BE-së dhe ky projektligj ka kaluar në Komision pa asnjë vërejtje.

Po ashtu edhe komisionet e përhershme nuk kanë dhënë vërejtje në nenet dhe amendamentin e projektligjit, prandaj mendojmë se ky projektligj bashkë me nenet dhe amendamentin duhet të votohet në Kuvend, sepse mendojmë se i zgjidh shumë çështje që kanë të bëjnë me pronën e komunës. Faleminderit!

KRYESUESI: Në sallë janë të pranishëm 60 deputetë. I ftojme deputetët të kthehen në sallë.

(Ndërprerje e shkurtër incizimit)

Tani e votojmë amendamentin e pikës katër. Në sallë janë të pranishëm prezentë 63 deputetë. Në këtë projektligj është propozuar vetëm një amendament. Vazhdojmë me votimin e amendamentit të propozuar në raportin e Komisionit FunkSIONal.

E votojmë amendamentin e propozuar nga Komisioni FunkSIONal, amendamenti 1, neni 8, paragrafi 2, pas fjalës “Kuvendi i Komunës 3 anëtarësh”, shtohen fjalët “nga subjektet e ndryshme, të përfaqësuara në Kuvend”, dhe vazhdon teksti. Prandaj, e votojmë amendamentin. Regjia!

Konstatohet se me 57 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 1.

Tash e votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi me amendamentin e miratuar.
Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatoj se me 51 vota për, 6 vota kundër dhe 1 abstenim, Kuvendi e miratoi Ligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës.

Pika tjetër e rendit të ditës:

8. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Medie

Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 12 nëntor 2012, ka kërkuar nga grupet parlamentare që deri në mbledhjen e sotme t'i propozojnë deputetët për anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Medie.

Komisioni përbëhet prej 9 anëtarëve. I ftoj kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare që t'i propozojnë deputetët për anëtarët e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Medie.

Grupi Parlamentar i PDK-së i ka propozuar dy anëtarë, Xhevahire Izmaqi dhe Ramë Vataj. E ka fjalën kryetari i Grupit, zoti Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Grupi Parlamentar i PDK-së i propozon Behar Selimin dhe Ramë Vatën.

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, kryetari i grupit, zoti Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Grupi Parlamentar i LDK-së i propozon zonjën Lirije Kajtazi dhe zotëri Sadri Ferati.

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të "Vetëvendosjes", zoti Afrim Kasolli.

AFRIM KASOLLI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Grupi Parlamentar i Lëvizjes "Vetëvendosje" e propozon për Komisionin ad hoc deputeten Alma Lama.

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të AAK-së, fjalën e ka zonja Kymete Bajraktari.

KYMETE BAJRAKTARI: Faleminderit, zoti kryesues!

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e propozon Teuta Haxhiun.

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Koalicionit Kosova e Re, fjalën e ka kryetarja e Grupit, zonja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!
Koalicioni për Kosovë të Re për këtë komision e propozon zotëri Jeton Svircën.
Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Dhe një anëtar nga Grupi Parlamentar SLS, fjalën e ka
Sasha Milosavleviq.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala gospodine predsedavajući!
Samostalna liberalna stranka predlaži za člana ad hoc Komisije Milivoja Stojanovića.

KRYESUESI: “6+” Parlamenter Grubu Şefi, Müfera Şinik.

MÜFERA ŞİNİK: Teşekkür ederim Sayın Başkan vekili!
Bağımsız Medya Komisyonunun üyelerin seçim komisyonuna 6+Parlamenter Grubu
olarak milletvekili Sayın Fikrim Damka’yı öneriyoruz. Teşekkür ederim!

KRYESUESI: Teşekkür ederim! Grupi Parlamentar i PDK-së i propozon dy anëtarë:
Behar Selimi dhe Ramë Vataj;

Grupi Parlamentar i LDK-së, dy anëtarë: Lirije Kajtazi dhe Sadri Ferati;

Grupi Parlamentar i “Vetëvendosjes” e propozon një anëtar, Alma Lama;

Grupi Parlamentar i AAK-së e propozon një anëtar, zonja Teuta Haxhiu;

Grupi Parlamentar Koalicioni Kosova e Re e propozon një anëtar, deputetin Jeton Svirca;

Grupi Parlamentar i SLS-së e propozon një anëtar, Milivoje Stojanoviq dhe

Grupi Parlamentar “6+” e propozon një anëtar, Fikrim Damka.

Të nderuar deputetë,
Tash procedojmë me votim.
Në mbledhje janë të pranishëm 67 deputetë.
Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatoj se me 58 vota për, 2 kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi i emëroi anëtarët e
Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Medie.

Ngarkohet Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për
Medie që të veprojë në përputhje me nenin 11, paragrafi 2.3 të Ligjit numër 04/L-044 për
Komisionin e Pavarur për Medie.

I kemi edhe dy pika. I kryejmë? Ok-ej.

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mallrat e liruar nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni FunkSIONAL e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim në parim.

E ftoj ministrin e Financave, zotin Bedri Hamza që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin. Urdhëroni ministër!

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti kryesues!

Deputetë të nderuar,

Qeveria e Republikës së Kosovës, nëpërmjet Projektligjit për lirimin nga tatimi doganor dhe mallrat me zero tatim doganor, propozon politika për: krijimin e një ambient të favorshëm për disa industri në sektorin privat; përmirësimin potencial të bilancit tregtar, duke i ndihmuar kompanitë që eksportojnë shërbime, si dhe bëjnë nxitjen e zëvendësimit të produkteve të importuara me ato të prodhuara në vendin tonë; nxitjen e punësimit dhe rritjen e mirëqenies qytetare.

Qeveria e Republikës së Kosovës, përkatësisht Ministria e Financave, pas analizave të bëra, ka konstatuar që nëpërmjet politikave fiskale të propozuara do t'i mundësojë sektorit privat zhvillim të qëndrueshëm, posaçërisht në sektorët të cilët janë në zhvillim e sipër, në sektorët që po fillojnë prodhimin dhe dita-ditës po e rritin prodhimin, e me këtë edhe numrin e të punësuarve. Lirimet nga tatimet doganore të propozuara kryesisht përfshijnë lëndën e parë dhe gjysmëproduktet, të cilat përdoren nënprodhim, vijat e prodhimit, makinat e veçanta dhe të kombinuara të të gjitha llojeve që shërbejnë për prodhim, pajisjet për ofrimin e shërbimeve të teknologjisë informative, një degë e cila është duke u zhvilluar me të madhe në Kosovë në ofrimin e shërbimeve edhe jashtë shtetit tonë.

Në kuadër të propozimeve tona, e kemi paraparë edhe të drejtën e lirit për të gjitha llojet e konstruksioneve montazh, që shpërbejnë për ndërtimin e objekteve montuese prodhuese, fabrikat ky hyjnë edhe stabilimentet frigorifer, që është shumë e kërkueshme për të gjithë qytetarët, apo subjektet që kultivojnë pemë dhe perime për t'i ruajtur në gjendje të mirë si produkte sezonale. Kur jemi te dega e bujqësisë, e kemi liruar edhe sistemin e ujitjes të tokë. Po ashtu, si rezultat i marrëveshjeve të tregtisë së lirë që ka lidhur Kosova me shtetet tjera, është vërejtur një kategori e produkteve finale, të cilat nuk i nënshtrohen tatimit doganor gjatë importimit. Në të njëjtën kohë, lënda e parë për prodhimin e këtyre produkteve i nënshtrohet tatimit doganor në import. Kjo gjendje e bën prodhuesin të mos jetë në pozitë të favorshme për të prodhuar, andaj duke e parë këtë gjendje kemi marrë vendim që lëndët e para për këto produkte t'i lirojmë nga tatimi doganor.

Qeveria e Republikës së Kosovës po ashtu ka marrë vendim që ta lirojë nga tatimi doganor një grup produktesh farmaceutike, që kryesisht gjejnë aplikim nëpër institucionet shëndetësore, spitalore, e posaçërisht nëpër klinikat e Qendrës Universitare të Kosovës.

Kemi të bëjmë me preparate kundër sëmundjeve të rënda dhe kronike, siç janë: barërat e shtrenjta kundër kancerit, barërat dhe preparatet që përdoren për hemodializë, barërat për pacientë me sëmundje kronike të diabetit dhe barërat tjera për trajtim të sëmundjeve të gjakut, tretjet dhe zëvendësuesit e tyre, që në masë të madhe përdoren në emergjenca, si dhe si material harxhues mjekësor, që përdoren si mjete ndihmëse pas operacioneve të heqjes së disa sëmundjeve. Me këto lirime, ne do t'i ndihmojmë qytetarët tanë që këto produkte farmaceutike t'i marrin me çmime më të lira dhe më kualitative.

Të gjitha këto propozime për lirim nga tatimi doganor dhe mallrat me tatim zero doganor janë rezultat i bashkëpunimit dhe transparencës të Ministrisë të Financave dhe komunitetit të biznesit. Ne, pas konsultimeve dhe paraqitjeve tona që i kishim para biznesit, kemi pranuar propozime shumë të çmueshme nga biznesi. Falë këtyre propozimeve, ne e kemi zgjeruar dhe pasuruar edhe më shumë listën e mallrave edhe me lëndë të tjera, të cilat marrin pjesë në procesin e prodhimit.

Po ashtu, më lejoni të theksoj se kjo fushë deri më tani ka qenë e rregulluar me Rregulloren e UNMIK-ut, 2007/31. Aprovimi i Projektligjit do ta konsolidojë dhe avancojë bazën ligjore dhe politikat fiskale të vendit tonë.

Deputetë të nderuar,

Siç e paraqita më lart, këto lirime do të ndikojnë pozitivisht në zhvillimin ekonomik të vendit, po ashtu edhe në jetën e qytetarëve tanë. Ministria e Financave ka qenë shumë e kujdesshme gjatë draftimit të ligjit, përkatësisht listës së mallrave të liruara nga tatimi doganor. Ligji, përveç që e ka për qëllim kryesor nxitjen e prodhimit, e ka për qëllim edhe mbrojtjen e prodhuesit. Andaj, duke pasur parasysh rëndësinë e këtij projektligji, propozoj ta miratoni projektligjin për lirim nga tatimi doganor me mallrat me tatim zero doganor. Ky ligj ka kosto financiare, mirëpo kostoja financiare është e llogaritur dhe është marrë në konsideratë. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, ministër!

Të nderuar deputetë,

Pas prezantimit të Projektligjit, hap debatin për diskutim në parim dhe fjalën e ka kryetarja e Komisionit për Buxhet dhe Financa, zonja Safete Hadërgjonaj.

SAFETE HADËRGJONAJ: Ju faleminderit, kryesues!

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar Projektligjin për mallrat e liruara nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor. Ky Projektligj i përcakton mallrat të cilat lirohen nga tatimi doganor, që mund të lëshohen në qarkullim të lirë me shkallën zero të tatimit, për arsye të natyrës së mallit dhe për arsye të përdorimit të tyre të veçantë.

Qëllimi i lirimeve nga taksa doganore është në funksion të përmbushjes së obligimeve, me qëllim të krijimit të kushteve për nënshkrimin e marrëveshjeve tregtare me Bashkimin Evropian dhe për stimulimin e prodhimit vendor. Projektligji si i tillë përmban memorandum shpjegues për objektivat që synon t'i realizojë ligji dhe tregon për harmonizimin me legjislacionin në fuqi. Po ashtu, projektligji e përmban edhe deklaratën

për ndikimet buxhetore, që vlerësohen me një kosto buxhetore prej 5,1 milionë euro dhe me ndikim negativ në realizimin e të hyrave buxhetore.

Projektligji e përmban edhe deklaratën për afrim dhe harmonizim me legjislacionin e Bashkimit Evropian, sipas së cilës konkludohet se është i përafshuar me të. Po ashtu, projektligji është i hartuar mirë në aspektin formal juridik dhe sipas ndarjes së dispozitave edhe në gjuhën zyrtare për hartimin e legjislacionit dhe si i tillë i përmbush kriteret formale juridike që parashihen me nenin 54 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Komisioni për Buxhet dhe Financa i ka dhënë përkrahje këtij projektligji dhe rekomandojmë që të miratohet edhe në lexim të parë në seancë, që Komisionit t'i krijohet mundësia t'i bëjë përmirësimet e nevojshme gjatë procedurave të mëtutjeshme.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Radha është e kryetarëve ose përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, fjalën e ka deputetja Hasime Krasniqi.

HASIME KRASNIQI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka hartuar dhe analizuar këtë projektligj dhe në parim do ta mbështesë. Duke e parë rëndësinë e këtij projektligji, meqë deri më tani kjo fushë ka qenë e rregulluar me Rregulloren e UNMIK-ut, kurse nëpërmjet miratimit të këtij projektligji hapet rruga për rregullimin e kësaj fushe. Projektligji për mallrat e liruara nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor, që është në përgjithësi i përafshuar me legjislacionin e BE-së, ky projektligj nuk ka kosto shtesë financiare në Buxhetin e Republikës së Kosovës, por ka ndikim negativ në të hyrat e përgjithshme, mirëpo edhe me gjithë faktin që me këtë projektligj në vitet pasuese do të kemi ulje në të hyrat e përgjithshme doganore rreth 5,1 milionë euro, Qeveria e Republikës së Kosovës me këtë projektligj bën stimulimin për prodhuesit vendorë, sidomos në sektorin e bujqësisë, të shëndetësisë, të industrisë përpunuese e tjera, që vjen edhe si rezultat i kërkesave të vazhdueshme nga bizneset dhe të mbështetur nga Qeveria e Republikës së Kosovës, me qëllim zgjerimin e listës së produkteve të liruara nga taksat doganore, që pritet të ketë ndikim pozitiv në ambientin e të bërit biznes në Republikën e Kosovës.

Andaj, Grupi Parlamentar do ta mbështesë dhe kontributin tonë do ta japim në Komisionin Funksional. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, fjalën e ka deputetja Hykmete Bajrami.

HYKMETE BAJRAMI: Ju faleminderit, kryesues!

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

Te Projektligji për mallrat e liruar nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor, LDK-ja si parti e qendrës së djathtë, e përkrah çdo iniciativë që në mënyra të ndryshme shtytë dhe nxit zhvillimin ekonomik dhe prodhimtarinë, gjithmonë duke pasur parasysh strukturën e ekonomisë së vendit dhe nevojën për ndryshime pozitive.

Në memorandumin shpjegues thuhet se mallrat e liruar nga taksa doganore të limituara në anekset e këtij ligji do ta përmirësojnë ambientin e biznesit dhe do ta rritin prodhimin vendor. Deri këtu është krejt në rregull, por pyetjet dhe konfuzioni lind atëherë kur ne me kujdes e shikojmë listën e mallrave që lirohen nga taksat doganore. Nga lista është vështirë të shihet se heqja e këtij 10%-shi, cilin sektor të prodhimit do ta stimulojë. Madje, nëse i analizojmë disa mallra veç e veç, është vështirë të thuhet se ligji do të ketë ndikim pozitiv. Nëse Qeveria është e orientuar drejt stimulimit të prodhimit vendor, atëherë është e logjikshme që të hiqet taksa doganore nga ato mallra, të cilat nuk prodhohen në Kosovë dhe që janë të domosdoshme për procesin e prodhimit, por assesi të lirohen nga taksat doganore mallrat që prodhohen në Kosovë, sepse atëherë ne me ligj tregtinë po e vëmë mbi prodhimin.

Po i përmend vetëm disa mallra. Për shembull, në aneks e kemi mallin “kafshë”. Nuk është specifikuar se cilat kafshë dhe për çfarë qëllimesh. Mandej, e kemi mallin “misër”. Nëse ne e heqim taksën doganore prej 10% për misrin, atëherë ne e stimulojmë importin e misrit, e jo prodhimin e tij. Mandej kemi tonerë për printerë. Ministri e përmendi që ligji ka për qëllim edhe stimulimin e zhvillimit të sektorit të IT-së, me sa e kam parë, do të thotë lidhur me këtë të jenë vetëm tonerët dhe nuk e di assesi se çfarë ndikimi mund të ketë heqja e taksës doganore nga tonerët për printerë në zhvillimin e këtij sektori. Mandej kemi kafshë të gjalla e tjera, por nuk ka specifikacion për cilat kategori.

Të nderuar deputetë,

Në këtë listë ne e kemi edhe produktin “naftë”. Si do të ndikojë lirimi nga taksa doganore e naftës prej 10%? A thua do ta blejnë bujqit naftën më lirë? Përgjigjja është jo. A do ta kemi ne si konsumator naftën 10% më lirë? Përgjigjja është jo.

Ministri në Komision e tha se naftës i hiqet taksa doganore prej 10%, në mënyrë që kompanitë e huaja që eksportojnë naftë në Kosovë të jenë në pozitë të barabartë me kompanitë e huaja që vijnë nga vendet e CEFTA-s dhe eksportojnë naftë në Kosovë. Thua se Qeveria e ka rregulluar shumë mirë ambientin e biznesit brenda dhe tash i ka mbetur të kujdeset për kompanitë e huaja. Kjo është shumë vështirë të besohet. Heqja e taksës doganore nga nafta, nuk mund të shihet ndryshe, vetëm si një partneritet në heshtje i Qeverisë me kompanitë private, por jo ato të huaja që janë eksportuese, por këto të vendit që e importojnë naftën nga vendet që nuk janë anëtare të CEFTA-s. Ne, si LDK, do ta mbështetim ligjin në parim pikërisht për shkak të disa artikujve të sektorit të shëndetësisë, që janë shumë të rëndësishëm, mirëpo do të kërkojmë shpjegime shumë të detajuara nga ministri gjatë amendamentimit të ligjit. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, fjalën e ka deputetja Albana Fetoshi

ALBANA FETOSHI: Faleminderit, kryesues!

Edhe ne e përkrahim këtë ligj për shkak se kryesisht janë mallrat e liruara nga tatimi doganor dhe kryesisht këto mallra hyjnë si lëndë e parë në Kosovë dhe sigurisht e stimulojnë prodhimin vendor. Janë kryesisht mallra si lëndë e parë, e stimulojnë prodhimin vendor dhe Lëvizja “Vetëvendosje” në parim e përkrah këtë projektligj.

Një vërejtje ndoshta te neni 4, në të cilin thuhet: “Qeveria e Republikës së Kosovës, në konsultim me Komisionin për Buxhet dhe Financa, mund të bëjë ndryshim”. Mendoj që duhet të futet edhe Kuvendi për shkak se nuk është e mjaftueshme që vetëm Komisioni të bëjë ndryshimin e këtij ligji, mirëpo në parim e mbështetim projektligjin. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, kryetari i Grupit, Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës do ta mbështesë në parim këtë projektligj. Me siguri se ka tema të cilat duhet të shikohen në Komision Parlamentar dhe mendoj se Ministria e Financave do të jetë gjatë gjithë kohës bashkë me Komisionin, në mënyrë që të gjitha vërejtjet, të cilat mund të shfaqen, përpos këtyre që u thanë në seancë plenare, të shqyrtohen aty. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Koalicionit Kosova e Re, deputetja Sevdije Lama.

SEVDIJE LAMA: Ju faleminderit, kryesues!

Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovën e Re e mirëpret Projektligjin për mallrat e liruara nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero dhe të njëjtin do ta votojmë. Kontributin do ta japim në Komisionin përkatës. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! SLS nuk ka të paraqitur. Në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Duda Bale.

DUDA BALJE: Zahvaljujem!

Parlamentarna grupa “6+” je analizirala i odlučila da podrži Nacrt zakona o robama, koje su izuzetno od carinskih dažbina i robe, koje imaju nultu carinsku stopu iz velikog broja pozitivnosti koji on donosi našoj državi u razvoju celokupnog ekonomskog sistema i u mnogim sferama i biznisa u njoj. Svoj dalji doprinos daće kroz rad u funkcionalnoj komisiji. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Fjalën e ka deputeti Muhamet Mustafa

MUHAMET MUSTAFA: I nderuari kryesues,

I nderuari ministër,

Unë ju falënderoj që e keni sjellë një projekt të tillë, për arsye se, siç kam thënë edhe në diskutimet rreth buxhetit, institucionet duhet të ndërmarrin diçka që ta përmirësojnë pozitën konkurruese të bizneseve tona, sidomos të atyre prodhuese, prandaj çdo tentim në

atë drejtim duhet të mbështetet. Unë kam disa sugjerime që në leximin e dytë të analizohen pak më afër. Nën një, kam frikë që në qoftë se ne fillojmë t'i diferencojmë sektorët e nënsektorët, rrezikohemi prej një administrimi të tepruar dhe prej ndikimeve mandej që mund t'i kemi në administrim në Dogana, në shpediton, në këto gjëra, mandej prej kërkesave sektorëve të ndryshëm.

Ndoshta më mirë do të ishte të jetë një solucion, që domethënë i trajton sektorët disi në mënyrë të barabartë. Ne këtu po e shohim se bujqësinë e kemi trajtuar, por ne kemi nevojë që ta stimulojmë edhe për impute të importet secilin prodhues që e zëvendëson një import dhe e rrit eksportin, pa marrë parasysh sektorin ku punon ai, për ato impute të prodhimit, të cilat nuk prodhohen në vend. Nën një, unë e pashë listën e pajisjeve, të cilat do të lirohen nga tatimi doganor. Atje ishin disa pajisje, edhe më herët e kemi pasur një lirim më duket për pajisjet bujqësore, por unë mendoj parimisht se nuk duhet ta kemi, të them ashtu, një diskriminim pozitiv të sektorëve të caktuar. Secili investitor që sjell pajisje nga importi dhe krijon vende të punës, ne nuk kemi arsye që ta ngarkojmë me doganë.

Këto janë vetëm disa gjëra që të diskutohen dhe të shihen në leximin e dytë edhe në Ministri, përndryshe mendoj se është një punë që duhet ndërmarrë, por parimisht ne duhet t'i ikim administrimit të tepruar në sektorët, në nënsektorët. Diskriminimi pozitiv midis sektorëve nuk është shumë i përshtatshëm për ekonominë e tregut dhe për konkurrencën e barabartë.

Çështja që nuk po e shoh se po diskutohet ende, e që është elementare, që është shumë e rëndësishme, më e rëndësishme se kjo ndoshta, është që ne për importuesit e imputeve dhe pajisjeve, TVSH-në të mos e mbledhin në kufi, por t'i kreditojmë disa vjet investitorët e mëdhenj, varësisht prej vëllimit të investimeve, përndryshe nëse investitorët e paguajnë TVSH-në, me një pritje 6-7 maj, nuk di sa është tash ajo pritje, ne nuk do të kemi investime të mëdha, sepse investitorët e kreditojnë buxhetin e shtetit në atë mënyrë. Shteti duhet ta mbledhë TVSH-në kur t'i shesim. Kur vjen një investitor në kufi - ne e skanojmë aty, ia dimë adresën, ia dimë vlerën, ia japim një plan të pagimit të TVSH-së, njëlloj siç i jepet plani i pagimit të kredisë dhe mendoj se kjo është esenciale për klimën e investimeve. Prandaj, unë e kisha inkurajuar ministrin që të mendojë ta gjejë këtë zgjidhje, sepse po më duket se kjo është pika kyçe në tërheqjen e investimeve. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Ali Sadriu.

ALI SADRIU: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Përsëritet zoti ministër,

Të nderuar kolegë,

Nuk dua të i përsëris gjërat që i trajtuan kolegët e nderuar në mënyrë shumë profesionale. Në listë nuk vërejtja pozicionin e grurit, zoti ministër, importimin e grurit, që gjithashtu do të ketë lehtësi. Mendoj se është koha që të mendojmë për atë, sepse ne e dimë që industrinë e mullinjve e kemi shumë të zhvilluar në Kosovë dhe nëse edhe grurin e

lirojmë prej tarifës, atëherë këtë industri do ta fuqizojmë dhe mendoj se me këtë do ta rritim edhe punësimin.

Unë mendoj se bujqit nuk do të dëmtohen, sepse në fund të fundit duhet ata ngritur me mekanizma tjerë, me forma tjera të subvencioneve dhe përfundimisht mendoj se është koha që rreth kësaj teme, vetëm për këtë e përmenda, është shumë me rëndësi që të mendojmë, sepse benificionet do t'i kemi të shumta. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Ramiz Kelmendi.

RAMIZ KELMENDI: I nderuar kryesues,

Zoti ministër,

Kolegë deputetë,

Sjellja e këtij ligji është një mundësi e mirë që me këtë të përfshihen ndryshimet pozitive fiskale, duke e hequr doganën në të gjitha repromaterialet që nevojiten për përpunim, prodhim dhe mundëson rritjen e vendeve të punës dhe të konkurrencës së denjë nga prodhuesit tanë. Pra, të hiqet në tërësi dogana, e jo parcialisht, që të gjithë aktorët ekonomikë ta shijojnë, me ndihmën e këtij ligji, të fillojë të vlejë për të gjithë nga dita e parë e implementimit.

Së dyti, për materiale investuese, që shërbejnë për ndërtimin e objekteve për prodhim dhe përpunim, pra edhe për të gjitha ato repromateriale që shërbejnë për ndërtimin e objekteve që hyjnë në funksion të zhvillimit dhe hapjes së vendeve të reja të punës. Kisha insistuar që edhe heqjen e TVSH-së për makineri prodhuese, transportuese, e ndoshta edhe kreditimin e TVSH-së, duke mos e paguar për të gjitha repromaterialet apo materialet për investim, ndërtim dhe përpunim.

Dhe, së katërti, heqjen e doganës dhe TVSH-së për pajisjet elektronike në funksion të ngritjes intelektuale të rinisë, siç janë kompjuterët dhe pjesët përcjellëse të saj. Prandaj, Grupi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, kërkon që komisionet përkatëse t'i kenë parasysh këto kërkesa dhe t'i implementojnë të gjitha këto në këtë ligj, mundësisht sa më shpejt. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Mursel Halili

MURSELJ HALJILJI: Zahvaljujem gospodine predjedavajući Skupštine!

Želeo bih da pozdravim sve prisutne,

Naravno da želim da pozdravim ovakvu ideju vezano za oslobađanje od carinskih dažbina robe koja je vrlo bitna za razvoj privrede, a posebno usmerena za poboljšanje života lica kojima je to potrebno. Ja znam i pretpostavljam da postoji i jedna odredba ili UNMIK-ova uredba vezana za oslobađanje poreza za automobile, za uvoz automobila za lica sa posebnim potrebama, pa sam imao nameru da bi bilo dobro da i ovde se to spomene, znači lica koja su tretirana, odnosno kvalifikovana kao lica sa posebnim potrebama, trebalo bi da imaju i mogućnosti uvoza automobila novih generacije, ali oslobođenih od carine. Mislim da bi naj taj način mnogo bolje bilo regulisano i poboljšalo bi život tim licima. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Deputeti i fundit i paraqitur, deputeti Hamza Bale. I ftojme deputetet te kthehen ne sallë per votim.

HAMZA BALJE: Zahvaljujem predsedavajuçi!

Kolege zastupnici,

Ovaj Nacrt zakona utvrđuje promet robe koja su izuzete od carinskih dažbina i mogu biti puštene u slobodni promet sa 0% carinske stope, i to po osnovu prirode robe i zbog njihove posebne namjene. Do sada je ova oblast bila regulisana UNMIK-ovim Uredbom, i sada usvajanjem ovog Nacrta zakona otvara se put za regulisanje mnoštvo problema koji su se nagomilali u toku ove UNMIK-ove Uredbe.

Kratkoročno gledano, ovan zakon može imati negativni uticaj na ukupni budžetske prihode, međutim dugoročno ovaj zakon obezbeđuje razvoj ekonomije, infrastrukture, zdravstva, pa i samog pojedinca građanina Kosova unutar naše države, a da ne zaboravimo da pospešuje i integrisanje ljudi sa ograničenim sposobnostima. Hteo bih da naglasim da se u doradi ovog projektbudžeta ubaci kao amandament potrebe za nacionalnim parkom, odnosno proizvode koje će biti od značaja za razvoj nacionalnog parka, bez obzira dali se radi o građi, o mladim sadnicama, koji služe za pošumljavanje nacionalnih parkova, a što je primer za nacionalni park Šar Planina. Zatim i razvoja proizvodnje mleka i mlečnih proizvoda, mesa i mesnih proizvoda kao je njihova ambalažiranje u originalnim pakovanjima, koja bi trebalo da promovisu ideju Nacionalnog parka, znači ovde bi trebalo da se nađe modus kako doći do promovisanja i implementiranja ovog zakona u nacionalnim parkovima. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Fjalën e ka ministri.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Dëshiroj t'i falënderoj të gjithë deputetet për diskutimet dhe kontributin e tyre dhe të bëj përpjekje për t'i dhënë disa sqarime.

Projektligji, përveç që merret me lirim e lëndëve të para, të pajisjeve për prodhim, të shumë medikamenteve që përdoren në shëndetësi, e zëvendëson edhe e ndryshon Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2007/31. Dhe, kur jemi te pjesa e anekseve, disa produkte që u përmendën këtu dhe lëndë të para kanë qenë pjesë e rregulloreve të UNMIK-ut dhe është dashur të barten në këtë ligj.

Po jap vetëm dy sqarime për disa produkte. U përmend nafta. Nafta edhe në të kaluarën, në bazë të marrëveshjes të CEFTA-s, ka qenë e liruar prej doganës. Nuk është liruar me këtë projektligj, e qëllimi ka qenë që importi i naftës është, kryesisht prej OKTA-s dhe në atë kohë të mos i jepet monopoli vetëm një kompanie, por të kenë mundësi ata që merren me këtë produkt të furnizohen edhe prej burimeve tjera.

Gjithashtu u përmend misri. Edhe me Marrëveshjen e CEFTA-s, për këtë produkt nëse importohet nga vendet e CEFTA-s, nuk paguhet doganë. Dhe ne nuk kemi dashur t'ua lëmë monopolin disa vendeve që ne realisht paraprakisht të paragjykojmë dhe ta kanalizojmë se kah do të jetë importi i produkteve të caktuara.

Unë jam i sigurt që gjatë punës në komisione, ne si Ministri e Financave, do të jemi në dispozicion të komisioneve funksionale. Do të pasurohet ky projektligj, ka mundësi që të shtohen edhe produkte të reja, ka mundësi që të përmirësohet dhe edhe një herë duke ju falënderuar për diskutimet ju lus që të njëjtin ta votoni dhe ta përmirësojmë në komisionet funksionale. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Të nderuar deputetë, në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të Projektligjit për mallrat e liruar nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor.

Në mbledhje janë të pranishëm 63 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatoj se me 57 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për mallrat e liruar nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor.

Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

Tash kalojmë në pikën e radhës:

10. Shqyrtimi i Raportit të tretë për zbatimin e Planit të Veprimit të Kuvendit të Kosovës për integritet evropian për vitin 2012

Komisioni për Integritet Evropian, në koordinim me komisionet tjera parlamentare e ka hartuar dhe Kuvendit ia ka paraqitur për shqyrtim dhe miratim Raportin e tretë për zbatimin e Planit të Veprimit të Kuvendit të Kosovës për integritet evropian, për vitin 2012.

Ftoj kryetarin e Komisionit për Integritet Evropian, Lutfi Haziri, që në emër të Komisionit ta paraqesë dhe arsyetojë raportin.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Nuk ka anëtarë të Qeverisë për këtë raport jashtëzakonisht të rëndësishëm për vendit.

Megjithatë, më lejoni që fillimisht ta bëj një përmirësim, sepse është Raporti i tretë dhe i katërt për këtë vit sipas periudhës kohore, meqenëse nuk kemi arritur me kalendar për shkak të publikimit të rekomandimeve të studimit të fizibilitetit.

Vetëm si përmirësim dhe për hir të korrekhtësisë ky raport i paraqitur në Kuvend, përfshin periudhën e tretë dhe të katërt të vitit 2012. Në këtë raport janë të arriturat dhe sfidat e institucioneve të Republikës, që përfshijnë kriteret politike, fushën e demokracisë dhe sundimit të ligjit, të drejtat e njeriut dhe mbrojtjen e minoriteteve, çështjet rajonale dhe

obligimet ndërkombëtare, kriterin ekonomik, fushën e ekzistencës së ekonomisë së tregut dhe kapacitetet për të përballuar presionin konkurrues dhe forcën e tregut brenda Unionit dhe në standardet evropiane në fushën e tregut të brendshëm, politikat sektoriale dhe drejtësia, liria e siguria.

Më 14 qershor të këtij viti, Komisioni Evropian i ka dorëzuar Kosovës Udhërrëfyesin për procesin e liberalizimit të vizave. Po ashtu me rëndësi të veçantë është zhvillimi i dialogut të strukturuar për sundimin e ligjit i cili është inauguruar në Bruksel në mes Kosovës dhe Bashkimit Evropian.

Më 10 tetor të këtij viti, Komisioni Evropian për herë të parë e ka publikuar Raportin për studimin e fizibilitetit, në Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit në mes BE-s dhe Kosovës dhe rekomandimi pozitiv i tij pritet të adaptohet nga Këshilli i Ministrave, më 17 dhjetor të këtij viti.

Komisioni për Integritet Evropian, në bashkëpunim me komisionet tjera parlamentare i Kuvendit tonë, në Raportin e tretë dhe të katërt për zbatimin e Planit të Veprimit brenda Kuvendi për Integritet Evropian, duke marrë parasysh të gjitha raportet e komisioneve, të gjitha raportet e zyrave dhe bordeve, ka kënaqësinë që të njoftojë për arritjet tona të përbashkëta në këtë sektor.

Kuvendi në këtë raport ka shënuar progres në një varg çështjesh, duke krijuar komisione pune, angazhime konkrete dhe miratim për reformën kushtetuese dhe zgjedhore si pjesë e kriterëve që Komisioni Evropian i ka bërë për Kosovën.

Dëgjimet publike të ministrave të linjës, raportimin e tyre, miratimin e legjislacionit të kërkuar sipas Raportit të Progresit 2011, mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve dhe kërkohet edhe më tutje të rriten kapacitetet për monitorim.

Komisionet parlamentare në progresin e arritur kanë paraparë që të rrisin mbikëqyrjen në zbatimin së paku të një ligji për kalendarin vjetor.

Bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile, Projekt-rregulloren e punës së Kuvendit, e cila ndodhet në shqyrtim në këtë Kuvend, projekti i binjakëzimit me programin e tij për mbështetjen e Kuvendit të Kosovës nga Parlamenti Kombëtar Hungarez, me financimin e BE-së, si dhe Kuvendi ka shqyrtuar dhe miratuar raporte vjetore, tremujore, periodike për shpenzimet e Kuvendit dhe raporte tjera të organeve të pavarura kushtetuese.

Megjithatë, progres të limituar apo progres, i cili nuk është arritur fare sa i përket sundimit të ligjit edhe më tutje mbetet sfida kryesore që përfshin veriun e Kosovës dhe funksionalizimin e sistemit gjyqësor, edhe pse ka pasur disa reforma, janë paralajmëruar reforma tjera në administratë publike, nuk është raportuar për progres sa i përket mbrojtjes së fëmijëve, deklarimit të pasurisë nga zyrtarët publikë. Nuk ka pasur raportim për statistikën ekonomike për vlerësimin gjithëpërfshirëse të gjendjes ekonomike e tjera.

Më lejoni që me statistika t'i paraqes numerikisht angazhimet dhe rolin tonë në këtë progres.

Në kriteret ekonomike nga 62 sfida të adresuara, janë realizuar 15. Në kriteret ekonomike nga 23 sfida të adresuara, kemi realizuar vetëm 4 dhe tek standardet evropiane, në kriteret e standardeve evropiane, nga 96 sfida janë realizuar 22 sfida.

Edhe më tutje është tregues i qartë se duhet angazhim serioz në realizimin e këtij angazhimi.

Atëherë, rekomandimi final i Komisionit për Integritet Evropian është që duhet të rishikohet roli i Kuvendit të Republikës së Kosovës në këtë agjendë. Meqë Kuvendi merr pjesë në të gjitha mekanizmat, institucionet që merren me integritet evropian, ne propozojmë që roli i Kuvendit, në të ardhmen, nga janari i vitit të ardhshëm, të jetë roli i mbikëqyrësit të zbatimit të planit nacional dhe planeve sektoriale për integritet evropian, duke rritur kapacitetet e komisioneve që të mbikëqyrin, të monitorohet dhe të kontrollohet puna e ekzekutivit si bartës i procesit të integritetit evropian.

Pjesëmarrja jonë në Këshillin nacional si Kuvend i Republikës dhe në mekanizmat tjerë, që përfshijnë dialogun ndërparlamentar me Parlamentin Evropian, përfshirjen dhe integritetin regional të Kuvendit, të komisioneve parlamentare dhe të autoriteteve tjera, është tregues i qartë që Kuvendi në këtë drejtim e ka rolin e vet.

Edhe raporti i fundit tregon për kapacitete të ulëta të mbikëqyrjes së ekzekutivit, mos monitorim i rregullt i punës së ministrave, sektorëve dhe agjencive të pavarura dhe problemeve që i ka adresuar edhe vetë Raporti i progresit.

Rishikimi i këtij roli dhe i agjendës evropiane do të bënte që të dallohen qartë angazhimet e institucioneve sipas detyrës kushtetuese.

Edhe më tutje ky Kuvend është peng i autonomisë buxhetore, i cili është kërkuar nga Komisioni Evropian. Duhet të definohet qartë çka nënkuptohet me autonomi buxhetore, cili është roli i Kuvendit si bartës i këtij institucioni dhe angazhimet konkrete në mënyrë që raporti financiar dhe roli ynë të përmirësohet.

Mbikëqyrja, si rol kryesor kushtetues i këtij Kuvendi, duhet të jetë e kënaqshme në mënyrë që t'i parandalojë abuzimet në formë të ndryshme që çdo ditë mund t'i shohim nga sektorët dhe nga organet tjera që janë jashtë Kuvendit të Kosovës.

Atëherë, duke kërkuar rritjen e kapaciteteve të shërbimit civil në Kuvend, rritjes së kapacitetit të komisioneve parlamentare, shpresoj shumë që më 10 dhjetor, ne do të arrijmë që së bashku me Komisionin Evropian, Kryesinë e Kuvendit të Republikës, kryetarët e komisioneve funksionale, ta adaptojmë planin e ri në rolin tonë dhe angazhimet konkrete që pritet të jenë jashtëzakonisht të mëdha që prej janarit të vitit të ardhshëm. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është te kryetarët e komisioneve parlamentare. Fjalën e ka kërkuar deputeti Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Puna që është bërë me raportin është punë voluminoze dhe normalisht kur ka punë voluminoze ka edhe mundësi më të mëdha të gabimeve edhe teknike. Unë e mora fjalën vetëm për të bërë disa korrigjime sa i përket punës së Komisionit për Legjislacion.

Vërejtjet e mia janë te pika 32 ku thuhet, raportimi i punës së Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme. Logjikisht do të duhej të ishte kështu që Komisioni për Legjislacion ta kishte këtë kompetencë dhe të merret me këtë punë, mirëpo Komisioni Funksional në kuadër të funksionit të Kuvendit, me vendim të Kryesisë është caktuar Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Tregti dhe Industri, është caktuar si Komision Funksional për Ligjin për Dhomën e Posaçme dhe si rezultat i kësaj edhe puna, e cila bëhet në këtë Dhomë duhet të referohet në këtë Komision.

Pika 40, sa i përket sigurisë në burgje, vlerësojmë se ka ndodhur një gabim, besoj që është teknik, nuk ka dalë e plotë përgjigja e Komisionit dhe është folur vetëm për Burgun e Sigurisë së Lartë, ndërsa mungojnë disa elemente tjera që janë: regjistrimi elektronik i të burgosurve; regjistri elektronik i produkteve në burgje dhe shumë elemente tjera, që besoj që mund të përmirësohen dhe është çështje teknike.

Pika 52, po ashtu është kërkuar nga Komisioni për Legjislacion përgjigje sa i përket respektimit të Ligjit për familjen dhe të shihet se si qëndron puna për dhunën në familje. Edhe kjo pikë nuk është kompetencë e Komisionit për Legjislacion, por është kompetencë e Komisionit për të Drejtat e Njeriut.

Si dhe në pikën 75, bëhet një referencë e gabuar sa i përket Komisionit për Legjislacion, thuhet me emërtimin e vjetër: Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi. Realisht, nuk quhet më ashtu dhe sipas Rregullores së punës është Komisioni për Legjislacion dhe Nën komisioni për Mandat, Imunitete dhe Rregullore të Punës.

Këto ishin vërejtjet teknike që i kisha unë dhe në përgjithësi, mendoj se Raporti është i mirë dhe besoj se zoti Haziri ka bërë punë të mirë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar, fjalën e ka deputetja Blerta Deliu-Kodra.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit kryesues!

Sot po e shqyrtojmë Raportin e tretë për zbatim të Planit të Veprimit të Kuvendit të Kosovës për Integritet Evropian, për vitin 2012. Në fillim, ajo që vërtet vlen të theksohet është fakti se viti që ne po e përmbylлим me plot të drejtë mund të quhet edhe vit i konkretizimit të agjendës evropiane të Kosovës. Me lansimin e procesit të studimit të fizibilitetit të Kosovës edhe zyrtarisht ka filluar procesi afatgjatë i anëtarësimit në Bashkimin Evropian, që nënkupton se Kosova tashmë është e gatshme të fillojë edhe negociatat për Marrëveshjen për Stabilizim- Asociim.

Në këtë rast, Republika e Kosovës do të jetë partner i barabartë me Bashkimin Evropian, sikurse të gjitha vendet e rajonit. Kosova ka arritur t'i tejkalojë shumicën e sfidave politike, ekonomike, si dhe standardet evropiane për fillim të negociatave për MSA-në dhe ky përbën një sukses të përbashkët të të gjitha institucioneve, por edhe të vetë qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Sa i përket plotësimit të kriterëve, do të thotë të katër kriterëve për fillim të negociatave për Marrëveshjen për Stabilizim-Asociim, përkatësisht sundimi i ligjit, mbrojtja e minoriteteve si dhe administrata publike dhe tregtia, mund të them se ka filluar intensifikim i punëve dhe janë shpërndarë pothuaj se të gjitha detyrat sa i përket këtyre katër kriterëve.

Në fushën e sundimit të ligjit, sistemi gjyqësor ka kaluar në një reformë, me ç'rast është mundësuar që në vitin 2013, të fillojë sistemi i ri i gjykatave e po ashtu këtu vlen të theksohet se me këtë rast janë rritur edhe pagat e gjykatësve dhe kanë siguruar edhe një profesionalizëm në kryerjen e punëve nëpër gjykata.

Sa i përket sfidës tjetër, unë mendoj se mbetet ende lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe kërkohet gjithashtu të miratohet legjislacioni për konfiskim të pasurisë së paluajtshme si dhe të rishikohet Ligji për parandalim të shpërndarjes së parasë dhe financim të terrorizmit dhe të miratohet po ashtu edhe strategjia kundër korrupsionit. Kur jemi te kjo e fundit, vlen të theksohet se dje Qeveria e Kosovës e ka miratuar strategjinë kundër korrupsionit, e cila këtyre ditëve pritet të vijë edhe në Kuvend për miratim.

Sa i përket fushës së respektimit të të drejtave të njeriut, mund të them se Kosova po zbaton standarde ndërkombëtare për respektimin e të drejtave të njeriut, edhe pse ka ende punë për t'u bërë në këtë drejtim.

Progres është shënuar edhe në reformën e Administratës Publike, duke e sjellë një formë moderne dhe evropiane të legjislacionit në fuqi.

Si sfidë mbetet edhe sigurimi i hapësirave për institucionin e Avokatit të Popullit dhe sigurimi i pavarësisë financiare të tij. Kur jemi te Avokati i Popullit, Komisioni për Integritet Evropian e ka pasur një takim me ministren Vlora Çitaku, e cila edhe një herë ka dëshmuar se do të përmbushen të gjitha kërkesat e institucionit të Avokatit të Popullit, duke siguruar një mundësi financiare, por edhe të gjitha kërkesat që ai të jetë i lirë ta bëjë punën e vet ashtu sikur duhet.

Sa i përket punës së Kuvendit, është kërkuar që të fuqizohet edhe roli i Kuvendit dhe të ngritën kapacitetet, siç e përmendi edhe zoti Haziri, e këto kapacitete veçanërisht te Departamenti për Çështje Ligjore dhe ato Procedurale, duke u shtuar edhe roli i tij mbikëqyrës ndaj Qeverisë.

Kur jemi te roli mbikëqyrës vlen të theksohet edhe raportimi i kryeministrit, zotit Thaçi, për dialogun, i cili ka shënuar një hap para në këtë drejtim. Legjislacioni zgjedhor është i

domosdoshëm t'i pasqyrojë më mirë praktikat më të mira të Bashkimit Evropian, e po ashtu edhe zbatimimi të jetë në pajtim me të gjitha standardet ndërkombëtare.

Ajo që duhet të thuhet është se raportimet e komisioneve të Kuvendit nuk kanë qenë gjithëpërfshirëse, nga të gjitha komisionet dhe këtu duhet gjithsesi të përmend e kam përmendur edhe një herë punën dhe efikasitetin që e ka treguar Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini dhe Administratë Lokale, me kryetar zotin Vehapi, i cili ka qenë vazhdimisht i përkushtuar që të raportojë në baza të rregullta te Komisioni për Integritet.

Dhe, fare në fund, dua të përshëndes dhe të falënderoj edhe zotin Haziri për punën e mirë që e ka bërë në krye të Komisionit për Integritet Evropian. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, fjalën e ka deputetja Vjosa Osmani.

VJOSA OSMANI: Faleminderit, kryesues!

Deputetët e LDK-së, po ashtu i japin përkrahje këtij raporti. Është evidente që numri i sfidave të zbatuara në krahasim me ato të pazbatuara në këtë tremujor është shumë më i madh dhe për nga numri kemi 181 sfida të adresuara, derisa mbesin vetëm 41 të pa adresuara, nga gjithsej 222 dhe besoj se kjo tregon po ashtu për përkushtimin e Kuvendit të Kosovës në këtë proces.

Megjithatë, mbesin disa sfida që ne si Kuvend duhet t'i përmendim qysh tani në mënyrë që t'i kushtojmë shumë më shumë rëndësi në tremujorin e ardhshëm. E para ka të bëjë me mbikëqyrjen e Kuvendit ndaj Qeverisë dhe unë do t'i jap vetëm dy shembuj, ku mendoj se komisionet e Kuvendit në tërësi duhet të jenë më të kujdesshme dhe të punojnë në mënyrë më intensive.

E para ka të bëjë me Ligjin për shërbimin civil. Ne të gjithë jemi të njoftuar që ka qindra raste të vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, të cilat nuk zbatohen nga Qeveria e Kosovës dhe në përgjithësi nga institucionet publike. Mendoj që këtu i takon pikërisht Kuvendit që ta ketë një rol më udhëheqës, që të insistohet që këto vendime të zbatohen nga ministrinë përkatëse.

Dhe e dyta, është shembulli Ministrisë së Administratës Publike dhe i rolit të saj në I-qeverisje apo qeverisje elektronike dhe kjo kryesisht do të zbatohet përmes Projektligjit për organet qeveritare për shoqëri të informacionit, projektligj ky që tani e kemi në Kuvend, mirëpo në qoftë se ai projektligj kalohet në Kuvend në formën e tanishme, domosdoshmërisht do të jetë në kundërshtim të plotë me parimin e ndarjes së pushteteve, sepse i lejon Ministrisë së Administratës Publike që të ndërhyjë në sistemin e informacionit dhe e-mail-at e të gjitha institucioneve tjera, qoftë gjyqësorit, qoftë Kuvendit, qoftë Presidencës, gjë që nuk lejohet në asnjë vend të Bashkimit Evropian dhe ne si deputetë nuk duhet ta lejojmë as vetë që të ndodhë një gjë e tillë.

E treta, është sikur që edhe e përmendi zoti Haziri, autonomia buxhetore e Kuvendit, një sfida që domosdoshmërisht duhet të merremi ne si Kuvend me të dhe jo të presim që

iniciativa të vijë nga Qeveria. Në shumicën e vendeve evropiane, që i kemi zbatuar, e kanë këtë parim dhe Kuvendi domosdo duhet të insistojë në mënyrë që t'i zhvillojë departamentet e veta që ta ketë këtë autonomi buxhetore.

Dy çështje të tjera kanë të bëjnë me raportet e komisioneve. E para është pika 30, ku flitet për Raportin e Këshillit Gjyqësor dhe Prokurorial ku thuhet se gjendja e gjykatave në veri të Mitrovicës është e pandryshueshme, i takon këtij Kuvendi që domosdoshmërisht të reagojë dhe të kërkojë nga Ministria e Punëve të Brendshme që t'i ofrohet siguri gjykatave.

Ministri i Punëve të Brendshme, zoti Rexhepi ka raportuar në këtë Kuvend, se arsyeja e vetme pse nuk i ofrohet siguri gjykatave apo gjykatësve dhe prokurorëve që të udhëtojnë për në veri, është për shkak se kurrë nuk është kërkuar një mbrojtje apo siguri e tillë, kështu që është me rëndësi që komisionet e Kuvendit të adresojnë këtë çështje dhe të kërkojnë nga Këshilli Gjyqësor që domosdoshmërisht një kërkesë të tillë t'ia dorëzojnë Ministrisë së Punëve të Brendshme, rrjedhimisht edhe Policisë.

Përfundimisht, te pika 44, flitet për raportin mbi zbatimin e rekomandimeve të Kuvendit. Deri tani komisionet e Kuvendit janë marrë në mënyrë shumë specifike me këtë punë vetëm me Ministrinë e Administratës Publike. Mirëpo, ka me dhjetëra rekomandime të Kuvendit që i kemi miratuar ne ndonjëherë edhe në mënyrë unanime, të cilat nuk zbatohen nga Qeveria, prandaj është koha e fundit që Kuvendi dhe të gjitha komisionet të merren me të gjitha rekomandimet e Kuvendit dhe të shikojnë zbatueshmërinë e tyre.

Kaq lidhur me analizën e këtij raporti. I ftojme deputetët që ta përkrahin dhe Lidhja Demokratike i jep përkrahje të plotë.

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes”, zonja Alma Lama e ka fjalën.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryesues!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” më lejoni të them që në fillim se unë propozoj dhe kërkoj që kur të vijë puna për të diskutuar raportin që e përgatit Komisioni për Integritet Evropian, është shumë e rëndësishme që të ndahet një seancë e veçantë, sepse ky është një raport që flet për punën dhe raportimin e të gjitha institucioneve, për mënyrën se si përmblidhen kërkesat e Komisionit Evropian në lidhje me vërejtjet e tyre.

Prandaj, kam vë re që shpesh ky lloj shqyrtimi lihet në fund të seancave, duke ia ulur rëndësinë dhe sigurisht duke i shkurtuar edhe kohën.

Ne këtu votojmë për mënyrën se si është raportuar, por sigurisht se nuk jemi të gjithë dakord për punën që është bërë, prandaj duhet ta bëjmë të qartë ndarjen mes këtyre dy gjërave. Pra, votojmë për mënyrën e raportimit, por jo për përmbajtjen e dokumentit. Sepse, në rast se flasim për përmbajtjen e dokumentit do të shohim se shumica e vërejtjeve të cilat kanë ardhur nga Raporti i Progresit, nuk kanë gjetur zbatim, ose nuk

janë përmbushur, ose janë përmbushur në një fazë embrionale, ose ka shumë demagogji, ka shumë fjalë, ujë si me thënë në raportim, mirëpo nuk ka veprime konkrete.

Janë të shumta vërejtjet që vijnë në këtë raport dhe natyrisht ne para pak kohësh patëm raportin e fizibilitetit, i cili ishte një skaner shumë i detajuar i gjendjes aktuale dhe nuk kemi, si të themi, që ky raport ka një përmbajtje pozitive përderisa e pamë se skaneri i fizibilitetit nuk ishte i tillë dhe aty u panë se sa pak janë plotësuar vërejtjet që erdhën një vit më parë.

Do të përmend disa shembuj, të cilët mendoj se duhet të zgjidhen. Ashtu siç tha edhe parafolësja nga LDK-ja, së pari është pavarësia e institucionit të Kuvendit, pavarësia financiare. Është shumë e rëndësishme që ne të hartojmë një ligj, e kam thënë edhe herë tjetër, një ligj në mënyrë që Kuvendi të caktojë vetë buxhetin e tij. Kuvendi aktualisht nuk e kontrollon ashtu, nuk e mbikëqyrë ashtu sikur se duhet Qeverinë, dhe për më tepër nuk mbikëqyr financat, mënyrën s si menaxhohen financat publike. Me një fjalë, Qeveria e Kosovës i shpenzon paratë si t'ia ketë qejfi.

Çështja tjetër, që është shumë e rëndësishme dhe që është vërejtja numër 23, në këtë dokument, sepse nuk dua të përsëris parafolësit, lidhet me reformën në administratën publike. Fare qartë thuhet, në këtë vërejtje se administrata publike ka ndërhyrje të mëdha politike. Pra, është krejtësisht e politizuar. Dhe me sa kemi informacion, sepse ne jemi në kontakt të përditshëm, nuk ka, absolutisht nuk është ndërmarrë asnjë masë për t'u përmirësuar kjo gjendje. Administrata vazhdon të jetë e okupuar, si me thënë, nga personat të cilët janë pjesë e partive politike, mirëpo masa të cilat jo vetëm do të shkurtinin numrin e administratës, por edhe do të vendosin njerëzit e duhur në vendin e duhur në bazë të ekspertizës së tyre, nuk ka pasur deri tani, përkundrazi, gjendja po vjen duke u përkeqësuar.

E njëjta çështje vazhdon të mbetet edhe në lidhje me korrupsionin. Korrupsioni vazhdon të jetë fenomeni numër një në institucionet e Kosovës dhe këtu natyrisht nuk mund të lëmë pa e përmendur rastin më të fundit dhe më skandaloz që ndodhi në Ministrinë e Brendshme, ku avulluan 1,4 milionë euro ose 10% i përfolur, ndonjëherë mund të jetë edhe 20%, e kësaj here ishte 10%. Pra, korrupsioni ndodh brenda institucioneve të Kosovës.

Ndërkohë që një vërejtje tjetër e këtij raporti lidhet me përmirësimin e punës së Policisë me prokurorinë. Pra, si mund të presim që Policia të përmirësojë punën me prokurorinë kur kemi rastin konkret që pikërisht Policia është e korruptuar dhe natyrisht se në raste të tilla është e paimagjinueshme të shohim se si mund të luftohet korrupsioni.

Vërejtjet në këtë dokument janë të shumta, mirëpo ajo që bie në sy është që zbatimi ose marrja në konsideratë për përmbushjen e tyre është shumë e pakët.

Natyrisht, ne si grup parlamentar, do ta votojmë, por për mënyrën e raportimit, pra për punën që bën Komisioni për Integritet Evropian, por edhe një herë dua të theksoj ndarjen. Ne absolutisht nuk pajtohemi me përmbushjen e këtyre standardeve të cilat

kërkohen nga Komisioni Evropian. Pra, është bërë shumë pak dhe po vazhdohet të bëhet shumë pak për sa i përket kësaj çështjeje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kryetari i Grupit Parlamentar të AAK-së, deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, edhe një herë, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Ne do ta mbështetim raportimin, mendojmë se është raportim korrekt. Po ashtu kemi qenë të informuar me kohë dhe me saktësi nga përfaqësuesi ynë në Komisionin për Integritet Evropian, zoti Shala.

Sidoqoftë, edhe unë dua të them se, edhe pse e votojmë raportin, edhe pse mendojmë se raporti është korrekt për të arriturat dhe për mangësitë, kurrësi nuk mund të jemi të kënaqur me të arriturat. Do të thotë janë çështje të ndara, siç tha edhe parafolësja, me goxha korrektësi. Janë dy çështja të ndara, ajo se a e votojmë raportin dhe se a jemi të kënaqur me të arriturat në këtë drejtim?

Sidoqoftë, them edhe një herë, po do ta votojmë raportin, mirëpo duhet të shpresojmë se në të ardhmen të mos votohet vetëm raporti, por të jemi të kënaqur edhe me të arriturat. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, fjalën e ka kryetarja e Grupit, Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Koalicioni për Kosovë të Re, e ka shqyrtuar planin e raportimit të Komisionit për Integritet - Raporti i tretë për zbatimin e Planit të Veprimit të Kuvendit të Kosovës për vitin 2012, ku paraqiten sfidat e adresuara në aspektin politik e ekonomik dhe në aspekte tjera. Mirëpo, mund të themi se Komisioni për Integritet e ka bërë një përmbledhje shumë të mirë, por në esencë mbetet akoma të punojë edhe Kuvendi, edhe Qeveria dhe të gjithë, që të kemi një gjendje ndryshe faktike në terren.

Raporti, si raport është nxjerrë mirë, në bazë të gjitha komisioneve parlamentare dhe sfidave të cilat i përket dhe ne mund të përgëzojmë Komisionin për Integritet dhe të gjithë deputetët aty për punën e tyre, mirëpo mbetet që të punojmë edhe në të ardhmen.

Koalicioni për Kosovë të Re, e përkrah Raportin e tretë për zbatimin e Planit të Veprimit të Kuvendit të Kosovës për Integritet Evropian.

KRYESUESI: Faleminderit! SLS, nuk ka të lajmëruar. Grupi Parlamentar “6+”, Albert Kinolli.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar “6+” e ka shqyrtuar Raportin e tretë për zbatimin e Planit të Veprimit të Kuvendit të Kosovës për Integritet Evropian.

Mendojmë se ka pasur progres, mirëpo ka pasur edhe ngecje dhe pa dashur t' i përsëris ato që i thanë veç i ngritën këto çështje kolegët e mi të nderuar, sidomos nga Komisioni për Integritet Evropian, me të cilat ne pajtohemi plotësisht, ne si Grupi Parlamentar 6+ do të votojmë për këtë plan të veprimit të Kuvendit të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Halit Krasniqi.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryesues!

Unë nuk dua të përsëris mendimet e kolegëve që i dëgjova për raportin dhe do të fokusohem për sentitizimin e gjithë asaj që dëgjova me një fjalë, jo edhe aq ndoshta të shkurtër, që ishte kënaqësi t'i dëgjoje grupet parlamentare me një gjuhë, me një unitet dhe me një sens që u manifestua për këtë raport dhe ky është një vullnet që do të duhej të reflektojë edhe në të gjitha temat, jo vetëm për integritetin e Kosovës, ku synojmë, në BE, por edhe për konsolidimin e institucioneve të saj të brishta në konsolidim, në formim e sipër.

Edhe në të ardhmen, në të gjitha temat, do të duhej të karakterizojë këtë Kuvend, kjo frymë dhe ky unitet që e karakterizoi sot në lidhje me raportin e tretë për zbatimin e Planit të Veprimit për Integritet Evropian të vitit 2013. Faleminderit, kryesues!

KRYESUESI: Faleminderit! A e dëshiron fjalën kryetari i Komisionit, Lutfi Haziri? Jo. Vazhdojmë me votimin e Raportit të tretë për zbatimin e Planit të Veprimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, për Integritet Evropian për vitin 2012, me rekomandime.

Në mbledhje janë të pranishëm 64 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se me 55 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi Raportin e tretë për zbatimin e Planit të Veprimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës për Integritet Evropian për vitin 2012.

Fjalën e ka kërkuar në emër të Grupit Parlamentar të "Vetëvendosjes", deputeti Liburn Aliu.

LIBURN ALIU: Faleminderit, kryesues!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes "Vetëvendosje", bazuar në nenin 49 të Rregullores së Kuvendit të Kosovës, në lidhje me shqyrtimin e çështjeve urgjente, kërkoj që në vazhdim të seancës, ose pas një pauze, të diskutohet çështja e asaj çka aktualisht po ndodh në veriun e vendit. Pra, e kemi një eskalim të situatës atje, me ç'rast kemi një mobilizim të mbrojtjes civile dhe ka eskalim të dhunshëm të gjendjes atje. Nga mediet kemi informatat që ka pasur edhe ndërhyrje të ROSU-s në pjesën veriore e po ashtu ka pasur njëkohësisht edhe tërheqje të njësiteve të ROSU-s. Kjo tregon që situata, gjendja e sigurisë së qytetarëve në veri të vendit është në rrezik dhe mendoj se kjo është çështje urgjente që do të duhej të diskutohej dhe me këtë rast do të duhej që ministri i Punëve të Brendshme të jetë këtu dhe të na raportoj, të na njoftoj mbi gjendjen, mbi situatën në veri.

Unë pra, kërkoj që të hidhet një votim një gjë e tillë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Dëgjuam propozimin e Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes”. Në sallë janë 69 deputetë.

Neni 49 i Rregullores lidhur me shqyrtimin e çështjeve urgjente në Kuvend thotë se kryetari i Kuvendit i mundëson deputetit të propozojë në Kuvend, por propozimi i tij vihet në votim. Nëse Kuvendi me votim vendos ta marrë çështjen parasysh, çështja radhitet në rendin e ditës së mbledhjes.

Prandaj, vihet në votim kërkesa e Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes”. Adem Grabovci e ka fjalën, në emër të PDK-së.

ADEM GRABOVCI: Kolegë të nderuar,
Çështja e veriut është preokupimi më i madh për çdo qytetar të Kosovës, dhe jo vetëm për qytetarët e Kosovës por lirisht mund të them me përgjegjësi të plotë se është preokupim dhe shqetësim i një shkalle shumë më të lartë, është shqetësim edhe për rajonin. Me veriun nuk jemi duke u marrë vetëm institucionet e vendit tonë, por janë duke u marrë edhe në bashkëpunim me BE-në, me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me të gjitha vendet liridashëse a paqedashëse që e dëshirojnë sigurinë për çdo qytetar të vendit.

Unë kam informacione të sakta se ministri është në terren dhe situata është në kontroll dhe ne nuk e shohim të drejtë që sot të diskutohet për këtë çështje. Për të diskutuar për këtë çështje ne duhet të konsultohemi dhe koordinohemi me të gjithë faktorët relevantë, qofshin ata vendorë, qofshin ata ndërkombëtarë, me qëllim të ecjes përpara dhe jo të marrim një vendim të papeshuar mirë, i cili mund të jetë me pasoja të rënda, jo vetëm për vendin tonë, por edhe për krejt rajonin.

Prandaj, ne u bëjmë thirrje të gjitha institucioneve, qofshin ato vendore, qofshin ato ndërkombëtare, le të koordinojnë, le të jenë aktivë, le të japin kontributin e vet atje dhe ne normalisht se jemi në mbështetje të gjitha vendimeve që i marrin përfaqësuesit tanë institucional, qofshin Qeveria, qofshin të tjerët. Prandaj ne jemi kundër që në këtë moment të debatohet për këtë çështje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Arben Gashi, në emër të LDK-së.

ARBEN GASHI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, mendoj se është me interes që qytetarët e Kosovës të jenë të informuar për atë çfarë po ndodh, mirëpo në të njëjtën kohë duhet të balancojmë e të shohim se çka është realisht situata. Ministri i Punëve të Brendshme, kryeministri dhe presidenti i vendit kanë për detyrë kushtetuese që të jenë në krye të detyrës dhe në krye të detyrës do të thotë se ata duhet të përgjigjen se çka po ndodhë në pjesën e veriut të Kosovës, por në të njëjtën kohë duhet të jenë të pranishëm mundësisht dhe sa më afër vendngjarjes.

Në këtë rast, unë mendoj se duhet të ketë koordinim më të madh mes grupeve parlamentare, Kryesisë së Kuvendit dhe në momentin më të mirë të mundshëm, kur të krijohen rrethanat të diskutohet dhe informohet edhe Kuvendi edhe qytetarët e Kosovës se çka po ndodh.

Mendoj se ne si Kuvend është me interes t'i drejtohem kryeministrit të vendit, presidentit të vendit e po ashtu edhe ministrit që t'i kryejnë detyrat e tyre kushtetuese dhe në këtë rast përkrahja jonë është që t'i kryejnë detyrat kushtetuese dhe në momentin më të mirë të mundshëm në interes të vihet dhe raportohet në Kuvend dhe mendoj se duhet të mbetet e hapur çështja që të koordinohen të gjitha grupet parlamentare dhe Kryesia e Kuvendit e të diskutohet për këtë punë në momentin më të mirë të mundshëm.

Unë nuk po them se nuk është momenti më i mirë i mundshëm tani, mirëpo mendoj se duhet të ketë koordinim sepse ne nuk kemi shumë informacion se ku ndodhet ministri dhe kryeministri, ku ndodhet presidentja dhe strukturat tjera që duhet ta respektojnë kushtetutën dhe kushtetutshmërinë në këtë vend. Prandaj, mendoj se duhet të marrim kohë pak më shumë dhe të mos reagojmë në efekt.

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, ne shprehim gatishmërinë që kurdo është Kuvendi i gatshëm që të mblidhet e diskutojë për këtë çështje dhe të përkrahë institucionet e vendit, jemi të gatshëm të vijmë. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Në emër të Grupit të AAK-së, kryetari Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Falemnderit, zoti nënkryetar!

Mendojmë se është jashtëzakonisht legjitime brenga, por po ashtu duhet shtuar se informacionet të cilat ne si deputetë i kemi në këtë moment, janë shumë të pakta, për të mos thënë gati se nuk kemi informacione reale, përpos asaj që po shkruhet shpejt e shpejt nëpër portale.

Çështje tjetër është se instrumenti të cilin e posedon Kuvendi tani e që është debati dhe kërkesat eksplicite të drejtuara ndaj Qeverisë dhe institucioneve tjera të Kosovës, nuk do të ndikojnë drejtpërdrejt në situatë tani për tani.

Unë propozoj që kryetarët e grupeve parlamentare dhe Kryesia e Kuvendit të jenë në koordinim të vazhdueshëm dhe nëse është nevoja nesër të mblidhet Kuvendi, nëse e shohim të nevojshme të debatojmë. Të debatojmë tani për tani mendojmë se Kuvendi do ta shfrytëzojë një instrument i cili nuk mund të ndihmojë realisht për shkak se edhe një herë po ju them këta deputetë që jemi këtu në sallë nuk dimë diçka më tepër dhe nuk mund t'i sjellim zyrtarët e Qeverisë, të cilët po duket se vetëm janë jashtë.

Mendoj se sot nuk kemi kurrfarë kushte për të debatuar, mirëpo kërkoj që të jemi në konsultime që nesër në mëngjes nëse e shohim të arsyeshme të mblidhet Kuvendi edhe një herë dhe të debatojmë. Falemnderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kryetarja e Grupit Parlamentar të KKR-së, Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Edhe Koalicioni për Kosovë të Re shpreh shqetësimet në lidhje me gjendjen në pjesën e veriut të Kosovës, mirëpo tani për tani s'kemi informacione. Dhe në rast se duhet të zbatohet Kushtetuta e ligjet e Kosovës, atëherë është presidentja e para e shtetit, kryeministri dhe ministri i Punëve të Brendshme të cilët në bazë të informacioneve të zotit Grabovcit, gjenden në terren, atëherë i gjithë debati kam frikë që s'mund të aludojë aty ku mund t'u ndihmojmë atyre njerëzve në pjesën e veriut të Kosovës, mirëpo prapëseprapë pajtohem me shefin e Grupit të AAK-së që nëse është e nevojë, ditën e nesërme Kryesia e Kuvendit, së bashku me shefat e grupeve parlamentare dhe në konkluzion me Qeverinë, që të mos debatohet kot, por të dihet çka ka ndodhur gjendja faktike në veri, atëherë të japim sugjerime e këshillat tona për Qeverinë apo edhe t'u ndihmojmë atyre njerëzve në rast se është gjendja aq alarmante.

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të SLS, fjalën e ka Sasha Milosavljeviq.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hala, predsedavajući!

I mi se slažemo da je ovo veoma važno pitanje o kome treba raspravljati ovde u Parlamentu, ali isto mislimo da sada nije pravi trenutak i da ne bi trebali danas da raspravljamo o tome. Hvala!

KRYESUESI: “6+” Parlamenter Grup adına Grup Başkanı Sayın, Müferra Şinik.

MÜFERRA ŞİNİK: Teşekkür ederim sayın başkan vekili, Kosova Kuzeyindeki durumun ne denli önemli ve acil olduğunu Başbakan, Cumhurbaşkanı ve Kosova vatandaşlarına kadar sade vatandaşın bile farkında olduğunu hepimiz bilmekteyiz. Ancak bu durumun bugün Kosova Meclisi'nde tartışılmasından yana değiliz.

Bu yüzden “6+” Parlamenter Grubu, bu tartışmanın bugün olmamasından yanadır. Teşekkür ederim!

KRYESUESI: Teşekkür! I dėgjuam kryetarët e grupeve parlamentare, dhe sipas nenit 49 të Rregullores së Kuvendit, unë e vë në votim propozimin e Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, me ngritje dore.

(Sugjerime)

Me elektronikë, po janë paraqitur edhe folës tjerë, por këtë e përcakton votimi. Pra, sipas nenit 49, shefat e grupeve janë deklaruar dhe jemi në procedurë për votim. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim.

Kush është për propozimin e Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes”?

Do të votojmë në mënyrë elektronike. Atëherë, lus regjinë dhe deputetët të votojnë tani.

(Ndërhyrje)

Po, e dëgjuam propozimin e Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes” dhe lidhur me nenin 49, shqyrtimi i çështjeve urgjente, dhe për këtë sipas Rregullores, unë e hedh propozimin e Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes” në votim.

Regjia, ju lus të përgatitemi për votim. Votojmë tash!

Në sallë janë të pranishëm 80 deputetë.

Kanë votuar 50 kundër, 15 për dhe asnjë abstenim dhe nuk kalon propozimi.
Faleminderit!

E përgatiti:

Njësia për Transkriptim dhe Lekturë